



INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË

RAPORTI I SHITATË VJETOR

2006–2007

drejtuar

Kuvendit të Kosovës

11 korrik 2007

Telefoni: ++381 38 545 303

Telefaksi: ++381 38 545 302

e-mail: ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org

web faqja: www.ombudspersonkosovo.org

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	4
HYRJE	6
PREZANTIM I INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT	6
MANDATI I INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT.....	7
USHTRUESI I DETYRËS SË OMBUDSPERSONIT.....	8
ZËVENDËSI I OMBUDSPERSONIT.....	9
QASJA PUBLIKE NË INSTITUCIONIN E OMBUDSPERSONIT.....	10
PËRZGJEDHJE E ÇËSHTJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË -----	12
ASPEKTE TË PËRGJITHSHME.....	12
ZHVILLIMET NË SEKTORIN LIGJOR.....	13
GJYQËSORI NË KOSOVË.....	21
PAPËRSHTATSHMËRIA E MEKANIZMAVE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË DHE ROLI I OMBUDSPERSONIT	28
KOMUNITETET MINORITARE NË KOSOVË.....	35
GJENDJA E PERSONAVE TË ZHVENDOSUR DHE KUSHTET PËR KTHIMIN E TYRE	43
ÇËSHTJET PRONËSORE DHE TË BANIMIT.....	52
TË DREJTAT E FËMIJËVE NË KOSOVË.....	59
DISKRIMINIMI NË KOSOVË.....	68
BARAZIA GJINORE NË KOSOVË.....	72
AKTIVITETET E INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT -----	78
HETIMET, AVOKIMET & NDËRHYRJET.....	78
EKZAMINIMI I LEGJISLACIONIT.....	79
AKTIVITETET E GRUPEVE TË VEÇANTA TË INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT	79
<i>Aktivitetet e grupit për të drejtat e fëmijëve</i>	80
<i>Aktivitetet e Grupit për Mos-Diskriminim</i>	82
<i>Aktivitetet e Njësisë për Barazi Gjinore</i>	84
BASHKËPUNIMI ME BASHKËSINË NDËRKOMBËTARE	86
BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE.....	88
BASHKËPUNIMI ME OJQ-TË VENDORE.....	89
MËSIMI PRAKTIK.....	89
MARRËDHËNIET ME MEDIA DHE NGRITJA E NJOHURIVE.....	90
BASHKËPUNIMI DHE NDËRTIMI I KAPACITETEVE	91
<i>Bashkëpunimi: Konferencat, seminarët dhe punëtoritë</i>	92
<i>Ndërtimi i kapaciteteve: Vizitat studimore dhe trajnimet</i>	95
KONFERENCA E OMBUDSMANËVE TË RAJONIT.....	97
E ARDHMJIA FINANCIARE E INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT.....	98
PËRKRAHJA FINANCIARE DHE NË TË MIRA	99
PËRMBLEDHJA E RASTEVE DHE STATISTIKAVE -----	103
PËRMBLEDHJA E RASTEVE.....	103
MASAT E PËRKOSSHME DHE RAPORTET.....	103
PËRMBLEDHJA STATISTIKORE E RASTEVE.....	104
SHTOJCA I: PËRMBLEDHJET E RAPORTEVE -----	106
SHTOJCA II: PËRMBLEDHJE TË MASAVE TË PËRKOHËSHME -----	122
SHTOJCA III: PËRMBLEDHJEVE TË LETRAVE TË PËRZGJEDHURA INTERVENUESE ---	123

<u>SHTOJCA IV: REKOMADIMET E PËRBASHKËTA NGA PJESËMARRËSIT E</u> <u>KONFERENCËS SË OMBUDSMANËVE TË RAJONIT (8-9 QERSHOR 2007)-----</u>	<u>149</u>
<u>SHTOJCA V: SKEMAT ORGANIZATIVE TE INSTITUCIONIT TE OMBUDSPERSONIT---</u>	<u>155</u>
<u>SHTOJCA VI: LISTA E PUNONJËSVE-----</u>	<u>157</u>
<u>SHTOJCA VII: LISTA E SHKURTESAVE-----</u>	<u>159</u>

PARATHËNIE

Është privilegj i veçantë të punohet në mbrojtjen e të drejtave të të gjithë kosovarëve gjatë kësaj periudhe historike për Kosovën. Ky privilegj bëhet edhe më i rëndësishëm kur të merret parasysh që Institucioni i Ombudspersonit është jo vetëm mekanizmi prijës i Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por edhe instrumenti kyç për konsolidimin e sundimit të ligjit brenda demokracisë tonë.

Ky vit ka qenë padyshim edhe një vit tjetër i mbushur me sfida për Institucionin e Ombudspersonit. Administrata ndërkombëtare vazhdon të veprojë jashtë mandatit të Ombudspersonit. Kuvendi i Kosovës ende nuk e ka emëruar Ombudspersonin dhe ende nuk është miratuar legjislacioni i Kuvendit i paraparë për ta forcuar rolin e Institucionit të Ombudspersonit.

Ky është Raporti i shtatë vjetor që po publikohet që nga themelimi i Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë në vitin 2000, dhe i dyti që po i drejtohet drejtpërdrejt Kuvendit pas largimit të Ombudspersonit ndërkombëtar.

Në këtë raport do të gjeni përshkrimin dhe vlerësimin e situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë. Shpresoj që Kuvendi do t'ia kushtojë vëmendjen e duhur gjetjeve të këtij raporti dhe do ta përdorë atë si bazë për të zhvilluar politika më efektive për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.

Derisa gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet ka pasur arritje të caktuara lidhur me themelimin e një kornize të duhur ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ende ka probleme në zbatimin efikas të sundimit të ligjit. Kjo situatë nuk duket që do të ndryshojë derisa autoritetet të mos e forcojnë zotimin e tyre për ndërtimin e një shoqërie plotësisht demokratike, një zotim që unë e konsideroj të jetë thelbësor për të ardhmen e të gjithë kosovarëve.

Gjyqësori do të duhej të jetë shtylla e çdo demokracie të lirë dhe të fuqishme, mirëpo sistemi gjyqësor i Kosovës ende shikohet me mosbesim nga vetë njerëzit që do të duhej t'i shërbejë. Në mënyrë të ngjashme, dega ekzekutive e IPVQ-ve ende karakterizohet me papërgjegjësi dhe mungesë të dedikimit ndaj procesit të hapur dhe përgjegjës të vendimmarrjes.

Nëse statusi i pazgjidhur i Kosovës mund të shihet si një mozaik, atëherë (mos)funksionimi i tri shtyllave të përshkruara më lart e ka krijuar një ndjenjë të mungesës së pjesëve kryesore të tij. Për ta përfunduar atë, autoritetet dhe gjykatat duhet të ikin nga retorika politike dhe t'i dedikohen ballafaqimit me sfidat me të cilat përballen njëherazi edhe të gjithë kosovarët. Këto sfida përfshijnë rindërtimin e besimit mes komuniteteve dhe luftën kundër varfërisë, krimit të organizuar, diskriminimit dhe dhunës.

Tejkalimi i këtyre sfidave kërkon vetëm politika të freskëta, guximtare dhe të qëndrueshme nga autoritetet. Përfundimi i mozaikut dhe të garantuarit e respektimit të sundimit të ligjit në vend, në anën tjetër, kërkon dedikimin e tyre.

Hilmi Jashari

Ushtrues i Detyrës së Ombudspersonit

HYRJE

Ky raport vjetor është publikuar në pajtim me nenin 16.1 të Rregullores Nr. 2006/06 të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë, dhe rregullën 16 të Rregullave Procedurale të Institucionit të Ombudspersonit.

Raporti i shtatë vjetor mbulon vitin e gjashtë të plotë të veprimeve të Institucionit, nga 1 korriku 2006 deri më 30 qershor 2007. Ky raport përmban tri pjesë kryesore. Pjesa e parë është një prezantim i Institucionit të Ombudspersonit, punonjësve të tij dhe punës së tij. Pjesa e dytë përmban një analizë të çështjeve të të drejtave të njeriut në Kosovë nga këndvështrimi i Ombudspersonit. Pjesa e tretë përshkruan aktivitetet dhe veprimet e Institucionit të Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet.

Prezantim i Institucionit të Ombudspersonit

Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës është themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/38, kështu që u krijua një institucion i pavarur i cili ka mandat të shqyrtojë çështjet që kanë të bëjnë me shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut apo keqpërdorim të autorizimeve nga administrata ndërkombëtare dhe ajo publike vendore në Kosovë. Institucioni i Ombudspersonit është hapur zyrtarisht më 21 nëntor 2000 në Prishtinë. Në fillim të punës së tij kishte 18 punonjës dhe në atë kohë të gjithë punonjësit e lartë ishin ndërkombëtarë. Me zgjerimin e institucionit dhe me hapjen e zyrave regjionale, numri i punonjësve gradualisht u rrit në 50 dhe gradualisht punonjësit ndërkombëtarë u zëvendësuan nga punonjësit vendorë. Që nga themelimi i hershëm, stafi i Institucionit të Ombudspersonit ka qenë multietnik; sot, shumica e punonjësve është e përkatësisë etnike shqiptare, kurse pjesa tjetër janë të përkatësisë serbe, turke dhe rome. Nga mesi i vitit 2003 deri në dhjetor 2005, Institucioni udhëhiqej nga një Ombudsperson ndërkombëtar, ndërsa dy zëvendësit e tij, një ekip juristësh për të drejtat e njeriut dhe punonjësit përkrahës administrativ ishin kosovarë. Në dhjetor të vitit 2005, Ombudspersoni ndërkombëtar u largua dhe një nga zëvendësit e tij u emërua Ushtues i Detyrës së Ombudspersonit deri në emërimin e një Ombudspersoni të ri.

Në muajin shkurt 2006, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara (PSSP), shpalli Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit me të cilën zëvendësoi Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/38. Sipas kësaj rregulloreje të re Institucioni i Ombudspersonit ende ka mandat që të hetojë ankesa kundër autoriteteve lokale apo organeve tjera të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (IPVQ), por nuk ka më mandat që të hetojë ankesa kundër UNMIK-ut. Gjuhët e punës së këtij Institucioni që më herët ishin gjuha angleze, shqipe dhe serbe, tani janë gjuha shqipe dhe serbe.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/06 po ashtu parasheh një strukturë të re organizative: në vend të Ombudspersonit ndërkombëtar dhe dy zëvendësve të tij, tani udhëheqësia e Institucionit përbëhet nga një Ombudsperson vendor, një Zëvendës Kryesor i Ombudspersonit dhe tre zëvendës të tjerë të Ombudspersonit, ku të gjithë duhet të emërohen nga Kuvendi i Kosovës. Sipas raundit të parë të votimit të pasuksesshëm në dhjetor 2006, kjo Rregullore tani është zëvendësuar me Rregulloren UNMIK-ut Nr. 2007/15 e cila thjeshtësoi procedurën e emërimit të Ombudspersonit të ri. Më 22 Qershor 2007, Kuvendi i Kosovës aprovoi amendamentet e Rregullës Procedurale për Emërimin e Ombudspersonit dhe Zëvendës Ombudspersonave, dhe më 28 Qershor 2007 publikoi konkurs të ri për pozitën e Ombudspersonit. Pritet që Ombudspersoni i ri të emërohet nga Kuvendi i Kosovës dhe që eventualisht ai/ajo të pranojë funksionin deri kah fundi i vitit 2007.

Mandati i Institucionit të Ombudspersonit

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/38 dhe Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2006/06 i dhanë një mandat Ombudspersonit që të pranojë dhe hetojë ankesa nga çdo person në Kosovë që beson se të drejtat e saj/tij i janë shkelur nga ndonjë autoritet publik lokal në Kosovë. Institucioni zhvillon hetime, publikon raporte dhe ofron shërbime juridike dhe avokim publik. Të gjitha shërbimet kryhen falas. Nëse hetuesit e Institucionit gjejnë së ka shkelje të të drejtave të njeriut, përfaqësuesit udhëheqës të Institucionit mund të kërkojnë zgjidhje përmes kanaleve të ndryshme. Ata mund të kërkojnë informacione plotësuese nga autoritetet publike, rekomandojnë veprime për autoritetet lokale, publikojnë raporte, apo të ngritin brengat e tyre pranë mediave. Në rastet që kanë të bëjnë me ankesat e kosovarëve drejtuar autoriteteve publike jashtë Kosovës, Institucioni i Ombudspersonit mund të ofrojë shërbimet e tij të mira ose mund t'i përcjellë ato raste te Ombudsmani kompetent vendor ose ndonjë institucion tjetër i natyrës së njëjtë në shtetin përkatës.

Institucioni i Ombudspersonit ka kompetencë që të veprojë në mënyrë të pavarur kur pranon informata dhe mund të hapë hetime në mungesë të ankesës individuale (të ashtuquajturat “hetime *ex officio* apo hetimet sipas detyrës zyrtare). Institucioni ka mandat për të monitoruar politikat dhe ligjet e aprovuara nga ana e autoriteteve vendore për të siguruar që ato i respektojnë standardet e të drejtave të njeriut dhe kërkesat e qeverisjes së mirë. Në rastet kur Institucioni i Ombudspersonit konsideron që një praktikë ose situatë e përgjithshme ndikon jo vetëm në një individ ose një grup të tyre por në tërë qytetarët si tërësi dhe në të njëjtën kohë nuk është në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ai do të nxjerrë një raport special, i cili do të përfshijë rekomandimet drejtuar Kuvendit të Kosovës.

Në mënyrë që të përqendrohet në çështjet e veçanta të disa grupeve të cënueshme të njerëzve, në veçanti fëmijëve, grave dhe minoriteteve, Institucioni i Ombudspersonit ka formuar tri grupe të posaçme juristësh: Grupin për të Drejtat e Fëmijëve (GDF), Njësinë për Barazi Gjinore (NjBGj) dhe Grupin për Mos-diskriminim (GMD).

Ndonëse monitoron pajtueshmërinë e gjyqësorit me standardet e të drejtave të njeriut, Institucioni i Ombudspersoni nuk zëvendëson gjykatën dhe nuk mundet që në mënyrë të drejtpërdrejtë të hetojë krimet, ndryshojë aktvendimet e gjykatës apo të lëshojë vendime detyruese. Institucioni i Ombudspersonit nuk merret me kontestet mes personave privat dhe, siç u përmend më lartë, nuk ka juridiksion as mbi UNMIK-un e as mbi KFOR-in, forcën ushtarake përgjegjëse për siguri në territorin e Kosovës.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/38 mbi Themelimin e Institucionit të Ombudspersonit të Kosovës dhe tjerat që pasuan kanë përcaktuar vlerat dhe parimet mbi të cilat vepron ky Institucion. Si për çdo institucion të pavarur vlerat dhe parimet më të rëndësishme në këtë aspekt janë pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti. Angazhimet dhe sfidat me të cilat është ballafaquar Institucioni i Ombudspersonit të Kosovës, gjatë periudhës së kaluar gjashtë vjeçare, kanë treguar se ne i kemi implementuar këto vlera dhe parime, të cilat në fakt janë edhe standarde që ndihmojnë të bëhet vlerësimi i punës së këtij institucioni kudo që ky institucion ekziston në botë.

Sfida kryesore e Institucionit të Ombudspersonit është fakti që, përmes angazhimeve dhe veprimeve të tij, ka për qëllim të ndikojë dhe balancojë raportin mes administratës publike dhe njerëzve të cilëve ajo mëton t'u shërbejë. Në këtë kontest një nga objektivat e tij kryesore është të zhvillojë atë që quhet kultura e qeverisjes së mirë, që do të thotë administrim i mirë, transparencë dhe llogaridhënie e administratës publike para publikut te gjerë, si dhe forcim i përgjithshëm i sundimit të ligjit.

Ekzistimi i Institucionit të Ombudspersonit përgjithësisht ka një ndikim pozitiv në administratë, së paku vetëm për arsyen e thjeshtë se kjo e fundit e kupton se është një palë e tretë që e vëzhgon performancën e saj në raport me qytetarin. Nga ky aspekt, sa më shumë që Institucioni i Ombudspersonit punon dhe angazhohet, aq më shumë njerëzit kuptojnë që ata mund t'i parashirojnë ankesat e tyre në këtë Institucion përmes një procedure të thjeshtë dhe e cila është falas. Ankesat e tilla mund të jenë veprime apo vendime të administratës, që ankuesit i konsiderojnë të padrejta ose të pafavorshme për ta, apo mungesa e veprimeve nga administrata, apo madje edhe drejtësia e procedurave gjyqësore. Kur pranohen ankuesit apo vizitorët e përditshëm, veprimet e Institucionit të Ombudspersonit përfshijnë: këshillë juridike, marrjen e informatave nga departamente të ndryshme të administratës publike, gjykatat dhe institucionet tjera publike, monitorimin e procedurave të caktuara si dhe informimin e administratës mbi ngjarje të ndryshme dhe papajtueshmërinë e tyre me ligjin e aplikueshëm në Kosovë. Në rastet e rralla urgjente, Institucioni i Ombudspersonit mund të publikojë kërkesa për masa të përkohshme. Lloji i veprimit dhe metoda e aplikuar zakonisht do të ndryshojë varësisht nga rrethanat e secilit rast individual.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit

Pas largimit të Ombudspersonit ndërkombëtar z. Marek Antoni Nowicki në Dhjetor 2005 dhe pas miratimit të Rregullores së re të UNMIK-ut mbi Ombudspersonin vendor, procedurat e emërimit për Ombudspersonin e ri aktualisht janë ende në pritje në

Kuvendin e Kosovës. Përderisa të emërohet Ombudspersoni tjetër, një nga zëvendësit e Ombudspersonit aktual, z. Hilmi Jashari, është duke ushtruar detyrën e Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit njëkohësisht me detyrat e tij të Zëvendësit të Ombudspersonit.

Z. Hilmi Jashari ka lindur në vitin 1969 në Mazgit, në Kosovën Qendrore. Z. Jashari diplomoi në Fakultetin Juridik në Prishtinë më 1993 dhe filloi të punojë si sekretar i Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Obiliq, në organizatën më të madhe jo-qeveritare në Kosovë. Pas vitit 1994, ishte i përfshirë në aktivitetet e shoqatave të ndryshme shqiptare jashtë vendit. Mes viteve 1996 – 1998, z. Jashari punoi si asistent ligjor në zyrën e një avokati në Prishtinë.

Ai është duke punuar në Institucionin e Ombudspersonit qysh prej muajit tetor të vitit 2000, ku kishte filluar jurist dhe në muajin korrik 2001 është caktuar Drejtor i Hetimeve. Më 14 mars 2004, ai emërohet si Zëvendës Ombudsperson nga z. Harri Holkeri, PSSP në atë kohë. Mandati i tij është zgjatuar nga z. Søren Jessen-Petersen, PSSP, më 15 korrik 2005.

Sipas një vendimi nga z. Søren Jessen-Petersen me datë 1 Janar 2006, z. Jashari u emërua Ushtrues i Detyrës së Ombudspersonit.

Zëvendësi i Ombudspersonit

Zëvendës Ombudspersoni i ndihmon Ushtruesit të detyrës së Ombudspersonit në drejtimin e punës së Institucionit të Ombudspersonit dhe e zëvendëson në mungesë të tij.

Z. Ljubinko Todorović, Zëvendës Ombudsperson, ka lindur në vitin 1951 në Graçanicë. Ai është emëruar Zëvendës i Ombudspersonit më 15 shtator 2000 nga z. Berndard Kouchner, PSSP në atë kohë. Posti i tij si Zëvendës i Ombudspersonit është zgjatuar disa herë, kurse herën e fundit më 11 Janar 2006 nga z. Søren Jessen-Petersen, PSSP i mëparshëm.

Z. Todorović diplomoi në Fakultetin Juridik në Prishtinë më 1981. Më 1991, ai dha provimin e jurisprudencës. Ai tashmë ka punuar në profesione të ndryshme. Mes tjerash, z. Todorović ka qenë përfshirë si ligjor i një korporate, inspektor pune dhe avokat publik i vetëqeverisjes për Komunën e Prishtinës. Ai gjithashtu ka qenë sekretar i Bordit Ekzekutiv të Kuvendit Komunal të Prishtinës, si dhe sekretar i Kuvendit Komunal të Prishtinës.

Para vendosjes së Administratës Ndërkombëtare të UNMIK-ut në Kosovë, z. Todorović ka punuar si drejtor në “Qendrën Gjeriatrike” në Prishtinë.

Qasja publike në Institucionin e Ombudspersonit

Qasja në Institucionin e Ombudspersonit ofrohet përmes zyrës së saj qendrore në Prishtinë dhe zyrave në terren në Gjilan, Pejë, Mitrovicë, Prizren dhe Graçanicë. Zyrat në terren janë zakonisht të përbëra nga një ose dy juristë dhe një asistent ligjor/përkthyes. Zyra e terrenit në Mitrovicë gjithashtu ka nën-zyrën e saj në pjesën veriore të qytetit dhe Zyra e terrenit në Pejë ka nën-zyrën e saj në fshatin Vidanjë afër Klinës. Në të dy nën-zyrat punon nga një jurist.

Zyra qendrore në Prishtinë është e hapur për palët katër ditë në javë, respektivisht prej të hënës deri të enjten mes orës 10:00 dhe 14:00. Zyrat në terren pranojnë ankuesë dy herë në javë mes orës 10:00 dhe 14:00, respektivisht të hënën dhe të enjten në Gjilan, Pejë, Mitrovicë dhe Graçanicë. Zyra e terrenit në Prizren pranon ankuesë të hënën dhe të mërkurën. Natyrisht, ankuesit janë të mirëseardhur që në rastet urgjente të vijnë edhe jashtë orarit të pranimit.

Juristët e zyrës qendrore dhe ata që punojnë në zyrat e terrenit rregullisht vizitojnë komunat, enklavat dhe zonat në të cilat gjenden bashkësi të konsiderueshme etnike joshqiptare. Të vetëdijshëm se të burgosurit dhe të paraburgosurit kudo në Kosovë kanë qasje të kufizuar ndaj institucioneve dhe se janë të cenueshëm ndaj shkeljeve të të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit gjithashtu bëjnë vizita të rregullta dhe të shpeshta në burgje dhe qendra paraburgimi kudo në Kosovë.

Institucioni i Ombudspersonit, në bashkëpunim me autoritetet kompetente të burgjeve, ka vazhduar procesin e komunikimit të drejtpërdrejt me të burgosurit dhe të paraburgosurit përmes kutive postare speciale të vendosura në të gjitha burgjet dhe qendrat e paraburgimit në Kosovë. Vetëm punonjësit e Institucionit të Ombudspersonit kanë qasje në këto kuti postare. Shpesh herë ndodh që përmes këtyre kutive postare të burgosurit dhe të paraburgosurit ta bëjnë kontaktin e parë me Institucionin e Ombudspersonit. Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu i shpërndanë formularë administratave të qendrave të paraburgimit dhe burgjeve, që mund të shfrytëzohen nga të burgosurit apo paraburgosurit për të bërë ankesa apo kërkesa, të cilat më pas përcjellen te Institucioni nga administrata kompetente.

Një herë në muaj, një jurist i Institucionit të Ombudspersoni gjithashtu e viziton edhe Entin për Kujdesin Social në Shtime, ku është e vendosur një kuti e posaçme postare për ta lehtësuar qasjen në Institucion.

Institucioni mban rregullisht Ditët e Hapura, gjatë të cilave ankuesit mund të takohen personalisht me Ombudspersonin apo ndonjë zëvendës të Ombudspersonit apo ndonjë anëtar tjetër stafi i Institucionit. Në zyrën qendrore në Prishtinë, Dita e Hapur organizohet dy herë në muaj, ndërsa në Zyrat rajonale ajo organizohet dy herë më muaj. Një herë në muaj, gjithashtu është një Ditë e Hapur në Gjakovë. Gjithashtu, Institucioni mban shënime për ankues nga Lipjani të interesuar që të takohen me Ombudspersonin. Kur kjo listë plotësohet, atëherë edhe atje mbahet një Ditë e Hapur. Në rajonet që mbulohen nga

ana e Zyrrave të terrenit, banorët informohen rreth datave të këtyre ditëve të hapura përmes listave që publikohen në ndërtesat e komunave të ndryshme, lajmërimeve në mediat lokale si dhe përmes datave që publikohen në prezantimin e Institucionit të Ombudspersonit në ueb-faqe.

Linja telefonike për raste urgjente në zyrën qendrore të Institucionit të Ombudspersonit është e lidhur drejtpërdrejt me zyrën kryesore të juristëve pa kaluar nëpër centralin telefonik të Institucionit të Ombudspersonit. Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu është duke pranuar gjithnjë e më shumë ankesa përmes postës elektronike nga banorët e Kosovës dhe kosovarët që jetojnë jashtë vendit.

Komunikimi mes Ombudspersonit dhe kosovarëve që janë duke qëndruar përkohësisht në Serbi dhe në masë më të vogël në Mal të Zi vazhdon të përmirësohet përmes bashkëpunimit me Komisioner Serb për Refugjatë (vetëm për Serbinë) dhe OJQ-së humanitare spanjolle “Movimento por la Paz, el Desarme y la Libertad (Lëvizja për Paqe, Çarmatosje dhe Liri – MPDL). Institucioni dhe MPDL vazhdojnë të bashkëpunojnë sipas marrëveshjes së nënshkruar gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, sipas të cilës MPDL u pajtua që të ndihmojë ankuesit në plotësimin e formularëve të ankesës dhe kontaktimin me Institucionin e Ombudspersonit.

PËRZGJEDHJE E ÇËSHTJEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT NË KOSOVË

Aspekte të përgjithshme

Si edhe në periudhën e fundit raportuese, paqartësia e vazhdueshme në lidhje me statusin e ardhshëm të Kosovës vazhdon të vë hije mbi gjithçka tjetër. Me përqendrimin e tyre vetëm në negociatat e statusit në Vjenë dhe Nju Jork, edhe autoritetet ndërkombëtare edhe ato vendore në nivelin qendrorë dhe komunal rëndom kanë pak kohë për problemet e përditshme që dalin nga implementimi arbitrar i sundimit të ligjit.

Kjo dobësi e sundimit të ligjit është një kërcënim i zakonit që gjendet në shumicën e shkelleve të të drejtave të njeriut në Kosovë sot, qoftë nëse ato përfshijnë mungesën e ekzekutimit të procedurave gjyqësore, *de facto* eksproprijimet pa përcjellë procedurën e duhur të eksproprijimit ose problemet gjatë aplikimit të Ligjit mbi Procedurën Administrative. Thelbi i këtij problemi shpesh qëndron në mungesën e llogaridhënies së zyrtarëve publik dhe mungesës së njohurisë për ligjin e aplikueshëm. Kjo mungesë e njohurisë nuk është e befasishme kur të marrim parasysh derdhjen e madhe të ligjeve dhe parimeve të reja që duhet të implementohen.

Definimi i përgjithshëm i përgjegjësisë është një detyrë ose gatishmëri për të pranuar përgjegjësinë ose të përgjigjemi për veprat e kryera. Një nga problemet kryesore të Kosovës është fakti se shumë zyrtarë nuk kanë ndjenjë të përgjegjësisë ndaj përmbushjes së duhur të detyrave të tyre, e lere më ndaj popullit të Kosovës. Kosovarët, në anën tjetër, nuk janë të informuar sa duhet për ligjet ekzistuese ose të drejtat e tyre për të kërkuar llogaridhënie të tillë nën këto ligje. Kjo mungesë e qartësisë ligjore është rezultat i kaosit të përgjithshëm ligjor në Kosovë i përmendur aty shpesh në Raportin vjetor të kaluar. Nëse administrata publike dhe gjyqet nuk e din se cilat ligje ekzistojnë në Kosovë dhe cilat prej ligjeve jugosllave të aplikueshme para 23 marsit 1989 qëndrojnë sot, si mund të pritët që personat laik ta dinë këtë në Kosovë?

Ata që vuajnë më së shumti nga kjo paqartësi ligjore dhe arbitraritet janë ata të cilët, për arsye të ndryshme, janë në telashe më të ndjeshme se sa të tjerët. Këtu përfshihen njerëzit e varfër, minoritetet etnike, personat me aftësi të kufizuara, gratë (posaçërisht gratë beqare) dhe fëmijët. Pasi që zëri i këtyre njerëzve shpesh nuk dëgjohej, duhet të ketë më shumë vetëdijesim për nevojat e tyre specifike në mesin e publikut dhe autoriteteve të Kosovës. Gjithashtu duhet të ketë më shumë iniciativa që kanë për cak përfshirjen e këtyre njerëzve në proceset vendimmarrëse që prekin të drejtat e tyre.

Një pengesë tjetër në implementimin e duhur të sundimit të ligjit është fakti se shumë shkelje serioze kriminale të kryera në Kosovë nuk përndiqen si duhet, posaçërisht nëse ato janë të ndërlidhura me krimin e organizuar, lufta të brendshme politike ose janë etnikisht të motivuara. Disa prej këtyre rasteve nuk mund të hetohen në mënyrë të duhur për shkak të mungesës së dëshmitarëve bashkëpunues. Të tjerët janë rezultat i mos presionit të mjaftueshëm nga hetuesit ndaj hetimeve nga frika e rrezikimit të vetes ose

familjeve të tyre. Si rezultat, një numër i kryerësve të veprave penale asnjëherë nuk kanë nevojë që të përgjigjen për krimet e tyre; edhe më e tmerrshme, të njëjtët kanë të gjitha mundësitë që t'i përsërisin krimet e ngjashme në të ardhmen. Përderisa Shërbimi Policor i Kosovës ka arritur mjaft gjatë disa viteve të fundit, ende është një forcë e re policore me përvojë dhe fuqi të pamjaftueshme që t'u kundërvihet rretheve të veçanta kriminale të cilat ende operojnë në Kosovë.

Në një situatë ku shumë ligje injorohen dhe padrejtësitë janë të mëdha, nuk është befasi se ende publiku ende ka pak besim në ekzekutivin, legjislativin dhe gjyqësinë, shumë pjesë të të cilave perceptohen si të korruptuara dhe jo-efikase. Përderisa shumë prej rasteve të diskutuara në këtë raport vetëm sa e konfirmojnë këtë bindje, ka raste tjera ku zyrtarët publik kanë bashkëpunuar me Ushtruesin e Detyrës të Ombudspersonit dhe kjo ka arritur të shpjerë në zgjidhjet pozitive të këtyre rasteve.

Mund vetëm të shpresohet se ky trend pozitiv do të vazhdojë. Një bashkëpunim i forcuar në mes të Institucionit të Ombudspersonit dhe institucioneve publike të Kosovës do të rrisë më tej nivelin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut; gjithashtu do të krijonte një situatë kur implementimi i duhur i sundimit të ligjit nuk do të ishte përjashtim, por normë.

Zhvillimet në sektorin ligjor

Një zbatim efikas i sundimit të ligjit është ndër faktorët kryesor për funksionimin e çdo shoqërie. Nëse një shoqëri dështon që ta zbatojë sundimin e ligjit, ajo në përgjithësi do të dështojë edhe që t'i zbatojë parimet e të drejtave të njeriut. Prandaj, parandalimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut është i lidhur me themelimin e një sistemi të duhur të sundimit të ligjit. Fatkeqësisht, sistemi ligjor në Kosovë vazhdon të jetë prapa standardeve ndërkombëtare, duke ia mohuar kështu tërë popullsisë disa nga të drejtat e tyre më themelore.

Raportet e kaluara vjetore e kanë kritikuar vazhdimisht sistemin konfuz ligjor në Kosovë, një sistem që shpesh herë është në mospajtim me sundimin themelor të parimeve të ligjit. Deri më tani, kritika e tillë nuk ka hasur në ndonjë përgjigje praktike.

Një nga problemet kryesore në lidhje me sistemin vendor ligjor është mungesa e qartësisë ligjore dhe transparencës së tij. Nuk është e qartë cilat ligje nga koha e Jugosllavisë janë ende në fuqi dhe ende nuk ekziston ndonjë organ më i lartë gjyqësor për t'u marrë me këto çështje. Të gjitha Rregulloret e UNMIK-ut dhe ligjet e Kuvendit të Kosovës e theksojnë thjeshtë që ato i zëvendësojnë të gjitha ligjet ose dispozitat ligjore që nuk janë në pajtim me to, duke mos e specifikuar saktësisht se cilat ligje apo dispozita i zëvendësojnë. Derisa Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 mbi Ligjet e zbatueshme në Kosovë thotë se ligjet jugosllave të shpallura pas 23 marsit të vitit 1989 janë të zbatueshme në Kosovën vetëm nëse nuk janë diskriminuese, ende secila gjykatë mund të vendosë se cilat nga këto ligje konsiderohen të jenë diskriminuese.

Gjashtë vite pas shpalljes së Kornizës Kushtetuese me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/09 të datës 15 maj 2001, ende nuk është themeluar Kolegji i Veçantë i Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet e Kornizës Kushtetuese, i paraparë me Kapitullin 9.4.11 të Kornizës Kushtetuese. Ky Kolegj, megjithatë, vetëm do ta lehtësonte pjesërisht situatën e ndërlikuar ligjore, pasi që sipas formulimit të Kapitullit përkatës, ai është përgjegjës që, mes tjerash, të shqyrtojë a është ndonjë ligj i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në pajtim me Kornizën Kushtetuese dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Nuk është e qartë nëse kjo e përfshin edhe marrjen e vendimeve mbi zbatimin e ligjeve jugosllave apo vlerësimin e pajtueshmërisë së Rregulloreve të UNMIK-ut me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Edhe nëse zbatueshmëria e një ligji nuk vihet në pyetje, ka shumë situata ku individët, zyrat administrative apo gjykatat nuk janë të sigurta se si t'i zbatojnë dispozitat e caktuara ligjore. Kjo ndodh shpesh me Rregulloret e UNMIK-ut, shumë nga të cilat kanë sjellë koncepte dhe struktura të reja që nuk kanë qenë pjesë e sistemit ligjor të zbatuar deri më tani. Në pjesët tjera të Evropës dhe botës, kuadrot akademike shkruajnë komantarë për ta ndihmuar interpretimin e ligjeve më të rëndësishme. Komantarë të tillë nuk ekzistojnë në Kosovë, përveç atyre që u referohen ligjeve jugosllave, shumë prej të cilave tashmë janë zëvendësuar me ligje tjera. Përgatitja e komantarëve të tillë do të ishte një hap i madh drejt krijimit të një sigurie ligjore dhe qartësisë që ka të bëjë me ligjet në Kosovë.

Një shembull i asaj ku një komantar do të ishte shumë i dobishëm është Kodi i përkohshëm i procedurës penale i Kosovës, i cili përmban dispozita të caktuara që janë të hapura për interpretime të ndryshme. Për shembull, neni 254 ia mundëson prokurorit publik ose gjykatës që të urdhërojë këqyrjen ose rikonstruksionin e vendit të ngjarjes në procedurën penale. Si pasojë e kësaj, as gjykata, as prokurori publik nuk e ka të qartë se cilat janë kompetencat e tij/saj; gjykatat e konsiderojnë prokurorin publik që të jetë kompetent, derisa prokurori publik nuk dëshiron të ndërhyjë në kompetencat e gjykatave. Fakti që gjykata, prokurori publik dhe policia kanë të drejtë të kryejnë këqyrje dhe rikonstruksione të tilla vetëm sa e rrit konfuzionin në këtë drejtim. Prandaj, do të duhej të ketë më shumë qartësi në lidhje me këto çështje.

Një faktor tjetër që shkakton konfuzion në masë të madhe në sistemin ligjor të Kosovës është zbatimi paralel i sistemit ligjor të Serbisë, jo vetëm nga gjykatat paralele, por edhe nga zyrat administrative paralele të udhëhequra nga Ministria e Drejtësisë e Serbisë. Këto gjykata dhe zyra administrative vazhdojnë të funksionojnë në enklavat serbe në Kosovë dhe në disa qytete në Serbi dhe nuk njihen nga UNMIK-u.

Ligji i Kuvendit të Kosovës mbi gazetën zyrtare, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut të datës 12 maj 2005, tani është duke u zbatuar si duhet falë themelimit të Zyrës për Menaxhimin dhe Administrimin e Gazetës Zyrtare të Kosovës në prill të vitit 2006. Megjithatë, qasja në ligjet e caktuara jugosllave që janë ende të zbatueshme në Kosovë mbetet shumë e vështirë, nëse jo edhe e pamundshme. Edhe pse Institucioni i Ombudspersonit kishte pranuar informata nga Zyra e Kryeministrit që janë duke u bërë përpjekje për t'u siguruar që baza e të dhënave ligjore që i përmban të gjitha ligjet e

zbatueshme në Kosovë të jetë funksionale në gjysmën e dytë të vitit 2006, kjo bazë e të dhënave ende nuk funksionon.

Në vitin 2007, Këshilli Gjyqësor i Kosovës e filloi krijimin e një baze të të dhënave që planifikohet t'i përmbajë të gjitha ligjet e zbatueshme në Kosovë, të drejtën sipas praktikës së mëparshme të gjykatave të larta në Kosovë, instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dokumentet ligjore të Bashkimit Evropian, si dhe shkrime akademike ligjore. Kjo bazë e të dhënave do të jetë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Sipas informatave të marra nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, baza e të dhënave është ende duke u përgatitur dhe do të duhej të bëhet funksionale në shtator të vitit 2007. Qëllimi i këtij projekti është që të krijohet një bazë e të dhënave që do të ishte e lehtë për t'u përdorur jo vetëm nga juristët, por edhe nga publiku në përgjithësi. Derisa nga një bazë e tillë e të dhënave prapë se prapë do të përfitonin vetëm personat që kanë qasje në internet, ky është një hap i rëndësishëm për të sistemuar të gjitha ligjet e zbatueshme në Kosovë, duke e rritur me këtë rast edhe transparencën ligjore.

Rregulloret e UNMIK-ut vazhdojnë të publikohen në ueb sajtin e UNMIK-ut në internet pas shpalljes së tyre dhe kështu nuk janë të arritshme për personat që nuk kanë qasje në internet. Kohëve të fundit, megjithatë, edhe kjo mënyrë e informimit të publikut për Rregulloret e reja të UNMIK-ut – deri më tani, ka vonesa, të gjitha rregulloret e UNMIK-ut që janë shpallur pas 1 marsit 2007, duke përfshirë edhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2007/15, që e ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/06 mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë, ende nuk janë publikuar.

Një problem që ende nuk është zgjidhur përkundër asaj që është përmendur në katër Raportet e kaluara Vjetore është mungesa e vazhdueshme e *vacatio legis* në pothuajse të gjitha ligjet e Kuvendit të Kosovës ose Rregulloreve të UNMIK-ut të nxjerra gjatë kësaj dhe periudhave tjera për të cilat është raportuar. *Vacatio legis* është periudha e caktuar kohore në mes të shpalljes së ligjit dhe zbatimit të tij, që ka për qëllim t'i jap publikut dhe institucioneve kompetente për zbatimin e ligjit mundësinë për t'u përshtatur dhe përgatitur për situatat e reja ligjore. Deri më tani, as UNMIK-u, as Kuvendi i Kosovës nuk duket ta kenë pranuar nevojën e përfshirjes së *vacatio legis* në tekstet ligjore. Në mungesë të kësaj, Rregulloret e UNMIK-ut dhe ligjet e Kuvendit hyjnë në fuqi menjëherë pasi që t'i shpallë PSSP. Si rezultat, shumica e institucioneve nuk janë të gatshme për to dhe si rrjedhim institucionet e rëndësishme formohen disa muaj apo vite pas themelimit të tyre në letër. Një problem tjetër në këtë drejtim është fakti që si administrata vendore, ashtu edhe gjyqësori nganjëherë vërshohen në masë aq të madhe me numrin e madh të rregulloreve dhe ligjeve të reja të shpallura brenda një kohe të shkurtër sa që dështojnë që t'i zbatojnë ato si duhet apo nuk i zbatojnë fare. Kështu, mungesa e *vacatio legis* në legjislacionin e Kosovës shkakton vonesa në zbatimin e duhur të këtij legjislacioni.

Një shembull i një institucioni që është themeluar me ligj por jo në realitet është Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, që do të kishte pasur mandat të shqyrtojë ankesat për shkelje të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u. Ankesat e tilla kanë qenë nën juridiksionin e Institucionit të Ombudspersonit, mirëpo pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/06 mbi Institucionin e Avokatit të Popullit në Kosovë më 16 shkurt

2006, mandati i Institucionit të Ombudspersonit u kufizua vetëm në pranimin e ankesave kundër IPVQ-ve. I themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, ky Panel ende nuk është funksional edhe pse janë emëruar anëtarët e tij. Në mungesë të Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, momentalisht nuk ekziston asnjë organ në Kosovë që ka kompetenca për t'i shqyrtuar dhe hetuar ankesat për shkelje të të drejtave të njeriut nga UNMIK-u.

Në anën tjetër, ka pasur një numër të zhvillimeve pozitive në lidhje me Ligjin e Kuvendit të Kosovës nr. 2004/34 për zhdukjen e korrupsionit, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/26 të datës 12 maj 2005. Agjensioni Kosovar Kundërkorrupsionit i themeluar me këtë ligj është funksional prej muajit shkurt të vitit 2007. Megjithatë, pas një fushatë dyjavore kundër korrupsionit në dhjetor të vitit 2006, një linje urgjente dhe konfidenciale telefonike që ishte hapur për të pranuar pohimet e individëve për korrupsion duket të mos punojë si duhet. Për më tepër, ende duket që në opinion ka mungesë të informatave mbi punën e Agjensionit. Përkundër faktit që qeveria ka ndërmarrë rishtas masa të caktuara për ta ndalur korrupsionin, është qenësorë që qeveria, bashkë me Kuvendin e Kosovës dhe faktorët tjerë të rëndësishëm, ta demonstrojë përkrahjen e madhe të saj për këtë Agjension për të garantuar që të rritet numri i ankesave. Kjo do të duhej të përfshinte edhe përkrahjen financiare të duhur dhe të vazhdueshme.

Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/4 mbi Ndalimin e trafikimit me njerëz është një shembull tjetër i një ligji që nuk mund të zbatohet në mënyrë të duhur përderisa institucionet kompetente ende nuk janë themeluar. Gati katër vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje të UNMIK-ut, PSSP e shpalli Urdhëresën administrative nr. 2005/3. Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ ishte, mes tjerash, që t'i sqarojë përgjegjësitë e Koordinatorit për Ndhimë të Viktimave dhe të themelojë fondet për dhënien e ndihmës financiare dhe kompensimit për viktimat e trafikimit. Derisa Ministria e Drejtësisë duket të ketë filluar dy here procedurën për emërimin e Koordinatorit për Ndhimë të Viktimave (në fund të vitit 2005 dhe në gjysmën e parë të vitit 2006), ky post është ende i zbrazët. Për më tepër, ende nuk janë siguruar fondet për dhënien e ndihmës financiare dhe kompensimit për viktimat e trafikimit. Për këtë arsye, ende pritet që Rregullorja e UNMIK-ut dhe Urdhërsa administrative ta përmirësojnë situatën e personave të trafikuar.

Në qershor të vitit 2006, PSSP e shpalli Rregulloren e shumëpritur të UNMIK-ut nr. 2006/36 për ndihmë juridike, duke e krijuar me këtë rast një sistem të integruar për ndihmë juridike në procedurën civile, penale dhe administrative. Fatkeqësisht, ende nuk janë emëruar të gjithë anëtarët e Komisionit për ndihmë juridike, që është përgjegjës për administrimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të ndihmës juridike. Për më tepër, Zyra Koordinuese e Ndhimës Juridike (sekretariati i Komisionit) dhe Byroja e Qarkut për Ndhimë Juridike (përgjegjëse për pranimin e kërkesave për ndihmë juridike dhe ofrimin e ndihmës juridike) ende nuk janë themeluar në realitet. Si rezultat, Kosova ende nuk ka një sistem funksional të ndihmës juridike. Në procedurën civile, shumë palë që nuk mund ta paguajnë avokatin vazhdojnë që ta përfaqësojnë veten përkundër faktit që shpesh herë

nuk e kuptojnë në tërësi ligjin apo procedurën dhe kështu nuk mund t'i mbrojnë interesat e veta ashtu si duhet.

Një numër i ligjeve jugosllave të kohës para 23 marsit 1999 ende nuk janë zëvendësuar me ligje tjera dhe për këtë arsye janë ende të zbatueshme. Megjithatë, ato injorohen vazhdimisht, qoftë për arsye se autoritetet kompetente presin shpalljen e ligjeve të reja ose për shkak se nuk kanë njohuri për ekzistimin e këtyre ligjeve. Një shembull i dështimit të tillë të zbatimit të legjislacionit ekzistues është Ligji mbi eksproprijimin i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, i vitit 1978. Ligji i ri mbi eksproprijimin, që Kuvendi i Kosovës e miratoi më 8 shkurt 2007, ende nuk është shpallur nga ana e PSSP-së dhe është në pritje për të hyrë në fuqi. Si rrjedhim, ligji jugosllav është ende i zbatueshëm dhe përcakton procedurën e drejtë të eksproprijimit – duke përfshirë edhe mjetet përkatëse juridike – që kanë për qëllim mbrojtjen e individit nga ndërhyrjet jo proporcionale në të drejtën për pronë. Në shumë raste që i ka hetuar Institucioni i Ombudspersonit, është gjetur që komunat dhe autoritetet qendrore qeveritare nuk janë duke e zbatuar këtë ligj si duhet apo nuk ndjekin kurrfarë procedure të eksproprijimit. Shembuj tjerë tregojnë zbatim diskriminues të këtij ligji. Shumë rrallë ndodh që komuna t'i kompensojë personat të cilëve u është marrë pronë, edhe pse ligji i mësipërm i obligon ato që ta bëjnë këtë. Kjo shkakton një numër të shkeljeve të së drejtës për pronë dhe që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut.

Në rastet kur toka që është pronë private dedikohet për qëllime publike, PSSP mund ta ushtrojë autoritetin e tij për të intervenuar në pajtim me Rezolutën nr. 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB-ve (1999). Edhe pse shumica e eksproprijimeve që kanë ndodhur gjatë viteve të fundit nuk janë kryer në pajtim me ligjet ekzistuese, UNMIK-u kryesisht ka dështuar që të reagojë në pajtim me autorizimet e tij.

Shembuj tjerë ku ligjet janë injoruar pothuajse në tërësi janë Ligji i Kuvendit të Kosovës kundër diskriminimit, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/32 më 20 gusht 2004, dhe Ligji i Kuvendit të Kosovës për barazi gjinore, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/18 më 7 qershor 2004. Për më shumë hollësi lidhur me këto Ligje, shih pjesët e këtij Raporti që kanë të bëjnë me mosdiskriminim dhe barazinë gjinore.

Megjithatë, dështimi i plotë për ta zbatuar një ligj ekzistues është përjashtim në Kosovë. Zakonisht, problemi nuk qëndron në moszbatimin e një ligji, por më shumë në zbatimin selektiv të tij. Një shembull i kësaj është Ligji i Kuvendit të Kosovës mbi ndërtimin, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/37 më 14 tetor 2004. Ende ka shumë ankesa lidhur me mënyrën në të cilën autoritetet kompetente e zbatojnë këtë ligj. Ndërtimet e paligjshme vazhdojnë të jenë rregull më shumë se përjashtim në Kosovë, dhe komunat dhe gjykatat shpesh herë e përkrahin këtë dukuri në mënyrë indirekte duke ndërmarrë masa kundër disa shkelëseve të ligjit, por duke refuzuar që të përfshihen në raste tjera.

Zbatimi i Rregulloreve të UNMIK-ut nr. 2001/27 mbi Ligjin themelor të punës në Kosovë, Ligjit i Kuvendit të Kosovës nr. 2003/19 mbi për Siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/33, dhe Ligjit të Kuvendit të Kosovës Nr. 2002/09 mbi Inspektoratin e punës të

Kosovës, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/4, ende paraqet problem. Sipas hetimeve të Institucionit të Ombudspersonit gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, dispozita të caktuara të ligjeve të mësipërme vazhdojnë t'i shkelin të drejtat e të punësuarve. Këto lëshime janë edhe më të dukshme në sektorin privat, ku shumë punëdhënës e punësojnë fuqinë punëtore nga tregu i zi pa lidhur kontrata për punësim duke iu shmangur me këtë rast shumë dispozitave që i mbrojnë të drejtat e punëtorit. Autoritetet kompetente përgjegjëse për zbatimin e këtyre ligjeve deri më tani nuk kanë ndërmarrë hapa efektiv për t'i dhënë fund kësaj praktike të paligjshme.

Pasi që Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27 mbi Ligjin themelor të punës në Kosovë (që në mënyrë të përgjithshme rregullon punësimin në Kosovë) nuk i mbulon në mënyrë adekuate një numër të çështjeve (për më shumë hollësi në lidhje me këtë, shih pjesën e këtij Raporti që ka të bëjë me të drejtat të fëmijëve), Kuvendi i Kosovës filloi punën rreth përgatitjes së një Ligji të ri mbi punën. Ai gjithashtu filloi të përgatisë ligjin mbi liritë e organizimit sindikal në Kosovë, si dhe një ligj që e specifikon të drejtën për grevë. Komisioni i Kuvendit të Kosovës për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale e ftoi Institucionin e Ombudspersonit në një debat publik për ligjet e lartpërmendura, ku një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit i parashtroi komentet në lidhje me to.

Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu e mbikëqyri zbatimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-28 2005/26 mbi procedurën administrative, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/33 të datës 13 maj 2006. Qëllimi i këtij Ligji është që të rregullojë procedurën administrative dhe ofrimin të shërbimeve sa më efektive të administratës publike për të gjithë banorët e Kosovës. Derisa vetë Ligji nuk i rregullon në mënyrë adekuate të gjitha pjesët e procedurës administrative, autoritetet kompetente ende nuk janë duke e zbatuar Ligjin si duhet. Hetimet e Institucionit të Ombudspersonit treguan se organet administrative publike në shumicën e rasteve nuk i respektojnë afatet ligjore për t'i përfunduar procedurat administrative, kurse shumë rrallë ndodh që të përfillen dispozitat që e përcaktojnë formën dhe përmbajtjen e akteve administrative dhe obligimin që pranuesit e këtyre akteve të informohen për mjetet juridike në dispozicion. Disa zyra administrative as që përgjigjen në kërkesa individuale përkundër faktit që janë të obliguara me ligj që ta bëjnë këtë. Ky dështim i organeve kompetente për ta zbatuar Ligjin mbi procedurën administrative në mënyrë gjithëpërfshirëse është në kundërshtim me parimin e qeverisjes së mirë dhe respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe ndikon në masë të madhe në transparencën e procesit vendimmarrës administrativ. Në një letër që Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ia dërgoi Kryeministrit të Kosovës më 29 janar 2007, kërkoi nga ai që t'i këshillojë të gjitha organet kompetente administrative që të angazhohen më shumë në zbatimin e Ligjit mbi procedurën administrative, duke i cekur disa shembuj të keq-administrimit. Kryeministri u përgjigj duke e theksuar që Zyra e tij i kishte këshilluar organet administrative që i kishte cekur Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit në letrën e tij që në të ardhmen t'i përmbahen Ligjit mbi procedurën administrative.

Ligji i Kuvendit të Kosovës për Qasje në Dokumente Zyrtare, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/32 më 6 nëntor 2003), është i një rëndësie të veçantë për funksionimin e duhur të një shoqërie demokratike. Qëllimi i këtij Ligji është që t'u mundësohet

qytetarëve që më për së afërmi të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike, duke garantuar kështu më shumë transparencë në sektorin publik administrativ. Deri më tani, Kryeministri e ka nxjerrë një udhëzim administrativ dhe është themeluar Komisioni ndërinstitucional për Vlerësimin e Praktikave Administrative në Fushën e Dokumenteve Zyrtare. Përveq kësaj, Qeveria dhe “institucionet relevante” të përmendura në këtë Ligj nuk kanë vepruar në pajtim me obligimet që i kanë për të zbatuar Ligjin brenda afateve të caktuara kohore.

Sa i përket Ligjit të Kuvendit të Kosovës për pensionet e personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/40 më 17 dhjetor 2003), Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale ka nxjerrë disa akte nënligjore për zbatimin e këtij Ligji. Ministrinë tjera që janë të obliguara të nxjerrin akte të ngjashme nënligjore deri më tani nuk e kanë bërë këtë. Këto akte nënligjore janë të nevojshme për zbatimin e duhur të nenit 13 të këtij Ligji, i cili ka të bëjë me beneficionet e personave me aftësi të kufizuar. Dështimi i shumicës së ministrive kompetente për të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për më shumë se tri vite e gjysmë paraqet një shkelje të vazhdueshme të parimeve të qeverisjes së mirë. Si rezultat, personat me aftësi të kufizuar nuk kanë pasur mundësi që të përfitojnë nga të drejtat e tyre të garantuara me këtë Ligj. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit e ka ngritur këtë çështje disa herë te Ministrinë përkatëse mirëpo pa sukses. Në shtator të vitit 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ia dërgoi një letër Kryeministrit në lidhje me këtë çështje, mirëpo deri më tani nuk ka pranuar ndonjë përgjigje.

Disa dispozita të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës gjithashtu nuk janë duke u implementuar ashtu si duhet. Për shembull, edhe pse paragrafi 1 i nenit 209 parashih bashkëpunimin mes prokurorit publik dhe policëve të caktuar nën mbikëqyrjen e tij (policia gjyqësore), ky bashkëpunim nuk është duke u realizuar ashtu si duhet. Policia duket të veprojë më shumë në mënyrë individuale dhe ndodh që të mos e përfshijë fare prokurorin publik që, sipas nenit 47 të Kodit të përkohshëm të procedurës penale të Kosovës është autoriteti kryesor përgjegjës për hetimin e veprave penale. Si rezultat, prokurori publik nganjëherë as që informohet fare lidhur me raste të caktuara penale. Si UNMIK-u, ashtu edhe SHPK nuk përgjigjen gjithmonë në kërkesat e prokurorëve për informata

Hetimet e Institucionit të Ombudspersonit gjithashtu zbuluan një mospërfillje të caktuar të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/24 për taksën rrugore të automjeteve. Aneksi A i kësaj Rregulloreje vendos që personat që i kanë paguar të gjitha taksat e importit për automjetet e importuara në Kosovë janë të liruar nga pagesa e taksave rrugore për një periudhë prej 30 ditësh nga data e pagesës së atyre taksave. Mirëpo, në praktikë, Njësia për regjistrimin e automjeteve nuk e njeh këtë periudhë të lirimit nga pagesa dhe kërcënon me gjoba pronarët e automjeteve që nuk i kanë paguar taksat rrugore, madje edhe para skadimit të periudhës prej 30 ditësh. Përkundër intervenimit të Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit në këtë çështje përmes një letre që ia dërgoi Ministrit të Punëve të Brendshme në dhjetor të vitit 2006, kjo situatë ende mbetet e pandryshuar.

Një problem tjetër ka të bëjë me automjetet me targa të shteteve të jashtme që së pari janë importuar në Serbi dhe prej aty në Kosovë. Ligji në Serbi thekson që të gjitha automjetet me targa të shteteve të jashtme që hyjnë në Serbi duhet të regjistrohen dhe të marrin targa të automjetit të Serbisë. Pasi që autoritetet serbe nuk i pranojnë targat e automjeteve me “KS” që përdoren në Kosovë, ata i regjistrojnë banorët e Kosovës me targa të vjetra jugosllave, që pastaj nuk i njih UNMIK-u. Megjithatë, sipas Vendimit ekzekutiv të UNMIK-ut nr. 6/2002 mbi regjistrimin e automjeteve private në Kosovë nga banorët e përhershëm të Kosovës, që është nxjerrë në vitin 2002 dhe është vazhduar disa herë, personat me targa të automjetit që nuk konsiderohen të vlefshme në Kosovë kanë të drejtë t’i ndërrojnë ato ashtu edhe dokumentet e regjistrimit të automjetit t’i ndërrojnë me targa të automjetit të Kosovës pa pasur nevojë që ta paguajnë tarifën e caktuar. Ky vendim është shkëlur vazhdimisht nga pjesëtarë të caktuar të SHPK-së, të cilët i kanë konfiskuar këto automjete në rastet kur pronarët nuk i kanë paguar taksat rrugore kur kanë hyrë në Kosovë. Vendimi ekzekutiv sjell deri te interpretime të ndryshme – derisa disa pjesë të SHPK-së nuk e njohin fare, Dogana e UNMIK-ut i liron pronarët e automjeteve nga obligimi për ta paguar taksën rrugore por i obligon ata që ta paguajnë akcizën dhe TVSH-në. Njësia për regjistrimin e automjeteve, në anën tjetër, insiston që këta pronarë të automjeteve nuk duhet ta paguajnë kurrfarë takse. Përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit kanë kërkuar disa herë që Njësia për regjistrimin e automjeteve të kërkojë nga UNMIK-u sqarime lidhur me këtë vendim ekzekutiv, por kjo nuk është bërë deri më tani. Në ndërkohë, pronarët e automjeteve nuk mund t’i përdorin sepse ua kanë konfiskuar. Njëkohësisht, ata nuk kanë kurrfarë njohurie se nga cilat taksa janë të liruar kurse cilat duhet t’i paguajnë.

Ende ekzistojnë mosërrputhje në lidhje me zbatimin e duhur të Ligjit të Kuvendit të Kosovës për Familjen Nr. 2004/32, që hyri në fuqi më 20 janar 2006. Edhe pse ky ligj u shpall për ta zëvendësuar Ligjin e RSFJ-së mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare, ai nuk i mbulon disa fusha që i rregullon ligji i vjetër. Si rezultat, të dy ligjet vazhdojnë të zbatohen në praktikë, që shkakton shumë huti lidhur me atë se cili organ është përgjegjës për të marrë vendime të caktuara. Një përshkrim më i hollësishëm i kësaj çështjeje mund gjendet në pjesën e këtij Raporti vjetor që ka të bëjë me të drejtat e fëmijëve.

Gjykatat në Kosovë ende dështojnë që ta zbatojnë Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/12 mbi mbrojtjen kundër dhunës në familje, të shpallur më 9 maj të vitit 2003. Një nga problemet kryesore përfshin vonesat në procedurat gjyqësore pas kërkesave për urdhër mbrojtës. Më shumë informata lidhur me këto probleme mund të gjeten në pjesën për barazinë gjinore të këtij Raporti vjetor.

Në disa fusha nuk ka kurrfarë ligji për të rregulluar situatat e caktuara. Një shembull i kësaj është çështja e prokurorëve publik në Kosovë. Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë së Kosovës, i themeluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/8 mbi themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës, dikur ishte kompetent për ta këshilluar PSSP-në në lidhje me emërimin e prokurorëve, si dhe gjykatësve dhe gjykatësve porotë. Mirëpo, ky organ tani është zëvendësuar me Këshillin Gjyqësor të Kosovës pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52 dhe ka kompetenca vetëm për përcaktimin e politikave të punës dhe shpalljen e rregullave dhe udhëzimeve dhe emërimin e

gjykatësve, gjykatësve laikë dhe punonjësve të tjerë jogjyqësorë. Neni 1.6 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/52 thotë që deri sa të themelohet një subjekt i ngjashëm përgjegjës për prokurorët, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/52 do të vlejë përkohësisht edhe për prokurorët. Kjo situatë e përkohshme tani po zgjat më shumë se një vit e gjysmë, por deri më tani nuk është themeluar kurrfarë organi përkatës për ta plotësuar këtë zbrazëti.

Gjithashtu, nuk ekziston ndonjë mjet juridik për procedurat e stërzgjatura gjyqësore. Kjo çështje u ngrit në të gjitha raportet në të cilat Institucioni i Ombudspersonit erdhi në përfundim se procedura të caktuara gjyqësore kishin zgjatur aq shumë sa për ta shkelur të drejtën e një personi që çështja i tij të zgjidhet brenda një kohe të arsyeshme. Përkundër rekomandimeve të vazhdueshme për UNMIK-un dhe Kuvendin e Kosovës gjatë pesë viteve të fundit për ta krijuar një mjet të tillë juridik, duket që deri më tani nuk janë ndërmarrë kurrfarë veprimesh për ta përgatitur një ligj të tillë.

Është e qartë se një nga problemet kryesore të legjislacionit në Kosovë nuk është aq shumë cilësia e tij, sa është mungesa e zbatimit të drejtë. Kjo është shpesh herë problem i mungesës së përgjegjësisë. Megjithatë, në shumicën e rasteve, ligjet në Kosovë nuk janë zbatuar sepse personat përgjegjës për zbatimin e tyre thjeshtë nuk dinë si ta bëjnë këtë. Duke marrë parasysh numrin e madh të rregulloreve të UNMIK-ut dhe ligjeve që janë shpallur në Kosovë prej vitit 1999, nuk është për t'u befasuar që administrata dhe gjyqësori në Kosovë kanë probleme për ta përvetësuar tërë këtë legjislacion. Në mënyrë që të përmirësohet kjo situatë, UNMIK-u dhe ekspertët tjerë të përfshirë në procesin legjislativ do të duhej të jenë më shumë aktiv në dhënien e këshillave dhe nxjerrjen e direktivave mbi zbatimin dhe interpretimin e drejtë të ligjeve në Kosovë. Kuvendi i Kosovës gjithashtu duhet t'i obligojë Ministrinë që të raportojnë më me rregull mbi zbatimin e ligjeve të Kuvendit të Kosovës.

Gjyqësori në Kosovë

Në përgjithësi, përderisa është arritur përparim në fusha të caktuara të gjyqësorit në Kosovë, prapë se prapë është vështirë të anashkalohet fakti që sistemi gjyqësor në Kosovë ende vuan nga të meta të konsiderueshme.

Prej themelimit të tij në dhjetor të vitit 2005, Ministria e Drejtësisë ka vazhduar të marrë gradualisht më shumë përgjegjësi nga Departamenti i Drejtësisë të UNMIK-ut. Sa i përket gjyqësorit, Ministria tani është përgjegjëse, mes tjerash, edhe për zhvillimin e politikave lidhur me administrimin e drejtësisë, duke përfshirë edhe qasjen në drejtësi. Në vitin 2006, Ministria e Drejtësisë e përgatiti një plan strategjik për vitet 2006–2011, i cili përmban objektivat e përgjithshme, planet dhe qëllimet strategjike që Ministria synon t'i arrijë gjatë kësaj periudhe.

Një projektligj për gjykatat është duke u përgatitur tani për më shumë se dy vite, mirëpo nuk është miratuar ende. Një ligj i tillë do t'i sqaronte rolet e gjyqësorit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës, një organ i përbërë nga gjykatës vendore

dhe ndërkombëtarë dhe nga një numër i ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, Kuvendit të Kosovës, Odës së Avokatëve të Kosovës dhe sektorit akademik, që është përgjegjës për rekrutimin dhe emërimin e gjykatësve, vendosjen e politikave administrative dhe ofrimin e mbikëqyrjes administrative të gjyqësorit. Ligji i ri gjithashtu do të përfshinte procedura e hollësishme për caktimin e gjykatësve masat disiplinore në rast të sjelljes së pahijshme të tyre.

Në mungesë të këtij ligji, rekrutimi dhe emërimi i gjykatësve dhe gjykatësve porotë vazhdon të bëhet si në të kaluarën; gjykatësit i rekomandon Këshilli gjyqësor i Kosovës dhe i emëron PSSP-ja. Derisa procesi i rekomandimit dhe emërimit do të dukej të garantojë një pavarësi të gjyqësorit për shkak të institucioneve të ndryshme të përfshira në këtë proces, vendimi përfundimtar nëse një gjykatës do të emërohet apo jo ende mbetet në duart e PSSP-së, i cili në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/1 ka autorizim për pushtetin përfundimtar administrativ dhe ligjor në Kosovë. Kjo situatë është e pandryshuar prej vitit 1999, duke krijuar një mosbalancim të pushtetit dhe një pengesë për gjyqësorin e pavarur në Kosovë.

Në Kosovë ende gjendet një kontingjent i gjykatësve ndërkombëtar që i ndihmon gjykatësit e vendit në punën e tyre. Në raportin e kaluar vjetor u përmenden brengat lidhur me procedurën e emërimit të gjykatësve ndërkombëtar, më së shumti për shkak të mungesës së qartësisë dhe transparencës procedurale. Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar ende emërohen drejtpërdrejt nga ana e PSSP-së dhe kohëzgjatja e mandatit të tyre nuk përmendet në rregulloren e zbatueshme të UNMIK-ut (nr. 2000/06 mbi emërimin dhe shkarkimin nga detyra të gjykatësve ndërkombëtarë dhe prokurorëve ndërkombëtarë e datës 15 shkurt 2000, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/34 të datës 27 maj 2000 dhe Rregulloren e UNMIK-ut 2001/2 të datës 12 janar 2001). Kriteret e përzgjedhjes së gjykatësve ndërkombëtar janë gjithashtu shumë pak kërkuese. Edhe nëse PSSP-ja i detyron kandidatët që t'i nënshtrohen ndonjë forme të testimit të kualitetit dhe intervistave të zgjata, procedura e hollësishme e UNMIK-ut për t'i emëruar këta gjykatës është e mbyllur ndaj botës së jashtme dhe varet vetëm nga PSSP-ja. Si kjo, ashtu edhe kohëzgjatja e papërcaktuar e mandatit mund ta komprometojë pavarësinë dhe paanshmërinë e këtyre gjykatësve. Mungesa e transparencës në kriteret e përzgjedhjes sjell deri të një dallim i madh në kualitetin e punës së gjykatësve individual. Kjo ndodh gjithashtu për shkak të faktit që nuk ka ndonjë organ mbikëqyrës të cilit do të mund t'i parashtrohen ankesat në rast të sjelljes së pahijshme të këtyre gjykatësve. Edhe nëse gjykatësi nuk është i paanshëm apo tregon sjellje të pahijshme, nuk ka ndonjë mundësi për të nisur procedurën disiplinore apo mënyra tjera për t'u siguruar që veprimet e tilla të mos përsëriten.

Për më tepër, nuk ka ndonjë rregull të qartë lidhur me atë se me çfarë raste do të punojnë zakonisht gjykatësit ndërkombëtar. Neni 1.2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/06 vetëm thekson që gjykatësit ndërkombëtar mund t'i zgjedhin rastet dhe të marrin përgjegjësi për ato. Gjatë viteve të kaluara, gjykatësit ndërkombëtar kanë punuar me rastet që përfshijnë krime të luftës, krimin e organizuar si dhe terrorizmin, dhunën ndëretnike, vrasjet politike dhe korrupsionin. Disa raste shkojnë drejtpërdrejt të gjykatësit ndërkombëtar, kurse disa të tjera ua përcjellin gjykatësit vendorë.

Derisa është e vërtetë që gjyqësori vendor në Kosovë ende ka nevojë për përkrahje nga kolegët e tyre ndërkombëtarë, do të duhej të jetë me e qartë se cilat raste u caktohen atyre dhe cilat u caktohen gjykatësve vendorë. Gjithashtu, kriteret e përzgjedhjes do të duhej të ishin më të hollësishme dhe më transparente. Do të duhej të ketë një procedurë më të hapur për emërimin e gjykatësve ndërkombëtar që e përfshin jo vetëm PSSP-në, por edhe një organ të pavarur të jashtëm siç është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, që tashmë ka qenë e përfshirë në procedurën e emërimit të pjesëtarëve të Panelit Këshillëdhënës për të drejtat e njeriut pranë UNMIK-ut. Në fund, do të duhej të themelohet një organ special i pavarur që do të merrej me ankesat në lidhje me sjelljen e pahijshme të gjykatësve ndërkombëtar.

Në raportet e kaluara vjetore janë përmendur gjykatat paralele që gjenden në enklavat serbe brenda Kosovës dhe në qytete të caktuara të Serbisë. Këto gjykata financohen dhe paguhen nga ana e Qeverisë së Serbisë dhe aktgjykimet e tyre nuk i njeh as UNMIK-u, as IPVQ-të. Ata prapë se prapë vazhdojnë të kryejnë veprime të caktuara siç është regjistrimi i shitblerjes së pronave që shpesh herë konsiderohen të paligjshme nga autoritetet në Kosovë. Kjo vazhdon të shkaktojë konfuzion në këtë fushë të ligjit.

Sa i përket gjykatësve vendor të paguar nga IPVQ-të, ka shumë pak ndryshime për të mirë prej periudhës së kaluar për të cilën është raportuar. Gjyqësori në Kosovë vazhdon të ketë numër të pamjaftueshëm të punonjësve dhe të cilët marrin paga të ulëta, duke pasur ndikim negativ në efikasitetin, pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit. Ngarkesa me raste, posaçërisht në gjykatat civile, vazhdon të rritet dhe shumë raporte që Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka publikuar gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet kanë treguar një mungesë të qartë të menaxhimit të duhur të rasteve në gjykatat që janë hetuar; duket që një akt i thjeshtë administrativ nganjëherë kërkon më shumë kohë se vetë vlerësimi i rastit, që nganjëherë përfundohet brenda ditës.

Sipas ligjit në fuqi, gjykatësit porotë do të jenë të përfshirë në procedurën penale dhe civile të gjykatës në të gjitha instancat. Në praktikë, megjithatë, sistemin i mungon menaxhimi i duhur – në disa raste, gjykatësit porotë nuk marrin pjesë në procedurë edhe pse protokollat e gjykatave theksojnë që ata kanë qenë të pranishëm, në raste tjera gjykatësit porotë janë caktuar të marrin pjesë në dy gjykime në të njëjtën kohë. Administrimi dhe caktimi i gjykatësve porotë për gjykime ka nevojë të madhe për përmirësim.

Në Kosovë nuk ka traditë të gjyqësorit të pavarur dhe si rrjedhim as një kuptim të duhur në mesin e shoqërisë kosovare se çka nënkupton një gjyqësor i tillë. Pavarësia e gjyqësorit nënkupton, mes tjerash, që një gjykatës duhet të jetë i lirë nga çdo formë e presionit dhe ndërhyrjes që vjen nga ana e palëve të përfshira në procedurë, nga ana e ekzekutivit apo nga ana e kujtdo tjetër. Administrimi i drejtësisë do të duhej që, natyrisht, ta respektojë ligjin e jo konsideratat politike. Do të duhej të ekzistojë një mur etik dhe profesional që mbron gjykatësit nga të gjitha ndërhyrjet e jashtme, duke ua mundësuar që ta zbatojnë si duhet sundimin e ligjit dhe për të garantuar që tjerët t'i përmbahen atij.

Ky koncept i përgjithshëm i pavarësisë së gjyqësorit, megjithatë, nuk dominon në Kosovë. As ekzekutivi, as palët e procedurës, por as vetë gjyqësori nuk e respekton këtë parim. Si administratë ndërkombëtare, ashtu edhe ajo vendore i kanë kontaktuar gjykatësit jo zyrtarisht në lidhje me shumë çështje të ndryshme. Në një rast kur UNMIK-u nuk ishte i kënaqur me shitjen e një shtëpie në lagjen e rindërtuar “Mëhalla e romëve” për të kthyerit, përfaqësuesit e UNMIK-ut i kontaktuan gjykatësit e Gjykatës së qarkut në Mitrovicë për t’i pyetur për rrugët ligjore për ta ndaluar regjistrimin e shitblerjeve të tilla në të ardhmen. Në këtë rast, Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë i dha këshillë ligjore lidhur me çështjen, madje propozoi që ta ndalë regjistrimin e kontratave të tilla derisa UNMIK-u të mos e ndërrojë *status quo*-në ligjor. Forma të tilla të lidhjes së marrëveshjeve mes ekzekutivit dhe gjyqësorit do të kishin qenë të padiskutueshme në sistemet tjera ligjore. Në Kosovë, kërkimi i këshillës ligjore për zgjidhjen e një çështje nga një gjykatës që më vonë mund të ndodhë të jetë gjykatës përgjegjës për atë çështje e rrezikon jo vetëm paanshmërinë e gjykatësit, por e sfidon edhe pavarësinë dhe funksionalitetin e sistemit të drejtësisë në tërësi.

Një çështje tjetër që ankuesit e kanë ngritur vazhdimisht pranë Institucionit të Ombudspersonit dhe gjetiu përfshin edhe pohimet e përhapura për korrupsion brenda gjyqësorit. Këto pohime zakonisht është e pamundur që të dëshmohen, kështu që edhe nëse personi ankohet pranë Njesisë së Inspektionit Gjyqësor të Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut, ankesa shumë rrallë sjell deri te masa disiplinore apo shkarkimi i një gjykatësi. Derisa në Kosovë ekziston një agjension kosovar kundër korrupsionit, i themeluar në mes të vitit 2005, sipas Ligjit të Kuvendit të Kosovës kundër korrupsionit, ai ka funksionuar tani vetëm për një kohë të shkurtër. Momentalisht, niveli i njohurisë së gjyqësorit për këtë ligj dhe Agjension duket të jetë shumë i ulët.

Momentalisht, ka debate të vazhdueshme lidhur me atë nëse Njësia e Inspektionit Gjyqësor, që momentalisht është pjesë e Departamentit të Drejtësisë pranë UNMIK-ut dhe është përgjegjëse për zhvillimin e inspektimeve, auditimeve dhe hetimeve brenda sistemit gjyqësor të Kosovës, do të bëhet pjesë e Ministrisë së Drejtësisë apo Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Një zgjidhje për këtë debat do të ishte që ajo të transformohet në një njësi që do të ishte e pavarur nga të dy organet.

Pagat e ulëta që marrin gjykatësit vendore vazhdojnë të paraqesin problem edhe shpesh herë janë arsyeja kryesore për marrjen e tyre të mitës, nënshtrimin ndaj kërcënimeve dhe formave tjera të korrupsionit. Veprimet korruptuese të gjykatësve shpesh herë arsyetohen si rezultat i keqësimit të përgjithshëm të standardit të jetës të shkaktuar nga pagat e ulëta në Kosovë dhe çmimet e larta në shoqërinë kosovare. Si Ombudspersoni i mëparshëm, ashtu edhe Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit vazhdimisht e kanë theksuar nevojën që të rriten pagat e gjyqtarëve, duke e argumentuar këtë me faktin që nëse një gjykatës ka të ardhura të mjaftueshme për të mbajtur familjen e tij/saj, atëherë gjasat janë më të vogla që ai/ajo të marrë mitë apo t’i nënshtrohet kërcënimeve gjatë vendosjes në një rast. Për më tepër, gjykatësit do të duhej të mbrohen më mirë në rastet kur pranojnë kërcënime-rojet e sigurimit apo mbrojtja e policisë do të duhej të jetë në dispozicion të gjykatësve të caktuar njëjloj sikur se janë të caktuar për politikanët.

Një çështje tjetër që ka ndikim të drejtpërdrejt në kualitetin e aktvendimeve dhe aktgjykimeve të gjykatës dhe shpejtësinë me të cilën nxjerrën ato është mungesë e kushteve adekuate të punës në shumicën e gjykatave. Pothuajse çdo gjykatë në Kosovë ankohet rreth numrit të vogël të punonjësve dhe infrastrukturës së pamjaftueshme. Mungesa e hapësirës në sallat e gjykimeve shpesh herë ia mohon publikut të drejtën për të marrë pjesë në seanca gjyqësore, duke e zvogëluar kështu edhe transparencën e punës së gjykatave. Një problem tjetër i vazhdueshëm është kualiteti i dobët i përkthimit të dokumenteve dhe përkthimit gojor nëpër seanca gjyqësore. Kjo çështje është përmendur edhe në raportin e kaluar vjetor dhe situata nuk ka ndryshuar për të mirë. Gjykatat ende nuk janë duke e ndjekur procedurën për përcaktimin e kualitetit të përkthyesve dhe interpretëve, të vendosur më Ligjin jugosllav të vitit 1969 që e rregullon çështjen e përkthyesve dhe interpretëve në gjykata.

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet që numri i pamjaftueshëm i gjykatësve mund ta rrezikojë edhe paanshmërinë e gjykatësve. Kjo posaçërisht vlen për situatat kur gjykatat e instancës së dytë e kthejnë lëndën për rishqyrtim në gjykatën komunale; lëndët atëherë i shqyrton i njëjti kolegji i gjykatësve që e ka nxjerrë aktgjykimin e mëparshëm të instancës së parë. Përfshirja e mëhershme në një rast paraqet rrezik që një ose më shumë gjykatës tashmë mund ta ketë formuar mendimin e tyre mbi rastin dhe për këtë arsye më nuk janë të paanshëm në vlerësimin e tyre. Një rrezik tjetër që rezulton nga ky sistem është fakti që kolegji i gjykatësve që e ka nxjerrë vendimin përkatës nuk do ta rishqyrtojë lëndën në ndonjë mënyrë tjetër edhe nëse kjo është kërkuar nga gjykatat përkatëse të qarkut. Rastet e tilla nuk janë vetëm shembuj të mungesës së paanshmërisë, por më shumë janë shembuj të interpretimit të gabueshëm të ligjit dhe zbatimit të tij në praktikë. Si rezultat, disa lëndë shkojnë dhe kthehen prej instancës së parë në atë të dytën, duke shkaktuar zvarritje të mëtejshme të procedurës gjyqësore. Kualiteti i administrimit të drejtësisë është faktor i rëndësishëm në këtë kontekst. Një faktor tjetër është që, për dallim prej sistemeve ligjor jashtë vendit, në Kosovë nuk ekziston e drejta lëndore e gjykatave më të larta që do të obligonte dhe udhëzonte gjykatat më të ulëta lidhur me mënyrat e zbatimit të drejtë të ligjit. Edhe nëse Gjykata Supreme e nxjerr një vendim lidhur me një rast të caktuar, e drejta e tillë lëndore kurrë nuk citohet dhe shpesh herë as që shpërndahet në gjykatat më të ulëta. Kjo shkakton një mungesë të vazhdimësisë në administrimin e drejtësisë në Kosovë.

Për shkak të valës së legjislacionit të ri që e kanë miratuar dhe shpallur UNMIK-u dhe Kuvendi i Kosovës prej vitit 1999, shumica e gjykatësve duket të jenë të painformuar për një numër të ligjeve në fuqi. Derisa Instituti gjyqësor i Kosovës i bën të gjitha për t'i trajnuar këta gjykatës, ata ende duket të kenë vështirësi për t'i zbatuar këto ligje në praktikë. Supozohet që shumë gjykatës nuk i zbatojnë këto ligje thjeshtë për shkak të frikës nga zbatimi i gabueshëm i tyre. Mënyra e vetme për ta përmirësuar këtë do të ishte caktimi i monitoruesve ligjor që do të merrnin pjesë në debatet e kolegjeve të gjykatësve dhe, duke pasur kujdes që të mos e rrezikojnë pavarësinë dhe paanshmërinë e gjykatësve, t'i drejtojnë ata te ligjet dhe të drejtën lëndore të anashkaluar. Natyrisht, për këtë masë do të nevojitej edhe pajtimi paraprak i kryetarëve të gjykatave.

Si përgjigje në numrin e pamjaftueshëm të gjyqtarëve në disa gjykata, Këshilli Gjyqësor i ka transferuar në disa raste gjyqtarët nga një gjykatë në tjetrën. Në të njëjtën kohë, mungesa e gjyqtarëve të kualifikuar duket ta ngadalësojë procedurën e emërimit të gjyqtarëve të ri. Këshilli Gjyqësor gjithashtu u angazhua në një grup punues për ta përgatitur një strategji për ta zvogëluar ngarkesën me raste pronësore nëpër gjykata. Këtë grup punues e themeloi Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për zhvillim ndërkombëtar dhe e kryesoi një përfaqësues i Misionit të OSBE-së në Kosovë. Në grup përfshiheshin përfaqësuesit e OSBE-së, Departamentit të Drejtësisë në UNMIK, Ekipit Planifikues të Bashkimit Evropian, Agjencioni Kosovar i Pronës, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Qendrës Kombëtare për Gjykatat Shtetërore. Më 16 mars 2007, Grupi e publikoi një strategji dhe plan veprimi për reduktimin e ngarkesës me raste pronësore, i cili i identifikoi ngarkesat ekzistuese, mënyrat e mundshme për t'i zvogëluar ato dhe veprimet për t'iu shmangur atyre në të ardhmen. Ai gjithashtu rekomandoi reforma legjislative dhe të menaxhimit të rasteve që do ta përmirësonin procedimin e rasteve në gjykata dhe efikasitetin e gjykatave të rregullta gjatë punës me raste pronësore. Deri më tani, duket që Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk ka ndërmarrë hapat e duhur për ta realizuar këtë strategji dhe mbetet të shihet se sa do të jetë efikase ajo për ta reduktuar ngarkesën me raste që kanë të bëjnë me konteste pronësore.

Sa i përket kontesteve pronësore, është alarmues fakti që gjykatat në Kosovë nuk kanë ndonjë procedurë të duhur për ta vërtetuar vërtetësinë e dokumenteve që parashtrohen për të dëshmuar transferimin e pronës. Si rezultat, shumë transferime të pronës janë zhvilluar në bazë të dokumenteve të falsifikuara, posaçërisht kontratave, letrave të autorizimit dhe dokumenteve të identifikimi të falsifikuara. Duket që në disa raste gjykatësit që punojnë në gjykatat e financuar nga Serbia marrin mitë për t'i regjistruar kontratat e shitblerjes me data të pasakta. Duke e përdorur vulën jugosllave, këta gjykatës pastaj i vulosin këto kontrata me një datë para vitit 1999 edhe pse në fakt transferimi ka ndodhur pas vitit 1999 apo, në rastet më të rënda, kur pronari i pronës nuk ka dashur fare që ta shesë atë.

Sa i përket përmbartimit të aktgjykimeve të gjykatës, një mungesë për zbatimin e duhur të vendimeve të tilla është ende numri i pamjaftueshëm i referentëve ekzekutiv për të garantuar ekzekutimin e tyre. Shpesh herë, dobësia e paramenduar e gjyqësorit në Kosovë nxit palët përgjegjëse që të mos i respektojnë aktgjykimet e gjykatave. Në veçanti, komuna të caktuara konsiderojnë që nuk janë të obliguara që t'u përmbahen aktgjykimeve të gjykatave, madje as nuk e konsiderojnë të nevojshme që ta arsyetojnë këtë dështim për ta respektuar sundimin e ligjit.

Vështirësitë për përpjekjet për t'i ekzekutuar aktgjykimet në rastet kur palët e paditura janë ndërmarrjet e dikurshme shoqërore që tani administrohen nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) janë përmendur në raportin e kaluar vjetor dhe nuk ka ndonjë përparim në dukshëm në këtë drejtim. Numri i këtyre rasteve është ngritur vazhdimisht gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet. Gjykatat vazhdojnë të nxjerrin aktgjykime në favor të ankuesve, derisa bankat vazhdojnë ta kundërshtojnë përmbartimin duke pohuar që llogaritë përkatëse bankare janë të zbrazëta ose që ekzekutimi i vendimeve të tilla do të shkelte udhëzimet që janë marrë nga AKM. Nuk duket të jenë bërë përpjekje të vërteta

për ta tejkeluar këtë situatë, përkundër rekomandimeve të Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, me të cilat është kërkuar nga organet që merren me aspektet ligjore të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore që ta zgjidhin këtë çështje.

Një nga arsyet e zvarritjes së procedurave gjyqësore para fazës së përmbartimit është mungesa e ekspertëve dhe pajisjeve për të përgatitur ekspertizat përkatëse, si dhe mungesa e fondeve të mjaftueshme për t'i paguar ato. Sa u përket rasteve penale, Zyra e Mjekësisë Ligjore e UNMIK-ut, aktivitetet e së cilës përfshijnë kryerjen e autopsive dhe kontrollimeve fizike të viktimave, si dhe në dhënien e ekspertizës për gjykatat lidhur me këtë çështje, nuk është në gjendje që t'u përgjigjet të gjitha kërkesave të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Vonesat për të dorëzuar raportet e autopsisë sjellin deri të zvarritja e hetimeve, që si rrjedhim shkakton vonesat në nisjen e procedurës penale pranë gjykatës. Në rastet kur ishte nevojitur ndonjë ekspert për të sqaruar dhe dëshmuar mbi atë që është shkruar në raportin e autopsisë, në një numër të rasteve gjykatat nuk e kanë ftuar ekspertin mjekësor që e ka përgatitur atë raport, por kanë vendosur ta ftojnë për të dëshmuar një ekspert që më parë kishte punuar në Zyrën e Mjekësisë Ligjore të UNMIK-ut, edhe pse tani ishte duke punuar në kapacitet privat. Në rastet civile, gjithashtu vërehet një mungesë e ekspertëve në dispozicion për të dhënë mendime në fushat që përfshijnë, mes tjerash, çështjet pronësore dhe të gjeodezisë, aksidentet e trafikut dhe çështjet ndërtime. Siç është theksuar në Raportin e kaluar vjetor, themelimi i një instituti të veçantë përgjegjës për përgatitjen e ekspertizave të llojeve të ndryshme gjatë proceseve gjyqësore (në veçanti për gjykatat penale dhe prokurorët), do të ndihmonte në zgjidhjen e këtyre problemeve. Megjithatë, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, një institut i tillë nuk mund të themelohet në këtë kohë.

Një çështje që është përmirësuar deri në një masë falë donacioneve të shtuara është mbrojtja e dëshmitarëve. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Këshilli Gjyqësor mori donacione nga Zyra Ndërlidhëse e Britanisë së Madhe në Kosovë dhe Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, duke ia mundur që t'i instalojë pajisjet televizive për mbrojtjen e dëshmitarëve në sallat e gjyqësore të pesë gjykatave të qarkut në Kosovë. Ky ishte një hap i rëndësishëm drejt garantimit të sigurisë dhe konfidencialitetit të dëshmitarëve. Zyra ndërlidhëse e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë e përkrahu këtë iniciativë duke e financuar instalimin e pajisjeve për video xhirimin dhe incizimin e seancave gjyqësore. Ky projekt është duke vazhduar edhe tani.

Megjithatë, masat e tilla sjellin vetëm një lehtësim afatshkurtër për dëshmitarët në rastet penale. Ende nuk ka ndonjë program efikas për mbrojtjen e dëshmitarëve që do të mund të mbronte në mënyrë adekuate njerëzit dhe familjet e tyre të cilët përballen me rreziqe serioze nëse pajtohen që të dëshmojnë. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit vazhdoi të marrë informata lidhur me kërcënimin dhe frikësimin e dëshmitarëve; në shumë raste penale, kërcënimet e tilla shkaktojnë vonesa të konsiderueshme në hetimet e krimeve të rënda dhe e pengojnë administrimin e duhur të drejtësisë.

Sikur në shumë institucione publike në Kosovë, mungesa e mjeteve financiare është bërë një nga pengesat kryesore për të kryer reformën e duhur gjyqësore. Një pjesë e madhe e procesit është e varur nga donacionet ndërkombëtare. Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER) është e përfshirë në shumë projekte që kanë për qëllim forcimin e gjyqësorit dhe sistemit të drejtësisë. Një projekt afatgjatë përfshin themelimin e një Sistemi informativ mbi menaxhimin e rasteve (SIMR) në të gjitha gjykatat e Kosovës. Ky projekt tani është në përfundim e sipër dhe duket se SIMR do ta mundësojë në të ardhmen procedimin efikas të rasteve dhe arkivimin e të dhënave në formë elektronike.

Vitet e kaluara kanë treguar që vendosja e një sistemi të duhur dhe të drejtë gjyqësor kërkon një qasje gjithëpërfshirëse ndaj ndërtimit të kapaciteti, forcimit të rolit të gjyqësorit, ruajtjes së pavarësisë gjyqësore dhe zhvillimit të mekanizmave efikas mbrojtës ndaj sjelljes së pahijshme të gjykatësve.

Një numër i hapave të vegjël është bërë për ta arritur këtë qëllim. Megjithatë, ende ka nevojë të madhe për një reformë më të gjerë të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Në veçanti, duhet që urgjentisht të bëhen hapa më të mëdhenj për ta rritur pavarësinë gjyqësore dhe për të garantuar që gjykatësit të sillen në mënyrë të paanshme, duke mos lënë hapësirë për interesa private, ndikim të jashtëm apo çfarëdo forme të korrupsionit. Në çdo sistem demokratik, gjyqësori është shtylla kryesore që e mban parimin e sundimit të ligjit. Dështimi për ta përkrahur si duhet këtë shtyllë do të ketë pasoja negative në të gjithë sektorët e jetës private dhe publike.

Papërshtatshmëria e mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe roli i Ombudspersonit

Megjithëse UNMIK-u dhe IPVQ-të gjithnjë e më shumë kanë qenë të obliguara që të raportojnë mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë, dhe në veçanti rreth implementimit të instrumenteve të caktuara ligjore ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duket qartë që mbrojtja e të drejtave të njeriut në Kosovë është përmirësuar paksa që nga periudha e fundit e raportimit.

Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike në Kosovë dhe një numër instrumentesh tjera mbi të drejtat e njeriut kanë qenë pjesë e të drejtës së zbatueshme në Kosovë që nga viti 1999. Kah mesi i vitit 2004, Komisioni i KB-ve për të drejtat e njeriut kërkoi nga UNMIK-u, në bashkëpunim me IPVQ-të, që të përgatisë një raport mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë prej vitit 1999. Ky raport është dorëzuar në shkurt të vitit 2006 dhe Komisioni, pas një numër diskutimesh dhe kërkesash, ka lëshuar rekomandimet e veta finale në raport në fund të korrikut të vitit 2006. Këto përfshinin, rritjen e qartësisë ligjore, integrimin e programeve mbi të drejtat e njeriut në administratë, bashkëpunimin e plotë me Ombudspersonin, përfaqësimin e duhur gjinor dhe një numër çështjesh të tjera.

Komisioni i KB-ve për të Drejtat Sociale dhe Ekonomike gjithashtu ka kërkuar nga UNMIK-u, prapë në bashkëpunim me IPVQ-të, që të përgatisë një raport rreth gëzimit të

të drejtave ekonomike dhe sociale në Kosovë që nga qershori i vitit 1999. Ky raport është dashur t'i dorëzohet Komisionit në marsin e vitit 2007, por siç duket UNMIK-u ka kërkuar zgjatjen e këtij afati kohor.

Dokumentet e dorëzuara nga UNMIK-u tek Komisioni për të Drejtat e Njeriut në lidhje me implementimin e Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike në Kosovë ka nisur diskutimin më se të nevojshëm në nivel ndërkombëtar mbi situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë. Ishte hera e parë që trupa monitoruese mbi të drejtat e njeriut e KB-së ka kërkuar nga UNMIK që të raportojë mbi çështjet e të drejtave të njeriut, dhe pa dyshim që ka qenë hera e parë që shumë pjesë të IPVQ-vë është dashur të japin kontributin e tyre për një raport aq gjithëpërfshirës i cili përfshinë çështje të ndryshme mbi të drejtat e njeriut. Përgatitja e raportit mbi implementimin e Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (gjithashtu edhe përgatitja në vazhdimësi e raportit mbi Konventën për të Drejtat Ekonomike dhe Sociale) është një hap i parë i rëndësishëm drejt ngritjes së perceptimit të përgjegjësive nga strukturat ndërkombëtare si dhe ato lokale në lidhje me situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Sa i përket standardeve evropiane për të drejtat e njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut është e aplikueshme në Kosovë. Gjithashtu, Korniza e Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është e aplikueshme në Kosovë që nga viti 2004, pas marrëveshjes teknike mes Këshillit të Evropës dhe UNMIK-ut. Pas dorëzimit të raportit të parë nga ana e UNMIK-ut në Këshillin e Evropës në vitin 2005 mbi implementimin e Kornizës së Konventës, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës ka lëshuar një rezolutë në qershor të vitit 2006 në të cilin, mes tjerash, ata kërkuan implementim më të efektshëm të Kornizës së Konventës dhe nxitën UNMIK-un që të përmirësojë procesin e bartjes së kompetencave (të cilat përfshijnë bartjen e Institucionit të Ombudspersonit në duart e vendorëve) dhe funksionimi i gjyqësorit.

Qysh atëherë, ministrat kompetent, me ndihmën e Zyrës Këshilluese për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, kanë caktuar përgjegjësitë për implementimin dhe raportimin mbi implementimin e pjesëve të ndryshme të Kornizës së Konventës. Aktualisht, ministratë përkatëse janë duke zhvilluar plane veprimi se si të kryejnë detyrat e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit kemi parë se Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe Ligjin për liritë fetare. Të dy ligjet janë me rëndësi për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të caktuara në Kosovë, dhe mundet vetëm të shpresohet se implementimi i duhur i tyre do të adresojë të drejtat e komuniteteve minoritare në Kosovë.

Një hap tjetër drejt fuqizimit të mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve minoritare ka qenë faza fillestare e përgatitjes së Strategjisë së Përbashkët për Romët, Ashkalinjtë dhe Egjiptianët në vjeshtë të vitit 2006 nga Zyra e Kryeministrit, Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur. IPVQ-të prapë duhet të demonstrojnë gatishmërinë e tyre për implementimin e duhur të kësaj strategjie në mënyrë që të sigurohet sukcesi i saj.

Një tjetër instrument i të drejtave të njeriut i Këshillit të Evropës i cili është bërë i aplikueshëm në Kosovë në gusht të vitit 2004 është Konventa Evropiane për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor apo degradues apo ddëshkimit. Ky instrument i lejon Komisionit për Parandalimin e Torturës të Këshillit të Evropës të drejtën që të kenë qasje nëpër të gjitha objektet e paraburgimit në Kosovë. Diskutimet mes NATO-s dhe Këshillit të Evropës në lidhje me të drejtën e Komisionit për qasje në objektet e paraburgimit në Kampin “Bondsteel” të KFOR-it kanë rezultuar me një marrëveshje të nënshkruar në mes të vitit 2006. Komisioni ka bërë vizitën e parë zyrtare në objektet e paraburgimit në Kosovë në fund të marsit të vitit 2007, kur kanë vizituar burgjet dhe objektet tjera të paraburgimit si dhe objektet e shëndetit mendor. Pasi i kanë ofruar vërtetimet preliminare tek autoritetet kompetente në fund të vizitës së tyre, Komisioni ka premtuar dorëzimin e një raporti të plotë tek UNMIK-u dhe NATO-ja.

Sa i përket integritetit të programeve për të drejtat e njeriut në strukturat administrative (siç është kërkuar nga rekomandimet e Komisionit të KB-ve për të drejtat e njeriut), njësitë e të drejtave të njeriut janë themeluar në të gjitha ministrinë dhe vazhdojnë të marrin mbështetje në ngritje të kapaciteteve nga OSBE-ja.

Me 19 Mars 2007, Kryeministri ka lëshuar një Urdhëresë administrative për njësitë e të drejtave të njeriut në Qeverinë e Kosovës. Urdhëresa synon sigurimin e strukturave dhe integritetin e njësive për të drejtat e njeriut brenda ministrive të ndryshme. Përveç themelimit të koordinatorëve për të drejtat e njeriut në secilën ministri, urdhëresa administrative përfshinte specifikimet në lidhje me madhësinë e njësive për të drejtat e njeriut, kontratat, trajnimeve dhe ngritjes së kapaciteteve, si dhe roli të cilin luajnë këto njësi brenda ministrive. Gjithashtu përfshinë kushtet mbi obligimet e raportimit të rregullt dhe shkëmbimit të informatave brenda ministrive, dhe kërkon që njësitë për të drejtat e njeriut të bashkëpunojnë me strukturat tjera qeveritare. Neni 12 i urdhëresës për më tepër obligon këto njësi që të bashkëpunojnë me Institucionin e Ombudspersonit; kjo përfshirje më se e mirëseardhur pritet të rrisë bashkëpunimin në mes të Institucionit dhe ministrive në lidhje me çështje të ndryshme për të drejtat e njeriut.

Duket se një numër i ministrive kanë filluar implementimin e kësaj urdhërese, ndonëse niveli dhe shpejtësia e implementimit ka ndryshuar nëpër ministrinë përkatëse. Urdhëresa administrative gjithashtu duhet të zgjidh paqartësitë ekzistuese lidhur me përfshirjen e këtyre njësive në punët e përditshme të ministrive.

Zyra Këshilldhënëse për Qeverisje të Mirë, të drejta të njeriut, mundësitë të barabarta dhe çështje gjinore e cila vepron brenda zyrës së Kryeministrit të Kosovës ka ekzistuar që nga viti 2002. Në saktë të mandatit të gjerë të kësaj zyreje—ku parashihet përfshirje në fazat e ndryshme të përpilimit dhe implementimit të politikave, planeve vepruese dhe strategjive në fushat e lartpërmendura—është e përfshirë në të gjitha politikat qeveritare në lidhje me të drejtat e njeriut. Duke marrë parasysh vështirësitë e dala nga një mandat aq i gjerë si dhe problemet buxhetore me të cilat është ballafaquar në të kaluarën, Zyra këshilluese për Qeverisje të Mirë, të drejta të njeriut, mundësi të barabarta dhe çështje gjinore, ka qenë e dobishme në promovimin e të drejtave të njeriut brenda IPVQ-ve, dhe shpresohet se kjo

zyrë do të mbajë qëndrueshmërinë e saj për të promovuar të drejtat e njeriut. Në urdhëresën e Kryeministrit, Zyra këshilluese ka marrë edhe një mandat për të koordinuar punën e njësisë për të drejtat e njeriut si dhe të mbikëqyr implementimin e urdhëresës. Drejtori i Zyrës gjithashtu ka funksionin e Koordinatorit qeveritar për të drejtat e njeriut.

Përderisa krijimi i këtyre trupave për të drejtat e njeriut është një hap i rëndësishëm drejt përmirësimit të administratës së Kosovës nga brenda, Institucioni i Ombudspersonit vazhdon të jetë i vetmi mekanizëm i pavarur mbrojtës i të drejtave të njeriut në Kosovë që i mban IPVQ-të përgjegjëse përmes ligjit. Institucioni më parë ka qenë kompetent të shqyrtoj ankesat kundër edhe UNMIK-ut; fatkeqësisht, i është hequr kjo kompetencë me nxjerrjen e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit, e cila përcakton kompetencat e Institucionit vetëm për nivelin lokal.

Në këtë moment, Institucioni është ende nën udhëheqje të përkohshme pas skadimit të mandatit të Ombudspersonit Ndërkombëtar në dhjetor të vitit 2005. Është në duart e Kuvendit të Kosovës që të caktoj një Ombudsperson lokal, mirëpo fillimisht ky proces është vonuar për shkak të nxjerrjes së miratimit të vonuar të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/06 dhe procedura për rekrutimin dhe caktimin e Ombudspersonit të ri. Pas një votimi të pasuksesshëm në dhjetor të vitit 2006, PSSP-ja nxori Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/15 në mars të vitit 2007, duke ndryshuar Rregulloren ekzistuese të UNMIK-ut Nr. 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit, në mënyrë që të qartësojë dhe thjeshtësojë procedurat e caktimit në Kuvend. Kuvendi tashmë ka përshtatur rregullat dhe procedurat e veta për emërimin e Ombudspersonit dhe zëvendës Ombudspersonit konform Rregullores së re të UNMIK-ut, dhe ka shpallur ftesën e re për nominime për pozitën e Ombudspersonit. Tani kur procedura e re është ka filluar, caktimi i Ombudspersonit të ri pritet deri në fund të vitit 2007.

Pavarësisht nga këto vështirësi, Institucioni i Ombudspersonit vazhdon të shqyrtoj ankesat për të drejtat e njeriut dhe të monitorojë situatën e përgjithshme nga perspektiva e të drejtave të njeriut. Atëherë kur ankesat kundër UNMIK-ut janë hequr nga kompetencat e tij me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/06, Institucioni i Ombudspersonit në mënyrë të vazhdueshme ka kërkuar udhëzime nga ana e UNMIK-ut në atë se çfarë të bëhet me rastet në pritje kundër UNMIK-ut. Që atëherë nuk ka pasur asnjë reagim ndaj këtyre kërkesave, megjithatë, këto raste ose janë mbyllur për shkak të mungesës së juridiksionit, apo shqyrtime të këtyre rasteve janë kufizuar me udhëheqjen e autoriteteve lokale.

Si rezultat i kufizimeve të kompetencave të Institucionit të Ombudspersonit, nuk ekziston asnjë organ kompetent që të shqyrtojë supozimet kundër UNMIK të cilat përfshijnë shkeljen e të drejtave të njeriut dhe abuzim të autoritetit. Kjo do të thotë që ato pjesë të UNMIK-ut të cilat ende nuk janë transferuar në duart e autoriteteve lokale nuk ju nënshtrohen asnjë mekanizmi të përgjegjësive; megjithëse Misioni i KB-së në Kosovë raporton në Këshillin e Sigurimit të KB-së, ky trup nuk merret me ankesat e individëve për të drejtat e njeriut, përderisa anëtarët e UNMIK-ut në Kosovë gëzojnë imunitet të plotë.

Në një përpjekje për të mbushur këtë “boshllëk të përgjegjësisë”, në mars të vitit 2006 PSSP-ja themeloi të ashtuquajturin Panel këshillëdhënës për të drejtat e njeriut brenda UNMIK-ut, në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12 mbi themelimin e Panelit këshillëdhënës për të drejtat e njeriut. Sipas procedurës së cekur në Rregullore, anëtarët e Panelit emërohet nga Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe emërohen nga PSSP-ja. Paneli ka mandat të pranojë dhe shqyrtojë ankesat kundër UNMIK-ut për të drejtat e njeriut. Prapëseprapë, është e qartë, se si organ këshillëdhënës i cili para së gjithash është pjesë e Misionit të KB-së në Kosovë, Paneli Këshillëdhënës për të drejtat e njeriut është një zëvendësim i pamjaftueshëm i një mekanizmi të pavarur për mbrojtjen e të drejtave të njeriut siç është Institucioni i Ombudspersonit.

Në verën e vitit 2006, kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka emëruar tre kandidatë për panel. Nominimet u aprovuan nga PSSP-ja, i cili emëroi të tre kandidatët që të ulen të Panelin këshillëdhënës për të drejtat e njeriut disa muaj më vonë. Anëtarët e Panelit, megjithatë, deri më tani nuk janë ftuar në Prishtinë që të bëjnë betimin. Megjithëse ka shumë informata rreth Panelit këshillëdhënës për të drejtat e njeriut në faqen e internetit të UNMIK-ut, duke përfshirë ftesën që njerëzit të dorëzojnë ankesat. Paneli ka mungesë të sekretariatit dhe ende nuk ka filluar së vepruari.

Me ngritjen e vëmendjes e cila është duke ju kushtuar ndërrimit të pashmangshëm të UNMIK-ut me një mision të BE-së pas rezolutës për statusin e Kosovës, duket se nuk ka vullnet politik brenda UNMIK-ut për të implementuar Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/12. Kjo çështje ishte ngritur në një raport të lëshuar nga Human Rights Watch në qershor 2007, mbi mungesën e përgjegjësisë së UNMIK-ut dhe KFOR-it. Mundemi vetëm të shpresojmë që misioni i ardhshëm në Kosovë do të jetë i pajisur me një trup të pavarur mbikëqyrës për të drejtat e njeriut i cili shumë i mungon UNMIK-ut. Domosdoshmëria për një panel të tillë duket se është vërejtur nga misioni përgatitor i BE-së i cili tani vepron në Kosovë.

Fakti që UNMIK-u më nuk është nën juridiksionin e Institucionit të Ombudspersonit nuk do të thotë se nuk ka bashkëpunim në mes këtyre dy entiteteve, ndonëse ky bashkëpunim në përgjithësi është i kufizuar në raste individësh. Për shembull, kanë qenë disa takime të cilat kanë përfshirë Institucionin e Ombudspersonit dhe Zyrën e UNMIK-ut për Komunitete, Kthime dhe Çështje të Pakicave në çështjet sa i përket komuniteteve minoritare në Kosovë. Gjithashtu ekzistojnë raste kur Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka ngritur shqetësimet e tij tek PSSP-ja, ndonëse ai jo gjithmonë ka marrë përgjigje në këto letra dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/06 nuk përmban një obligim absolut për bashkëpunim. Çështja e bashkëpunimit mbetet tek vendimi që merret nga departamenti përkatës brenda UNMIK-ut.

Ka pasur përmirësime të konsiderueshme në bashkëpunimin e IPVQ-ve me Institucionin e Ombudspersonit. Gjatë kësaj periudhe të raportimit kemi parë disa raste dashamirësisë nga disa autoritete komunale dhe qendrore. Ekzistojnë shembuj të shumtë kur autoritetet publike kanë reaguar pozitivisht ndaj intervenimeve të Ombudspersonit, dhe ka pas shumë raste ankesat në pritje në Institucion janë zgjidhur falë bashkëpunimit të suksesshëm. Bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës gjithashtu është ngritur gjatë kësaj

periudhe të raportimit, dhe Institucioni pret me padurim debatin e Kuvendit në çështje të ndryshme mbi të drejtat e njeriut të cilat janë adresuar në këtë raport..

Megjithatë, ekzistojnë, një numër shembujsh negativë ku zyra të caktuara të administratës publike nuk kanë reaguar si duhet apo nuk kanë reaguar fare ndaj kërkesave apo intervenimeve të Institucionit. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka lëshuar dy raporte speciale mbi mungesën e bashkëpunimit të Kryetarit të Gjykatës Komunale të Ferizajt dhe të disa trupave brenda Komunës së Skenderajt dhe Mitrovicës. Në të dy raportet e tij, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka ardhur në përfundimin se dështimi i këtyre trupave për të bashkëpunuar me Institucionin e Ombudspersonit ishte shkelje e Nenit 4.6 dhe 4.8 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/06, të cilët kërkojnë nga institucionet publike në Kosovë që ndihmojnë Institucionin e Ombudspersonit në punën e tij dhe të përgjigjen në kërkesat e tij për informata dhe dokumente brenda një kohe të arsyeshme.

Kjo mungesë e bashkëpunimit nga ana e autoriteteve publike në Kosovë ndihmohet nga fakti që Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2006/06 nuk përmban asnjë mekanizëm i cili do të garantonte që zyrat publike të zbatojnë rekomandimet e Institucionit. Në raste të tilla, i vetmi veprim i hapur për Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit me këtë Rregullore është që të informojë Kuvendin e Kosovës dhe/apo mediat. Siç është cekur edhe në Raportet Vjetore më parë, Institucioni i Ombudspersonit do të forcohej shumë nëse Ombudspersoni do të mund të inicioje apo të merrte pjesë në gjykatë apo procedura tjera ligjore (siç është rasti në vendet tjera të botës). Institucioni do të mund të forcohej edhe duke obliguar autoritetet publike që të arsyetojnë mungesën e bashkëpunimit apo të përfshihet një afat kohor fiks për t'u përgjigjur në ligj i cili rregullon Institucionin e Ombudspersonit. Për më tepër, kushte shtesë të cilat garantojnë pavarësimin financiar dhe qëndrueshmërinë e Institucionit janë thelbësore.

Draft Ligji i Kuvendit të Kosovës mbi Institucionin e Ombudspersonit është një hap në drejtim të duhur. Sidoqoftë, Institucioni i Ombudspersonit pavarësisht përfshirjes së tij që nga fillimi, nuk ka qenë në gjendje të bindë grupin punues i cili ishte duke përgatitur draftin e parë që të përfshijë këto si dhe elemente të tjera të cilat do të ndihmonin në fuqizimin e Institucionit. Komisioni i Venedikut i Këshillit të Evropës siguroi komente për këtë ligj në qershor të vitit 2007, dhe Kuvendi i Kosovës pritet që të marrë në konsideratë këto komente para se të kalojë ligjin.

Mbetet të shihet nëse Kuvendi i Kosovës do të ndërrojë emrin e postit nga Ombudsperson në Avokati i Popullit. Ndërrimi i emrit të një institucioni aq mirë të themeluar gjashtë vite pas krijimit të tij mund të krijonte konfuzion midis popullatës së gjerë; gjithashtu do të kërkonte më shumë harxhime buxhetore, për shembull, kostoja e kampanjave të quajtura kampanjat për informimin e publikut.

Institucioni i Ombudspersonit mund të forcohet vetëm si një institucion i përkushtuar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut nëse ekziston një njohuri më e gjerë e të drejtave të njeriut nga individët brenda popullatës së përgjithshme. Shumë instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kanë qenë direkt të aplikueshme në Kosovë gjatë

gjashtë viteve të kaluara, mirëpo një numër i zyrtarëve publik (duke përfshirë edhe gjyqësorin) nuk janë veçanërisht të familjarizuar me parimet e tyre si dhe përbërjet specifike. Situata është edhe më e keqe brenda publikut të gjerë.

Kjo nuk është shumë për t'u çuditur duke pas parasysh faktin që shumica e këtyre instrumenteve (Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e saj, Konventa mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor) nuk kanë qasje nga publiku. Vetëm ata njerëz të cilët e dinë se çfarë janë duke kërkuar, mund të gjejnë këto instrumente nëpërmes internetit. Gjetja e këtyre teksteve në gjuhën shqipe dhe atë serbe është edhe më e vështirë, e cila kërkon si imagjinatën ashtu edhe njohuri të mirë mbi faqet e internetit për të drejtat e njeriut nga Shqipëria, Serbia dhe vendet tjera të rajonit.

Vetëdija e përgjithshme mbi instrumentet e të drejtave të njeriut mundet vetëm të qojë në përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë nëse ekziston një trupë e duhur gjyqësore e pavarur, me mandat, që të merret me ankesat për të drejtat e njeriut. Një trupë e tillë është më rëndësi të veçantë për Kosovën, pasi që territori i saj mbetet njëri ndër territoret e pakta në Evropë ku nuk aplikohen mekanizmat evropianë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të Këshillit të Evropës. Përderisa Qeveria e Serbisë (e cila ka ratifikuar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 2003) nuk ka juridiksion mbi territorin e Kosovës, statusi i UNMIK-ut si një mision ndërkombëtar pengon atë në nënshkrimin e konventës e cila para së gjithash është një traktat i shumanshëm në mes të shteteve. Kjo çështje mund të adresohet vetëm atëherë kur statusi i ardhshëm i Kosovës të jetë zgjidhur.

Në mungesë të një gjykate të veçantë apo ndonjë trupe tjetër vendimmarrëse kompetente për të ekzaminuar raste të tilla. Përderisa është duke bërë më të mirën që mund të bëjë për të mbushur këtë boshllëk, Institucioni nuk mund të zëvendësojë një trupë gjyqësore e cila mund të lëshojë vendime gjyqi të detyrueshme të cilat nëse do të ishte e nevojshme mund, të zbatoheshin me forcë. Për shkak të mandatit të kufizuar të Institucionit të Ombudspersonit dhe mbështetja e vazhdueshme në vullnet të mirë dhe bashkëpunim të strukturave qeveritare, sistemi i përgjithshëm i mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë mbetet i dobët, i parregullt dhe mjaft ulët kundrejt standardeve të të drejtave të njeriut të gëzuara në pjesët tjera të Evropës

Komunitetet minoritare në Kosovë

Në popullsinë e përgjithshme të Kosovës, shqiptarët etnik përbëjnë rreth 90% të tërë popullsisë kurse 10% të tjerë përbëhen nga serbët, romët, turqit, boshnjakët, goranët, egjiptianët dhe romët. Derisa këta paraqesin pakicën e popullsisë së përgjithshme në Kosovë, ekzistojnë disa zona të Kosovës ku shqiptarët etnik janë pakicë, siç është për shembull pjesa veriore e Mitrovicës dhe komunat e Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit në veri të Kosovës, komuna e Shtërpçës në jug dhe komuna e Novobërdës në lindje të Kosovës. Në zonat e banuara kryesisht me popullsi shqiptare, ka prirje të ndryshme për bashkëjetesë për sa i përket komuniteteve minoritare—derisa është e zakonshme që turqit, ashkalinjtë dhe egjiptianët të jetojnë bashkë me shqiptarët në zonat urbane dhe në fshatra, serbët dhe romët jetojnë më shumë në fshatrat dhe enklavat e përziera apo një-etnike të shpërndara nëpër tërë Kosovën. Në pjesë të ndryshme të Kosovës është edhe një numër i fshatrave të boshnjakëve. Gjithashtu, ka edhe kroatë që jetojnë në disa zona të Kosovës qendrore dhe lindore. Shumica e popullsisë gorane në Kosovë jeton në komunën e Dragashit. Problemet e përgjithshme me të cilat përballen të gjitha komunitetet minoritare në Kosovë janë arsimi, papunësia dhe (pa)mundësia për t'i përdorur gjuhët e tyre përkatëse, në kontekstin zyrtar nuk do të ishin shqiptarët apo serbët.

Sikur edhe gjatë periudhës së kaluar për të cilën është raportuar, ndarja mes komunitetit shqiptar dhe serb është ende e qartë dhe është më së shumti rezultat i qëndrimeve të kundërta politike të këtyre komuniteteve në lidhje me të ardhmen e Kosovës (shqiptarët dëshirojnë një Kosovë të pavarur, derisa serbët e Kosovës insistojnë që ajo do të mbetet pjesë përbërëse e Serbisë). Shumica, nëse jo të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me jetën e serbëve të Kosovës mbesin jashtëzakonisht të politizuara derisa Këshilli i Sigurimit i KB-ve dhe shtetet anëtare të tij janë të angazhuara në diskutimet intensive për statusin e Kosovës.

Mund të thuhet që shqiptarët dhe serbët kanë jetuar jetë të ndarë gjatë këtyre tetë viteve të fundit. Në zonat ku shqiptarët janë shumicë, ka shumë pak ose kurrfarë kontakti me komunitetin serb dhe rom dhe, në një masë më të vogël, me komunitetin boshnjak dhe goran. Në këtë kontekst, një nga pengesat më të mëdha është çështja e gjuhës. Në shumicën e rasteve, serbët, goranët, romët dhe boshnjakët që jetojnë në zonat ku flitet gjuha serbe nuk e flasin gjuhën shqipe. Këtë çështje e ka ngritur Ombudspersoni i mëparshëm ndërkombëtar në Kosovë qysh në vitin 2005, por deri më këtë datë nuk ka pasur ndonjë përpjekje nga ana e IPVQ-ve për të ofruara kurse pa pagesë të gjuhës shqipe për ata pjesëtarë të komuniteteve minoritare që kanë vullnet që ta mësojnë atë. Kurse të tilla do të kishin qenë posaçërisht të dobishme për pjesëtarët e komuniteteve minoritare që punojnë në IPVQ dhe do të kishte qenë hap i rëndësishëm për ta tejkaluar hendekun që gjendet mes këtyre komuniteteve.

Shumë fshatra në zonat minoritare, në veçanti enklavat serbe dhe rome, nuk vizitohen me rregull nga zyrtarët komunal. Derisa ka pasur aktivitete për ta përmirësuar qasjen në disa prej komunave, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e qeverisë në nivelin qendror, prapë se prapë duhet të përmirësohen kontaktet mes zyrtarëve komunal dhe banimeve të tilla nëpër

Kosovë. Në anën tjetër, enklavat serbe ende pranojnë përkrahje nga qeveria e Serbisë. Përfaqësues të ndryshëm të IPVQ-ve i kritikojnë banorët e enklavave për këtë, derisa këta të fundit ankohet që IPVQ-të nuk i përkrahin ata.

Situata e nxehtë politike dhe tensionet mes komunitetit shqiptar dhe serb kanë sjellë deri te një numër i incidenteve ndëretnike; për shembull, rregullisht janë hedhur me gurë autobusët që transportojnë kryesisht serbët nga enklavat në komunën e Skenderajt dhe të kthyerit në komunën e Pejës. Incidente të tjera të tilla janë raportuar edhe nga komunat e Gjilanit dhe Mitrovicës. Në nëntor të vitit 2006, janë hedhur gurë edhe në një autobus që po transportonte nxënësit serbë dhe romë në komunën e Obiliqit. Shpesh herë, kryerësit e këtyre akteve janë të moshës jomadhore. Kishte pasur një rast kur Kryetari i njëjës nga komunat është angazhuar personalisht në këtë çështje duke biseduar me familjet e dy djemve që kishin qenë përgjegjës. Pas kësaj, incidentet e hedhjes së gurëve u ndalën për një kohë, por duket që tani rishtas kanë filluar. Fatkeqësisht, nisma të tilla nga udhëheqësit e komunave përkatëse janë shumë të rralla, që përsëri tregon që ata me të vërtetë nuk e ndiejnë ndonjë përgjegjësi për të zgjidhur çështje të tilla.

Në qershor, gusht, shtator, nëntor dhe dhjetor të vitit 2006, ka pasur një numër të sulmeve me armë, të shumtën kundër të kthyerve serbë në komunën e Pejës. Një sulm është shënuar edhe në rajonin e Gjilanit, si dhe një sulm me granatë në një kafene në pjesën veriore të Mitrovicës. Të gjitha këto incidente kanë lënë një të vdekur dhe një numër të madh të të lënduarve. Megjithatë, duhet të theksohet edhe që Shërbimi Policor i Kosovës nuk ka mundur ta vërtetojë nëse të gjitha sulmet kishin pasur motive etnike.

Incidentet e tilla nuk do të duhej të shihen si shembuj të keqësimit të situatës së sigurisë. Përkundrazi, përkundër brishtësisë së vazhdueshme të situatës së përgjithshme të sigurisë në Kosovë, liria e lëvizjes së serbëve dhe romëve vazhdon të përmirësohet, posaçërisht në komunat e Prishtinës, Gjilanit dhe Prizrenit. Në anën tjetër, liria e lëvizjes në komunat e Pejës dhe Mitrovicës ende mbetet problematike për pjesëtarët e komuniteteve të lartpërmendura. Turqit, boshnjakët, goranët, ashkalinjtë dhe egjiptianët kryesisht nuk kanë probleme për të lëvizur në zonat ku jetojnë.

Transporti publik vazhdon të kalojë pa u ndalur nëpër enklavat e banuar me serbë dhe romë. Të vetmet mjete të transportimit për pjesëtarët e këtyre komuniteteve janë automjetet private, autobusët e vegjël, një linjë hekurudhore dhe transporti humanitar me autobusë që fillimisht e kishte ofruar UNMIK-u, e tani Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim. Kjo është në hap me nënshkrimin e marrëveshjes operative për bartjen e përgjegjësive në gusht të vitit 2006. Të dy ministratë morën zyrtarisht përgjegjësitë për këtë formë të transportit nga Departamenti i UNMIK-ut për administratën publike në janar të vitit 2007. Sipas informatave të pranuar nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, nga gjithsej 17 linja të parapara të autobusëve, 16 janë duke funksionuar si duhet kurse linja e autobusit që qarkullonte prej Leposaviqit në veri të Kosovës e deri në pjesë jugore të Mitrovicës është ndërprerë sepse askush nuk kishte qenë duke e shfrytëzuar atë.

Transporti i sigurt i komuniteteve minoritare, liria e lëvizjes dhe mundësia për të komunikuar me komunat dhe zonat tjera në Kosovë të banuara me pjesëtarë tjerë të komuniteteve të tyre ka një rol kyç në mbrojtjen e të drejtave të këtyre personave. Për këtë arsye, është thelbësore që të avancohet kjo formë e transportit duke e përfshirë atë në sistemin e përgjithshëm të transportit publik. Derisa janë ndarë mjete të mjaftueshme për të garantuar që linjat e autobusëve do të vazhdojnë të funksionojnë deri në fund të vitit, është e rëndësishme qenësore që IPVQ-të të vazhdojnë të ndajnë mjete të mjaftueshme për këtë transport edhe në vitin 2008, si dhe në vitet tjera në vijim.

Frika reale apo e paramenduar nga sulmi gjithashtu mund të ketë ndikim të drejtpërdrejt në situatën e banimit për shumë serbë dhe romë. Shumica e shtëpive të shkatërruara gjatë marsit të vitit 2004 tani janë rindërtuar, por shumë nga pronarët e këtyre shtëpive ose i kanë shitur dhe janë larguar, ose vazhdojnë të jetojnë në kontejnerë nga enklavat apo fshatrat serbe sepse kanë frikë të kthehen.

Tridhjetë e gjashtë kisha, manastire dhe objekte tjera kulturore dhe fetare ortodokse që ishin shkatërruar gjatë marsit të vitit 2004 tani janë rindërtuar pjesërisht ose në tërësi, dhe puna në të gjitha këto objekte do të duhej të përfundojë deri në fund të vitit 2007.

Megjithatë, prej nëntorit të vitit 2006 e deri në mars të vitit 2007, janë raportuar disa sulme në objektet fetare. Rasti më i vonshëm ishte sulmi me granatë të dorës në Manastirin e Deçanit – për fat të mirë, granata nuk e qëlloi manastirin dhe shpërtheu në një fushë në afërsi. Hetimet e policisë lidhur me këtë rast ende vazhdojnë. Sulmet e tilla vazhdojnë ta pengojnë ushtrimin e të drejtave fetare, posaçërisht për komunitetin serb. Shumë njerëz kanë frikë të marrin pjesë në shërbimet e kishës, posaçërisht nëse kisha nuk gjendet në afërsi të shtëpive të tyre.

Një çështje tjetër që kishte të bëjë me mbrojtjen e objekteve fetare përfshin vendimin e UNMIK-ut për ta forcuar hyrjen dhe muret Patriarkatit Ortodoks në Pejë. Në prill dhe maj të vitit 2007, Komuna e Pejës nxjerri vendimet për t'i ndaluar këto punë ndërtimore dhe ato nuk janë vazhduar prej atëherë.

Sa i përket rindërtimit të shtëpive të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve që ishin shkatërruar pas përfundimit të konfliktit të vitit 1999, gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportohet më në fund filloi rindërtimi i lagjes së romëve (Mëhalla e Romëve) në pjesën jugore të Mitrovicës. Një numër i madh i banorëve të dikurshëm të Mëhallës kishin jetuar më shumë se gjashtë vite në kampe në veri të Kosovës në kushte jashtëzakonisht të mjera infrastrukturore dhe higjienike. Rreziqet për shëndetin e banorëve të kampit, të shkaktuara nga niveli i lartë i helmimit me plumb nga një deponi në afërsi, më në fund solli deri te një presion i konsiderueshëm nga shtypi ndërkombëtar dhe Institucioni i Ombudspersonit. Si rrjedhim, UNMIK-u filloi ta planifikojë transferimin e këtyre njerëzve në kampin “Osterode” të KFOR-it, i cili ofronte kushte shumë më të mira higjienike dhe të jetës, duke përfshirë një fushë të sportit dhe qendrën për gratë. UNMIK-u gjithashtu filloi ta planifikojë kthimin e këtyre njerëzve në Mëhallën e Romëve, pas rindërtimit të shtëpive atje falë donacioneve ndërkombëtare. Shumica e banorëve të kampeve në veri të Kosovës tani janë bartur në kampin “Osterode”, kurse tetë familje

janë kthyer në shtëpitë dhe banesat e rindërtuara në Mëhallën e Romëve. Nëntëmbëdhjetë familje tjera janë kthyer në Mëhallën e Romëve nga banimet e PZhBV-ve në Serbi dhe në Mal të Zi. Familjet e mbetura në kampin “Osterode” dhe ato që jetojnë në kampet e tjera të veriut të Kosovës ende e presin kthimin e tyre në Mëhallë.

Gati të gjithë banorët, kryesisht romë dhe serbë, të një kampi tjetër të PZhBV-ve që gjendet në Plemetin, afër Obiliqit, në Kosovën Qendrore, tani kanë hyrë në banesat e reja që janë ndërtuar posaçërisht për ta. Kur të jenë larguar edhe dhjetë familjet e mbetura, kampi me siguri do të mbyllet deri në fund të vitit 2007. Ende është e paqartë se çfarë do të ndodhë me objektet arsimore brenda kampit pasi që ai të mbyllet; banorët e dikurshëm të kampit dëshirojnë ta mbajnë shkollën, derisa Komuna po ofron transport për t’i dërguar fëmijët në shkollë në Obiliq ashtu që të mund të mbyllet shkolla në Plemetin.

Sa i përket jetës së qëndrueshme në Kosovë, papunësia ende paraqet një dukuri që ndikon në tërë shoqërinë kosovare. Zakonisht, grupet e cënueshme vuajnë më së shumti nga situata e mjerë ekonomike dhe komunitetet minoritare nuk paraqesin përjashtim të kësaj rregulle. Shumë komunitete, posaçërisht komuniteti serb dhe rom, ende nuk kanë qasje të duhur në tregun e rregullt të punës në Kosovë. Punonjësit e Institucionit të Ombudspersonit vlerësojnë që niveli i papunësisë në mesin e komunitetit serb është i lart 70%; ndërsa në disa fshatra të tërë kthyerve serbë mund të jetë bile edhe 100%. Burimi kryesor i të ardhurave në fshatrat serbe është bujqësia, por në shumë raste, pronarët e tokës nuk kanë qasje në tokën e tyre, qoftë për shkak se ajo është e uzurpuar nga ndonjë palë e tretë, apo për shkak se kanë frikë ta kultivojnë tokën e tyre nëse ajo nuk gjendet në afërsi të fshatrave të tyre. Kështu, shumë nga banorët e këtyre fshatrave jetojnë nga ndihmat sociale ose nga mbledhja dhe shitja e hekurishteve dhe drurit.

Në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, niveli i përgjithshëm i papunësisë është edhe më i lartë se në komunitetin e rëndomtë serb dhe kryesisht sillet rreth 98%. Shumë faktorë të ndryshëm janë shkaktarë të kësaj situatë, por kryesori me siguri është mungesa e shkollimit dhe kualifikimeve të duhura për shkak se pjesëtarët e këtyre komuniteteve e braktisin shkollimin në një moshë të re. Derisa disa nga këta njerëz ndonjëherë gjejnë punë si punëtorë dore dhe ka familje që marrin ndihma sociale, është shumë e rrallë që ata të kenë punë të rregullt që do ta mundësonte një jetë të qëndrueshme. Shumë prej tyre gjithashtu jetojnë nga mbledhja dhe shitja e materialeve të hedhura.

Në mënyrë që të ringjallet zhvillimi ekonomik për komunitetet minoritare në Kosovë, Agjencia Evropiane për Rindërtim ka filluar një numër programesh për t’u ofruar pjesëtarëve të këtyre komuniteteve grante individuale ose kolektive për të nisur, për shembull, biznese të reja apo për të zhvilluar ato ekzistuese. Këto programe janë për biznese të mëdha dhe të vogla dhe realizohen nga ana e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM). Një numër i njerëzve tashmë janë paraqitur për grante brenda këtyre programeve, një fakt që mund të ndihmojë në lehtësimin e vështirësive me të cilat përballet pjesëtarët e këtyre komuniteteve.

Në disa raste, duket që komunat madje janë duke punuar kundër një jete të qëndrueshme të komuniteteve minoritare. Në mesin e një numri të rasteve kur probleme

infrastrukturore të këtyre komuniteteve hasën në indiferencë të autoriteteve komunale, vlen të veçohet problemi i komuniteti boshnjak në luginën e Zhupës në komunën e Prizrenit. Komuna vendosi që t'i ndërtojë mbi 400 shtëpi pushimi në këtë luginë piktoreske, me qëllim që në të ardhmen t'i japë me qira. Përveç faktit që një numër i tillë i madh i objekteve ndoshta edhe do ta shkatërronte qetësinë dhe vetminë e luginës, problemi kryesor për fshatrat e boshnjakëve ishte fakti që këto shtëpi do ta dobësonin edhe më tej furnizimin tashmë të pakët me ujë në luginë. Mbetet vetëm të shpresohet që Komuna e Prizrenit ka ndonjë plan për ta përmirësuar furnizimin me ujë para se të përfundohen këto shtëpi.

Një çështje tjetër që vazhdon të jetë problem për shumë pjesëtarë të komuniteteve minoritare në mbarë Kosovën ajo e përkujdesjes shëndetësore. Në këtë kontekst, sistemi paralel i shëndetësisë i udhëhequr dhe financuar nga Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Serbisë ende ofron shërbime për komunitetin serb dhe komunitetet tjera që jetojnë në zonat e banuara me serbë, si në zonat ku serbët përbëjnë shumicën, ashtu edhe në enklavën serbe në Graçanicë. Kjo strukturë paralele nuk njihet nga UNMIK-u apo IPVQ-të dhe nuk ka ndonjë lloj bashkëpunimi mes këtij sistemi të shëndetësisë dhe atij që e udhëheqin IPVQ-të. Punonjësit në entet paralele shëndetësore marrin pagat vetëm nga Serbia dhe i kanë refuzuar pagat nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës prej marsit të vitit 2006 për shkak se Qendra Koordinuese për Kosovë (QKK) e Qeverisë së Serbisë u kishte thënë që do të duhej të zgjidhnin nëse do të merrnin pagat nga IPVQ-të apo nga Serbia. Më parë, punonjësit e këtyre enteve shëndetësore kishin marrë paga si nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, ashtu edhe nga Buxheti i Qeverisë së Serbisë. Do të duhej të theksohet që pagat nga Buxheti i Qeverisë së Serbisë janë më të larta se ato që janë marrë më herët nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, dhe përfshijnë edhe përfitime sociale dhe të tjera.

Shumica e këtyre enteve paralele shëndetësore kryesisht ofrojnë ndihmën themelore shëndetësore, edhe pse në Graçanicë, Lapllasellë dhe pjesën veriore të Mitrovicës ka edhe spitale.

Një nga problemet lidhur me qasjen në shëndetësi të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve është fakti që ata shpesh herë nuk mund të paraqiten për sigurim shëndetësor apo ndihma sociale për shkak se shumë pjesëtarë të këtyre komuniteteve nuk janë të regjistruar. Sipas vlerësimit të KKKBR-së nga mesi i vitit 2006, ky problem prek përafërsisht 20–40% të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve—në shumicën e këtyre rasteve, familjet nuk janë regjistruar me gjenerata të tëra. Kjo parandalon që këta persona t'i gëzojnë shumë të drejta themelore, siç është e drejta për përkujdesje shëndetësore, arsim dhe mbrojtje sociale. Sipas një raporti të nxjerrë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë lidhur me regjistrimin civil të këtyre komuniteteve (pas një monitorimi që u ndërmor prej mesit të dhjetorit 2006 deri në mes të janarit 2007), madje ekziston rreziku që këta persona të peregjistruar të mbesin pa shtetësi.

Në maj të vitit 2006, si përgjigje në këtë problem, Zyra e Kryeministrit nxjerri rekomandime për komunat që të garantojnë që procedurat e papërfunduara të regjistrimit për komunitetet e mësipërme të mbyllen brenda gjashtë muajve të ardhshëm dhe që këta

persona të lirohen nga pagesa e taksave të vonuara për shërbime administrative. Gjithashtu, KKKBR e nisi një plan veprimi për një fushatë të regjistrimit civil drejtuar komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Partneri zbatues, një OJQ me emrin “Civil Rights Programme Kosovo”, e filloi zbatimin e kësaj fushate në shtator të vitit 2006. Në të njëjtën kohë, KKKBR vazhdoi të mbështesë një qasje më fleksibile dhe më të harmonizuar ndaj kësaj çështje në të gjitha komunat e Kosovës.

Megjithatë, sipas këtij raporti të OSBE-së, vetëm disa komuna i ndoqën rekomandimet që i kishte nxjerrë Zyra e Kryeministrit, ndërsa një numër i komunave pohuan që kurrë nuk i kishin pranuar ato. Në përgjithësi, duket që shumica e komunave janë larg nga miratimi i një qasjeje të përbashkët dhe që vetëm një përqindje e vogël e tyre kanë ndërmarrë masa për ta lehtësuar regjistrimin e pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Në shumë zyra komunale për regjistrim duket të ketë mungesë fleksibiliteti në këtë drejtim.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet gjithashtu ndodhi edhe zhvillimi i një strategjie të përbashkët për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian në mes të Zyrës së Kryeministrit, Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe Fondacionit Kosovar për shoqëri të hapur, në vjeshtë të vitit 2006. Fushat e mbuluara me këtë strategji përfshijnë: arsimin, banimin (duke përfshirë rindërtimin dhe legalizimin e banimeve jozyrtare), punësimin dhe forcimin e ekonomisë, situatat specifike të PZhBV-ve dhe refugjatëve, kthimi azilkërkuesve të refuzuar, regjistrimi/dokumentet personale, siguria, qasja në ndihmën sociale, qasja në shëndetësi, situata specifike e gruas, informacionet (mediat), kultura, pjesëmarrja dhe përfaqësimi politik, dhe diskriminimi. Derisa në diskutime rreth kësaj strategjie kanë qenë të përfshirë edhe përfshirë edhe një numër i përfaqësuesve të këtyre komuniteteve dhe janë mbajtur një numër i seminareve në lidhje me fusha të ndryshme, duket që strategjia nuk është duke përparuar aq shpejtë sa ishte shpresuar. Megjithatë, kur njëherë të jetë duke ecur si duhet, mbetet vetëm të shpresohet që ajo do t’ia arrijë të zgjidhë disa nga çështjet më serioze të këtyre komuniteteve, siç janë rindërtimi, punësimi, regjistrimi, qasja në shëndetësi dhe arsimit.

Sa i përket arsimit në përgjithësi, situata është e ngjashme me atë të sektorit të shëndetësisë–vazhdojnë të ekzistojnë dy sisteme në Kosovë. Shkollat paralele të udhëhequra dhe financuara nga Ministria e Arsimit e Serbisë ende ekzistojnë në të gjitha rajonet ku jetojnë serbët, romët që e flasin gjuhën serbe dhe goranët. Ato ndjekin programin mësimor të Serbisë, që tani pas reformave arsimore në Kosovë ndryshon nga ai që e ndjekin shkollat tjera në Kosovë. Punonjësit profesional dhe teknik të këtyre shkollave marrin pagat nga buxheti i Qeverisë së Serbisë. Njëlloj si në sektorin e shëndetësisë, ata vendosën që t’i mbajnë pagat e Serbisë dhe refuzuan pagat nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës në mars të vitit 2006.

Shumica e shkollave që ndjekin programin mësimor të Kosovës nuk ofrojnë mësim në gjuhën serbe kurse në Universitetin e Prishtinës ligjëratat mbahen vetëm në gjuhën shqipe. Për këtë arsye, shumica e fëmijëve të komunitetit serb dhe disa nga komuniteti rom dhe goran mund të shkollohen në gjuhën e tyre vetëm nëse e vijnë mësimin në shkollat paralele. Pasi që programi mësimor në Kosovë tani dallon nga programi mësimor në Serbi dhe Bosnjë dhe Hercegovinë, si dhe nuk njihet në asnjërin nga këto vende,

nxënësit që synojnë ta vazhdojnë shkollimin e lartë atje mund ta bëjnë këtë vetëm nëse e vazhdojnë shkollimin sipas programit mësimor të Serbisë.

Sa i përket komunitetit goran, ky problem ka ekzistuar prej vitit 2003 dhe palët ende nuk kanë arritur që ta gjejnë ndonjë kompromis. Ka pasur përpjekje nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që t'i integrojë nxënësit goranë në sistemin kosovar në nivel lokal, mirëpo mësuesit, prindërit dhe nxënësit e komunitetit goran kanë refuzuar vazhdimisht që ta pranojnë programin mësimor të Kosovës për shkak të arsyeve të përshkruara më lart. Mësuesit goranë gjithashtu marrin pagat nga buxheti i Qeverisë së Serbisë, edhe pse shkollat administrohen nga ana e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës.

Kjo krijoi probleme të caktuara kur në vjeshtë të vitit 2006, Komuna e Dragashit vendosi të hapë konkursin për 161 poste të punonjësve arsimor që i mbanin mësuesit goranë që kishin refuzuar që t'i nënshkruajnë kontratat e punës me IPVQ-të për shkak të pakënaqësisë së tyre me programin mësimor të Kosovës dhe faktit që ky program mësimor i kufizonte mundësitë e nxënësve të tyre për ta vijuar shkollimin e lartë në rajon. Autoritetet lokale ua ndaluan mësuesve që ta ndjekin programin mësimor në shkollat e Dragashit dhe insistuan që të punësohen mësuesit e ri përkundër ankesave të prindërve që mësuesve të ri u mungonin kualifikimet përkatëse. Si rezultat, shumica e nxënësve goranë përfunduar duke i bojkotuar këto shkolla, duket që tani një numër i vogël i nxënësve ndjek programin mësimor të Kosovës, kurse shumica dërmuese është duke e vijuar mësimin në shkollat në fshatra. Gjithsej 130 nxënës të shkollës së mesme janë duke e vijuar mësimin në shkollën në fshatin Milikë afër Dragashit, e cila mbetet në një gjendje jashtëzakonisht të mjerë.

Megjithatë, këto çështje nuk kanë të bëjnë me të gjithë pjesëtarët e komunitetit goran. Fëmijët tjerë goranë, bashkë me pjesëtarët e komunitetit boshnjak dhe turk, shkojnë në shkollat e integruara në sistemin arsimor të Kosovës. Ata e vijojnë mësimin në gjuhën shqipe dhe disa lëndë në gjuhën turke dhe boshnjake sipas programit mësimor nga Turqia dhe Bosnja dhe Hercegovina.

Shkolla të tilla nuk ekzistojnë në të gjitha pjesët e Kosovës. Në Prizren, për shembull, më shumë se 1000 nxënës të komunitetit boshnjak mbajnë mësim vetëm në gjuhën shqipe. Një situatë e ngjashme është edhe në Gjakovë, ku prindërit kërkuan për lëndë shtesë në gjuhën e tyre në mënyrë që t'i mësojnë fëmijët e tyre për kulturën, historinë dhe traditën e tyre, mirëpo Drejtoria komunale e arsimit e refuzoi këtë kërkesë me arsyetim të mungesës së mjeteve të duhura financiare.

Fëmijët e komunitetit rom e ndjekin sistemin arsimor të Kosovës ose shkojnë në shkollat paralele, varësisht nga njohja e gjuhës shqipe. Shkalla e lartë e varfërisë në këtë komunitet vazhdon të paraqesë vështirësi serioze për shkollimin e të rinjve dhe si rrjedhim, shumë familje thjeshtë nuk mund t'i blejnë tekstet mësimore për fëmijët e tyre. Fëmijët romë e braktisin shkollimin në moshë shumë të re, që rezulton me nivel të ulët të shkollimit në këtë komunitet. Një dukuri e njëjtë është vërejtur edhe në komunitetin ashkali dhe egjiptian.

Një problem tjetër që rrjedh nga braktisja e shkollimit të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptian dhe ka ndikim në këto komunitete është analfabetizmi. Përkundër ekzistimit të një numri të programeve dhe projekteve që kanë për qëllim zhdukjen e analfabetizmit, ende ka shumë njerëz të këtyre komuniteteve që kanë vështirësi të mëdha për të marrë pjesë në jetën publike për shkak të paaftësisë së tyre për të shkruar dhe lexuar. Ky problem ka ekzistuar edhe para vitit 1999, mirëpo situata është keqësuar edhe më tej prej atëherë për shkak të mungesës së sigurisë për disa pjesë të këtyre komuniteteve, si dhe mungesës së shkollimit për fëmijët e tyre.

Sa i përket shkollimit të lartë, situata është e njëjtë sikur edhe në periudhën e kaluar për të cilën është raportuar. Pjesëtarët e komuniteteve minoritare që nuk e flasin gjuhën shqipe nuk mund ta vijnë në Universitetin e Prishtinës, që nënkupton që ata duhet ta ndjekin shkollimin e lartë në pjesën veriore të Mitrovicës, në Serbi apo në shtetet tjera në rajon ku gjuha është e ngjashme me të tyre. Një përjashtim nga kjo rregull paraqesin studentët boshnjakë, që mund të ndjekin ligjëratat në gjuhën e tyre amtare në një shkollë për biznes në Pejë dhe një fakultet të edukimit në Prizren.

Lidhur me përdorimin e gjuhëve të komuniteteve minoritare në Kosovë, gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, përkatësisht më 20 tetor 2006, u shpall Ligji Kuvendit të Kosovës për përdorimin e gjuhëve, qëllimi i të cilit ishte që të krijohet një mjedis ku të gjitha komunitetet do të mund ta gëzonin identitetin e tyre gjuhësor. Gjuha shqipe dhe gjuha serbe, bashkë me alfabetet përkatëse, mbesin gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të njëjtë në të gjitha institucionet. Gjuha boshnjake, turke dhe rome kanë statusin e gjuhëve zyrtare në institucionet e atyre komunave ky më shumë se 5% të popullsisë i flasin ato gjuhë. Gjuha turke bile u vendos si gjuhë zyrtare në Komunën e Prizrenit, ku jetojnë shumë pjesëtarë të komunitetit turk. Disa pjesëtarë të komunitetit turk kanë dëshirë që gjuha turke të bëhet gjuhë zyrtare edhe në pjesët tjera të Kosovës.

Ligji i Kuvendit të Kosovës për përdorimin e gjuhëve ndalon çdo diskriminim në baza gjuhësore dhe qartas e mundëson përdorimin publik dhe privat të të gjitha gjuhëve. Megjithatë, një numër i dispozitave të tij ligjore ende nuk janë duke u respektuar në mënyrë adekuate në praktikë. Rastet praktike tregojnë që për sa i përket përdorimit të një numri të gjuhëve minoritare (kryesisht gjuhës dhe alfabetit serb), nuk është bërë ndonjë ndryshim i madh prej shpalljes së këtij Ligji. Një raport i nxjerrë nga në vitin 2006 nga Misioni i OSBE-së në Kosovë e konfirmoi që përkthimi i ligjeve, rregulloreve dhe dokumenteve tjera është ende joadekuat dhe shpesh herë i kualitetit të dobët; të gjitha komunat nuk kanë njësi përkthimi dhe ato njësi që tashmë ekzistojnë shpesh herë nuk kanë përvojë dhe nuk janë të trajnuara si duhet. Sipas ankesave të pranuar në Institucionin e Ombudspersonit, duket që shumë dokumente, duke përfshirë faturat dhe vendimet e Komunës vazhdojnë të mos përkthehen dhe shumë rrallë ndodh që komunat ta respektojnë drejtshkrimin e emrave në gjuhën serbe, boshnjake apo turke. Në përgjithësi, duket të mos ekzistojnë politikat komunale lidhur me gjuhët për t'i përmbushur obligimet e përcaktuara me Ligjin për përdorimin e gjuhëve dhe duket që ka shumë pak apo kurrfarë aktivitete për të ju qasur problemeve të komuniteteve në këtë

drejtim, (siç është për shembull vetëdijesimi apo trajnimi i punonjësve komunal) në mënyrë që të garantohet zbatimi i drejtë dhe i plotë i këtij Ligji.

Sa i përket komunikimit në përgjithësi, situata në shërbimet postare dhe telefonike mbetet e njëjtë sikur edhe në kohën e nxjerrjes së Raportit të fundit vjetor. Komunitetet e ndryshme ende përdorin sisteme të ndryshme. Shqiptarët, ashkalinjtë, egjiptianët, boshnjakët dhe turqit i shfrytëzojnë kryesisht shërbimet e Postës dhe Telekomit të Kosovës, derisa pjesëtarët e komunitetit serb dhe rom që jetojnë në enklavat në pjesën qendrore, veriore dhe jug-lindore të Kosovës i shfrytëzojnë shërbime postare të Serbisë. Lidhur me telefoninë mobile, në nëntor të vitit 2006, Agjencioni Kosovar për Telekomunikacion i shkyçi dhe ua konfiskoi pajisjet dy operatorëve të telefonisë mobile nga Serbia në Prishtinë dhe Gjilan, që në mënyrë ekskluzive i mbulonin zonat e banuara me pjesëtarë të komunitetit serb. Sipas Agjencionit Kosovar për Telekomunikacion, këto kompani ishin duke operuar në mënyrë të paligjshme në Kosovë. Shfrytëzuesit e shërbimeve të këtyre kompanive ishin kryesisht pjesëtarët e komunitetit serb për të cilët kjo ishte lidhja e vetme me Serbinë dhe pjesët tjera të Kosovës, (pasi që shumica e tyre nuk kanë qasje në linje tokësore). Pjesëtarët e komuniteteve tjera gjithashtu ishin duke shfrytëzuar shërbimet e këtyre dy operatorëve të telefonisë mobile.

Pas disa ditësh, në fakt, antenat e lartpërmendura u kyçën përsëri. Çështja politike se cilët operatorë të telefonisë mobile mund të veprojnë në Kosovë ende nuk është zgjidhur dhe, për momentin, pjesëtarët e komunitetit serb mund të përdorin celularët e tyre vetëm në zona të caktuara të Kosovës. Kjo ngrit çështje lidhur me sigurinë e tyre dhe mundësinë e komunikimit me zonat tjera. Operatorët ekzistues të telefonisë mobile në Kosovë kanë çmime shumë të shtrenjta dhe nuk lidhen mirë me operatorët e telefonisë mobile në Serbi. Mbetet të shihet nëse ky problem do të lehtësohet apo jo kur njëherë ta ketë filluar punën një operator i dytë i telefonisë mobile në Kosovë.

Është e qartë se, në pjesën më të madhe, situata me të cilën janë ballafaquar minoritetet nuk ka ndryshuar prej periudhës së fundit për të cilën është raportuar. Përkundër disa strategjive dhe programeve për ta garantuar realizimin e të drejtave të njeriut të komuniteteve minoritare në tërë Kosovën, këto të drejta ende marginalizohen edhe pse Konventa-kuadër për mbrojtjen e pakicave kombëtare (KKMPK) është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë prej gushtit të vitit 2005. Përfaqësuesit e këtyre komuniteteve ende nuk janë të përfshirë në mënyrë adekuate në proceset vendimmarrëse, posaçërisht në nivelin komunal, dhe ende duket që nuk ka dije të mjaftueshme për të kuptuar pse ata do të duhej të përfshihen në këto procese. Si autoritetet qendrore, ashtu edhe ato komunale, do të duhej të zhvillojnë më shumë aktivitete qasjeje ndaj komuniteteve minoritare në mënyrë që të njihen më mirë dhe merren në mënyrë të duhur me problemet specifike me të cilat përballen ato.

Gjendja e personave të zhvendosur dhe kushtet për kthimin e tyre

Pothuajse tetë vjet pas përfundimit të luftimeve në vitin 1999, ende ekziston një numër i madh i personave të zhvendosur që jetojnë brenda dhe jashtë Kosovës. Disa prej tyre,

kryesisht shqiptarët, janë zhvendosur gjatë ose shumë pak para viteve 1998-99 përderisa të tjerët, kryesisht serbët dhe komunitetet tjera jo-shqiptare, janë zhvendosur pas intervenimit të NATO-s në vitin 1999.

E drejta e të gjithë refugjatëve dhe PZHBV-ve për t'u kthyer në shtëpitë e tyre dhe vendin e origjinës është një e drejtë e njohur ndërkombëtarisht, dhe pas pranverës së vitit 1999 shumë refugjatë, të cilët paraprakisht kishin shkuar në vendet tjera u kthyen vullnetarisht, nganjëherë duke përfituar nga ndihma e vendeve nikoqire. Sidoqoftë, jo të gjithë kanë zgjedhur të kthehen, dhe disa vite pas përfundimit të luftimeve, shumë prej vendeve të tyre nikoqire kanë filluar që t'i kthejnë me dhunë (t'i riatdheshojnë). Disa nga këto vende kanë nënshkruar marrëveshje me UNMIK-un për këtë çështje dhe, bazuar në statistikat e UNMIK-ut, deri nga fundi i marsit të vitit 2007, 47 738 ishin kthyer në Kosovë në këtë mënyrë. UNMIK-u vazhdon të mos pranojë kthimin e dhunshëm të komuniteteve serbe dhe romë dhe të shqiptarëve etnik në vendet ku ata janë pakicë. Pjestarët e komuniteteve ashkalinjë dhe egjiptianë pranohen vetëm nëse kontrolli paraprak ka treguar se kthimi i tyre në vendin e origjinës nuk shkel të drejtat e tyre të njeriut. Përveç kësaj, UNMIK-u kërkon që riatdheshimi i të moshuarve, të sëmurëve, dhe fëmijëve të ndarë për të cilët janë identifikuar kushërinjtë dhe kujdestarët, mund të bëhet vetëm nëse kujdesi dhe mbrojtja e ofruar për këta njerëz nuk zvogëlohet si rezultat i kësaj.

Për të parandaluar kthimin e detyrueshëm, një numër i vendeve nikoqire vazhdon të nxisë kthimin vullnetar. Një projekt i bashkë-financuar së voni nga BE dhe qeveritë gjermane dhe sllovene ka rezultuar me hapjen e zyrës për riatdheshim në Mëhallën Rome në pjesën jugore të Mitrovicës. Përderisa ekziston një përqendrim në kthimin e minoriteteve, kjo zyre gjithashtu ndihmon të kthyerit tjerë dhe ofron ndihmë mjekësore dhe psikologjike.

Kur flitet për kthimet në Kosovë, zakonisht flitet për kthimet vullnetare. Shumë projekte të financuara ndërkombëtarisht janë iniciuar gjatë viteve të fundit për të siguruar se njerëzit që janë zhvendosur më parë, gjatë ose pas pranverës së vitit 1999, të mund të kthehen në shtëpitë e tyre. Sfida më e madhe në këtë drejtim është kthimi i pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, në veçanti serbëve dhe romëve, por gjithashtu edhe të komuniteteve ashkalinjë dhe egjiptianë. Sipas vlerësimeve të UNHCR-së, 245,353 PZHBV nga këto komunitete janë zhvendosur pas përfundimit të luftimeve të vitin 1999; 207,069 kanë ikur për në Serbi, 16,284 kanë shkuar në Mal të Zi, dhe 22,000 kanë mbetur në Kosovë. Për shkak të keqësimit të marrëdhënieve të tyre me popullatën shumicë shqiptare në Kosovë para dhe gjatë luftimeve të viteve 1998-99, këta PZHBV ende kryesisht vuajnë nga një frikë e vërtetë ose e perceptuar për sigurinë e tyre kur konsiderojnë kthimin. Situata aktuale politike, e shënuar me diskutime të vazhdueshme për statusin e ardhshëm të Kosovës, vetëm e rritë tensionin e përgjithshëm dhe e bën të vështirë për pjesëtarët e zhvendosur të komuniteteve pakicë që të vlerësojnë nëse është i mundshëm kthimi i qëndrueshëm në shtëpitë e tyre. Një çështje tjetër që duhet të konsiderohet është situata e vështirë ekonomike e Kosovës.

Raportet që vijnë nga ata që janë kthyer më herët në shtëpitë e tyre vetëm rrisin shqetësimet e të kthyerve të mundshëm. Në qershor të vitit 2006, një i kthyer serb është vrarë në shtëpinë e tij në Klinë, dhe në shtator të vitit 2006 dy shtëpi të të kthyerve serb

pësuan nga një sulm me bomba i cili la të lënduar katër persona. Këto incidente u dënuan publikisht në tërë Kosovën, si nga politikanët ndërkombëtarë ashtu edhe nga ata kosovarë dhe deri më tani nuk janë përsëritur; sidoqoftë, të kthyerit e mundshëm shpesh frikohen se ngjarjet e tilla mund të ndodhin përsëri. Shumë prej të kthyerve vazhdojnë të vuajnë nga ngacmimet e kohëpaskohshme, përfshirë frikësimin, sulmet mbi jetën e personave ose pronës dhe gjuajtja me gurë e autobusëve. Incidentet e tilla i bëjnë shumë të kthyer që të dyshojnë nëse është e mundur fare për ta që të shijojnë sigurinë e plotë. Prapëseprapë, duhet të vihet re se situata e përgjithshme e sigurisë ka vazhduar të përmirësohet gjatë viteve të fundit dhe se numri i sulmeve mbi të kthyerit ka rënë.

Të kthyerit dhe personat e zhvendosur kryesisht me origjinë serbe ende kanë vështirësi që t'i qasen tokës së tyre bujqësore, e cila ose është e zënë nga dikush tjetër ose nuk është në afërsi të zonës ku ata jetojnë. Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) tash është përgjegjëse për kthimin nën posedim të tokave të tilla, dhe pasi të ketë filluar me largimin e okupuesve ilegal nga këto toka, qasja e disa nga këta njerëz në tokat e tyre mund të përmirësohet.

Të kthyerit kryesisht të komuniteteve serbe dhe rome ende kanë frikë të vërtetë ose të perceptuar për sigurinë e tyre. Kjo frikë kryesisht i ndalon ata që të lëvizin lirshëm nëpër Kosovë dhe pengojnë qasjen në tregun e punësimit dhe shërbimet publike. Si masë mbrojtëse, Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) kryen patrulla të shpeshta dhe intensive në vendbanimet e banuara nga të kthyerit. Të ashtuquajturat linjat humanitare të autobusëve të financuara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës i lidhin fshatrat e të kthyerve me enklavat më të mëdha të serbëve ku të kthyerit mund të blejnë artikuj ushqimorë dhe artikuj tjerë të domosdoshëm ose të vizitojnë qendrat e përkujdesjes mjekësore.

Në mënyrë që ta përmbush mandatin e vet për të siguruar kthimin e sigurt dhe të papenguar për të gjithë refugjatët dhe personat e zhvendosur në shtëpitë e tyre, UNMIK-u, si pjesë e bashkëpunimit gjithnjë më të madh me IPVQ-të, ka hartuar dhe ri-hartuar shumë strategji dhe projekte për të siguruar kthimin e pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë.

Strategjia dhe udhëzuesi i fundit në lidhje në këtë drejtim janë Doracaku i korrigjuar për Kthim të Qëndrueshëm i lëshuar nga UNMIK-u në korrik 2006. Është i bazuar në parimin se kthimet duhet të jenë të qëndrueshme dhe se kjo është e mundshme vetëm nëse të kthyerit janë në gjendje të marrin një vendim të lirë dhe të informuar mbi atë se nëse donë ose jo të kthehen (e dëshirueshme do të ishte në vendin e tyre të origjinës). PZHBV-të duhet të jenë fuqia shtytëse prapa një kthimi të tillë, edhe pse gjithashtu është e rëndësishme që i tërë komuniteti i vendit ku ata dëshirojnë të kthehen të jetë i angazhuar në proces. Ekziston një përqendrim i madh në përgatitjen e mjedisit para se të bëhen kthimet, si dhe në zgjerimin e shtrirjes së aktiviteteve, dialogut ndër-etnik dhe të ashtuquajturave “vizitave shko informohu” dhe “vizitave shko e shih”, gjatë të cilave njerëzit që dëshirojnë të kthehen mund të vizitojnë komunat në të cilat dëshirojnë të kthehen dhe të vlerësojnë situatën vet.

Doracaku parasheh një përfshirje më të madhe të IPVQ-ve në procesin e kthimeve, si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal. Grupet punuese komunale menaxhojnë kthimin e njerëzve në komunat e tyre. Këto grupe punuese janë të përbëra nga përfaqësuesit e komunave, si dhe PZHBV-të, SHPK-ja, komuniteti ndërkombëtar dhe shoqëria civile. Në nivelin qendrorë, projektet e kthimit vullnetarë dhe iniciativat e ndërlidhura shqyrtohen nga Mekanizmi Qendror i Rishikimit i udhëhequr nga Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve, përderisa Grupi Udhëheqës i bashkë-kryesuar nga PSSP-ja dhe Kryeministri dhe i përbërë nga disa ministri, përfaqësues të komunitetit ndërkombëtar, SHPK-ja dhe AKP-ja rishikon punën e Mekanizmit Qendror të Rishikimit si dhe proceset e kthimeve dhe politikat e ndërlidhura si tërësi.

Mirëpo, përkundër qëllimeve të mira, statistikat e UNHCR-së tregojnë se vetëm 16,661 PZHBV dhe refugjat të komuniteteve pakicë janë kthyer vullnetarisht në vendin e tyre të origjinës në Kosovë në mes të vitit 2000 dhe marsit të vitit 2007. Ky numër përfshin 7,288 serbë, 4,428 ashkalinjë dhe egjiptianë, 2,113 romë, 1,447 boshnjakë dhe 708 goranë. Kjo është vetëm 6,76% e 245,353 personave të zhvendosur. Përderisa numri i të kthyerve ka arritur kulmin në vitin 2003 me 3,566 persona që kanë zgjedhur të kthehen, shifrat kanë rënë që nga dhuna e shënuar ndër-etnike e trazirave të marsit 2004. Norma më e ulët e kthimit është shënuar gjatë vitit 2006 dhe janarit – majit të vitit 2007, kur vetëm 2,098 persona janë kthyer gjatë një periudhe prej një viti e gjysmë, shumica prej të cilëve nga komunitetet rome, ashkalinjë dhe egjiptiane.

Shumica e PZHBV-ve nga komunitetet e pakicës serbe dhe rome – por edhe disa ashkalinjë dhe egjiptianë – ende jetojnë me familjen ose miqtë në Serbi ose në zonat brenda Kosovës ku serbët janë shumicë. Një përqindje e vogël vazhdon të qëndrojë në qendrat kolektive në Serbi ose Mal të Zi, shpesh me kushte të dobëta të jetesës. Edhe pse këta njerëz në përgjithësi kanë të drejtë për shërbime sociale, arsim, kujdes shëndetësor, liri të lëvizjes, strehim, punësim dhe drejtësi në Serbi, diskriminimi nga popullata lokale ose procedurat burokratike shpesh i parandalojnë ata që t'i shfrytëzojnë të drejtat të tyre ashtu si duhet. Nëse ata nuk janë në gjendje që të prezantojnë dokumentet e duhura, atëherë kanë vështirësi në marrjen e disa përfitimeve të caktuara (siç janë pensionet) ose gjetja e vendeve të sigurta të punës. Varfëria është e përhapur mjaft në mesin e njerëzve të kësaj grupe dhe shumica e tyre mendojnë se nuk marrin përkrahje të mjaftueshme nga qeveria serbe dhe agjencitë për ndihmë humanitare.

Kjo mungesë e dokumentacionit është më së shumti e përhapur në komunitetet e PZHBV-ve romë, ashkalinjë dhe egjiptianë. Disa nga këta njerëz nuk kanë dokumente civile fare, dhe për këtë e kanë të pamundur që të marrin certifikatën e nënshtetësisë në Serbi, dhe me këtë bëhen faktikisht të pa-shtet brenda vendit të tyre. Shumica e fëmijëve nga këto komunitete flasin vetëm gjuhën shqipe dhe nuk mund që të përcjellin shkollat në gjuhën serbe. Për shkak të mungesës së shkollimit të duhur në gjuhën shqipe dhe mungesës së shkollimit në gjuhën serbe, shumë prej tyre janë duke u rritur pa pasur shkollim të duhur.

Sipas UNHCR-së në Mal të Zi, shumica e PZHBV-ve kanë arritur në Mal të Zi në vitin 1999 dhe ende jetojnë aty. Rreth 6 500 PZHBV nga komunitetet rome, ashkalinjë dhe

egjiptianë që qëndrojnë në vendbanime gjithashtu rrezikojnë të mbesin pa-nënshtetësi për shkak të mungesës së dokumenteve të duhura. Tani, shumë prej fëmijëve të cilët nuk mund të regjistrohen tashmë janë pa-nënshtetësi dhe për këtë nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre civile, ekonomike, sociale dhe politike. Ka raste ku prindërit e tyre nuk janë regjistruar asnjëherë gjatë kohës sa jetonin në Kosovë; ndërsa në raste tjera këto dokumente janë humbur gjatë ikjes nga shtëpia e tyre në vitin 1999. Për ta zgjedhur këtë problem, UNHCR-ja ka filluar një program pa pagesë për ndihmë ligjore në vitin 2006 për të ndihmuar në gjetjen e dokumenteve të humbura dhe të ofrojë ndihmë në lëshimin e dokumenteve të reja në Mal të Zi dhe në Serbi. Që nga nëntori i vitit 2006, partnerët ligjorë implementues të UNHCR-së i kanë ndihmuar 150 njerëzve në Mal të Zi që të marrin dëshmi të lindjes dhe/ose kombësisë.

Bazuar në informata të pakonfirmuara, duket se Qeveria e Malit të Zi ka filluar me disa projekte në pajtim me strategjinë kombëtare që ka për qëllim të zgjedhë përgjithmonë çështjen e PZHBV-ve në Mal të Zi. Komisioneri Malazez për Refugjatë dhe PZHBV duket sa ka qenë në kontakt me UNMIK-un, IPVQ-të dhe UNHCR-në, si dhe me komunat e Pejës, Klinës, Deçanit dhe Gjakovës. Duket se “vizitat shko dhe shiko” janë duke vazhduar, dhe sipas shënimeve të pakonfirmuara, më shumë se 400 PZHBV nga Mali i Zi tash janë në gjendje të kthehen. Duket se 80% e këtyre të kthyerve të mundshëm janë nga komunitetet rome, ashkalinjë dhe egjiptianë, përderisa 20% janë serbë dhe malazezë.

Një protokoll mbi kthimet vullnetare dhe të qëndrueshme të PZHBV-ve në Kosovë i nënshkruar më 6 qershor 2006 në mes të IPVQ-ve, UNMIK-ut dhe qeverisë së Serbisë deri më tash nuk ka mund të rrisë numrin e kthimeve nga Serbia në Kosovë. Ky protokoll njeh obligimin e të gjitha palëve që të ofrojnë kthimin e sigurt dhe të lirë të PZHBV-ve në vendin e tyre të origjinës në një mënyrë të sigurt dhe dinjitoze, si dhe kthimin e të drejtave tyre pronësore. Gjithashtu përfshinë obligimin për të krijuar kushtet e duhura për lirinë e lëvizjes dhe krijojnë mekanizmat të cilët mundësojnë bashkëpunimin në mes të komunave pranuese në Kosovë dhe komunave aktuale nikoqire në Serbi.

Pjesërisht, arsyeja e mungesës së suksesit të këtij protokollit me siguri është për shkak të natyrës së dokumentit – si udhërrëfyes i politikave të lëshuara nga UNMIK-u dhe Zyra e Kryeministrit, nuk është aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Prandaj shumë komuna nuk e konsiderojnë si të obligueshëm ligjërisht dhe nuk e kanë përfshirë atë në strategjinë e tyre për kthime.

Sa i përket PZHBV-ve në Kosovë, shumica e familjeve shqiptare PZHBV vazhdojnë të jetojnë me kushërinjtë ose në shtëpi ose banesa me qira, kryesisht për shkak se shtëpitë ose banesat e tyre janë shkatërruar gjatë luftimeve në vitin 1999 dhe ende nuk janë rindërtuar. Në maj të vitit 2007, Institucioni i Ombudspersonit ka lëshuar një raport të posaçëm në të cilin ka ardhur në përfundim se për shkak se një numër i madh i komunave në Kosovë kanë premtuar që të rindërtojnë shtëpitë e personave kanë krijuar një pritje legjitime nga ana e këtyre individëve. Fakti se ky premtim nuk është përmbushur ka sjellë deri te shkelja e të drejtës së tyre për pronë sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës

Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila gjithashtu mbron pritjet legjitime për të marrë pronën.

Për më tepër, shumë serbë, romë, ashkalinjë dhe egjiptianë vazhdojnë të jetojnë në kontejnerë dhe qendra kolektive në Graçanicë dhe në komunën e Fushë Kosovës në Kosovën qendrore, si dhe në Shtërpce dhe Prizren në jug. Këto vendbanime përfshijnë personat e zhvendosur nga viti 1999 dhe të tjerët që kanë ikur nga shtëpitë e tyre gjatë trazirave të marsit 2004. Në rastin e grupit të dytë, një numër i madh i shtëpive të tyre janë rindërtuar nga qeveria e Kosovës, por jo të gjithë pronarët e shtëpive të rindërtuara ndjejnë se janë të sigurt që të kthehen, posaçërisht ata persona që kanë jetuar më herët në Fushë Kosovë dhe në fshatin Svinjare në komunën e Mitrovicës. Një situatë e ngjashme ekziston për shumë njerëz që janë zhvendosur në vitin 1999, të cilët tash kanë marrë nga Drejtoria për Çështje Pronësore Banesore e KB-së (DÇPB) vendimet që i lejon ata të rimmarrin shtëpitë dhe banesat e tyre. Këta persona preferojnë që t'i lënë shtëpitë e tyre nën administrim të pasardhësit të DÇPB-së, Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), ose planifikojë që të shesin pronën e tyre dhe të zhvendosen në zonat e banuara me serbë në pjesën veriore të Kosovës ose në Serbi.

Disa nga viktimat e ngjarjeve të dhunshme të marsit 2004 tash kanë marrë kompensimet për pronën e shkatërruar komerciale, kryesisht në komunën e Fushë Kosovës. Në rastet tjera në këtë komunë dhe në komunat e Prishtinës dhe Obiliqit, procedurat për kompensim të mobileve të dëmtuara dhe shkatërruara dhe të pronës tjetër të luajtshme janë duke vazhduar. Një numër i njerëzve me probleme të ngjashme janë përfshirë në listën për rindërtim dhe kompensim për dëmet por ende janë duke i pritur rezultatet. Edhe pse Institucioni i Ombudspersonit ka kërkuar procedura më të shpejta të kompensimit në lidhje me katër raste të tilla që nga viti 2005, ka pasur pak reagime nga IPVQ-të.

Kërkesa të ngjashme të kompensimeve që presin para gjykatave në Kosovë që nga viti 1999 ende nuk janë proceduar pasi që procedurat janë suspenduar pas lëshimit të një qarkoreje nga Departamenti i Drejtësisë të UNMIK-ut në vitin 2005. Përderisa kjo qarkore ka pasur për qëllim që të minimizojë ngarkesën e gjykatave lokale nga kjo sasi e madhe e kërkesave, ende duket të mos ketë një strategji alternative se si të zgjidhen ato.

Qyteti i ndarë i Mitrovicës i cili gjendet në pjesën veriore të Kosovës ka persona të zhvendosur shqiptarë dhe jo-shqiptarë të cilët kanë ikur në pjesën jugore dhe veriore të qytetit gjatë dhe pas luftimeve të vitit 1999. Për shkak të brengave të sigurisë, asnjëra palë ende nuk është e gatshme që të kthehet në pjesën tjetër të qytetit. Në një numër të rasteve, pronat e tyre ende janë të okupuara, shpesh nga PZHBV-të tjerë. Në dy raste që kanë të bëjnë me PZHBV nga pjesa veriore e qytetit të cilët momentalisht kanë zënë banesat në Mitrovicën jugore, Ushtruesi i Detyrës të Ombudspersonit ka kërkuar nga Kryeministri që këta njerëz të jenë të përjashtuar nga obligimi i pagesës së qirasë deri sa nuk marrin qiranë nga personat që kanë zënë banesat e tyre në pjesën veriore të Mitrovicës.

Deri së voni, shumë romë, ashkalinjë dhe egjiptianë të zhvendosur kanë jetuar në kampe në pjesë të ndryshme të Kosovës. Kampi i Plemetit në Kosovën qendrore, i cili i ofronte

strehim edhe serbëve dhe disa të tjerëve jo-shqiptarë, ku njerëzit jetonin në kushte të dobëta sanitare dhe shëndetësore, tashmë pothuajse nuk ekziston më; shumica e banorëve të tij janë transferuar në blloqet e ndërtesave, aty nga mesi i vitit 2006 dhe në fillim të vitit 2007. Dhjetë familjet e mbetura që jetojnë në kamp do të marrin strehimin e duhur në të ardhmen e afërt dhe komuna e Obiliqit planifikon ta mbyll kampin në fund të vitit 2007.

Shumica e njerëzve që më parë jetonin nëpër kampe në pjesën veriore të Kosovës tashmë janë zhvendosur në Kampin Osterode të KFOR-it, që gjendet në afërsi. Për pothuajse gjashtë vite, këta njerëz jetonin në kushte të paimagjinueshme dhe nën ekspozim të vazhdueshëm ndaj ndotjes prej plumbit që emitohej nga deponia e afërt e mbeturinave të kompleksit të minierave të Trepçës. Tash, 105 familje janë ri-vendosur në Kapim Osterode. Dy nga kampet në pjesën veriore të Kosovës janë mbyllur dhe në kampin e mbetur të Çesmin Llug-ut, ka përfaqësuar 40 familje të cilat presin që të ri-vendosen në Osterode.

Kampi Osterode është një kamp i organizuar dhe i menaxhuar mirë. Trajtimi mjekësor u është ofruar banorëve të kampit për të luftuar helmimin nga plumbi. Fëmijët kanë mundësinë që të përcjellin shkollën në pjesën veriore të Mitrovicës ndërsa transporti është organizuar nga drejtori i shkollës, si dhe ekziston një institucion para-shkollor në kamp. Ankesat për numrin e tualeteve janë zvogëluar pasi që menaxhmenti i kampit ka instaluar një numër të tualeteve të reja. Një zyrtar që punonte për menaxhmentin e kampit ka informuar Institucionin e Ombudspersonit se ende kishte probleme me furnizimin me ujë dhe kanalizim, edhe pse një prej arsyeve kryesore për këtë ka qenë vjedhja e vazhdueshme e pjesëve, çelësave dhe drynave. Ka pasur ankesa së fundi për mungesë të barërave dhe mbylljes së qendrës mjekësore në Kampin Osterode si rezultat e shkurtimeve buxhetore.

Duhet të përmendet se Kampi Osterode është vetëm një vendbanim i përkohshëm derisa të vijë koha kur shumica e banorëve të tij të mund të kthehen në shtëpitë e tyre në lagjen e Mëhallës së Romëve në pjesën jugore të Mitrovicës; kjo lagje ka qenë plotësisht e shkatërruar pas përfundimit të luftimeve në verë të vitit 1999. Rindërtimi i Mëhallës së Romëve është një nga projektet më të mëdha të kthimit gjatë viteve të fundit dhe është ende duke vazhduar. Tetë familje nga Osterode tash janë kthyer në shtëpitë dhe banesat e tyre të rindërtuara; 19 familje tjera janë kthyer nga vendbanimet për personat e zhvendosur që ndodheshin në Serbi dhe Mal të Zi.

Një nga kampet e mbetura për romë, ashkalinjë dhe egjiptianë në pjesën veriore të Kosovës është i vendosur në Leposaviq. Në këtë kamp, kushtet e jetës gjithashtu janë të dobëta, edhe pse jo aq të këqija si në kampet tjera në pjesën veriore të Kosovës. Shumica e banorëve të këtij kampi kanë jetuar më parë në Mëhallën e Romëve në pjesën jugore të Mitrovicës dhe momentalitet janë duke pritur që të kthehen atje.

Përveç projektit për kthim në Mëhallën e Romëve, informatat e marra nga Ministria e Kthimit dhe Komuniteteve kanë zbuluar se për momentin ekzistojnë projekte që janë duke u zhvilluar për kthime në komunat e Prizrenit, Klinës, Fushë Kosovës dhe

Vushtrrisë. Sipas Ministrisë, pesë projekte për kthime që janë duke vazhduar do të realizohen në vitin 2007. Njëzetepesë shtëpi do të rindërtohen në Vitomiricë, në komunën e Pejës, për 18 familje serbe, 3 boshnjake dhe 3 shqiptare që do të kthehen. Në fshatrat Nakaradë dhe Lismir në komunën e Fushë Kosovës, Ministria planifikon që të rindërtojë shtëpitë për 35 familje serbe të PZHBV-ve; në qytetin e Prizrenit, 15 shtëpi do të rindërtohen për PZHBV-të serbë. Shtëpitë gjithashtu do të rindërtohen për 19 familje serbe dhe 3 shqiptare në fshatin Bërkovë në komunën e Istogut. Të kthyerit nga komunitetet rome, ashkalinjë, egjiptianë dhe turq do të përfitojnë nga rindërtimi i 20 shtëpive në Vushtri. Të gjitha këto projekte janë paraparë të kompletohen deri në fund të vitit 2007. Për më shumë, sipas Ministrisë së Kthimeve dhe Komuniteteve, 46 familje të cilat kanë jetuar në Mal të Zi që nga viti 1999 dhe të cilat janë nga Peja dëshirojnë të kthehen në këtë qytet. Kërkesa e tyre do të merret parasysh gjatë projekteve të kthimit për vitin 2008. Sa i përket kthimeve në fshatin Babush të komunës së Ferizajt, ministria ka thënë se të gjitha kërkesat e bëra nga të kthyerit në këtë fshat janë përmbushur dhe se çelësat për 74 shtëpi do t'i dorëzohen familjeve Serbe të kthyer në fund të qershorit 2007, 62 nga 74 familjet tashmë i kanë marrë çelësat e shtëpive të reja të ndërtuara në këtë fshat.

Duket se gjatë periudhës së raportimit, kanë ngjarë një numër i kthimeve spontane vullnetare nga vendet fqinje të romëve, ashkalinjëve dhe egjiptianëve të zhvendosur. Sidoqoftë, deri më tash projekti i kthimit në Mëhallën e Romëve në pjesën jugore të Mitrovicës ka qenë i vetmi projekt i organizuar i kthimit masiv për këto komunitete.

Në praktikë, niveli i informimit dhe përfshirjes së PZHBV-ve në kthime dallon shumë nga komuna në komunë. Në një rast, komuna e Istogut kishte kryer disa aktivitete të informimit për të bindur ish banorët e fshatit të Rudeshit për tu kthyer; këta janë shumica persona nga komuniteti i romëve dhe egjiptianëve që momentalisht jetojnë në vendbanime në Mal të Zi. Komuna i ka bërë disa përpjekje për të krijuar kushtet për kthimin e tyre, midis tjerash duke kërkuar aprovimin e UNMIK-ut për të ashtuquajturën “shkëmbime-tokë”. Kjo do të përfshinte shkëmbimin e tokës në të cilën është i ndërtuar fshati me tokën komunale, për shkak të faktit se vetëm një pjesë e vogël e ish banorëve të Rudeshit mund të vërtetonin pronësinë e tokës në të cilën kanë jetuar dikur. Sidoqoftë, së voni projekti dhe shkëmbimi i tokës është suspenduar për shkak të faktit se në propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit të Kosovës të përgatitur nga i Dërguari i Posaçëm për Kosovën i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (UNOSEK), zona mbrojtëse rreth Manastirit Gorioç në afërsi është zgjeruar goxha në jug-lindje duke përfshirë fshatin Rudesh. Në këtë shembull, e drejta e banorëve të Rudeshit për t'u kthyer duket se është bërë dytësore për shkak të interesave tjera. Nëse propozimi i UNOSEK-ut pranohet, ky projekt i kthimit mund të ndalet i tëri. Para se të ndodhë kjo, duhet të ketë diskutime shtesë për atë se si të garantohen të drejtat e këtyre personave që të kthehen dhe në të njëjtën kohë të bëhet sigurimi i Manastirit të Gorioçit. Një situatë e ngjashme mund të shfaqet në të ardhmen në lidhje me vendbanimet e PZHBV-ve serbë në “zonat speciale” rreth Manastirit Visoki Deçani të Kishës Ortodokse serbe, mbetjet e të cilit së voni janë shkatërruar nga KFOR-i.

Deri më tash nuk ka pasur shumë kthime në zonat urbane në Kosovë. Shumë prej të kthyerve të mundshëm nga komunitetet pakicë, kryesisht serbë, kanë frikë për sigurinë e tyre nëse kthehen në banesat ose shtëpitë e tyre në qytete. Duket se Ministria e Kthimeve dhe Komuniteteve ka për qëllim të rritë kthimet në zonat urbane në të ardhmen dhe ka kritikuar ashpër disa komuna për pengimin e supozuar të procesit të kthimit urban.

Siç edhe tregojnë këto raste, ekziston një numër i projekteve për personat që dëshirojnë të kthehen vullnetarisht në Kosovë. Në anën tjetër, ndihma dhe përkrahja për njerëzit që kthehen në Kosovë ka qenë rudimentare. Përderisa UNHCR-i dhe IOM-i vazhdojnë të ofrojnë përkrahje dhe këshilla fillestare për të kthimet e detyrueshme, çështja se si të integrohen me mijëra njerëz të riatdhesuar çdo vit vazhdon të jetë e lënë anash nga UNMIK-u dhe IPVQ-të. Deri më tash, as UNMIK-u e as IPVQ-të nuk kanë ndarë fonde për t'u mundësuar këtyre njerëzve që të kenë një jetë të qëndrueshme. Shumë fëmijë nga të kthyerit me dhunë vazhdojnë të ballafaqohen me vështirësi në lidhje me arsimimin shkollor në Kosovë pasi që flasin gjuhën e ish vendit të tyre nikoqir më mirë se sa që e flasin gjuhën shqipe ose serbe.

Në mënyrë të pashpjegueshme, çështja e kthimeve të detyrueshme ose riatdhesimet e detyrueshme, që nga fillimi janë trajtuar ndaras nga kthimet vullnetare. Aq ndaras sa që asnjë organ që është zakonisht kompetent për kthime nuk ndihet përgjegjës për këtë grup të madh të njerëzve të kthyer. Në rastet kur të kthyerit me dhunë kanë ardhur te Institucioni i Ombudspersonit, personeli ka gjetur se UNMIK-u konsideron se çështja e integritit dhe përkrahjes për këta njerëz bie ekskluzivisht nën kompetencat e komunave. Komunat, në anën tjetër, ende vuajnë nga mungesa kronike e fondeve dhe ankohen se shpesh ato nuk informohen për riatdhesimet paraprakisht. Si rezultat, komunat gjithashtu kanë bërë shumë për t'iu ndihmuar këtyre njerëzve. Ministria e Kthimeve dhe Komuniteteve, nuk e konsideron çështjen e të kthyerëve me dhunë bien nën kompetencat e saja.

Në shumë raste, shtëpitë që i përkasin të kthyerve me dhunë ende janë gërmadha. Prandaj ata mbesin të zhvendosur, dhe deri më tash nuk kanë pasur zgjedhje tjetër vetëm se të kthehen tek të afërmit, të njohurit ose format tjera të ndihmës. Në shumë raste, ata që kishin mundësi, provuan të kthehen në ish vendet e tyre nikoqire në çfarëdo mënyrë, zakonisht ilegale. Përderisa në ndërkohë UNMIK-u ka formuar Grupin Punues për Riatdhesim për të përkrahur dhe këshilluar IPVQ-të mbi politikat dhe praktikat e ardhshme të migrimit, kjo prapëseprapë nuk i zgjedh problemet me të cilat ballafaqohen personat të cilët tashmë janë riatdhesuar në Kosovë. Një Grup Drejtues i përbërë nga UNMIK-u dhe Ministrinë e ndryshme është formuar për të hartuar një Strategji të Riintegritit të Personave të Riatdhesuar, që do të ndihmonte në sigurimin se të kthyerit me dhunë do të kenë qasje adekuate në informata, dokumente civile, ndihmë dhe shërbime sociale, ashtu që ata mund të riintegrohen në vendin e tyre të origjinës dhe të rindërtojnë jetën e tyre. Fatkeqësisht, kjo strategji ende është në fazën e të hartuarit dhe deri sa të kompletohet situata e keqe e shumicës së kosovarëve vështirë se do të përmirësohet. Gjithashtu nuk ka pasur përkrahje fare nga ish vendet nikoqire për të përmirësuar kushtet e jetesës për të kthyerit me dhunë në Kosovë, me siguri sepse ata dëshirojnë t'i "shpërblejnë" vetëm të kthyerit vullnetarë.

Sfidat e proceseve të kthimit dhe riatdhesimit me të vërtetë janë të shumëfishta, dhe PZHBV-të në tërë Kosovën ballafaqohen me vështirësi që kanë të bëjnë me pronën, strehimin dhe në disa raste me sigurinë dhe lirinë e lëvizjes. Përderisa është e qartë se kjo është një fushë e vështirë, IPVQ-të, e posaçërisht komunat, duhet të mbajnë më shumë përgjegjësi për problemet e PZHBV-ve dhe të të kthyerve, si vullnetarë ashtu edhe jo-vullnetarë. Sa i përket kthimeve të detyruara, është domosdoshmëri që UNMIK-u dhe IPVQ-të, me ndihmën e ekspertëve dhe donatorëve, të kompletojnë shpejtë strategjinë e tyre në mënyrë që të ndihmojnë këta njerëz që të integrohen në shoqërinë e Kosovës.

Çështjet pronësore dhe të banimit

Garantimi i pacenueshmërisë të së drejtave pronësore në Kosovë vazhdon të mbetet sfidë e madhe. Për shkak të të metave të përgjithshme në sundimin e ligjit në Kosovë, pronarët e pronave janë të mbrojtur vetëm në rast se ata mund ta mbrojnë vetveten. Autoritetet kompetente publike shpesh akuzohen për korrupsion, nepotizëm dhe dështimin e tyre për të reaguar në shkeljet evidente të ligjeve ekzistuese, dhe kjo situatë mund të përmirësohet vetëm nëse autoritetet fillojnë të marrin mbi vete përgjegjësi më të mëdha për zbatimin e atyre ligjeve.

Ky dështim për të reaguar me përgjegjësi është veçanërisht i theksuar në fushën e ndërtimeve të paligjshme, të cilat ende vazhdojnë në mënyrë të papërmbajtur në tërë Kosovën. Gjatë periudhës së raportimit, disa nga inspektoratet komunale ishin mjaft aktive, në disa raste duke shkatërruar ndërtesat e ndërtuara në mënyrë të paligjshme, apo duke e ndalur përfundimin e ndërtimeve. Mirëpo, rastet e tilla kanë qenë të rralla dhe nuk demonstrojnë një trend të përgjithshëm të zbatimit të fuqisë së ligjit.

Obligimi për të kërkuar leje ndërtimi para fillimit të ndërtimit të një ndërtese shpesh shpërfillet, dhe ndërtesa të mëdha banimi vazhdojnë të ndërtohen kudo dhe në çdo vend pa ndonjë konsideratë të veçantë ndaj parimeve të përgjithshme të planifikimit urban. Distanca midis këtyre ndërtesave të reja të saponëduara dhe pronave në afërsi të tyre në shumicën e rasteve është joadekuate, çka do të thotë se ndërtimi i ndërtesave të mëdha vazhdon të shkaktojë dëme tek ndërtesat fqinje. Në rastet e këtilla pronarët e pronave ankohen se inspektoratet komunale rrallë adresojnë ankesat e tyre në mënyrë të duhur.

Kur përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit e kanë ngritur këtë çështje me zyrtarët kompetentë të inspektorateve komunale, zyrtarët kanë thënë se ata ishin duke i adresuar ankesat e personave pronat e të cilëve ishte dëmtuar nga puna në ndërtimin e ndërtesave më të gjata. Në të njëjtën kohë zyrtarët komunalë pretendojnë se ishte vështirë për të siguruar se urdhrat e tyre do të zbatohen në mungesë të një policie funksionale për inspektim. Si një problem i vazhdueshëm është se nuk ka kompensim të përshtatshëm ligjor për personat të cilët ankohen lidhur me efektet negative që kanë ndërtimet e paligjshme në pronën e tyre.

Problemet e cituara në Raportin e fundit vjetor lidhur me eksproprijimin e pronave private vazhdojnë. Ligji i aplikueshëm për eksproprijimin i ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës i vitit 1978 nuk zbatohet, komunat vazhdojnë të eksproprijojnë pronën e njerëzve para përcaktimit të interesave të përbashkëta publike të cilat arsyetojnë masat e tilla. Pronarët ligjorë shpesh nuk janë të informuar lidhur me vendimet e komunave për eksproprijim, e as nuk janë të informuar lidhur me procedurat e mëtutjeshme të eksproprijimit. Rrallë ndonjëherë ka pasur raste ku individët kanë pranuar pronë tjetër si kompensim për pronat e eksproprijuara. Në shumicën e rasteve komunat i kanë eksproprijuar individët pa asnjë arsye dhe pa kompensim. Në fillim të vitit 2007 Ministria e administrimit të pushtetit lokal u përfshi në këtë çështje dhe nxiti komunat që të veprojnë në pajtim me ligjet ekzistuese, mirëpo, deri tani nuk pasur shumë rezultate pozitive lidhur me këto kërkesa.

Një shembull i eksproprijimit *de facto* ndodhi në mars të vitit 2007 në komunën e Klinës. Me qëllim të ndërtimit të një ndërtese të re, Komuna vendosi që të shkatërrojë një shtëpi e cila ishte pronë e një individi i cili nuk jetonte në Klinë pa e informuar atë për qëllimet e saja. Shtëpia e shkatërruar ishte nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP). (AKP është një agjenci e pavarur e krijuar nga OKB dhe është pasardhës i Drejtorisë për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB); u themelua për të shqyrtuar një kategori të veçantë të kërkesave për kthimin në posedim të pronave banesore). Prona i ishte dhënë një personi të tretë në baza humanitare. Edhe përkundër faktit se AKP-ja e kishte njoftuar komunën paraprakisht dhe kishte theksuar se pronat në fjalë ishin nën administrimin nga AKP-së, Komuna e shkatërroi shtëpinë, duke shkelur në këtë mënyrë obligimet e saja për të respektuar ligjin e aplikueshëm dhe sundimin e ligjit në përgjithësi në Kosovë.

Një shembull tjetër i kufizimit të të drejtave pronësore është deklarimi i të ashtuquajturës “zonë e veçantë” rreth manastirit *Visoki Deçani* të Kishës Ortodokse Serbe në komunën e Deçanit. Kjo hapësirë ka për qëllim mbrojtjen e trashëgimisë kulturore si dhe të manastirit dhe trashëgimisë natyrore të kanionit në të cilin është i vendosur ai. Kur e lëshoi këtë vendim, PSSP-ja deklaroi se krijimi i kësaj zone nuk do të ndikojë në të drejtat private pronësore, por që do t’i obligojë investitorët, pronarët dhe shfrytëzuesit potencialë të të gjithë tokës në këtë hapësirë që t’i binden ligjeve të Kosovës dhe standardeve ndërkombëtare në lidhje me ruajtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Megjithatë, në mars të vitit 2007 KFOR-i shkatërroi lokalet e një ish ndërmarrjeje shoqërore si dhe ato që kishin mbetur nga pronat të cilat u kishin takuar serbëve të zhvendosur të cilët banonin jashtë Kosovës. Me sa duket, pronarët e pronave nuk janë informuar lidhur me këto masa. Po që se do të shprehnin interesimin për t’u kthyer në Kosovë, do të duhet të merrej ndonjë vendim për ku do të ktheheshin ata—po që se nuk kanë mundësi të kthehen në shtëpitë e tyre të origjinës, atëherë këtyre personave do të duhej t’u ofrohej kompensimi.

Probleme të ngjashme mund të shfaqen edhe në të ardhmen në lidhje me kufizimet e të drejtave pronësore të personave pronat e të cilëve gjendet brenda “zonave të mbrojtura” të përfshira në propozimin gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (të përgatitur nga i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara

për Kosovë, apo UNOSEK). Sikurse edhe “zonat e veçanta” të përmendura më lartë, këto “zona mbrojtëse” kanë për qëllim që të ruajnë dhe mbrojnë hapësirën rreth një numri të zgjedhur të manastireve, kishave dhe objekteve tjera fetare, si dhe historike dhe kulturore të Kishës Ortodokse Serbe që kanë domethënie të veçantë për Serbët e Kosovës. Po që se pranohet ky propozim, personat të cilët kanë prona në këto hapësira nuk do të kenë mundësinë që të nisin disa forma të caktuara të ndërtimit apo zhvillimit industrial apo tregtar. Edhe po që se marrim parasysh nevojën dhe qëllimet e mira të këtyre zonave mbrojtëse, nuk duhet të harrohet fakti se kufizimet e këtilla mund të çojnë drejt zhvleftësimit të pronës, dhe pronarët përkatës të pronave duhet të kompensohen për këtë humbje vlere.

Po që se marrim parasysh propozimin dhe anekset e saja, ekzistojnë gjithashtu edhe raste kur duket e dyshimtë shtrirja e disa zonave mbrojtëse të cilat janë të nevojshme për të siguruar bashkëjetesën paqësore dhe funksionimin e hapësirave të lartpërmendura. Në rastin e Manastirit të Gorioçit, të Kishës Ortodokse Serbe, i cili gjendet afër Istogut, në pjesën perëndimore të Kosovës, zona mbrojtëse e propozuar nga UNOSEK-u në mënyrë të pashpjegueshme zgjeron shtrirjen në anën jug-lindore; zona rrethon objektet e ish ndërmarrjes shoqërore si dhe fshatin Rudesh të banuar me romë dhe egjiptianë. Banorët e kanë braktisur fshatin pas qershorit të vitit 1999, si pasojë e disa kërcënimeve të cilat u ishin drejtuar disa nga banorëve të këtij fshati. Duket se masat për kthim të iniciuara nga komuna e Istogut janë shtyrë për shkak të përfshirjes në zonën mbrojtëse si të fshatit ashtu edhe të ndërmarrjes shoqërore. Nevoja e privimit të ish banorëve të fshatit dhe të ish ndërmarrjes shoqërore nga pronat dhe shtëpitë e tyre duhet të ekzaminohet para se të pranohet propozimi. Nëse mbajtja e zonës mbrojtëse në formën e sajë ekzistuese konsiderohet si e nevojshme, atëherë duhet të bëhen negociata gjithëpërfshirëse midis Komunës, ndërmarrjes shoqërore dhe përfaqësuesve të fshatit Rudesh, me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje për këtë çështje pa komprometuar të drejtën e banorëve për tu kthyer në fshatin e tyre.

Në përgjithësi, shumë shtëpi të cilat ishin shkatërruar para, gjatë apo menjëherë pas luftimeve të viteve 1998-99, nuk janë rindërtuar. Për personat të cilët ikën nga shtëpitë e tyre gjatë pranverës së vitit 1999 (kryesisht serbë dhe romë), rindërtimi i shtëpive të tyre varet nga vullneti i tyre për tu kthyer në Kosovë. Çështja e kthimit është e shqyrtuar në mënyrë më të detajuar në këtë raport vjetor në kapitullin mbi personat e zhvendosur dhe kushtet për kthimin e tyre.

Shumica e shqiptarëve etnikë, të cilët ishin zhvendosur gjatë luftimeve, kanë demonstruar vullnetin për tu kthyer në shtëpitë e tyre. Një pjesë e madhe e shtëpive ishin rindërtuar pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s në vitin 1999, në kohën kur Kosova kishte qenë duke pranuar fonde të konsiderueshme nga donatorët ndërkombëtarë. Tani ato të holla janë shpenzuar, dhe për arsye të ndryshme një numër i konsiderueshëm i pronarëve të shtëpive kurrë nuk kanë përfituar nga këto donacione. Përderisa komunat në tërë Kosovën kanë premtuar vazhdimisht që do të rindërtojnë këto shtëpi, ata kurrë nuk kanë ndërmarrë asnjë hap për ta bërë atë. Të gjithë e dinë se buxhetet e vogla të komunave shpesh i parandalojnë që të ndihmojnë popullatën e tyre në mënyrë të duhur. Ende komunat e njëjta shpesh nuk e kanë marrë në konsideratë rindërtimin si një çështje

urgjente, pasi që shumica e njerëzve kanë gjetur deri tani vendstrehim të përkohshëm tek më të afërmit e tyre apo në shtëpitë e braktisura. Megjithatë, komunat kanë ngritur nivelin e pritjeve të popullatës duke premtuar vazhdimisht se do të rindërtojnë shtëpitë, dhe pronarët e këtyre shtëpive tani kanë pritje legjitime që kjo do të ndodhë. Për më tepër, DÇPB-ja tanimë i ka dëbuar një pjesë të madhe të personave të cilët kishin zënë në mënyrë të paligjshme pronat e braktisura pas kërkesave për kthim nën posedim të pronave të cilat i janë bërë këtij organi nga pronarët e ligjshëm. Është befasuese se në një situatë të tillë asnjëra nga komunat përkatëse – me përjashtim të komunës së Prizrenit – nuk kanë përfshirë ndihmën për rindërtim në buxhetet e tyre vjetore. Autoritetet qendrore e konsiderojnë këtë çështje si një problem me të cilin duhet të merren komunat, dhe nuk ndiejnë përgjegjësinë për të ofruar kontributin e tyre për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Në përgjithësi, shumica e autoriteteve komunale dhe qendrore nuk kanë demonstruar vullnetin politik për të zgjidhur çështjen. Në raportin e posaçëm, të lëshuar në maj të vitit 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit erdhi në përfundim se dështimi për t'u përpjekur që të zgjidhin çështjen e cila ndikon në popullatën në tërë Kosovën përbën shkelje të të drejtave të pronarëve të shtëpive në bazë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, e cila mbron të drejtat pronësore duke përfshirë edhe pritjen legjitime për gëzimin e të drejtës pronësore. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ndër të tjera ka rekomanduar, ndër të tjerat, se komunat përkatëse duhet të sajojnë strategjitë për të fituar fonde të mjaftueshme nga donatorët dhe të tjerët për të përmbushur premtimet e bëra. Pasi që ky është një problem shumë i përhapur, Qeveria e Kosovës dhe komunat, në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë, duhet të veprojnë shpejtë për të zhvilluar një strategji banimi për të adresuar këtë çështje.

Për personat shtëpitë e të cilëve nuk janë rindërtuar si dhe personat tjerë të cilët kanë nevojë për strehim komuna ka mundësi të kufizuara për ofrimin e ndihmës. Pasi që ka mandatin për të vendosur lidhur me kërkesat për kthim në posedim të pronave banesore, DÇPB-ja vazhdimisht ka deklaruar se sigurimi i strehimit për rastet humanitare nuk është pjesë e mandatit të tij, dhe se kjo vlen njëjtë edhe për pasardhësen e saj, AKP-në. Për më shumë, individët të cilët i qasen komunave në Kosovë shumë shpesh përfundojnë duke u dërguar nga një zyre administrative tek tjetra pa marrë kurrfarë ndihme të duhur. Komunat përsëri citojnë mungesën e fondeve si arsyen për krijimin e një numri tepër të vogël të strehimoreve. Duhet të vihet re se ka pasur pak apo hiç përpjekje për të ndarë të hollat për strehimore apo për të kërkuar financime nga donatorët. Këto raste përsëri demonstrojnë mungesën e përgjegjësisë së shumicës së komunave për mirëqenien e banorëve të tyre. Me një rast në Vushtrri, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit intervenoi suksesshëm tek komuna që familjet të cilat jetonin nën kushte të tmerrshme në të ashtuquajturat “Barakat e Sarajevës” t'i lëviznin në banesa komunale. Megjithatë, ka shumë komuna në të cilat banesat e tilla thjeshtë nuk ekzistojnë dhe ku intervenimet e Institucionit të Ombudspersonit nuk japin rezultate të tilla pozitive.

Përderisa një numër i rasteve të prezantuara para Institucionit të Ombudspersonit kanë bërë me çështjen e strehimit dhe me dështimin e komunave për të rindërtuar shtëpitë, një numër i rasteve përfshin edhe DÇPB-në, mandati i të cilit zyrtarisht ka përfunduar në dhjetor të vitit 2006. Bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2006/10 mbi zgjidhjen e kërkesave në lidhje me pronat e paluajtshme private, duke përfshirë edhe pronën

bujqësore dhe komerciale, të shpallur më 4 mars të vitit 2006, AKP-së i jepet mandati që të merret me kërkesat për kthimin në posedim të kategorive të pronës së paluajtshme të përmendura në titullin e Rregullores së UNMIK-ut (ndryshe nga mandati i DÇPB-së që kishte të bënte me kërkesat në lidhje me pronën e banimit). Bazuar në informatat e pranuar nga AKP-ja, në qershor të vitit 2007 janë lëshuar vendimet për të gjitha rastet të cilat kishin mbetur paraprakisht të pazgjidhura nga DÇPB-ja, dhe të gjitha përveç 100 prej tyre janë ekzekutuar. Këto raste të mbetura tani janë në procedurë të ekzekutimit.

Siç edhe është përmendur në Raportin e fundit vjetor, DÇPB-ja gjithashtu ka shqyrtuar edhe kërkesat e pronarëve legjitimë të cilëve u ishte ekspropriuar prona apo ishin privuar nga e drejta e tyre mbi pronën për shkak të ligjeve diskriminuese të regjimit të Millosheviçit të viteve 1989-1999 (e ashtuquajtura kategoria A e kërkesave). DÇPB-ja ka marrë vendim lidhur me të gjitha këto kërkesa, mirëpo jo gjithmonë në favor të parashtruesit të kërkesës së kategorisë A. Duket se sa i përket çështjeve të lidhura me kompensimin dhe të tjera, personat të cilët i përkasin këtij grupi ende mund të ndjekin kërkesat e tyre para gjykatave kompetente. DÇPB-ja është në proces të mbledhjes së këtyre rasteve për t'ua dërguar të dhënat e të gjitha këtyre rasteve gjykatave. Megjithatë, duket se gjykatat ende janë duke pritur që të miratohet legjislacioni (me gjasë një Rregullore e UNMIK-ut) e cila do t'i adresonte kërkesat e tilla.

Detyrat e DÇPB janë që të ndihmojë gjykatat në zgjidhjen e konflikteve të lidhura me kërkesat për pronësi në lidhje me pronën private të paluajtshme, duke përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale, dhe kërkesat të cilat përfshijnë të drejtat e pronarëve të ligjshëm në format e lartpërmendura të pronës në periudhën midis 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999. Vendimet lidhur me gjetjet dhe përfundimet e AKP-së duhet të bëhen bazuar në autoritetin e gjykatave të Kosovës. Deri më tani AKP-ja ka pranuar 23,652 kërkesa. Në disa nga këto kërkesa janë lëshuar vendimet mirëpo ato nuk janë zbatuar ende.

Nga mesi i qershorit të vitit 2007, AKP-ja u pajtua me kërkesën e Institucionit të Ombudspersonit që stafi i tij të mund të gëzonte qasje të papenguar në çfarëdo informata të cilat i nevojiten Institucionit për të kompletuar hetimet e tij pa pasur nevojë që të kalojë nëpër procedura të veçanta për të siguruar ato informata. Ky ishte një hap i madh përpara në bashkëpunimin e Institucionit të Ombudspersonit me AKP-në.

Institucioni i Ombudspersonit deri më tani nuk ka marrë asnjë ankesë të adresuar kundër AKP-së. Sidoqoftë, duket se AKP-ja është duke u përballur me disa vështirësi në përmbushjen e mandatit të saj, pasi që shumë gjykata ende nuk i kanë transferuar rastet tek Agjencia. Për më tepër, duket të ketë më shumë se 5000 kërkesa për administratën e DÇPB-së në lidhje me kontestet pronësore të banesave janë ende të pazgjidhura të cilat tani gjenden para AKP-së. Administrimi i tillë kryesisht përfshin edhe dhënien e banesave apo shtëpive me qira palëve të treta. Qiraja mujore pastaj i dërgohet pronarëve përkatës ligjorë. Deri më tani vetëm 100 nga këto shtëpi dhe banesa janë dhënë me qira. Me shpresë se AKP-ja do të arrij të zbatojë skemën ekzistuese të qiradhënies edhe më gjerë. Megjithëse nuk ka pasur ankesa se çmimet e qirasë, nga hetimet e mëtutjeshme në

këto çështje kemi zbuluar se çmimet e qirasë korrespondojnë me ato të tatimeve në pronë të mbledhura nga komunat.

Në rastet kur palët preferojnë që të shesin pronën e tyre para se ta japin atë të administrohet, atëherë janë paraqitur shumë raste të transaksioneve të rrejshme; letrat e autorizimit të përfaqësuesve ligjorë shpesh janë të falsifikuara, dhe nganjëherë pronarët e ligjshëm të shtëpive të cilët janë duke jetuar jashtë Kosovës (kryesisht të atyre të cilët janë shpërngulur në Serbi) nuk janë në dijeni se pronat e tyre janë shitur në mungesën e tyre. Format e tjera të transfereve të rrejshme përfshijnë edhe kontratat e falsifikuara, letrat e autorizimit dhe lejet e njoftimit. Numri i madh i dokumenteve të rrejshme të cilat janë duke qarkulluar nëpër Kosovë ka çuar drejt një ngatërrimi të konsiderueshëm lidhur me pronësinë. Në disa prej rasteve tri apo katër palë apo individë pretendojnë për pronësinë ligjore të të njëjtës pronë.

Krahas falsifikimit të dokumenteve, shumë prona janë duke u shitur edhe nën detyrim të dhunshëm. Nëse personi i cili dëshiron të blejë pronën ka ndikim dhe fuqi, gjykata nuk mund të bëjë gati asgjë për të ndihmuar pronarin e ligjshëm. Ka shembuj në tërë Kosovën kur pronarët e ligjshëm të cilët nën kërcënime kanë qenë të detyruar të shesin shtëpitë e tyre. Kjo duket se është duke ndodhur kohëve të fundit në një shkallë më të madhe në pjesën veriore të Mitrovicës, ku viktimat janë zakonisht shqiptarët etnikë apo etnitë tjera jo-Serbe.

Me qëllim të parandalimit të shitjeve të tilla, UNMIK-u vazhdon të zbatojë Rregulloren Nr. 2001/17 mbi Regjistrimin e kontratave për shitblerjen e patundshmërive në zonat e veçanta gjeografike të Kosovës. Në bazë të kësaj rregulloreje të gjitha shitblerjet e pronave në zonat e përcaktuara si të veçanta nga UNMIK-u (kryesisht hapësirat e banuara me komunitetet pakica) duhen të regjistrohen nga një anëtarë kompetent i UNMIK-ut. Në rastet e veçanta këtij anëtari të stafit i lejohet të refuzojë regjistrimin, midis tjerash edhe në rastet kur ai/ajo dyshon se kontrata është nënshkruar nën detyrim, kur shitja mund të çojë drejt prishjes së sigurisë, kur çmimi i shitjes është i paarsyeshëm apo kur fondet apo motivet për një shitje të tillë janë të dyshimta. Përputhshmëria e kësaj rregulloreje të UNMIK-ut me të drejtat e individit mbi pronën janë vënë në pyetje shumë herë nga Ombudspersoni i kaluar ndërkombëtar në Kosovë. Një problem tjetër lidhur me këtë Rregullore të UNMIK-ut është se është duke u zbatuar në një mënyrë mjaft arbitrare; është aplikuar në disa raste edhe në qoftë se prona nuk ka qenë në njërin nga zonat e veçanta të paracaktuara nga UNMIK-u. Fatkeqësisht, për shkak të imunitetit të përgjithshëm të UNMIK-ut, personat të cilët janë kufizuar në ushtrimin e të drejtës së tyre në lidhje me pronën nuk mund të ngritin padi në gjyq lidhur me këto çështje.

Gjithashtu është e diskutueshme nëse Rregullorja 2001/17 e UNMIK-ut me të vërtetë ka sukses që të parandalojë njerëzit që të shesin pronat e tyre, edhe në rastet kur në bazë të Rregullores së lartpërmendur ekzistojnë një apo më shumë prej arsyeve të cilat parandalojnë shitblerjen. Në shumicën e rasteve këto prona kalojnë nga një dorë në tjetrën në mënyrë joformale, edhe nëse shitja është ndaluar qartësisht nga UNMIK-u.

Ekzistojnë edhe zona të cilat nuk janë të përfshira në Rregulloren 2001/17 të UNMIK-ut mirëpo ku UNMIK-u dëshiron të parandalojë shitblerjen pa marrë parasysh. Kjo ka ndodhur në rastin e Mëhallës së Romëve në pjesën jugore të Mitrovicës. Mëhalla ishte shkatërruar plotësisht nga zjarri si pasojë e luftimeve të vitit 1999. pjesa më e madhe e banorëve të kësaj mëhale u larguan nga Kosova, apo u detyruan që të jetojnë në kampet e të zhvendosurve në pjesën veriore të Kosovës për më shumë se gjashtë vite në kushte të papërbalueshme sanitare dhe shëndetësore. Në vitin 2005, pas një presioni të konsiderueshëm nga mediat ndërkombëtare dhe Institucioni i Ombudspersonit, UNMIK-u dhe seksionet tjera të bashkësisë ndërkombëtare filluan të organizojnë rindërtimin e mëhallës së romëve dhe sivjet një numër i njerëzve arritën të futen në shtëpitë e rindërtuara. Shtëpitë ishin rindërtuar pas nënshkrimit të marrëveshjeve trepalëshe midis pronarëve të ligjshëm, donatorëve ndërkombëtarë dhe komunës së Mitrovicës. Për dallim prej marrëveshjeve të ngjashme të cilat ishin bërë me të kthyerit në vendet e tjera në Kosovë apo në vendet tjera në rajon, marrëveshja trepalëshe me personat të cilët shprehën dëshirën për t'u kthyer në mëhallën rome nuk kanë përfshirë klauzolën e cila ndalon shitjen e pronës për një kohë të caktuar. Kjo u bë problem kur një nga banorët e mëhallës e shiti shtëpinë e tij brenda një kohe të shkurtë pasi ia kishin rindërtuar.

Me qëllim të parandalimit të transaksioneve të këtilla, përfaqësuesit e UNMIK-ut u takuan me përfaqësuesit e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë për të kërkuar nga ata për këshilla lidhur me këtë problem. Kryetari i Gjykatës së Qarkut i informoi se bazuar në situatën momentale ligjore asgjë nuk mund të bëhej për të parandaluar shitblerjet e tilla. Megjithatë, donatorët mund të shtonin një aneks në marrëveshjen trepalëshe e cila ndalonte shitblerjen e asaj prone pa miratimin paraprak të donatorit dhe komunës, të cilën gjë e bënë duke e dërguar një letër në gjykatë e cila kërkonte që ata të regjistrojnë shitblerjen e pronës vetëm kur kanë dëshminë për një pajtim të tillë. Në atë mënyrë shitblerja e pronës mund të kufizohet. Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë gjithashtu ofroi suspendimin regjistrimin e shitblerjes së të gjitha pronave në mëhallën rome deri në kompletimin e veprimeve të lartpërmendura.

Përveç faktit se një sjellje e tillë rrezikon pavarësinë e gjyqësorit, ajo ngrit edhe çështje serioze lidhur me të drejtat pronësore të personave të cilët kanë përfituar nga marrëveshjet trepalëshe. Argumenti i UNMIK-ut se marrëveshja trepalëshe mund të interpretohet në atë mënyrë që të kufizojë shitblerjen e shtëpive të ndërtuara nuk përkrahet nga teksti i këtyre marrëveshjeve. Më 21 maj 2007, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër PSSP-së në të cilën ai shprehi shqetësimin e tij lidhur me këtë çështje. Ai shprehi dyshimet e tij nëse ekziston baza ligjore e cila kërkoj pajtimin e palëve të treta para shitjes së pronës nëse kjo nuk është përfshirë në kontratën origjinale të shitblerjes. Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit shtoi se çfarëdo aneksi i cili do t'i bashkëngjitej një kontrate e cila ishte nënshkruar që më herët nuk do të ishin të vlefshme pa nënshkrimin e të gjitha palëve kontraktuese. Deri më tani nuk ka pasur asnjë përgjigje zyrtare në këtë letër. Duke përmbushur ato kontrata të veçanta përsëri do të mund të shpinte drejt një situatë ku përfituesit e marrëveshjeve trepalëshe do të mund të ndiheshin të shtrënguar që të nënshkruajnë marrëveshjet e tilla, duke e komprometuar përsëri ushtrimin e lirë të të drejtave të tyre pronësore. Është vështirë të sigurohet se në këtë rast interesat e donatorëve do të merren parasysh (duke pasur njerëz të jetojnë në banesa dhe

shtëpia dhe të kenë të drejtat e tyre si pronarë ligjorë që të shfrytëzojnë pronën ashtu si ju përgjigjet). Nga perspektiva e të drejtave të njeriut nuk duket se ka ndonjë arsytim të përshtatshëm i cili e lejon UNMIK-un dhe donatorët që të ndalojnë shitblerjen e pronave po që se kjo nuk ka qenë në marrëveshjet trepalëshe dhe nëse Rregullorja e UNMIK-ut 2001/17 nuk ka qenë e zbatueshme në këtë rast.

Edhe në rastet kur shitblerja e pronës nuk është e ndaluar me ligj apo politika përkatëse, ekzistojnë një numër i pengesave për shitjen e pronës në Kosovë si rrjedhojë e luftimeve të vitit 1999. Zyrtarë kadastrale shpesh nuk i ka dokumentet e duhura nga periudha e Jugosllavisë ashtu që në shumë raste nuk mund të vërtetohet pronësia ligjore. Në disa raste është shkatërruar dokumentacioni apo regjistrat janë dërguar në Serbi nga stafi i mëhershëm i zyrtarëve të cilët e kanë lëshuar Kosovën më 1999. Marrja e dokumenteve të tilla është ende shumë e vështirë dhe mund të bëhet në mënyrë joformale përmes ndihmës së juristëve nga disa OJQ të cilat janë të specializuara në ato çështje. Zyrtarët të cilët punojnë në zyrtarë kadastrale nganjëherë i këshillojnë palët që të ngritin padinë para gjykatës kompetente, gjë që nuk ndihmon edhe aq në zgjidhjen e kërkesës së tyre e cila në thelb është një çështje politike e krijuar nga marrëdhëniet e tensionuara midis UNMIK-ut, IPVQ-ve dhe qeverisë serbe në Beograd.

Një problem tjetër është se para vitit 1999 është bërë shitblerja e shumë pronave por të cilat nuk janë futur në shënimet kadastrale. Zyrtarët të cilët janë të punësuar në zyrtarë kadastrale refuzojnë të pranojnë që ka pasur shitblerje të tilla po që se ato nuk janë të dokumentuara në shënimet kadastrale. Kjo ndodh edhe në rastet kur prona nuk është e kontestuar, kur ka vetëm një pronar ligjor dhe kur mund të vërtetohet nga dokumentet kadastrale të vulosura nga arkivat e qytetit në Prishtinë. Gjithashtu ekzistojnë probleme lidhur me disa kontrata të shitblerjes të vërtetuara pas vitit 2000 për shitblerjet e pronave të bëra para vitit 1999. Në rastet e tilla palët e përfshira zakonisht kanë vështirësi në ofrimin e dëshmive nga bankat për të vërtetuar se kishte pasur nga shitësi transfer parash të bërësi i pronës. Këto çështje mund të zgjidhen përmes udhëzimeve më fleksibile përbrenda zyrës kadastrale e cila i mundëson edhe format tjera të dëshmive të cilat do të vërtetonin se ka pasur shitblerje të pronës.

Mbrojtja e pronës është një fushë ku vërehet më së shumti dobësia e sundimit të së drejtës në Kosovë, pasi që as inspektoratet kompetente komunale e as gjykatat nuk kanë fuqi, vullnet apo kapacitet të mjaftueshëm për të garantuar një mbrojtje të tillë. Situata mund të përmirësohet vetëm me një fuqizim gjithëpërfshirës të sundimit të ligjit dhe të trupave ekzekutive dhe gjyqësorë që kanë për detyrë që ta zbatojnë atë.

Të drejtat e fëmijëve në Kosovë

Në periudhën për të cilën raportohet, derisa situata ekonomike në Kosovë vështirësohet edhe më tej, është e qartë që në të njëjtën masë do të vështirësohet edhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. Kosova bën pjesë në zonat më të varfra të Evropës. Duke u bazuar në një intervistë të një përfaqësuesi të UNICEF-it, të dhënë në shkurt të vitit 2007, rreth 17% të fëmijëve të të gjitha komuniteteve në Kosovë lindin në varfëri dhe mbesin të

varfër deri në moshën 6 vjeçare, derisa 12% të familjeve vendore jetojnë në varfëri të skajshme, që nënkupton që ato janë të detyruara që të mbijetojnë me jo më shumë se 0.99 euro në ditë.

Përkundër situatës së vështirë ekonomike dhe problemeve tjera me të cilat përballet Kosova si një mjedis i dalë nga konflikti, duhet të theksohet që prej vitit 1999, falë kontributit të shumë partnerëve ndërkombëtar, në vend ekziston një kornizë e mirë ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Megjithatë, njëlloj sikur edhe në shumë fusha tjera në Kosovë, problemi qëndron në zbatimin e kësaj kornize. Derisa është e qartë që gjatë viteve të kaluara është arritur një përparim, ende vërehet mungesa e një plani strategjik të qeverisë përmes të cilit do të zbatoheshin dhe koordinoheshin këta mekanizma, duke e penguar në këtë mënyrë edhe mbrojtjen efikase të të drejtave të fëmijëve në praktikë.

Sa i përket mirëqenies së fëmijëve dhe zhvillimit të tyre në pajtim me standardet e përcaktuara me instrumentet ndërkombëtare siç është Konventa e KB-se për të drejtat e fëmijës, mbrojtja ligjore nuk është e mjaftueshme nëse asaj nuk i shtohen edhe mbrojtja efikase institucionale dhe zbatimi adekuat i dispozitave përkatëse ligjore. Ligjet që rregullojnë të drejtat e fëmijëve u bënë pjesë e sistemit ligjor të Kosovës pas vitit 1999, në pajtim me Konventën e lartpërmendur. Megjithatë, njëlloj sikur se me ligje tjera të nxjerra prej atëherë, ende duhet të nxjerrën dispozita ligjore dhe udhëzime administrative përkatëse në mënyrë që të garantohet zbatimi i këtyre ligjeve.

Ligji kryesor i vendit për rregullimin e të drejtave të fëmijëve është Ligji i Kuvendit të Kosovës për Familjen, Nr. 2004/32, që hyri në fuqi më 20 janar 2006 dhe e zëvendësoi Ligjin e RSFJ-së mbi martesën dhe marrëdhëniet familjare. Mirëpo, siç është theksuar edhe në Raportin e fundit vjetor, në praktikë vazhdojnë të zbatohen të dy ligjet, më shumti për shkak të asaj që ligji i ri nuk i mbulon disa çështje që më parë ishin të rregulluara me ligjin e vjetër. Për shembull, edhe pse shihen përmirësime të caktuara në lidhje me ofrimin e qasjes dhe të drejtës së besimit në rastet kur prindërit janë të ndarë, zbatimi i ligjit në praktikë krijon vështirësi pasi që ligji i ri ka juridiksion ekskluziv për këto çështje mirëpo nuk e rregullon procedurën që duhet ndjekur në një rast të tillë.

Zyrtarët e qendrave për punë sociale dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale kanë theksuar që kanë pranuar udhëzime që ta zbatojnë si ligjin e ri, ashtu edhe atë të vjetrin. Kjo situatë krijon një konfuzion të konsiderueshëm për zyrtarët që janë të përfshirë në zbatimin e ligjit dhe njëkohësisht për individët, të drejtat e të cilave rregullohen me këto dy ligje.

Një shembull i konfuzionit që shkaktohet me këtë rast është që shpesh herë nuk është e qartë se cilat organe janë kompetente për të vendosur mbi çështje të ndryshme. Në procedurën e adoptimit, ligji përcakton që duhet të vendosë gjykata mirëpo nuk e specifikon çfarë gjykate duhet të jetë ajo. Prandaj, tri organe të ndryshme e konsiderojnë veten kompetente për të vendosur mbi adoptimin: qendrat për punë sociale, që ishin kompetente sipas ligjit të dikurshëm të Jugosllavisë, por gjithashtu edhe gjykatat komunale dhe të qarkut, të cilat vendosin mbi këto çështje në shkallë të parë. Situatë e

ngjashme ekziston edhe në çështjet që kanë të bëjnë me besimin e fëmijëve, ku rastet e fëmijëve që kanë lindur në lidhje martesore dërgohen në gjykata komunale ose, në rast të shkurorëzimit paraprak, në gjykatë të qarkut për të vendosur në shkallën e parë. Në rastet kur fëmijët kanë lindur në një lidhje jashtëmartesore, qendrat për punë sociale ende e konsiderojnë veten kompetente për të vendosur në to këto çështje dhe, duke marrë parasysh që ato janë organe administrative, i vetmi mjet juridik kundër vendimeve të tyre është Gjykata Supreme. Në mënyrë absurde, situata është e tillë që në procedurën e besimit të fëmijëve, natyra e procedurës gjyqësore varet nga statusi martesor i prindërve. Derisa gjykatat komunale dhe të qarkut së paku e ndjekin një procedurë të njëjtë, kjo nuk mund të thuhet edhe për Gjykatën Supreme, që ndjek një procedurë administrative që shpesh herë nuk përfshin seanca gjyqësore apo mban mbledhje të mbyllura. Kështu, fëmijët e lindur në lidhje jashtëmartesore nuk kanë të drejta të njëjta procedurale me ata të lindur në lidhje martesore. Ky problem gjithashtu u ngrit edhe tani rishtas në Raportin mbi Sistemin administrativ gjyqësor në Kosovë, që e nxjerri Misioni i OSBE-së në Kosovë në prill të vitit 2007.

Një çështje tjetër shqetësuese që e vështirëson mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve është mungesa e efikasitetit në ekzekutimin e vendimeve administrative dhe vendimeve të gjykatave, posaçërisht në rastet që kanë të bëjnë me qasjen dhe besimin e fëmijëve. Grupi për të Drejtat e Fëmijëve në Institucionin e Ombudspersonit të Kosovës u përfshi në raste të tilla duke kërkuar nga organet kompetente që t'i zbatojnë aktvendimet e formës së prerë të gjykatave në lidhje me besimin e fëmijëve. Në këto raste, për shkak të dështimit të gjykatave për t'i ekzekutuar këto vendime, fëmijët nuk kishin qenë në kontakt me prindërit e tyre me vite të tëra. Kjo situatë është posaçërisht e rëndë në rastet kur një nga prindërit ka vdekur kurse prindi tjetër, në fakt, nuk ka qasje te fëmijët. Grupi për të Drejtat e Fëmijëve poashtu ka intervenuar në disa raste lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore, përsëri në lidhje me çështjet e qasjes apo besimit të fëmijëve ose çështjet e prindërisë apo alimentacionit.

Përveç gjykatave, nganjëherë edhe shkollat dështojnë që t'i mbrojnë fëmijët që janë nën përkujdesjen e tyre nga dëmtimi i rëndë. Përveç problemeve të përgjithshme të shkaktuar nga mungesa e infrastrukturës dhe pajisjeve nëpër shkolla, ndëshkimi trupor gjithashtu duket të jetë dukuri e zakonshme në shkollat e Kosovës. Për më keq, ka edhe raste të keqtrajtimit seksual të cilave nuk u kushtohet vëmendja që e meritojnë. Grupi për të drejtat e fëmijëve punoi në një rast të tillë në një shkollë fillore të Komunës së Suharekës ku viktima kishte pasur vetëm dhjete vjet. Përkundër faktit që gjykata kompetente gjeti që mësuesi i saj e kishte keqtrajtuar seksualisht atë dhe e dënoi mësuesin sipas ligjit penal në fuqi, ky mësues vazhdoi të punojë në shkollë edhe për disa muaj. Kjo tregon një mungesë të përgjegjësisë së shkollës në këtë çështje, pasi që nuk kishte bërë aq sa duhet për t'i mbrojtur nxënësit e saj nga mësuesi i tyre, edhe pse disa vajza të tjera kishin ngritur pohime të njëjta kundër tij.

Në anën pozitive, prej vitit 1999 janë themeluar një numër i institucioneve të reja qeveritare në nivel qendror dhe komunal për t'u marrë me mbrojtje e të drejtave të fëmijëve. Një shembull i mire i kësaj është Komisioni Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve, që u themelua me vendim të Kryeministrit të Kosovës më 25 tetor 2006. Këtë

Komision e kryeson vetë Kryeministri dhe ka për qëllim komunikimin dhe koordinimin e politikave, programit dhe proceseve në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve brenda IPVQ-ve, si dhe lehtësimin e realizimit të të drejtave të fëmijëve dhe ofrimin e mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e tyre në shoqëri. Zyra Këshilluese për Qeverisje të Mirë, të drejta të njeriut, mundësi të barabarta dhe çështje gjinore pranë Zyrës së Kryeministrit ka filluar punën në vlerësimin e nevojave profesionale dhe financiare dhe është në kërkim të donatorëve që do ta ndihmojnë përgatitjen e një plani të veprimit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Sa i përket mekanizmave për mbrojtjen e fëmijëve, Grupi për të Drejtat e Fëmijëve në Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë vazhdon të funksionojë si mekanizmi i vetëm i institucionalizuar dhe i pavarur që heton rastet individuale, merret me situatat e përgjithshme të të drejtave të fëmijëve dhe angazhohet në promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Sipas neneve 26 dhe 27 të Konventës së KB-së për të drejtat e fëmijëve, përgjegjësia kryesore për mirëqenien e fëmijëve në çdo shoqëri qëndron mbi dy institucione: Në vend të parë dhe kryesor është familja, dhe nëse familja nuk është në gjendje që ta garantojnë mirëqenien e fëmijës, atëherë i mbetet qeverisë që ta ndihmojë familjen. Për shembull, familja është institucioni që do të duhej fëmijës t'ia sigurojë ushqimin, librat, shkollimin dhe përkujdesjen adekuate shëndetësore. Mirëpo, nëse familja nuk është në gjendje që të ofrojë këto kushte të jetës për shkak të të ardhurave të ulëta, atëherë këtë barrë e mban qeveria. Në kushte të tilla, familjet përkatëse varen nga ndihma e qeverisë. Mirëpo, nëse as qeveria nuk është në gjendje t'i ofrojë kushtet themelore të jetës, atëherë është vështirë që të ruhet një nivel adekuat i mirëqenies së fëmijës për të garantuar rritjen përkatëse fizike të fëmijës, si dhe zhvillimin shpirtëror, moral dhe social të tij apo saj.

Për shkak të papunësisë së madhe dhe standardit mesatarisht të ulët të jetës, shumë familje të komuniteteve të ndryshme në Kosovë nuk janë në gjendje t'i plotësojnë nevojat themelore të fëmijëve të tyre. Institucioni i Ombudspersonit pranon ankesat nga këta njerëz për çdo ditë – çështjet kryesore kanë të bëjnë me pamundësinë e këtyre njerëzve që t'u ofrojnë fëmijëve të tyre banim adekuat, ushqim të mjaftueshëm, rroba, libra shkollor, përkujdesje shëndetësore si dhe të drejta tjera themelore që janë të nevojshme për mirëqenien dhe zhvillimin e duhur të fëmijëve. Kjo situatë keqësohet edhe më tej me faktin që autoritetet kompetente publike, për shkak të buxhetit të tyre të kufizuar, kanë mundësinë që t'u ndihmojnë këtyre familjeve vetëm në raste të rralla.

Për shkak të nivelit të lartë të papunësisë në Kosovë, si dhe problemeve tjera që ekzistojnë në shoqëri të dala nga konflikti, shumë fëmijë në Kosovë detyrohen që ta marrin përgjegjësinë për mirëqenien e tyre në një moshë shumë të re.

Është bërë mjaft e rëndomtë që fëmijët në Kosovë të punojnë punë të ndryshme për ta ndihmuar buxhetin e familjes, që si rrjedhim e rrezikon mirëqenien e tyre. Fëmijët mund të shihen duke shitur cigare, bonbone dhe kikirikë nëpër kafene, bare dhe në rrugë deri në orët e vona të natës. Të tjerët, posaçërisht nga komuniteti rom, kërkojnë lëmshë në semaforë. Në të gjitha rastet e lartpërmendura, shumë nga këta fëmijë nuk janë më të

vjetër se gjashtë apo shtatë vjet. Edhe pse autoritetet kompetente qeveritare dhe shoqëria civile kanë ndërmarrë tani rishtas disa iniciativa për ta eliminuar këtë dukuri, problemi nuk do të zhduket derisa të aprovohet një plan zhvillimi dhe një strategji e duhur në Kosovë. Në të njëjtën kohë, strategjia e tillë mund të jetë e suksesshme vetëm nëse situata e përgjithshme ekonomike në Kosovë përmirësohet në mënyrë drastike.

Momentalisht, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me përkrahje të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP), është në proces të përpilimit të një kornize strategjike për eliminimin e formave të dëmshme të punës së fëmijëve. ONP ka një rol këshillëdhënës për Komitetin për Parandalimin e Punës së Fëmijëve, që përbëhet nga një numër i ministrive, OJQ-ve vendore, Odës Ekonomike dhe një shoqatë të sindikatave të punës. Pasi që Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/27 mbi Ligjin themelor të punës në Kosovë nuk e ka specifikuar në mënyrë të mjaftueshme se cilat janë punët e rrezikshme për fëmijët e moshës 15 – 18 vjeçare, Komiteti e ka përgatitur rishtas një listë të fushave të tilla të punës. Deri më tani, 27 punonjës të qendrave për punë sociale janë trajnuar për ta zbatuar pilot-projektin për eliminimin e punës së fëmijëve në komunat e Mitrovicës, Prishtinës dhe Prizrenit. Rregullorja e njëjtë e UNMIK-ut gjithashtu e ndalon punën e fëmijëve për të gjithë fëmijën nën moshën 15 vjeçare, mirëpo kjo Rregullore, siç u përmend më lart, shkelet për çdo ditë në të gjitha anët e Kosovës.

Derisa puna e fëmijëve është padyshim njëri nga problemet më të mëdha të dukshme për të drejtat e fëmijëve në Kosovën e sotme, mungesa e vendbanimit adekuat është një çështje tjetër që ka ndikim tejet negative në zhvillimin e fëmijëve. Shumë njerëz ende jetojnë në baraka ose te të afërmit e tyre. Shumë familje që ishin duke jetuar në mënyrë të paligjshme në shtëpitë dhe banesat që i kishin zënë në fund të konfliktit të vitit 1999, tani janë dëbuar nga ato dhe janë duke pritur rindërtimin e shtëpive të tyre të shkatërruara në vitet 1998-1999. Shumë të tjerë, kryesisht të komunitetit serb dhe rom, janë ende të zhvendosur. Një numër i tyre ende jetojnë në kampe të Personave të Zhvendosur Brenda Vendit (PZhBV), brenda dhe jashtë Kosovës në kushte të mjera të jetesës. Në një situatë të tillë, është e vështirë që fëmijëve kosovarë t'u ofrohen kushtet e nevojshme për zhvillimin dhe mirëqenien e tyre, siç kërkohet sipas nenit 27.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, pas intervenimit të Ushtresit të Detyrës së Ombudspersonit, familjet me një numër të fëmijëve të paaftë që ishin duke jetuar në kushte të mjera të jetës në të ashtuquajturat “Baraka të Sarajevës” në Vushtrri, u bartën në banesat që janë pronë e Komunës.

Një çështje tjetër në lidhje me kushtet normale të jetës është dhuna në familje. Në Kosovë, ky vazhdon të jetë problem i përhapur. Megjithatë, lufta kundër dhunës familjare është një nga luftërat më të vështira jo vetëm këtu, por në të gjitha shoqëritë, pasi që çdo gjë ndodh brenda familjes. Sipas botëkuptimit të shumë njerëzve, nuk ka asgjë të keqe në dhunën kundër fëmijëve apo anëtarëve tjerë të cënueshëm të familjes; edhe nëse fqinjët dhe autoritetet publike kanë njohuri për dukuri të tilla, ata zakonisht mendojnë që problemet e tilla nuk iu takojnë atyre dhe që do të duhej të zgjidhen brenda familjes. Për këtë arsye, shumica e rasteve të dhunës familjare nuk iu raportohen autoriteteve apo gjykatave.

Fakti që dhuna në familje shpesh herë konsiderohet dukuri normale në shoqërinë kosovare sjell deri te një situatë ku shumica e fëmijëve mbeten pa kurrfarë mbrojtje në shtëpitë e tyre. Kjo ka ndikim shumë negative në zhvillimin dhe mirëqenien e tyre, si dhe ua mohon vendbanimin dhe përkujdesjen e duhur.

Ka raste kur fëmijët rrahën aq keq sa që ka nevojë të dërgohen në spital për t'u trajtuar. Në rastet e tilla, nuk ekziston ndonjë praktikë që punonjësit e spitalit ta lajmërojnë qendrën për punë sociale apo policinë.

Në përgjithësi, fëmijët – si grup qartas më i cenueshëm – vuajnë nga mungesa e trajtimit përkatës në spitale. Në sistemin shëndetësor në Kosovë, që vazhdon të jetë jashtëzakonisht i nën-financuar, shpesh herë mungojnë pajisjet dhe ilaçet më themelore, siç janë shpatullat dhe vaksinat. Sipas nenit 25 të Konventës së KB-së për të drejtat e fëmijëve, të gjithë fëmijëve duhet t'u sigurohen kushtet më të mira shëndetësore dhe përkujdesje përkatëse shëndetësore. Edhe pse nuk është për t'u befasuar që Kosova, si mjedis i dalë nga konflikti, nuk mund t'i përmbushë këto standarde, prapë se prapë do të mund të bëhej më shumë për të garantuar që fëmijëve t'u ofrohet përkujdesja themelore shëndetësore.

Në Kosovë nuk mund të trajtohen të gjitha sëmundjet për shkak të mungesës së pajisjeve apo kadrove profesionale. Problemi kryesor këtu qëndron në faktin që, përkundër mungesës së fondeve, Ministria ka vazhduar të nxjerrë vendime për ndarjen e fondeve për trajtime të tilla, duke i ushqyer shpresat e njerëzve të përfshirë. Në një raport të nxjerrë më 22 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i klasifikoi këto shpresa si “pritje legjitime”, duke theksuar që në rastin që ishte hetuar, ankuesi e kishte marrë një vendim sipas të cilit i ishin ndarë fonde të caktuara. Edhe pse vendimi nuk ishte i natyrës obliguese (e kishte nënshkruar vetëm Ministri i Shëndetësisë, jo Ministri i Financave), ankuesi nuk kishte arsye që të dyshonte në vërtetësinë e tij pasi që vendimi ishte marrë në nivel të Ministrisë. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit konsideroi që dështimi i Ministrisë të Shëndetësisë për ta përmbushur premtimin e tij kishte përbërë shkelje të së drejtës së ankuesit për mbrojtjen e pronës sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, i cili mbulon edhe pritjen legjitime për të marrë një pronë apo pasuri. Ai rekomandoi që ankuesit t'i jepet kompensimi përkatës dhe që bashkëpunimi mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave të përmirësohet për ta garantuar sigurimin e fondeve për këtë program.

Në një numër të rasteve ku fëmijët nuk mund të trajtoheshin në Kosovë, Grupi për të Drejtat e Fëmijëve pranë Institucionit të Ombudspersonit ia arriti që t'i dërgojë disa fëmijë për t'u trajtuar në Itali, me ndihmën e KFOR-it italian dhe qeverisë së Italisë. Këto raste kishin të bënin kryesisht me fëmijët që ishin shumë të sëmurë. Megjithatë, duhet të ceket që këto raste ishin vetëm përjashtime dhe edhe pse ndihmuan që të shërohen disa nga fëmijët, ato prapë se prapë nuk e kundërshtojnë faktin që fëmijët në Kosovë nuk gëzojnë përkujdesje të duhur shëndetësore dhe që Ministria e Shëndetësisë deri më tani nuk e ka përgatitur një strategji të duhur për ta përmirësuar përkujdesjen shëndetësore për grupet e cenueshme të cilat nuk mund ta paguajnë trajtimin shëndetësor jashtë Kosovës.

Lidhur me situatën e shërbimeve shëndetësore për foshnjat, Kosova vazhdon ta kryesojë listën e vendeve me vdekshmëri më të lartë të fëmijëve deri në moshën njëvjeçare në rajon dhe në Evropë. Sipas statistikave të publikuara nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në vitin 2006, përafërsisht 35 nga çdo 1000 foshnje të lindura në Kosovë do të vdesë. Kjo ndodh shpesh herë për shkak të mungesës së pajisjeve përkatëse mjekësore dhe barnave, por nënat të shumtën e herëve ankohen rreth asaj që shërbimi në spitale është shumë i keq dhe që punonjësit e spitalit nuk brengosen fare për pacientët. Dy arsye për këtë mungesë motivimi supozohet të jenë pagat e ulëta të punonjësve të spitalit dhe mungesa e ndjenjës së ofrimit të një shërbimi dhe përgjegjësisë lidhur me të. Në këtë situatë, nënat që kanë mundësi financiare lindin jashtë Kosovës; mundësia tjetër është që mjekëve dhe motrave/teknikëve medicinale/ë t'u jepet ndonjë pagesë shtesë për ta garantuar trajtimin e duhur.

Një situatë tjetër alarmante lidhur me përkujdesjen adekuate shëndetësore për foshnjat u paraqit në gusht të vitit 2006, kur Grupi për të Drejtat e Fëmijëve mori informatën për mungesë të oksigjenit në Repartin e Neonatologjisë në Klinikën Gjinekologjike të Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë, duke e rrezikuar kështu jetën e një numri të foshnjave. Pas intervenimit të Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit, Inspektori kryesor i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Bordi i Qendrës klinike universitare u zotuan që kjo nuk do të ndodhte më dhe që ishin ndërmarrë masat disiplinore kundër punonjësve përgjegjës për mungesë të oksigjenit.

Një çështje tjetër e rëndësishme në lidhje me të drejtat e fëmijëve në Kosovë është ajo e arsimit. Edhe pse ekziston një kornizë e mirë ligjore për arsimin në Kosovë që krijon kushtet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ajo nuk është duke u zbatuar si duhet. Ligjet më të rëndësishme në këtë drejtim që i ka shpallur Kuvendi i Kosovës prej themelimit të tij në vitin 2001 janë Ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm dhe Ligji mbi arsimin parashkollor. Përsëri, mungesa e fondeve të duhura pasqyrohet pothuajse në të gjitha pjesët e sistemit arsimor, duke përfshirë mungesën e pajisjeve përkatëse, motivimin e mësimitdhënësve (për shkak të pagave të ulëta), vijimi i shkollës, transporti komunal për shkolla, infrastruktura e shkollave etj.

Për më tepër, buxheti minimal i ndarë për arsim ka sjellë deri te zbatimi joadekuat i ligjeve ekzistuese. Një shembull i kësaj është neni 3 i Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, që vendos që tekstet mësimore për shkollat fillore janë falas dhe që Qeveria do të duhej t'i sigurojë ato për shkollat e mesme nëse ka mundësi financiare për ta bërë këtë. Në realitet, Qeveria nuk është duke i ofruar tekstet mësimore për të gjithë fëmijët e shkollave fillore—të vetmit fëmijë që përfitojnë nga kjo janë një numër i fëmijëve nga familjet e varfër. Edhe pse Grupi për të drejtat e fëmijëve e ngriti këtë çështje në vitin 2004, fondet e ndara për këtë qëllim ende mbesin tepër të vogla për ta mundësuar zbatimin e drejtë të këtij Ligji.

Një problem tjetër në fushën e arsimit është mungesa e infrastrukturës përkatëse në shkolla. Shumica e shkollave, posaçërisht në zonat rurale, nuk kanë kushtet minimale për të ofruar shkollim efikas; mbingarkesa me numër të nxënësve ka nënkuptuar që mësimi të

mbahet në katër ose pesë ndërrime. Probleme tjera me të cilat përballen disa shkolla në Kosovë janë edhe kushtet e mjera higjienike, derisa në një numër të shkollave nuk ka as ujë të pijshëm.

Kushtet e mjera në shkolla i keqëson edhe më tej niveli zakonisht i ulët i arsimit që ofrohet. Sipas statistikave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, numri i mësimitdhënësve të pakualifikuar në shkollat kosovare është mes 15–18%, që ndodh më së shumti për shkak të asaj se punonjësit më të kualifikuar kanë gjetur diku tjetër vende punë që paguhen më mirë.

Problemet e tilla sjellin deri te një numër i madh i ndërprerjes së shkollimit. Kjo ndodh më së shumti për shkak të varfërisë, që nënkupton që fëmijët ose duhet të punojnë, ose prindërit e tyre thjesht nuk mund t'i blejnë tekstet dhe materialet tjera shkollore. Në zonat rurale, problemet shpesh herë janë edhe të natyrës infrastrukturore, pasi që shkollat janë thjeshtë tepër larg. Kjo veçanërisht shkakton probleme për vajzat, njëlloj sikur se edhe mungesa e mësuesëve në zonat rurale.

Sipas statistikave që i ka ofruar Enti Statistikor i Kosovës, në vitin 2006, vetëm 50% të vajzave shqiptare etnike të moshës 15–18 vjeçare e vazhdojnë shkollimin pas shkollës fillore. Djemtë nga ky komunitet gjithashtu braktisin shkollën për t'ia filluar punës. Përqindja e atyre që e vijojnë shkollimin është veçanërisht e ulët në komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, ku vetëm 50% të fëmijëve të moshës 6–14 vjeçare e vijojnë shkollimin. Shumë nga këta fëmijë e braktisin shkollën në një moshë shumë të re.

Por edhe kur fëmijët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian faktikisht shkojnë në shkollë, ekzistojnë faktorë tjerë që e vështirësojnë vijimin e shkollimit. Në rastin e shkollës që gjendet në kampin e PZhBV-së në Plemetin në Kosovën qendrore, është rrezikuar vijimi i shkollimit të nxënësve të kësaj shkolle me vendimet e autoriteteve komunale për ta mbyllur kampin pas rivendosjes së banorëve të kampit në banesat që ofronin kushte me të mira të jetës. Komuna kompetente e Obiliqit ka ofruar që të sigurojë transport për këta fëmijë në një shkollë në Obiliq, mirëpo udhëheqësit e banorëve të kampit thonë që familjet nuk dëshirojnë që fëmijët e tyre të shkojnë në një shkollë të re që është më larg nga shtëpitë e tyre se sa ajo e mëparshme. Edhe pse Grupi për të Drejtat e Fëmijëve është duke punuar në këtë rast, ende nuk është gjetur ndonjë zgjidhje e kënaqshme lidhur me të.

Një numër i fëmijëve romë që më parë kanë jetuar në kampet e PZhBV-ve në pjesën veriore të Mitrovicës tani kanë hyrë në shtëpitë e tyre të reja në lagjen Mëhalla e Romëve në pjesën jugore të këtij qyteti. Ata e ndërprejnë shkollimin në pjesën veriore të qytetit për shkak të vështirësive për të udhëtuar nga pjesa jugore e Mitrovicës, e banuar kryesisht me shqiptarë, në pjesën veriore të Mitrovicës, të banuar kryesisht me serbë. Megjithatë, falë drejtorit të shkollës, është organizuar transporti dhe këta fëmijë romë tani po e vijojnë shkollimin në pjesën veriore të qytetit sikur më herët.

Fëmijët serbë, në anën tjetër, shpesh herë ballafaqohen me problemin e numrit të kufizuar të shkollave, posaçërisht të shkollave të mesme. Për shkak të faktit që ende nuk është e mundur që pjesëtarët e komunitetit serb të lëvizin të lirë në të gjitha zonat e Kosovës,

këta fëmijë shpesh herë duhet të largohen nga shtëpia në moshë të re në mënyrë që të jetojnë afër shkollës së tyre, që si rrjedhim paraqet një barrë të rëndë financiare për familjet e tyre. Fëmijët goranë gjithashtu përballen me vështirësi të mëdha në sektorin e arsimit – kjo çështje është mbuluar në pjesën “Komunitetet minoritare në Kosovë” të këtij Raporti Vjetor.

Sipas Ligjit për shkollimin fillor dhe të mesëm në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është e obliguar që në sistemin arsimor t’i përfshijë edhe fëmijët me nevoja të posaçme. Kjo gjithashtu përfshin edhe fëmijët me paaftësi fizike dhe mentale. Megjithatë, një numër i nxënësve të tillë që shkollohen në shkolla të rregullta dhe të posaçme është shumë i vogël. Në vend se të dërgohen në shkolla, fëmijët me nevoja të posaçme shpesh herë fshihen apo lihen pa kurrfarë përkujdesje, posaçërisht në zonat rurale.

Përveç çështjeve që kanë të bëjnë me punën fizike, strehimin, shëndetin dhe shkollimin e fëmijëve, një nga dukuritë më shqetësuese në lidhje me fëmijët janë rastet kur ata janë viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore. Edhe pse pas përfundimit të konfliktit në vitin 1999, viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore ishin kryesisht persona që nuk ishin nga Kosova, duket të ketë rritje në trafikimin e fëmijëve nga Kosova. Në raportin e tij për Kosovën për vitin 2006, Departamenti i Shtetit i SHBA-ve vlerësoi që niveli i lartë i varfërisë, papunësisë dhe analfabetizmit ka krijuar një situatë ku fëmijët janë veçanërisht të rrezikuar të bëhen viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të përmendet që shumica e fëmijëve të trafikuar në Kosovë i kanë lënë familjet e tyre më parë për shkak të dhunës familjare.

Në mënyrë indirekte, duket të jetë një nga shkaqet e rritjes së delikuencës së të miturve. Krahas varfërisë dhe traumave të lidhura me luftimet e vitit 1999, si dhe situatës së vështirë sociale dhe pengesave për zhvillimin arsimor, shpie deri të e dhuna e vazhdueshme jashtë shtëpisë dhe me gjenerata të tëra. Edhe pse Ligji penal për të mitur i Kosovës, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/08 më 20 prill 2004 paraqet një kornizë të mirë ligjore për të punuar me këto raste (dhe është, në fakt, një nga ligjet më të avancuara në rajon në këtë fushë), ende nuk është krijuar një strukturë e duhur për ta garantuar zbatimin e tij. Për këtë arsye, në shkurt të vitit 2007, Agjencia Evropiane për Rindërtim, në bashkëpunim me UNICEF-in, IPVQ-të dhe pjesët përkatëse të shoqërisë civile, e filluan një projekt për ta përkrahur një sistem të drejtë dhe të duhur për të miturit në Kosovë, që është financuar nga ana e BE-së. Ky projekt është i paraparë të zgjasë deri në shkurt të vitit 2009. Me qëllim të realizimit të këtij projekti, IPVQ-të, OJQ “Terre des Hommes”, Qendra për të drejtat e njeriut pranë Universitetit të Prishtinës dhe partnerët tjerë në projekt e nënshkruan një memorandum të mirëkuptimit. Duke e bërë këtë, këta partnerë u zotuan që ta përmirësojnë sistemin e drejtësisë penale për të miturit në pajtim me Konventën e KB-ve për të drejtat e fëmijëve, si dhe ta promovojnë parandalimin e delikuencës së të miturve.

Siç shihet nga vështrimi i mësipërm, mungesa e strukturave përkatëse qeverisëse dhe sundimit të ligjit gjithmonë ka ndikim të veçantë negativ te ata që janë të paaftë për ta mbrojtur veten, posaçërisht fëmijët. Në një situatë të tillë, është vetëm falë angazhimit të

palodhshëm të faktorëve të caktuar ndërkombëtarë dhe vendorë që çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve aktualizohen vazhdimisht dhe strukturat kompetente të qeverisë përkujtohen rregullisht për obligimet e tyre ndaj familjeve dhe fëmijëve.

Diskriminimi në Kosovë

Trajtimi i pabarabartë i personave në situata të njëjta për shkak të prapavijës, statusit financiar apo social, përkatësisë etnike, gjinisë ose kapacitetit apo pamjes fizike është problem i vazhdueshëm në shoqërinë kosovare. Një diskriminim i tillë është rezultat i drejtpërdrejt i një problemi më të përgjithshëm, respektivisht mungesës së përgjegjësisë së autoriteteve qendrore dhe lokale dhe zbatimit arbitrar të sundimit të ligjit. Të dyja këto e lehtësojnë trajtimin e pabarabartë të grupeve të cënueshme apo më pak të privileguara se tjerat. Lufta kundër një dukurie të tillë vështirësohet veçanërisht me faktin që njerëzit, në të shumtën e rasteve, nuk janë të vetëdijshëm për konceptin e diskriminimit dhe kështu nuk janë në gjendje ta identifikojnë trajtimin e tyre të pabarabartë si diskriminim. Në shoqërinë kosovare, grupet e cënueshme janë aq të mësuara që të trajtohen ndryshe sa që nuk ankohen rreth kësaj apo nuk besojnë që një ankesë e tillë do të mund të ketë ndonjë ndikim në problemin e tyre.

Individët nuk ankohen gjithmonë, për shembull, nëse gratë e tyre nuk trajtohen si duhet në Qendrën klinike universitare në Prishtinë sepse familjet e tyre nuk kishin mundësi që t'u japin motrave dhe mjekëve ndonjë pagesë shtesë. Ata shpesh herë nuk ankohen kur ju nevojiten me muaj të tërë për ta nxjerrë një dokument të regjistrimit civil nga zyra publike, vetëm pse nuk e njohin personalisht zyrtarin kompetent.

Edhe në rastet kur individët janë ankuar për diskriminim si rezultat i parregullsive në Universitetin e Prishtinës, nepotizmit në punësim në sektorin publik ose asaj që nuk mund të përgjigjen në faturat ose aktet administrative për shkak se janë shkruar në një gjuhë që nuk e kuptojnë, është fakt që shumë nga këto ankesa mbesin të pashqyrtuara. Në rastet e fundit, Institucioni i Ombudspersonit ka arritur që t'i ndihmojë disa nga këta njerëz përmes intervenimeve të drejtpërdrejta, mirëpo është e vështirë që të përcillen, lere më të zgjidhen ankesat ku njerëzit janë diskriminuar për shkak të praktikave të pandershme apo nepotizmit.

Një analizim i kujdesshëm i një numri të rasteve ku individët ankohen për diskriminim shpesh herë zbulon që faktet e rastit nuk e përkrahin atë pohim. Neni 8 i Ligjit kundër diskriminimit, që është i bazuar në standardet ndërkombëtare, vendos që nëse viktimat e pohuar e diskriminimit mund t'i vërtetojnë dhe paraqesë faktet nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim, atëherë mbetet te pala e paditur që të dëshmojë që diskriminimi nuk ka ndodhur (duke e bartur kështu barrën e provës në rastet e diskriminimit). Megjithatë, në shumicën e rasteve të pohimeve për diskriminim, viktimat nuk mund t'i vërtetojnë faktet e tilla apo nuk dinë si ta bëjnë këtë. Në anën tjetër, në debatet publike, ankesat për diskriminim e kanë arritur një nivel alarmues dhe shpesh herë shfrytëzohen si çështje politike.

Te shumica e njerëzve ekziston një prirje që të thjeshtësohet problemi i diskriminimit. Përkundër besimit të përhapur, çdo dallim në trajtim nuk paraqet diskriminim. Diskriminimi ndodh vetëm atëherë kur personat që ndodhen në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyrë të pabarabartë për shkaqe që nuk mund të arsyetohen në mënyrë objektive, siç janë ato të theksuara më lart ose të përshkruara në nenin 2 (a) të Ligjit kundër diskriminimit (“gjinia, mosha, gjendja martesore, gjuha, paaftësia fizike ose mendore, orientimi seksual, kombi, mendimi apo bindja politike, religjioni apo besimi, përkatësia etnike apo sociale, raca, prona, lindja ose statuset tjera”). Nëse, për shembull, një person nuk merret për të punuar punë ndërtimore për shkak se është i dobët nga shëndeti dhe nuk mund të bartë barra të rënda, atëherë trajtimi i pabarabartë i tij në krahasim me kandidatët tjerë është bërë për një shkak që mund të arsyetohet në mënyrë objektive. Nëse, në anën tjetër, ai nuk merret për të punuar sepse i përket një komuniteti të caktuar etnik, atëherë ky shkak nuk mund të arsyetohet në mënyrë objektive por është i bazuar në paragjykimin që, për shkak të përkatësisë së tij etnike, ai mund të jetë i pabesueshëm, i pandershëm apo jo-punëtor.

Diskriminim gjithashtu mund të ndodhë në rastet kur personat në situata me të vërtetë të ndryshme trajtohen në mënyrë të barabartë. Një shembull i kësaj është problemi i personave me paaftësi fizike. Derisa të mos ketë angazhim të harmonizuar për t'i përmbushur kërkesat e personave me paaftësi fizike, ata do të vazhdojnë të diskriminohen përditë. Personat në karroca invalidësh ose nënat me karroca fëmijësh do të vazhdojnë të varen nga vullneti i mirë i njerëzve në afërsi për të mundur t'u qasen zyrave të caktuara publike. Në të shumtën e rasteve, as shtëpitë e reja të rindërtuara nuk i marrin parasysh personat me paaftësi fizike duke mos e ndërtuar ndonjë kalim për karrocë apo lehtësim tjetër të qasjes. Gjatë këtyre viteve të fundit, Ombudspersoni gjithashtu ka pranuar ankesa lidhur me pamundësinë e personave me paaftësi fizike që të marrin përfitimet pensionale të cilat u takojnë sipas ligjit. Në sektorin e arsimit, është pothuajse plotësisht e kotë që të flitet për objektet dhe programet speciale për fëmijët me paaftësi për të mësuar.

Një shembull tjetër i kësaj forme të diskriminimit është fakti që shumë dokumente publike nuk janë të arritshme për personat që nuk i flasin të dy gjuhët zyrtare në Kosovë. Ky problem paraqitet kudo që një pjesë e popullsisë së komunës nuk e kupton gjuhën e shumicës në atë komunë, si dhe në korrespondencën mes autoriteteve qendrore dhe komunale në vendet ku shumica e popullsisë nuk e flet gjuhën shqipe. Derisa një diskriminim i tillë ndodh zakonisht për shkak të mungesës së njësisë së përkthyesve dhe fondeve për t'i paguar ato, fakti që kjo dukuri është aq e përhapur tregon që informimi i popullsisë për çështjet që u takojnë nuk duket të jetë prioritet për shumicën e zyrave të administratës publike në Kosovë.

Problemi lidhur me gjuhën janë vetëm një nga problemet me të cilat përballen komunitetet që paraqesin pakicë në vendet ku jetojnë. Diskriminimi etnik është gjithashtu i përhapur në sektorin e punësimit dhe shëndetësisë, dhe pjesëtarët e komunitetet të caktuara minoritare (kryesisht serbët dhe romët, por edhe ashkalitë dhe egjiptianët) vazhdojnë t'i nënshtrohen rregullisht kërcënimeve dhe ngacmimeve. Në rastet që kanë të bëjnë me vepra penale kundër këtyre komuniteteve, siç janë vjedhja e gjedhëve ose

uzurpimi apo dëmtimi i pronës, kryerësit identifikohen shumë rrallë; pjesëtarët e këtyre komuniteteve ankohen që policia nuk i heton si duhet këtë vepra penale. Pjesëtarët e komunitetit serb gjithashtu ankohen që janë të përjashtuar nga procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore ku kanë punuar dikur.

Në disa raste, këto forma të diskriminimit janë të bazuara në paragjykimet e stërvjetra që shumica e komuniteteve etnike i kanë për njëra tjetrën. Në rastet tjera, posaçërisht kur viktimat janë pjesëtarë të komunitetit serb, ato janë rezultat i përkeqësimit të raportit mes komunitetit shqiptar dhe serb gjatë njëzet viteve të fundit. Tensionet mes dy komuniteteve janë rritur veçanërisht në këtë kohë kur po zhvillohen bisedimet për statusin e ardhshëm të Kosovës dhe çfarëdo kontakti normal mes tyre është bërë shumë i vështirë. Qasja në zyrat publike pengohet edhe përmes pamundësisë së vërtetë apo të paramenduar të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve për të lëvizur të lirë në të gjitha zonat e Kosovës.

Një arsye tjetër për diskriminimin në bazë të përkatësisë etnike apo bazave tjera është situata ekonomike në Kosovë, e karakterizuar me nivel të lartë të papunësisë dhe varfëri të përhapur. Në një situatë ku numri i vendeve të punës është i kufizuar, shumë punëdhënës e pranojnë haptas që nuk do ta merrnin parasysh punësimin e një personi të një komuniteti tjetër etnik, por më parë do ta punësonin dikë që e njohin.

Derisa situata ekonomike në Kosovë mbetet e mjerë si tani, është vështirë që kjo dukuri do të zhduket. Duhet bërë më shumë për ta rritur njohurinë e shoqërisë kosovare për diskriminimin dhe si të luftohet ai, si dhe do të nevojiten vite apo dekada të tëra për t'i kuptuar këto çështje. Mirëpo, sa më shumë ligje që shpallen për ta parandaluar atë dhe sa më shumë fushata dhe programe nisen për ta ndihmuar zbatimin e këtyre ligjeve dhe rritur njohurinë e përgjithshme për këtë çështje, aq më shpejtë do të përmirësohet situata ekzistuese.

Në Kosovë, shumica e ekspertëve do të pajtoheshin që Ligji kundër diskriminimit, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2004 dhe i shpallur nga PSSP në të njëjtin vit, është një instrument i duhur dhe i përshtatshëm për këtë qëllim. Ligji definon çka paraqet diskriminim, në çfarë rrethana dhe forma mund të ndodhë, ku mund të paraqiten ankesat në lidhje me të dhe si mund të bëhet kjo. Ligji gjithashtu e përmend Institucionin e Ombudspersonit si një entitet jashtëgjyqësor të autorizuar për pranimin e ankesave që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave në baza diskriminuese në sektorin publik dhe privat. Si rrjedhim, Institucioni e themeloi Grupin për mosdiskriminim (GMD), që merret me pranimin e këtyre ankesave.

Megjithatë, ashtu siç ndodh shpesh herë, problemi nuk qëndron në vetë ligjin por në zbatimin e tij. Gjatë tri viteve të fundit, Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar vetëm një numër të vogël të ankesave ku është pohuar diskriminimi. Një numër i madh i njerëzve që jetojnë në Kosovë nuk janë të vetëdijshëm për Ligjin kundër diskriminimit dhe nuk do të dinin ta formulonin një ankesë si duhet edhe po të ishin të vetëdijshëm për të. Gjykatat gjithashtu e kanë regjistruar vetëm një numër të vogël të ankesave lidhur me

diskriminimin deri më tani dhe shumë gjykatës duket ta kenë ende të paqartë se si të punohet me ato raste kur të paraqiten.

Gjatë viteve të fundit, faktorët e rëndësishëm ndërkombëtar dhe vendor janë bërë më të vetëdijshëm për mungesën e zbatimit të këtij ligji. Në nëntor të vitit 2005, Qeveria e Kosovës e miratoi një plan gjithëpërfshirës për zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit, dhe në gusht të vitit 2006, Kryeministri e nënshkroi një Udhëzim administrativ për zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit. Ky Udhëzim administrativ pati për qëllim krijimin e rregullave praktike dhe shërbimeve dhe lehtësimeve strukturore dhe fizike me qëllim të zbatimit të Ligjit kundër diskriminimit, si dhe ta promovimin e trajtimit të barabartë në përgjithësi. Një numër i vogël i ministrive dhe zyrave tjera administrative gjithashtu kanë nxjerrë udhëzime administrative për zbatimin e këtij ligji, si dhe kanë vazhduar trajnimet individuale dhe ngjarjet që kishin të bëjnë me rritjen e njohurisë mbi këtë ligj dhe aspekte tjera të ndërlidhura.

Megjithatë, këto përpjekje nuk kanë qenë edhe aq të suksesshme për rritjen e përgjithshme të nivelit të njohurisë dhe vetëdijes në lidhje me këtë ligj. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, janë ndërmarrë një numër i nismave për t'i identifikuar arsyet kryesore për nivelin e ulët të njohurisë mbi këtë ligj dhe zbatimit të tij, me përqendrim të shtuar në diskutimet rreth mënyrave për t'i tejkaluar këto pengesa. Një ngjarje e tillë ishte tryeza e rrumbullakët mbi zbatimin e këtij ligji, që Misioni i OSBE-së në Kosovë e organizoi në prill të vitit 2007, ku një numër i faktorëve të rëndësishëm në këtë drejtim (duke përfshirë Ushtuesin e detyrës së Ombudspersonit dhe përfaqësuesit e qeverisë vendore dhe shoqërisë civile) biseduan rreth mënyrave për ta rritur njohurinë e përgjithshme dhe zbatimin e Ligjit kundër diskriminimit.

Përafërsisht në të njëjtën kohë, GDF pranë Institucionit të Ombudspersoni e nisi një fushatë informimi për çështjen e diskriminimit në përgjithësi dhe rolin e Ombudspersonit në hetimin e ankesave në lidhje me diskriminimin. Kjo fushatë do të vazhdojë deri në fund të vitit 2007 dhe është e përshkruar më hollësisht në pjesën e këtij Raporti vjetor që ka të bëjë me aktivitetet e GDF-së.

Është e rëndësishme të theksohet që Ligji kundër diskriminimit nuk është instrumenti i vetëm që i mbrohet individët nga trajtimi i pabarabartë në Kosovë. Një numër i instrumenteve ndërkombëtare që i mbrojnë individët nga diskriminimi dhe shkeljet tjera të të drejtave të njeriut janë të zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejt në Kosovë sipas nenit 3 të Kornizës kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme. Ato e përfshijnë Deklaratën e KB-ve për të drejtat e njeriut, Konventën ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike dhe Konventën evropiane për të drejtat e njeriut. Megjithatë, nivelet qendrore dhe lokale të qeverisë, gjykatat dhe publiku në përgjithësi i njohin shumë pak këto instrumente. Kjo ndodh më së shumti për shkak se tekstet e këtyre instrumenteve nuk janë në dispozicion për publikun dhe është vështirë që personat që punojnë në administratën publike t'i gjejnë ato, posaçërisht në gjuhën shqipe dhe serbe.

Siç është theksuar më lart, problemi i diskriminimit është dy-shtresor. Në njërin anë, ka mungesë të përgjithshme të njohurisë mbi atë se çka është diskriminimi dhe si të luftohet

ai, kurse në anën tjetër, strukturat e brishta administrative, ekzekutive dhe gjyqësore në Kosovë, që janë tipike për vendet në tranzicion, e lehtësojnë diskriminimin dhe e pengojnë zhdukjen e tij. Trajtimi i barabartë për të gjithë banorët e Kosovës mund të ndodhë vetëm atëherë kur populli i saj mund t'i identifikojë situatat kur ka ndodhur diskriminimi dhe kur autoritetet publike të kenë vullnet dhe mundësi për t'i përkrahur ata dhe për të vepruar sipas ankesave të tyre.

Barazia gjinore në Kosovë

Barazia gjinore është pjesë e parimit të përgjithshëm të barazisë para ligjit që ekziston në të gjitha vendet demokratike. Ajo e përsërit këtë parim të përgjithshëm për njerëzit e gjinive të ndryshme, duke nënkuptuar që të dy gjinitë do të trajtohen në mënyrë të barabartë në të gjitha situatat. Rastet kur njerëzit e gjinive të ndryshme nuk trajtohen në mënyrë të barabartë mund të nënkuptojë që ata janë duke u diskriminuar.

Koncepti i diskriminimit në bazë të gjinisë përfshin dallimin në trajtim, përjashtimin apo kufizimin në bazë të gjinisë, që me atë rast e rrezikon apo parandalon gëzimin ose ushtrimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në politikë, shoqëri, kulturë apo fusha tjera. Çfarëdo dallimi në trajtim është diskriminues vetëm atëherë kur nuk ka ndonjë arsyetim objektiv apo të arsyeshëm.

Për shkak të statusit të saj momental, Kosova nuk është nënshkruese e instrumenteve ndërkombëtare siç është Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, e miratuar nga Asambleja e përgjithshme e KB-së në vitin 1979. Pasi që Korniza kushtetuese për vetëqeverisje të përkohshme në Kosovë i obligon të gjitha institucionet në Kosovë që të zbatojnë instrumente të caktuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë edhe Konventën mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, rrjedh që kjo Konventë është e zbatueshme në mënyrë të drejtpërdrejt në Kosovë. Parimet e saj janë përfshirë në mënyrë më të hollësishme në Ligjin për barazi gjinore, të shpallur nga Kuvendi i Kosovës më 9 shkurt 2004, që hyri në fuqi me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/18 të datës 7 qershor 2004. Në pajtim me kërkesat e nenit 6 të këtij Ligji, Institucioni i Ombudspersonit e themeloi Njësinë për Barazi Gjinore për të punuar me ankesat që kanë të bëjnë me diskriminimin në bazë të gjinisë. Njësia për Barazi Gjinore (NjBGj) përqendrohet në rastet e diskriminimit në bazë të gjinisë dhe angazhohet për të ndikuar në politikat dhe proceset që e promovojnë analizimin, parandalimin dhe mbikëqyrjen e shkeljeve të të drejtave të njeriut në bazë të gjinisë.

Çështja kryesore në lidhje me Ligjin për barazi gjinore është fakti që shumë faktorë që rrjedhin nga ligjet dhe traditat e lashta, si dhe problemet me të cilat përballet Kosova si shoqëri në tranzicion, krijojnë shumë pengesa për zbatimin e drejtë dhe të duhur të këtij Ligji dhe parimeve që i përmban Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas.

Megjithatë, duhet të theksohet që përkundër vështirësive në këtë drejtim, është bërë shumë prej vitit 1999 për të promovuar vetëdijesimin në lidhje me barazinë gjinore. Në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Kosovës ekziston Zyra për Çështje Gjinore, kurse një numër i ministrive dhe komunave kanë njësuar apo zyrtarët përkatës për barazi gjinore. Në të njëjtën kohë, UNMIK-u, OSBE-ja dhe disa OJQ për gratë kanë qenë shumë aktive në promovimin e të drejtave të gruas në tërë Kosovën. Megjithatë, shtrohet pyetja nëse shumica e fushatave, tryezave të rrumbullakëta apo seminareve që janë mbajtur për t'i shqyrtuar të drejtat e gruas kanë arritur të depërtojnë deri në zonat rurale, ku ekziston një koncept më tradicional lidhur me rolin e gruas në shoqëri.

Në një situatë të një niveli të lartë të papunësisë në Kosovë, është e vështirë që femrat të mund të konkurrojnë në tregun e punës. Gjasat janë më të mëdha që do të punësohen meshkujt, posaçërisht për emërimet të larta, edhe në rastet kur ka kandidatë femra me kualifikime të njëjta. Kështu, niveli i papunësisë është më i lartë në mesin e femrave se sa meshkujve; sipas informatave të marra nga Zyra për Çështje Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, niveli i papunësisë është 70% për femrat dhe 51.7% për meshkujt. Vetëm 13% të femrave jetojnë kryesisht nga të ardhurat e fituara nga punësimi i tyre.

Një numër i madh i këtyre femrave të punësuar nuk marrin rroga të rregullta. Sipas një raporti të publikuar nga PKBZh-ja mbi zhvillimin njerëzor në Kosovë të vitit 2004, femrat kryesisht punojnë në pozita me të ardhura të ulëta dhe mesatarisht marrin rroga që janë deri katër herë më të ulëta se ato të meshkujve. Meshkujt mesatarisht shkollohen dy vite më shumë se femrat dhe është më e rëndomtë që femrat ta vijojnë vetëm shkollën fillore dhe të mesme, kështu që niveli i analfabetizimit në mesin e tyre është më i ulët. Sipas këtij raporti, përqindja e meshkujve që marrin pjesë në tregun e punës ishte 75% në vitin 2004, derisa përqindja e femrave vetëm 31%. Mund të supozohet që pak ka ndryshuar prej atëherë. Tradicionalisht, më shumë femra punojnë në sektorin e arsimit dhe shëndetësisë, derisa më shumë meshkuj duket të jenë duke punuar në sektorin e tregtisë, manifakturës dhe ndërtimitarisë. Sipas informatave që ka marrë Institucioni i Ombudspersonit, shumica dërmuese e femrave janë të punësuar në sektorin e shërbimeve, derisa vetëm një numër i vogël i tyre është i punësuar në tregti, industri të rëndë apo bujqësi.

Në krahasim me shtetet dhe rajonet tjera, shkalla e përfshirjes së femrave në nivelin politik dhe qeveritar në Kosovë duket të jetë e kënaqshme: në Kuvend të Kosovës, përfaqësuesit e gjinisë femërore mbajnë 30% të ulëseve. Në anën tjetër, vetëm një nga trembëdhjetë ministrat që e përbëjnë Qeverinë e Kosovës është femër. Brenda Qeverisë është edhe një zëvendëse e ministrit dhe një sekretare e përhershme. Kjo tregon që derisa përfaqësimi i gjinive në administratën publike të Kosovës mund të duket mirë në letër, meshkujt ende dominojnë në masë të madhe procesin politik dhe vendimmarrës. Shembulli më i fundit është procesi i negociimit për statusin e Kosovës, që u mbajt në vitin 2006 dhe në fillim të vitit 2007 në Vjenë – as edhe një femër nuk ishte e përfshirë në këto bisedime.

Duke u bazuar në informata nga Ministria e Shërbimeve Publike, numri i femrave në postet drejtuese në shërbimin civil është shumë jo-proporcional me atë të meshkujve. Në

nivelin komunal, femrat mbajnë vetëm 90 poste drejtuese nga 893 sa janë gjithsej. Sa i përket këtyre posteve, proporcioni gjinor është përafërsisht 1 me 10 në favor të meshkujve.

Edhe pse femrat janë zakonisht viktime të diskriminimit në bazë të gjinisë, ka pasur raste kur edhe meshkujt janë viktimizuar. Më 6 tetor 2006, Institucioni i Ombudspersonit nxjerri një raport mbi diskriminimin në bazë të gjinisë në shpalljet e konkurseve për vende të lira të punës në sektorin publik që ishin publikuar në gazetën e përditshme “Koha Ditore” mes 1 gushtit 2004 dhe 31 gushtit 2005. Në këtë raport, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjeti që në një numër të shpalljeve për vende të lira të punës, organet punëdhënëse e kishin specifikuar që këto vende të punës ishin vetëm për femra. Ai konsideroi që në secilin nga këto raste nuk kishte pasur ndonjë arsyetim të arsyeshëm për një dallim të tillë në trajtim dhe gjeti që praktikat e tilla ishin në kundërshtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare që e mbrojnë barazinë gjinore në tregun e punës.

Ky raport tregoi përsëri që autoritetet punëdhënëse publike janë pak të vetëdijshme për parimet e mundësisë së barabartë. Gjatë hetimeve, një numër i autoriteteve punëdhënëse nuk dhanë përgjigje të kënaqshme në kërkesat e Institucionit të Ombudspersonit për informata në lidhje me arsyet pse kishin kërkuar që kandidatët për ato vende të punës të jenë vetëm femra. Në njërin nga rastet, autoriteti punëdhënës madje e specifikoi që femrat ishin më të përshtatshme për t’i kryer detyrat e asistentit administrativ, që faktikisht kishin të bëjnë me pranimin e thirrjeve telefonike dhe pritjen e mysafirëve.

Edhe pse është një pasqyrim i diskriminimit të kandidatëve meshkuj për vende të punës në sektorin publik, raporti i mësipërm prapë se prapë është vetëm një përjashtim. Siç është theksuar më lartë, diskriminimi i femrave është formë shumë më e përhapur e diskriminimit në bazë të gjinisë.

Përveç vështirësive për të gjetur punë, një pengesë tjetër për jetën e pavarur të shumë femrave në Kosovë është fakti që ato zakonisht nuk posedojnë ndonjë pronë private apo patundshmëri. Ligjet në fuqi u japin femrave dhe meshkujve të drejta të barabarta në lidhje me trashëgiminë e pronës, mirëpo në shumicën e komuniteteve në Kosovë, me përjashtim të komunitetit serb deri në një masë, prona familjare zakonisht kalon te meshkujt. Posaçërisht në zonat rurale, ideja që një femër mund ta trashëgojë shtëpinë dhe patundshmëritë tjera të familjes është larg nga ajo e zakonshme. Në mesin e rasteve kur femrat kanë kërkuar një pjesë të pronës (për shembull pas shkurorëzimit), ka pasur edhe raste të tilla kur ato janë kërcënuar nga bashkëshortët e tyre apo meshkujt tjerë të familjes.

Kjo shpesh ndodh për shkak se traditat dhe zakonet e lashta të një numri të komuniteteve në Kosovë janë të bazuara në parimin që femrat “u takojnë” familjeve të tyre, në vend se ta kenë ndonjë pavarësi individuale. Nëse një femër nuk është e martuar, ajo është pjesë e familjes së të atit të saj, kurse pas martesës bëhet pjesë e familjes së bashkëshortit të saj. Si pasojë e kësaj, femrat zakonisht janë plotësisht të varura nga familjet e tyre dhe familjet e bashkëshortëve të tyre. Fëmijët tradicionalisht konsiderohen të jetë pjesë e familjes së të atit, derisa më të afërmit e familjes shpesh herë do të besojnë që kanë më

shumë të drejta mbi fëmijët se sa nëna e tyre. Në shoqërinë shqiptare, posaçërisht në zonat rurale, nga të vejat pritet të kthehen në familjen e tyre të lindjes, derisa fëmijët mbesin me familjen e bashkëshortit të saj.

Në bashkësinë rome, shumica e femrave janë zakonisht plotësisht të varura nga bashkëshortët e tyre dhe nga to kryesisht pritet që të rrinë në shtëpi dhe të përkujdesen për shtëpinë dhe familjen – është e rrallë dhe zakonisht e papranueshme që femrat të punësohen dhe të jenë të pavarura nga bashkëshortët e tyre, edhe pse ka disa përjashtime ku femrat kanë filluar të punojnë, madje edhe t'i drejtojnë bizneset e tyre. Sipas një raporti të publikuar nga Instituti për Raportim në Luftë dhe Paqe në mes të vitit 2005, nga vajzat rome pritet që të mësojnë të gatuajnë në moshën pesë ose gjashtë vjeçare dhe që rreth moshës dymbëdhjetëvjeçare të fillojnë të kërkojnë bashkëshortë. Shkalla e shkëputjes së vijimit të shkollimit është më e larta në këtë bashkësi, më së shumti për shkak të asaj që prindërit nuk e shohin ndonjë arsye që ato ta vazhdojnë shkollimin më tej se shkolla fillore.

Varësia e skajshme e femrave nga familjet e bashkëshortëve të tyre në Kosovë i shtyn shumë nga ato që të mos kërkojnë shkurorëzim nga bashkëshortët e tyre. Edhe në rastet kur femrat janë viktima të dhunës familjare, ato shpesh herë më shumë do ta parapëlqejnë atë gjendje ekzistuese se sa të ndahen nga fëmijët e tyre, t'i bëhen barrë familjes së tyre të lindjes apo, në rastin më të keq, të përballen me rreziqet e panjohura të të qenit të detyruara që ta mbajnë veten. Shumica e nënave vetushqyese nuk kanë përfunduar në këtë situatë me dëshirë të tyre – zakonisht, ato janë të veja që i kanë humbur bashkëshortët dhe shtëpitë e tyre gjatë konfliktit të armatosur të vitit 1998-99 apo femra që janë keqtrajtuar seksualisht gjatë këtyre luftimeve dhe i kanë braktisur familjet e tyre. Fatkeqësisht, edhe pse ka disa OJQ dhe strehimore që i ndihmojnë këto femra, nuk ekziston ndonjë përkrahje specifike qeveritare për këtë grup të njerëzve. Veçanërisht, Institucioni i Ombudspersonit, bashkë me UNIFEM-in dhe OJQ-në “Medica”, ka kërkuar që femrat që janë keqtrajtuar seksualisht gjatë viteve 1998-99 të përfshihen në listën e personave që marrin përfitime sipas Ligjit të Kuvendit të Kosovës për statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve të viktimave civile të luftës. Megjithatë, deri më tani nuk është arritur ndonjë përparim lidhur me këtë çështje.

Sa i përket perceptimit të femrës dhe rolit të saj në shoqëri, ende ka dallime të konsiderueshme mes zonave rurale dhe urbane në Kosovë. Në zonat rurale, për shkak të traditave dhe zakoneve të rrënjësura thellë, pozita sociale e femrës është qartas e nënshtruar ndaj asaj të mashkullit dhe shoqëria është shumë pak e vetëdijshme për konceptin e barazisë gjinore. Në qytete dhe qyteza, shoqëria është shumë më e vetëdijshme për çështjet gjinore mirëpo një numër i familjeve, posaçërisht ato që kanë migruar nga zonat rurale, ende u përmbahen traditave dhe botëkuptimeve origjinale të zonave rurale.

Dhuna në familje, kryesisht e drejtuar ndaj grave dhe fëmijëve, vazhdon të jetë problem i madh i të gjitha komuniteteve në Kosovë. Fatkeqësisht, vetëm një numër i vogël i këtyre rasteve u raportohet autoriteteve kompetente. Për shkak të lidhjeve të konsiderueshme

emocionale mes viktimave dhe kryerësve të akteve të dhunës, shpesh herë ndodh që femrat që i raportojnë këto raste nuk kërkojnë urdhrat mbrojtës. Në shoqëritë ku jetojnë, posaçërisht në zonat rurale, femrat shpesh herë konsiderohen të jenë fajtoresh për aktet e dhunës familjare dhe dëshmitarët e sjelljes së tillë zakonisht besojnë që këto raste duhet të zgjidhen brenda familjes. Në shumicën e komuniteteve në Kosovë, nga meshkujt është pritur tradicionalisht që t'i dënojnë gratë e tyre. Një shembull i kësaj mund të gjendet edhe në *Kanun*, ligjin tradicional të shqiptarëve, ku theksohet që “burri ka të drejtë ta rrahë dhe ta lidhë gruan nëse ajo nuk i përfill fjalët dhe urdhrat e tij”.

Gjatë kësaj dhe periudhave tjera për të cilat është raportuar, Institucioni i Ombudspersonit është informuar për një numër të ankesave që kanë të bëjnë me zbatimin jo të drejtë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër dhunës në familje. Me rastin e tryezës së rrumbullakët të organizuar nga ana e Institucionit të Ombudspersonit dhe PKBZh-së në nëntor të vitit 2006 dhe që kishte të bëjë me zbatimin e drejtë të Rregullores së lartpërmendur, Ombudspersoni nxjerri një raport në lidhje me këtë temë. Në këtë raport, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjeti se shumica e gjykatave nga të cilat viktimat kishin kërkuar nxjerrjen e urdhrave mbrojtës, nuk e kishin bërë këtë brenda afateve të caktuara me Rregulloren e UNMIK-ut. Ai konsideroi se kjo ishte shkelje e Rregullores dhe mospërfillje e obligimit të gjykatës për t'i mbrojtur viktimat në pajtim me Konventën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në veçanti nenin 3, që mbron të drejtën për të qenë i lirë nga keqtrajtimi, dhe nenin 8, që mbron të drejtën për respektimin e vendbanimit. Pas diskutimeve në tryezën e rrumbullakët, organizatorët përpiluan rekomandimet me të cilat kërkoheshin përmirësime në punën me këto raste në gjykata, trajnime shtesë të gjykatësve lidhur me dhunën në familje, ndryshime të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12 dhe udhëzime administrative mbi zbatimin e drejtë të saj, si dhe aktivitete tjera për ta rritur njohurinë e përgjithshme në lidhje me këtë çështje.

Një shembull tjetër shqetësues i viktimizimit të grave dhe vajzave në Kosovë është trafikimi me qenie njerëzore. Shumica e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë vijnë nga disa nga shtetet më të varfra në Evropë. Për shkak të statusit të tyre të paligjshëm, ato vuajnë nga diskriminimi në qasje në të drejtat sociale dhe ekonomike dhe shpesh herë i janë nënshtruar dhunës familjare apo të bazuar në gjini edhe në shtetet prej nga vijnë ato.

Një raport i publikuar nga Amnesty International në vitin 2004, thekson që në Kosovë është në rritje trafikimi i femrave të vendit, shumica e të cilave janë ende vajza. Sipas këtij raporti, gratë dhe vajzat e trafikuar që detyrohen të merren me prostitucion janë gjithashtu viktimat e mohimit të të drejtave të njeriut që shkel një numër të marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë Konventën ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas dhe Konventën e KB-së për të drejtat e fëmijëve. Shumë raporte tjera për trafikimin me qenie njerëzore janë publikuar në Kosovë, mirëpo problemi është ende i pranishëm dhe autoritetet vendore nuk duket të marrin përgjegjësi për ta shqyrtuar këtë problem.

Në mënyrë që të përmirësohet situata e tanishme në fushën e barazisë gjinore në Kosovë, autoritetet dhe institucionet kompetente publike në Kosovë duhet të angazhohen më shumë për ta luftuar një dukuri siç është dhuna në familje apo trafikimi me qenie njerëzore. Do të duhej të përgatiten strategji për të garantuar që femrave t'u jepen mundësi të njëjta me ato të meshkujve, për shembull në tregun e punës. Edukimi për trajtimin e barabartë për të gjithë personat, pa marrë parasysh gjininë e tyre, do të duhet të fillojë në një moshë shumë të re; gjithashtu, duhet të ngritet më shumë vetëdija për rëndësinë e trajtimit të barabartë brenda shërbimit civil. Personat që merren me barazinë gjinore duhet gjithashtu të trajnohen vazhdimisht. Si në nivelin qendror qeveritar, ashtu edhe në atë komunal, do të duhej të ketë angazhim të shtuar për të përkrahur dhe ndërtuar më shumë shtëpi të sigurta dhe strehimore, si dhe për të përmirësuar në të njëjtën kohë kushtet në strehimoret ekzistuese, mundësisht me ndihmë të donacioneve ndërkombëtare.

AKTIVITETET E INSTITUCIONIT TË OMBUDSPERSONIT

Si rrjedhojë e vonesave për emërimin e Ombudspersonit të ri, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit ka vazhduar që të kryejë detyrat e Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën po raportohet. Përveç udhëheqjes së Institucionit të Ombudspersonit, ai ka pasur takime të shumta dhe të rregullta me përfaqësues të Institucioneve dhe Organizatave vendore dhe ndërkombëtare.

Përderisa puna më e madhe e Institucionit vazhdon që të përfshijë hetime dhe këshillime lidhur me çështjet e të drejtave të njeriut, gjithashtu përqendrohet edhe në një mori të aktiviteteve tjera. Këtu përfshihet komentimi i ligjeve dhe i politikave qeveritare nga një këndvështrim i orientuar për të drejtat e njeriut, duke mbajtur kontakte me media dhe duke zhvilluar aktivitete për ngritjen e njohurive, shpesh me përkrahjen dhe bashkëpunimin e organizatave ndërkombëtare apo OJQ-ve. Institucioni i Ombudspersonit po ashtu përpiket për të mbajtur raporte të mira të punës me strukturat e qeverisjes lokale dhe bashkëpunon me një numër të organizatave lokale, rajonale dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duke shkëmbyer informacione dhe përvoja. Ky sektor paraqet një pasqyrë të të gjitha aktiviteteve të Institucionit të Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën po raportohet si dhe të çështjeve operative siç është financimi dhe mësimi praktik.

Hetimet, avokimet & ndërhyrjet

Pas pranimit të një ankese ose informate për shkelje potenciale të të drejtave të njeriut ose keqpërdorim të pushtetit, Institucionit të Ombudspersonit i duhet që të vendosë për mënyrën më adekuate për të vepruar. Kjo varet nga faktet e secilit rast individual. Zakonisht, personeli i Institucionit të Ombudspersonit mundohet që të zgjidhë rastet duke adresuar letrën intervenimi autoriteteve të ndryshme publike ose përmes takimeve personale me përfaqësuesit e zyrave përkatëse administrative. Atëherë kur rastet nuk e marrin vëmendjen e merituar, Ombudspersoni mund të informojë mediat me qëllim të ngritjes së informimit publik. Disa raste mund të zgjidhen përmes ndërhyrjeve dhe këshillimeve, por kjo qasje mund të funksionojë vetëm nëse të dyja palët, ankuesi dhe autoriteti mbrojtës, të kenë vullnet për të komunikuar për gjetjen e zgjidhjes.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, stafi i Institucionit të Ombudspersonit kanë arritur që të zgjidhin një numër të rasteve përmes ndërmjetësimit. Në disa raste, kjo ka përfshirë edhe ndihmën ofruar qytetarëve për të fituar ndihmën sociale dhe forma të tjera të përkrahjes. Në rastet e tjera Institucioni i Ombudspersonit ka qenë i dobishëm duke iu ndihmuar personave të sëmurë ose të paaftë për të marrë trajtim adekuat brenda ose jashtë Kosovës.

Në disa raste, ku persona të caktuar janë kërcënuar me procedurën e dëbimit të inicuar nga Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore, ndihma e Institucionit të Ombudspersonit përmes ndërmjetësimit ka pasur sukses duke pezulluar këto procedime për qëllime humanitare ose të tjera.

Ekzaminimi i legjislacionit

Një pjesë e mandatit të Institucionit të Ombudspersonit përfshin komentimin e ligjeve të Kuvendit të Kosovës. Institucioni mund të avokojë në adoptimin ose amendamentimin e ligjeve ose mund të bëjë thirrje për përmirësimin e implementimit të ligjeve të aplikueshme. Institucioni nganjëherë konsultohet nga Kuvendi i Kosovës gjatë planifikimit apo draftimit të ligjeve të ndryshme ose nga autoritetet tjera lidhur me aplikimin e ligjeve. Në rastet e tilla, nga Institucioni kërkohet që të ekzaminojë pajtueshmërinë e këtyre ligjeve dhe praktikave me standardet e të drejtave të njeriut. Zakonisht, kërkesat e tilla kanë të bëjnë me draft-ligjet që janë në fazën e diskutimit.

Në pjesën e dytë të vitit 2006, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit ka marrë pjesë në grupet punuese për draftimin e “Ligjit për mbrojtje nga shpifjet dhe ofendimet” dhe “Ligjit për policinë”. Institucioni i Ombudspersonit gjithashtu ka vazhduar që të jetë i përfshirë në draftimin e Ligjit të Kuvendit të Kosovës për Avokatin e Popullit. Një nga anëtarët e stafit të Institucionit ka qenë pjesë e nën-grupeve punuese përgjegjëse për draftimin e këtij ligji.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ndër të tjera ka komentuar edhe lidhur me ligjet në vijim:

- Draft-ligji i Kuvendit të Kosovës për Punën, në shkurt 2007
- Draft-ligji i Kuvendit të Kosovës për të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal në Kosovë, në shkurt 2007
- Draft-ligji i Kuvendit të Kosovës për Grevat, në shkurt 2007

Aktivitetet e grupeve të veçanta të Institucionit të Ombudspersonit

IOK gjithashtu ka grupe të veçanta juristësh që janë përgjegjës për hetimin e rasteve dhe për ngritjen e njohurive rreth çështjeve në disa fusha të ndjeshme, në veçanti në ato çështje që përfshijnë grupet e cënueshme. Grupi për të Drejtat e Fëmijëve (GDF) përqendrohet në të gjitha ato çështje që kanë të bëjnë me fëmijët duke përfshirë por nuk kufizohet në çështjet që u përkasin shkollave, kujdesit ndaj fëmijës dhe kujdestarisë së fëmijës; Njësia për Barazi Gjinore (NjBGJ) përqendrohet në ato çështje që kanë të bëjnë me diskriminimin në bazë të gjinisë në fushat e ndryshme dhe dhunës në familje. Grupi për Mos-Diskriminim (GMD) përqendrohet në fushat tjera të diskriminimit, në veçanti në ato fusha që bazohen në paaftësi dhe identitet etnik, fetar dhe kombëtar.

Secili nga këto grupe të veçanta bashkëpunon me OJQ-të dhe organizatat tjera që punojnë në fushën e tyre me interes. Ata vijnë në seminarë e konferenca të shumta në Kosovë dhe jashtë vendit. Disa organizata, duke përfshirë edhe OJQ-të që kanë bashkëpunuar ngushtë

me këto grupe dhe që kanë dhënë përkrahje dhe asistencë të çmueshme gjatë periudhës për të cilën raportohet janë UNDP, OSBE dhe OJQ-të “Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut” dhe OJQ-ja e grave të Kosovës “Medica”.

Aktivitetet e grupit për të drejtat e fëmijëve

Objektivat e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve (GDF) në Institucionin e Ombudspersonit të Kosovës (IOK) janë që të monitorojë, të mbrojë dhe të hetojë shkeljet e të drejtave të fëmijëve nga autoritetet publike. E themeluar në mars 2004, GDF gjithashtu synon në ngritjen e dukshmërisë së të drejtave të fëmijëve në Kosovë dhe që të ndikojë në zhvillimin e politikës.

Aktualisht, GDF është i plotësuar me personel prej një juristi; pas largimit të juristit të mëparshëm të GDF në dhjetor 2006, u caktua një jurist i ri për të plotësuar këtë pozitë në maj 2007. GDF bashkërendohet nga Zëvendës Drejtori i Departamentit të Hetimeve i Institucionit.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, aktivitetet e GDF kanë çuar tek disa rezultate konkrete. Numri i rasteve lidhur me të drejtat e fëmijëve pranë Institucionit është rritur konsiderueshëm, një fakt gjithashtu i bashkëpunimit të ngushtë në mes të GDF dhe zyrave rajonale të Institucionit të Ombudspersonit. GDF është ende në proces të themelimit të fortë dhe vendosjes së kontakteve me aktorët social që punojnë në të drejtat e fëmijëve, dhe pritjet që kjo edhe më tej të rrisë numrin e ankesave që do të pranohen nga ky grup. GDF vazhdon në shpërndarjen e pllakateve, fletushkave dhe materialeve promovuese të tij në takimet dhe punëtoritë e ndryshme të cilat i vijon.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, GDF përfundoi pjesën e dytë të fushatës dy-fazëshe mbi ngritjen e vetëdijes, që u iniciua në prill të vitit 2006. Mes tetorit dhe dhjetorit 2006, GDF i vizitoi shkollat në Komunat e Prishtinës, Fushë Kosovës, Rahovecit, Dragashit, Gjakovës, dhe Glllogocit. Gjatë këtyre vizitave, juristët e GDF-së shpërndanë fletushka dhe mbajtën prezantime për t'i informuar nxënësit mbi të drejtat e tyre dhe si të ankohen rreth shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2006, GDF vazhdoi t'i reklamojë aktivitetet e veta në secilën nga këto gazeta ditore: Koha ditore në gjuhën shqipe, Yeni Dönem në gjuhën turke dhe Jedinstvo në gjuhën serbe.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, juristi i GDF dhe Zëvendës Drejtori i Departamentit të Hetimeve që koordinon grupin morën pjesë në disa takime dhe konferenca jashtë vendit që adresonin të drejtat e fëmijëve. Nga 26 gjer më 28 shtator 2006, juristët e GDF morën pjesë si vërtues në një takim të Rrjetit Evropian të Ombudsmanëve për Fëmijë (RjEOF) i cili u mbajt në Athinë, Greqi. Pas kësaj, më 29-30 shtator ata vijuan një Konferencë në Athinë që u organizua bashkërisht nga Komisioneri i Këshillit Evropian për të Drejtat e Njeriut, Ombudsmani për të drejtat e njeriut në Federatën Ruse dhe Ombudsmani Grek. U diskutuan çështjet kyçe në fushën e të drejtave

të fëmijëve, siç janë “Themelimi i zyrave të pavarura për të drejtat e fëmijëve: modelet e ndryshme” dhe “Dëgjimi i fëmijëve, duke i përfshirë ata dhe duke e bërë që zëri i tyre të forcohet”.

Më 19-20 tetor 2006, juristët e GDF morën pjesë në një konferencë mbi “Themelimin e Rrjetit të Ombudsmanëve për të Drejtat e Fëmijëve në Evropën Jug-Lindore”, e organizuar në Novi Sad (Serbi) nga Ombudsmeni i Vojvodinës. Në këtë konferencë, Zëvendës Drejtori i Departamentit të Hetimeve mbajti një prezantim me temën “Zbatueshmëria e Konventës së KB-së për të Drejtat e Fëmijëve përmes ligjeve vendore”.

Prej 14 gjer më 17 nëntor 2006, një psikolog nga zyra e Ombudsmanit Grek mbajti një kurs trajnimi për GDF në selinë e Institucionit të Ombudspersonit në Prishtinë. Qëllimi i këtij trajnimi ishte që t’u ofronte juristëve të GDF këshilla se si të merren me rastet e të drejtave të fëmijëve nga pikëpamja e psikologut. Përfaqësuesi i zyrës së Ombudsmanit Grek po ashtu mbajti një sesion trajnimi për tërë personelin ligjor të Institucionit të Ombudspersonit.

Prej 1 gjer më 2 dhjetor 2006, eksperti ndërkombëtar mbi të drejtat e fëmijëve dhe profesor në Qendrën e të drejtave të njeriut në Universitetin Ghent në Belgjikë u mbajti sesione trajnimi stafit profesional të Institucionit të Ombudspersonit me temën të drejtat e fëmijëve sipas Konventës së KB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve. Gjatë dy ditëve të trajnimit intensiv, profesori përmendi Konventën nen pas neni, duke i lidhur dispozitat e ndryshme me gjendjen aktuale të të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Më 26 dhe 27 mars 2007, përfaqësuesit e OJQ-së së ShBA-së Instituti i Iniciativës për Paqe (IIP) vizitoi Kosovën. Ndhimuar nga GDF ata u takuan me OJQ të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve të cilat veprojnë në Kosovë. Qëllimi i vizitës ishte të hulumtohej mundësia e zhvillimit të “Iniciativës së Medias për Fëmijë” për fëmijët parashkollorë në Kosovë, për t’i mësuar ata në respektimin e diversitetit dhe për t’i edukuar ata që në moshën e hershme që të kenë tolerancë ndaj të tjerëve.

Më 7 prill 2007, juristi i GDF-së mori pjesë në një takim të mbajtur në Novi Sad që u organizua nga Ombudsmeni i Vojvodinës në emër të rrjetit të Ombudsmanëve për të Drejtat e Fëmijëve në Evropën Jug-Lindore. Temë e takimit ishte “ushqimi i shëndoshë – jetë e shëndoshë”, dhe juristi i GDF-së mbajti një prezantim në temën “Sa ndikon varfëria në pamundësinë e realizimit të jetës së shëndoshë?”.

GDF shfrytëzoi vizatimet e fëmijëve, të marra nga gara në vizatim e periudhës së mëhershme e raportimit nëpër shkollat e tërë Kosovës, në përgatitjen e orarit të klasës duke theksuar nene të ndryshme të Konventës së KB-së mbi të Drejtat e Njeriut. Këto orare u shpërndan nëpër shkolla nëpër tërë Kosovën. Ky projekt u realizua në saje të përkrahjes së çmueshme të UNICEF-it.

Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, GDF përgatiti një përpilim të ligjeve të Kosovës lidhur me të drejtat e fëmijëve. Pritet që përpilimi të publikohet në fillim të vitit

të ri akademik shkollor dhe do të lëshohet në një ngjarje të veçantë duke i ftuar autoritetet qendrore dhe komunale dhe përfaqësuesit e OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare.

GDF ishte gjithashtu aktiv në hetimin e një numri rastesh duke përfshirë çështjet e të drejtave të fëmijëve. Këto përfshijnë të drejtat e qasjes së fëmijëve ndaj dy prindërve (e veçanërisht kur prindërit janë të ndarë), procedura gjyqësore të stërzgjatura mbi të drejtën e qasjes, pagesat për të mbajtur fëmijën, verifikimi i atësisë dhe rastet që përfshijnë rrëmbimin e fëmijës nga njëri prind. Rastet tjera përfshijnë zbatimin e aktvendimeve gjyqësore dhe vendimeve administrative lidhur me të drejtat e fëmijëve. GDF gjithashtu ndërhyri në bazë të ankesave për kushte jo adekuate të jetesës, të drejtën për arsim parashkollor, mungesës së oksigjenit për foshnje në Klinikën Universitare të Prishtinës, dhe të drejtën për strehim dhe kujdes adekuat shëndetësor.

Gjatë tërë periudhës për të cilën raportohet, GDF mbajti takime me aksionarë të ndryshëm vendorë dhe ndërkombëtarë, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile, me qëllim të përkrahjes së bashkëpunimit me synim të mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të fëmijëve. GDF gjithashtu bashkëpunoi me UNICEF-in, me Misionin e OSBE-së në Kosovë, me OJQ-në Save the Children, si edhe me OJQ tjera të ndryshme që veprojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Aktivitetet e Grupit për Mos-Diskriminim

I themeluar në mars të vitit 2005, Grupi për Mos-Diskriminim (GMD) përbëhet nga dy juristë të specializuar në çështjet e mos-diskriminimit. GMD i heton ankesat apo informatat tjera që pranohen nga Institucioni i Ombudspersonit që tregojnë se diskriminimi mund të ketë ndodhur në rastet individuale apo në situatat e përgjithshme. GMD sikurse grupet tjera të specializuara pranë Institucionit të Ombudspersonit, koordinohet nga zëvendës drejtori i hetimeve i Institucionit.

Baza ligjore për të ekzistuar GMD është Ligji kundër-diskriminimit, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr.32/2004 më 29 gusht 2004, i cili autorizon Ombudspersonin që të pranojë dhe hetojë ankesat që përfshijnë pretendimet e diskriminimit. Sipas nenit 4 të Ligjit kundër-diskriminimit, kjo gjithashtu përfshin pretendimet e diskriminimit në sektorin privat.

Më 14 dhjetor 2006, përfaqësuesit e GMD morën pjesë në një konferencë mbi përpilimin e strategjisë për përfshirjen në shoqëri të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas. Konferenca u organizua nga Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me misionin e OSBE-së në Kosovë. Qysh prej atëherë, përfaqësuesit e GMD kanë vijuar disa grupe të punës mbi implementimin e strategjisë.

Më 18 prill 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit mori pjesë në një tryezë të rrumbullakët mbi “Implementimin e Ligjit kundër-diskriminimit”, organizuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë. Gjatë asaj tryeze të rrumbullakët ai mbajti një prezantim mbi kompetencat e Institucionit të Ombudspersonit për të hetuar ankesat që lidhen me

diskriminim. Prezantimi u bazua në Ligjin e kundër-diskriminimit, punën e GMD (përfshirë rastet specifike) si edhe raportet e lëshuara nga Institucioni i Ombudspersonit në lidhje me diskriminimin.

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes ndaj diskriminimit dhe punës së GMD, grupi inicioi një fushatë kundër-diskriminimit në mes të muajit maj 2007, i cili do të vazhdoi në fillim të vitit të ardhshëm shkollor në shtator. Përfaqësuesit e GMD vizituan mësuesit dhe drejtorët në shkollat fillore dhe të mesme, përfaqësues komunalë dhe OJQ (veçanërisht ato që mbrojnë të drejtat e njerëzve të paaftë) në këto komuna Podujevë, Prishtinë, Graçanicë, Prizren, Rahovec, Gjakovë, Pejë dhe Mitrovicë. Fushata synonte në përhapjen e dijes mbi parimet dhe format e ndryshme të diskriminimit. GMD shpreson që viktimat e diskriminimit kështu do të jenë në gjendje që më mirë të njohin shkeljet e tilla të të drejtave të njeriut, dhe të dinë se ku të drejtohen që të ankohen për ato. Nga shtatori 2007, GMD ka për qëllim të vizitoi komunat tjera në rajonet jugore, qendrore dhe lindore të Kosovës.

Gjatë vizitave të tyre që ju bënë institucioneve të përmendura, përfaqësuesit e GMD mbajtën ligjërata të shkurta në atë se çka është diskriminimi dhe si të luftohet ai. Ata po ashtu shpërndanë materiale që u publikuan në kohën e fundit si pjesë e fushatës, duke përfshirë edhe pllakate e afishe (“Ndal diskriminimit!”), si edhe fletushka duke informuar publikun mbi diskriminimin dhe si të ankohen rreth tij tek GMD. Fletushka po ashtu përfshin një kuiz përmes së cilës lexuesit mund të testojnë dijen e tyre mbi format e ndryshme të diskriminimit.

Si pjesë e fushatës kundër-diskriminimit, GMD organizoi një garë arti në bashkëpunim me OJQ-në vendore “Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut”. Nga artistët e tërë Kosovës u kërkua që të përgjigjen në pyetjen “Çfarë do të thotë diskriminimi për ju?”. Në maj 2007 në Prishtinë u mbajt një shfaqje me punimet më të mira. Fituesit patën mundësinë të marrin pjesë në Programin Shkëmbyes të Inicativës Rinore në mes artistëve të rinj në Beograd dhe Prishtinë.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, GMD hetoi një numër të ankesave duke përfshirë rastet e pohuara të diskriminimit në pjesë të ndryshme të jetës publike. Shumë nga këto ankesa përfshinë mungesën e qasjes në dokumente, punësim dhe arsim si pasojë e mungesës së aftësisë së ankuesit në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë, zakonisht në gjuhën shqipe. Të tjerat përfshinë rastet e pohuara të diskriminimit në dispozitën e akomodimit humanitar në komunën e Gillogocit, ankesa që fëmijët fizikisht të paaftë nuk mund të vijonin arsimin e tyre në komunën e Podujevës dhe diskriminim në lidhje me disa beneficione të ofruara nga administrata publike. Një ankesë tjetër që u pranua nga GMD e që erdhi nga një OJQ kishte të bënte me të drejtat e të shurdhërve; ankesa ishte rreth mungesës së përkthyesve në gjuhën me shenja në pothuajse të gjitha institucionet e Kosovës. Si pasojë e mungesës së përkthyesve, të shurdhëtit shpesh e kanë të vështirë që të komunikojnë siç duhet me zyrtarët që punojnë në administratën publike.

Një rast tjetër që vlen të përmendet ka të bëjë më një ankesë të diskriminimit të moshës që është dorëzuar nga ish punonjësit e ish ndërmarrjes në pronësi shoqërore “Modeli” në

Gjakovë. Pas privatizimit të kësaj ndërmarrjeje, të gjithë punonjësit me moshë mbi 42 vjeç u ankuan se ata humbën vendet e tyre të punës. Ankesa e punonjësve po ashtu është drejtuar kundër Qeverisë së Kosovës, e që ata thonë se nuk kanë ndërmarrë kurrfarë mase në mbrojtjen e të drejtave të personave me moshë në mes të 45 deri 62 vjeç. Punonjësit ankohen se do të përjetojnë vështirësi në gjetjen e vendeve të reja të punës, gjendja e keqe edhe më shumë u përkeqësua me faktin që ata nuk kanë të drejtë në pensione apo forma tjera të asistencës sociale.

Aktivitetet e Njesisë për Barazi Gjinore

Njësia për Barazi Gjinore (NjBGJ) rishqyrton rastet që përfshijnë pretendimet e diskriminimit në bazë të gjinisë. Përveç analizave ligjore, parandalimit dhe monitorimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut në lidhje me gjininë, ajo gjithashtu angazhohet në aktivitetet e avancimit të parimit të barazisë gjinore. NjBGJ është themeluar në përputhje me nenin 6 të Ligjit për barazi gjinore të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2004/18, dhe është entiteti i vetëm në Kosovë me mandat për të pranuar dhe hetuar diskriminimin në bazë të gjinisë. NjBGJ është gjithashtu përgjegjëse që të rishikojë ligjet dhe të ngrit çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e duhur të këtij ligji dhe Ligjit për barazi gjinore në veçanti.

NjBGJ përbëhet nga një jurist të specializuar në çështjet e barazisë gjinore dhe të drejtat e grave, nën koordinimin e Zëvendës drejtorit të hetimeve të Institucionit. Fillimisht paga e këtij juristi është financuar nga donacionet e qeverisë norvegjeze, ndërsa që marsi i vitit 2007 mbulohet nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës.

Shumë ankesa që i janë paraqitur NjBGJ-së kanë të bëjnë me dhunën në familje, diskriminimin në bazë të gjinisë në fusha të ndryshme, në veçanti gjatë punësimit, vuajtjet me të cilat ballafaqohen nënat e vetme dhe problemet që kanë të bëjnë me kujdestarinë e fëmijës apo ndarjen e pasurisë pas procedurës së shkurorëzimit. Numri i çështjeve të dhunës në familje që u pranua gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportohet ka shënuar rritje në krahasim me periudhën e kaluar të raportimit. NjBGJ kërkoi të bashkëpunonte në baza të rregullta me SHPK-në, me Divizionin për Mbrojtje të Viktimave në Ministrinë e Drejtësisë, qendrat e mirëqenies sociale, shtëpitë e sigurta dhe OJQ-të.

Gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet, NjBGJ-ja ka mbajtur takime të rregullta me udhëheqës të shumtë ndërkombëtarë dhe vendorë, si dhe me përfaqësues të shoqërisë civile, me qëllim të përmirësimit të bashkëpunimit për arritjen e objektivave të përbashkëta siç janë barazia gjinore dhe avancimi i të drejtave të grave në shoqërinë kosovare. NjBGJ gjithashtu bashkëpunoi me përfaqësues të UNDP, UNIFEM, SIDA dhe përfaqësues të ndryshëm të OJQ-ve të grave që veprojnë në Kosovë.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, NjBGJ po ashtu mbajti aktivitete të shumta dhe vijoi trajnime e seminare të ndryshme.

Dy ditë para Ditës ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj grave me 25 nëntor 2006, NjBGJ-ja në bashkëpunim me UNDP-në organizoi një tryezë të rrumbullakët për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr.2003/12 për Mbrojtjen kundër dhunës në familje. Pesëdhjetë e gjashtë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë morën pjesë në këtë ngjarje, ndër ta kishte përfaqësues nga SHPK-ja, gjykatës, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Barazi Gjinore, avokatë të viktimave, si dhe përfaqësues nga qendrat e mirëqenies sociale, shoqëria civile dhe OJQ-të.

Qëllimi i tryezës së rrumbullakët ishte të diskutohej gjer këtu zbatimi i turbullt i Rregullores së UNMIK-ut më lartë dhe identifikimi i mënyrave në të cilat autoritetet përgjegjëse siç janë policia, gjykatat dhe organizatat tjera qeveritare dhe jo-qeveritare do të mund të bashkëpunonin në këtë pikëpamje në të ardhmen. Institucioni i Ombudspersonit publikoi një raport *ex officio* në këtë tryezë të rrumbullakët në lidhje me zbatimin e neneve 7 dhe 9 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2003/12. Në bazë të hetimeve të zhvilluara nga NjBGJ-ja, ky raport nxori në pah se shumica e gjykatave nuk lëshonin urdhra për mbrojtje brenda afateve kohore të saktësuar në këto dispozita.

Një raport tjetër i publikuar gjatë periudhës për të cilën raportohet, përfshinte diskriminimin në bazë të gjinisë në konkurset e shpallura në sektorin publik. Hetimet e bëra nga NjBGJ nxorën në shesh se në një numër të këtyre konkurseve, punëdhënësit publik kishin hapur pozita vetëm për kandidatet femra. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit konsideroi që kjo e shkeli legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar duke ndaluar diskriminimin në bazë të gjinisë.

Sa i përket trajnimit, juristi i NjBGJ-së vijoi pjesën e dytë të seminarit titulluar “Programi rajonal mbi statusin e barabartë të të drejtave të grave”, mbajtur në gusht të vitit 2006 dhe u organizua nga Instituti Suedez Raoul Wallenberg për të drejtat e njeriut dhe të Drejtës Humanitare. Seminari u mbajt në Kiev, Ukrainë dhe u vijua nga aktivistë, përfaqësues të shteteve dhe OJQ-të për të drejtat e njeriut nga vende të ndryshme evropiane. Programi ngërtheu një seri mësimesh, vizita studimore dhe debate rreth rolit të instrumenteve kyçe të të drejtave të njeriut dhe institucionet e angazhuara në mbrojtjen e të drejtave të grave, dhe secili pjesëmarrës ishte i obliguar të paraqiste një plan veprimi për shtetin apo rajonin e tyre. Juristi i NjBGJ-së pati mundësinë të merrte pjesë në këtë program në saje të përkrahjes zemërgjerë nga UNIFEM-i.

Konferencat tjera të vijuar nga NjGJB-ja në vitin 2006 përfshirë edhe konferencën “Ombudsmanët kundër diskriminim të dyfishtë të grave”, organizuar në nëntor 2006 në Novi Sad nga Ombudsmani në Vojvodinë. Në dhjetor 2006, juristi i NjGJB-së morri pjesë në takim të organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore pranë Zyrës së Krye ministrit në temën “Neni 70 i Ligjit mbi familjen në Kosovë dhe implikimet në zbatimin e tij në praktikë”. Në përgjithësi, NjBGJ-ja mirëmbajti kontakte dhe takime të rregullta me Agjencionin për Barazi Gjinore; NjBGJ-ja është ftuar për t’i vijuar të gjitha ngjarjet e organizuara nga kjo zyre gjatë periudhës për të cilën raportohet.

Më 14 shkurt 2007, OJQ-ja e grave “Medica” nga Gjakova organizoi një tryezë të rrumbullakët në zyrat e Institucionit të Ombudspersonit në temën “Zhvillimi i procesit të

përfshirjes së grave të cilat kanë përjetuar abuzim seksual gjatë konfliktit në Kosovë në kuadër të Ligjit të kuvendit të Kosovës mbi statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe familjeve me viktime civile në luftë”. Zëvendës-drejtori i hetimeve të Institucionit mbajti një prezantim në këtë temë. Pas kësaj tryeze të rrumbullakët, Zëvendës-drejtori i hetimeve dhe përfaqësuesit e “Medica”-s patën takim me Ministrin e Mirëqenies Sociale, gjatë së cilës ata kërkuan përkrahjen e Ministrit dukë kërkuar që gratë të cilat ishin viktime të abuzimi seksual në vitin 1998-1999 të përfshihen në ligjin e lartpërmendur.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, juristi i NjBGJ-s u takua me OJQ të shumta që merreshin me aspekte të ndryshme të të drejtave të grave, në mes tyre me OJQ-në suedeze të grave “Kwina to Kwina”, OJQ-në kosovare të grave “Qendra kosovare mbi studimet e gjinisë”, “Norma” dhe “Gratë për Gratë”, OJQ-në serbe të grave “Ruka Ruci” nga Fushë Kosova dhe OJQ-në etnike turke të grave “Zybejde Hanim” nga Prizreni.

Konferencat e vijua në vitin 2007 në fushën e gjinisë dhe të të drejtave të grave përfshijnë edhe një seminar të organizuar në mars të vitit 2007 në Gjakovë nga OJQ-ja “Shoqata e gruas”. Në këtë konferencë, Zëvendës-drejtorja e Departamentit të Hetimeve mbajti një fjalim në temën “Zbatimi i Rregullores së UNMIK-ut mbi dhunën në familje”. Ajo gjithashtu vijoi një punëtori dy ditore në temën: “Gjendja e grave në rajonin e Ballkanit perëndimor”, organizuar nga Qendra rajonale për minoritete në Beograd në mesin e muajit maj 2007. Dy çështjet kryesore që u diskutuan gjatë kësaj punëtorie ishin “Punësimi dhe si të stimulohet zhvillimi ekonomik i grave” dhe “Dhuna në familje”. Zëvendës-drejtori i i hetimeve mbajti një prezantim mbi gjendjen e grave në Kosovë në lidhje me këto tema. Përveç forcimit të bashkëpunimit rajonal të Ombudsmenëve dhe institucioneve tjera për të drejtat e njeriut që punojnë në këtë fushë, punëtorja lehtësoi shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në mes të pjesëmarrësve.

Bashkëpunimi me bashkësinë ndërkombëtare

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit vazhdoi të jetë në kontakt të ngushtë me Misionin e OSBE-së në Kosovë, me Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (ZKLDNj) në Prishtinë dhe zyret e ndryshme në kuadër të UNMIK-ut, kryesisht Zyra për Komunitete, Refugjatë dhe Çështje të Minoriteteve. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ngriti disa çështje me rëndësi për PSSP-në, përfshirë pavarësinë e gjyqësorit dhe çështjet që përfshijnë ushtrimin e të drejtave pronësore nga banorët e lagjes Mëhalla e Romëve në pjesën jugore të Mitrovicës.

OSBE vazhdon t’i ofrojë përkrahjen më të madhe Institucionit të Ombudspersonit, kryesisht duke siguruar këshilltarë të posaqëm për stafin e Institucionit në fushën e ligjit dhe mediave. Deri në pranverën e vitit 2007, ishte një këshilltar tjetër i lartë që siguronte funksionimin e duhur të administratës së Institucionit të Ombudspersonit. Seksioni i Informimit dhe Teknologjisë së Komunikimit të OSBE-së në mënyrë të vazhdueshme ofronte ndihmë të çmueshme duke siguruar funksionimin e serverit të kompjuterëve të

Institucionit të Ombudspersonit dhe meriton falënderime të veçanta për përkushtimin dhe përkrahjen e tyre.

Në gjysmën e dytë të vitit 2006, UNDP ofroi përkrahje substanciale duke ndihmuar në organizimin e tryezës së rrumbullakët mbi implementimin e Rregullores së UNMIK -ut nr. 2003/12 mbi Mbrojtjen kundër dhunës në familje, në lokalet e zyrës qendrore të Institucionit të Ombudspersonit në Prishtinë.

Një ngjarje tjetër e madhe e cila u realizua me një përkrahje të konsiderueshme të stafit profesional i ZKLDNj, si nga zyra e Prishtinës ashtu dhe nga selia në Gjenevë dhe përkthyesit dhe administrata e OSBE-së, ishte Konferenca e Ombudsmanëve Rajonal e mbajtur në Prishtinë më 8 dhe 9 qershor 2007.

Institucioni i Ombudspersonit vazhdoi të ketë kontakte të shpeshta me Drejtorinë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP), ish Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Banesore (DÇPB) në lidhje me një numër rastesh ku njerëzit u ankuan mbi procedurat tek DÇPB. Megjithatë, ishin disa raste, ku rekomandimet e Ushtuesit të Detyrës së Ombudspersonit nuk u diskutuan apo implementuan.

Institucioni i Ombudspersonit po ashtu kontaktoi Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) sa i përket një numri të rasteve, por jo gjithmonë ka pranuar përgjigje sa i përket letërkëmbimit në këtë kontekst. Megjithatë, që nga pranvera e vitit 2007, AKM-ja ka rritur bashkëpunimin në këtë pikëpamje.

Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit ka vazhduar bashkëpunimin me Koordinatorin për Standarde në UNMIK, kryesisht duke informuar atë rreth një numri të çështjeve të drejtave të njeriut të hetuara nga Institucioni.

Gjatë tërë periudhës për të cilën raportohet, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit u takua disa herë me përfaqësues të njësive të ndryshme të KFOR-it për të shkëmbyer informata dhe për të diskutuar situatën e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Sikurse edhe në periudhat e mëhershme të raportimit, Institucioni i Ombudspersonit ka mbajtur kontakte të rregullta me misionet diplomatike të vendeve të ndryshme si në Prishtinë, ashtu edhe në Beograd e Shkup.

Institucioni i Ombudspersonit ka vazhduar të bashkëpunojë dhe të komunikojë me disa organizata tjera ndërkombëtare dhe OJQ që punojnë apo monitorojnë zhvillimet në Kosovë, në veçanti me:

- Komisionin e BE-së
- Misionin Monitorues të BE-së
- Human Rights Watch
- Qendrën për të Drejtën Humanitare në Beograd dhe zyrën e saj në Prishtinë
- Zyra e ICRC-së në Prishtinë
- ONM

- OJQ-në Spanjolle “Lëvizja për Paqe, Çarmatim dhe Liri”
- Save the Children
- Komitetin Suedez të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Stokholm dhe në zyrën e tij në Beograd
- UNHCR-në
- UNICEF-in
- UNIFEM-in

Bashkëpunimi me institucionet vendore

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit pati takime me përfaqësuesit e IPVQ-ve në nivel qendror, duke përfshirë Kryetarin e Kosovës, Kryeministrin e Kosovës, Kryetarin e Kuvendit të Kosovës, për të diskutuar çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut dhe të ardhmen e Institucionit të Ombudspersonit. Një numër i njëjësive mbi të drejtat e njeriut të krijuara pranë ministrive gjithashtu kanë bashkëpunuar me Institucionin e Ombudspersonit në baza individuale. Në mars të vitit 2007, Kryeministri i Kosovës nxori një udhëzim administrativ duke i obliguar këto njësi mbi për të drejtat e njeriut që të komunikojnë dhe të shkëmbejnë informata me Institucionin e Ombudspersonit.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit rregullisht adresoi kërkesa për informata dhe letra intervenimi ministrive të ndryshme, duke ua tërhequr vëmendjen për çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut lidhur me punën e ministrive të tyre. Fatkeqësisht, të gjithë ministrat nuk u përgjigjën në këto intervenime. Në rastet kur ata i përgjigjeshin Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit, informata nuk ishte complete apo nuk përcillej nga ndonjë veprim i duhur. Shumë autoritete komunale të Kosovës ishin edhe më pak të përgjegjshme ndaj përpjekjeve të Institucionit për të ndihmuar ose ndërmjetësuar në lidhje me ankesat e individëve të cilat bien nën juridiksionin e tyre. Përfundimisht më i theksuar nga kjo rregull është rasti i Komunës së Vushtrisë dhe e Fushë Kosovës, të cilat zakonisht janë përgjigjur me kohë në kërkesat dhe rekomandimet e Ombudspersonit. Kurse në rastin e kundërt, Komuna e Prishtinës ka vazhduar të mos bashkëpunojë me Institucionin, sikurse edhe Komuna e Skenderajt dhe e Mitrovicës. Sa i përket dy Komunave të fundit, Institucioni publikoi një raport special në të cilin Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit konsideroi që kjo mungesë e bashkëpunimit kishte shkelur obligimet e këtyre komunave për të bashkëpunuar me Institucionin sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë.

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, bashkëpunimi më Kuvendin e Kosovës është përmirësuar dukshëm, veçanërisht me Komisionin e Kuvendit për Çështjet Gjyqësore dhe Legjislative dhe Kornizë Kushtetuese. Shembujt e një bashkëpunimi të mirë ishin diskutimet e vazhdueshme në lidhje me draft ligjin e Kuvendit mbi Avokatin e Popullit, pjesëmarrja aktive e Kryetarit të Komisionit në Konferencën Rajonale të Ombudsmanit dhe bashkëpunimi në lidhje me projektin e organizuar dhe financiar nga Qendra Ndërkombëtare e Tranzicionit Demokratik në Hungari për forcimin e institucionit demokratik në rajonin e Ballkanit.

Stafi i Institucionit të Ombudspersonit ishte gjithashtu në kontakt të vazhdueshëm me gjykatësit e të gjitha gjykatave në Kosovë për të marrë informatat më të reja në ato raste ku individët janë ankuar për procedurat e stërzgjatura. Në shumicën e rasteve, bashkëpunimi me gjyqësorin ishte i mirë, duke përfshirë Gjykatën Komunale në Ferizaj, e cila për një kohë të gjatë dështoi t'i përgjigjet kërkesave të Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit.

Bashkëpunimi me OJQ-të vendore

Përveç bashkëpunimit me OJQ-të vendore të përmendura më lartë, Institucioni i Ombudspersonit po ashtu përmirësoi bashkëpunimin me OJQ-të kosovare. Personeli i Institucionit të Ombudspersonit rregullisht takoi një numër të OJQ-ve të grave dhe fëmijëve përfshirë edhe Qendrën për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, “Norma” dhe “Medica”. Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informatave vazhdoi me OJQ-në HANDIKOS që merret me mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

Personeli i Institucionit të Ombudspersonit gjithashtu bashkëpunoi me disa OJQ në projekte për ngritjen e vetëdijes. Një projekt i tillë ishte edhe një garë arti me temën “Çfarë do të thotë diskriminimi për ju?”, të cilën e organizoi Institucioni së bashku me OJQ-në “Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut”, si pjesë e fushatës së përgjithshme e Institucionit në ngritjen e vetëdijes kundër diskriminimit iniciuar në pranverën e vitit 2007. Gara e artit arriti pikë kulmore më një shfaqje të mbajtur në lokalet e Inicativës Rinore në maj të vitit 2007 dhe shpërblimet për fitues gjithashtu u siguruan nga Iniciativa Rinore.

Edhe një projekt tjetër që u organizua me një OJQ, ishte një tryezë e rrumbullakët për të drejtat e grave që kanë përjetuar abuzim seksual gjatë luftimeve në vitin 1998-1999, të cilën Institucioni i Ombudspersonit e mbajti sipas kërkesës së OJQ-së së grave “Medica” me seli në Prishtinë.

Mësimi praktik

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit u ofroi mësim praktik njëmuor për 25 studentë nga Fakulteti Juridik dhe Fakulteti i shkencave politike të Universitetit të Prishtinës. Mësimi praktik në Institucionin e Ombudspersonit iu ofrua edhe dy fituesve të Kosova Case Challenge 2006, një simulim i gjykimit gjatë të cilit nga pjesëmarrësit kërkohet që ta simulojnë procedurën pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Për herë të parë, Institucioni i Ombudspersonit angazhoi edhe dy praktikantë që punuan në kohë të ndryshme në zyrën për media të Institucionit.

Marrëdhëniet me media dhe ngritja e njohurive

Institucioni i Ombudspersonit i ka shtuar përpjekjet për marrëdhënie me media dhe ngritje të njohurive gjatë kësaj periudhë për të cilën po raportohet duke e zhvilluar një strategji më të gjerë për informim të publikut dhe duke i përkushtuar vëmendje më të madhe zgjerimit të sferës së zyrës për çështjet me publikun. Gjithashtu është rritur fokusimi për themelimin dhe përkujdesjen ndaj partneritetit me media dhe me grupet e shoqërisë civile me qëllim të promovimit të punës së Institucionit të Ombudspersonit dhe çështjeve për të drejtat e njeriut në përgjithësi.

Për herë të parë që nga fillimi, faqja e internetit e Institucionit të Ombudspersonit është rindërtuar tërësisht gjatë periudhës për të cilën po raportohet. Përveç dizajnit të ri dhe strukturës përmbajtësore më të përshtatshme për përdorim, faqja e internetit tani ofron veçori të tjera siç janë galeritë me foto, artikuj të arkivuar nga gazetatat, mundësinë për kërkim dhe lidhje tek faqet tjera të rëndësishme. Shpresohet se këto veçori të shtuara do të tërheqin më shumë vizitorë në faqen e internetit dhe do të promovojnë më mirë raportet, deklaratat publike dhe aktivitetet e Institucionit të Ombudspersonit. Faqja e re e internetit do të lancohet gjatë korrikut 2007 në adresën aktuale të internetit të Institucionit (www.ombudspersonkosovo.org).

Një risi tjetër e Institucionit të Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën po raportohet është publikimi i formularit të ankesave, i cili po ashtu përfshin informata themelore lidhur me Institucionin. Duke e plotësuar formularin para bisedës me juristët e Institucionit, ankuesit tani kanë mundësi që t'i qartësojnë faktet që ndërlidhen me rastet e tyre, gjë që shërben në përmirësimin dhe përshtetësinë e procesit fillestar të konsultimeve. Formularët për ankesa janë në dispozicion në zyrat dhe faqen e internetit të Institucionit të Ombudspersonit, po ashtu edhe në ndërtesat e administratës publike, gjykata dhe burgje kudo në Kosovë.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit dhe personeli i lartë i Institucionit kanë vazhduar kontaktet pozitive me mediat vendore dhe ndërkombëtare, duke marrë pjesë në konferenca për shtyp, debate radio-televizive si dhe në intervista sy me sy me qëllim të promovimit të disa çështjeve të ndryshme lidhur me të drejtat e njeriut për publikun e gjerë. Veçanërisht, interesimi i gazetarëve vendorë është rritur për përcjelljen e raporteve të Institucionit. Mediat lokale po ashtu e kanë përcjellë me interesim të veçantë procesin e emërimit për postin e Ombudspersonit, i cili mbetet për tu finalizuar.

Konferenca Rajonale për Ombudsmanë, nikoqir i së cilës për herë të parë ishte Institucioni i Ombudspersonit në qershor 2007, ka tërhequr vëmendjen e gjerë të mediave për aktivitetet dhe prioritetet aktuale të Institucionit. Karakteri ndërkombëtar i kësaj ngjarjeje dhe pjesëmarrja aktive e palëve të interesuara vendore, e ka ngritur edhe më shumë perceptimin publik të Institucionit si mekanizmi udhëheqës për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Grupet e veçanta të Ombudspersonit vazhdojnë që të ngritin njohuritë e publikut dhe palëve të interesuara lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me punën e tyre. Grupi për të

Drejtat e Fëmijëve (EDF) ka vazhduar me “Fushatën për njohuritë mbi të Drejtat e Fëmijëve” e cila është iniciuar gjatë periudhës së fundit për të cilën është raportuar, e cila përbëhet nga vizita dhe shpërndarje të materialeve nëpër shkolla kudo në Kosovë. GDF po ashtu ka përgatitur një përpilim të ligjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, i cili do t’iu shpërndahet të gjitha palëve të interesuara gjatë pjesë së dytë të vitit 2007. Në anën tjetër, Njësia për Barazi Gjinore (NjBGj), gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportohet, vëmendjen e ka përqendruar në ngritjen e njohurive lidhur me çështje gjinore si dhe në kujdesin ndaj partneritetit në mes të shoqërisë civile. Shembull i këtij bashkëpunimi ishte tryeza e rumbullakët lidhur me dhunën në familje, nikoqir i së cilës ishte Institucioni i Ombudspersonit në bashkëpunim me UNDP-në të cilët i kanë mbledhur OJQ-të dhe palët e tjera të interesuara për të adresuar implementimin e disa masave të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12 për mbrojtje ndaj dhunës në familje.

Grupi për Mos-Diskriminim ka qenë veçanërisht aktiv në sferën publike, duke lancuar një fushatë “Stop Diskriminimit” që përbëhet nga ligjëratat kundër diskriminimit nëpër shkolla, grupe të shoqërisë civile dhe autoritetet lokale kudo në Kosovë. Pamfletet dhe afishet e publikuara së fundmi, janë shpërndarë si pjesë e fushatës. Si shtesë, dhe në bashkëpunim me OJQ-në vendore “Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut”, GMD ka organizuar një garë me punime artistike që i përgjigjeshin pyetjes “Çka do të thotë diskriminim për ju?”. Në Maj 2007, në Prishtinë është mbajtur një ekspozitë me punimet më të mira të dorëzuara nga të gjitha anët e Kosovës . Më tepër informata lidhur me aktivitetet e grupeve të veçanta për ngritjen e njohurive mund të gjinden brenda sektorit të aktiviteteve të këtij raporti vjetor.

Për herë të parë, zyra për marrëdhënie me publikun e Institucionit të Ombudspersonit ka qenë nikoqire e dy praktikantëve gjatë periudhës për të cilën po raportohet, një gjatë periudhës gusht-shtator 2006 dhe tjetri gjatë periudhës prill-maj 2007, njëkohësisht duke i mundësuar zyrës për marrëdhënie me publikun zgjerimin e fushëveprimit të aktiviteteve dhe efektivitetit për periudhën e ardhshme raportuese.

Bashkëpunimi dhe ndërtimi i kapaciteteve

Institucioni i Ombudspersonit ka vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me institucionet e ngjashme të vendeve të tjera, në rastet ku zgjidhja e një ankese ka kërkuar edhe angazhimin e tyre. Bashkëpunim për qëllime të tilla ka pasur, për shembull, me Ombudsmanin e Malit të Zi, Kroacisë, Spanjës, Zvicrës, Norvegjisë dhe Finlandës.

Veç kësaj, personeli i Institucionit të Ombudspersonit ka marrë pjesë në një numër të vizitave studimore, konferencave, punëtorive dhe seminareve të ndryshme. Qëllimi i këtyre vizitave ishte njohja e personelit të Institucionit të Ombudspersonit me përvojat më të mira të institucioneve të tjera të ombudsmanëve dhe organizatave për të drejtat e njeriut nga vendet e rajonit dhe nga Evropa.

Bashkëpunimi: Konferencat, seminarët dhe punëtoritë

Në **gusht 2006**, një juriste e Njesisë për Barazi Gjinore (NjBGj) në kuadër të Institucionit të Ombudspersonit, ka ndjekur pjesën e dytë të seminarit me temë “Programi rajonal për statutin e barabartë të të drejtave të grave” i organizuar nga Instituti suedez për të Drejtat e Njeriut dhe Ligjin Humanitar Raull Wallenberg. Seminari është mbajtur në Kiev të Ukrainës, kurse pjesëmarrës në të kanë qenë aktivistë, përfaqësues shtetërorë dhe OJQ për të drejtat e njeriut nga shtete të ndryshme evropiane. Juristja e NjBGj-së ka marrë pjesë në këtë program duke iu falënderuar përkrahjes së UNIFEM-it

Më **31 gusht 2006**, zëvendës drejtorja e Departamentit të Hetimeve të Institucionit të Ombudspersonit ka marrë pjesë në një seminar të organizuar në Prishtinë nga misioni i OSBE-së në Kosovë për inspektorët e policisë, me këtë rast ajo e ka prezantuar rolin e Institucionit të Ombudspersonit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Më **14-16 shtator 2006**, një përfaqësuese e Institucionit të Ombudspersonit ka marrë pjesë në një seminar me përfaqësuesit e tjerë të institucioneve të ombudsmanëve nga tërë Evropa Jug-Lindore. Përfaqësuesja ka mbajtur një prezantim në temën “Ombudspersoni si institucion i reformave administrative”. Seminari është mbajtur në Ohër, IRJ e Maqedonisë, kurse është organizuar nga Ombudsmeni i Greqisë si pjesë e projektit EUNOMIA.

Më **21 shtator 2006** zëvendës drejtorja e Departamentit të Hetimeve të Institucionit të Ombudspersonit, së bashku me përfaqësuesit e njësive për të drejtat e njeriut në kuadër të ministrive të qeverisë së Kosovës, kanë marrë pjesë në një seminar të organizuar nga Instituti Ligjor i Kosovës në Prishtinë në bashkëpunim me OSBE-në dhe me Zyrën për qeverisje të mirë, për të drejta e njeriut, mundësi të barabarta dhe çështje gjinore, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit. Përfaqësuesi i Institucionit ka prezantuar rolin e Institucionit të Ombudspersonit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ka bërë thirrje për rritje të bashkëpunimit në mes të njësive për të drejtat e njeriut dhe Institucionit.

Nga **26 -28 shtator 2006**, juristët e Grupit për të Drejtat e Fëmijëve (GDF) të Institucionit të Ombudspersonit kanë marrë pjesë si vëzhgues në Rrjetin Evropian të Ombudsmanëve për Fëmijë, të organizuar nga Ombudsmeni i Greqisë në Athinë. Juristët e GDF-së e kanë shfrytëzuar këtë mundësi për shkëmbimin e informatave dhe përvojave të mira me institucionet e ombudsmanëve të vendeve të tjera.

Më **29-30 shtator 2006**, juristët e GDF-së kanë marrë pjesë në një konferencë të mbajtur në Athinë e cila është organizuar nga Komisioneri për të Drejtat e Njeriut i Këshillit të Evropës, në bashkëpunim me Ombudsmenin për të drejtat e njeriut në Federatën Ruse dhe Ombudsmeni grek. Disa nga temat kryesore që janë diskutuar ishin: “Themelimi i zyrave të pavarura për të drejtat e fëmijëve: modelet e ndryshme” dhe “Ndëgjimi dhe përfshirja e fëmijëve në ngritjen e zërit të tyre”.

Më **6-7 tetor 2006**, jurist[et e Institucionit të Ombudspersonit kanë marrë pjesë në një seminar të mbajtur në Prishtinë, lidhur me temën “ Sundimi i ligjit dhe çështjet e

qeverisjes së mirë”. Seminari ishte organizuar nga Këshilli i Evropës dhe ishte sponsoruar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

Më **12-13 tetor 2006**, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit dhe një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit kanë marrë pjesë në Forumin për Shoqëri Civile të Lisbonit për Protokolin Shtesë të Marrveshjes Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore të mbajtur në Lisbon të Portugalisë. Forumi është organizuar nga Qendra Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore në bashkëpunim me OJQ-në “Koalicioni për një Protokoll Shtesë”

Më **19-20 tetor 2006**, juristët e GDF-së kanë marrë pjesë në konferencën për “Themelimin e një rrjeti të ombudsmanëve për të drejtave e fëmijëve në Evropën Jug-Lindore” e cila u mbajt në Novi Sad (Serbi) dhe ishte organizuar nga Ombudsmani i Vojvodinës. Njëri nga avokatët e GDF-së ka bërë një prezantim gjatë konferencës lidhur me “Aplikueshmërinë e Konventës së Kombeve të Bashkuara nëpërmes ligjeve vendore”

Më **23-27 nëntor 2006**, një jurist dhe një asistent ligjor i Institucionit të Ombudspersonit kanë marrë pjesë në një seminar me temën “Ndërtimi i Paqes, Transformimi i konflikteve dhe rindërtimi pas luftës, pajtimi dhe zgjidhja” i cili është mbajtur në Cluj-Napoka, Rumani kurse ishte organizuar nga OJQ “Kalimi në Paqe dhe Rrjeti i Zhvillimit”.

Më **25 nëntor 2006**, NjBGj në bashkëpunim me UNDP-në kanë organizuar një tryezë të rrumbullakët lidhur me implementimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/12 për “Mbrojtjen kundër dhunës në familje”. Në këtë ngjarje morën pjesë pesëdhjetë e gjashtë ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, në mesin e tyre përfaqësues të SHPK-së, gjyqtarë, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, juristë të viktimave si dhe përfaqësues të qendrave për mirëqenie sociale, shoqërisë civile dhe OJQ-ve.

Në **dhjetor 2006**, një avokat i NjBGj-së ka marrë pjesë në një tryezë të rrumbullakët në Prishtinë, të organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit lidhur me temën “Neni 70 i Ligjit të Kosovës mbi familjen dhe implikimet për zbatimin e tij në praktikë”.

Më **13-14 dhjetor 2006**, zëvendës drejtorja e Departamentit të Hetimeve ka marrë pjesë në një punëtori në Prishtinë që kishte për qëllim zhvillimin e strategjive për të drejtat e njeriut në Kosovë. Punëtorja ishte organizuar nga Zyra e Këshilldhënëse për qeverisje të mirë, për të drejtat e njeriut, për mundësi të barabarta dhe çështje gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe zyrën e Kombeve të Bashkuara të Komisionerit të Lartë për të Drejtat Njerëzore.

Më **14 dhjetor 2006**, përfaqësuesit e GMD-së kanë marrë pjesë në një konferencë për përpilimin e një strategjie për integrimin në shoqëri të komuniteteve romë, ashkalinjë dhe egjiptianë. Konferenca është mbajtur në Prishtinë dhe është organizuar nga qeveria e Kosovës në bashkëpunim me misionin e OSBE-së në Kosovë.

Më **7 shkurt 2007**, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka qenë panelit në një konferencë të titulluar “Përgjegjësia, Barazia dhe Sundimi i së Drejtës :drejt një të ardhme demokratike” organizuar nga Iniciativa e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut në Prishtinë.

Më **14 shkurt 2007**, Institucioni i Ombudspersonit ka mbajtur një tryezë të rrumbullakët të organizuar nga OJQ-ja e grave “Medica” lidhur me temën “Zhvillimi i procesit për integrimin e grave që kanë pësuar abuzim seksual gjatë konfliktit në Kosovë, në Ligjin e Kuvendit të Kosovës për Statutin dhe të Drejtat e Familjeve të Martirëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjestarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Familjet e Viktimave Civile të Luftës”.

Më **3-4 mars 2007**, një jurist i Institucionit të Ombudspersonit ka marrë pjesë si gjykatës në rundin preliminar të Kosovës në një garë të gjykatës së improvizuar. Kjo garë ishte pjesë e “Sfida e Çështjes së Ballkanit 2007” dhe ishte organizuar nga Shërbimi Universitar Botëror i Austrisë (WUS). Më **28 maj deri më 1 qershor 2007** një jurist tjetër nga Institucioni i Ombudspersonit ka marrë pjesë si gjykatës në rundin final të garës së mbajtur në Vjenë të Austrisë.

Më **29-30 mars 2007**, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka marrë pjesë në “ Takimin për dimensionet plotësuese njerëzore për lirinë e tubimit, sindikale dhe shprehjes; duke siguruar pjesëmarrje të plotë dhe të barabartë në shoqëritë pluraliste” të mbajtur në Vjenë të Austrisë. Mbledhja është organizuar nga zyra e OSBE-së për institucione demokratike dhe të drejta njerëzore dhe nga Kryesia spanjolle e OSBE-së.

Më **7 prill 2007**, një jurist i GDF-së ka marrë pjesë në një takim të mbajtur në Novi Sad i cili ishte organizuar nga Ombudsmeni i Vojvodinës në emër të Rrjetit të Ombudsmenëve për të drejtat e njeriut në Evropën Jug-Lindore. Tema e takimit ka qenë “ Ushqimi i shëndetshëm dhe mënyra e shëndetshme e jetës”; juristja e GDF-së ka bërë një prezantim me temën “Si ndikon varfëria në paaftësimin e realizimit të mënyrës së shëndetshme të jetës?”

Më **11 prill 2007**, një përfaqësues i Qendrës Ndërkombëtare për Tranzicion Demokratik (QNTD)-një institucion i pavarur i themeluar nga Qeveria Hungareze , ka vizituar Institucionin e Ombudspersonit si pjesë e një projekti që synon forcimin e institucioneve demokratike në rajonin e Ballkanit.

Më **18 prill 2007**, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka marrë pjesë në tryezën e rrumbullakët me temën “Zbatimi i Ligjit kundër-diskriminimit” të organizuar nga misioni i OSBE-së në Kosovë, në të cilën ka bërë një prezantim lidhur me kompetencat e Institucionit të Ombudspersonit për hetimin e ankesave që kanë të bëjnë me diskriminim.

Më **24 prill 2007**, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit dhe Zëvendësi i Ombudspersonit morën pjesë në Tryezën e Rrumbullakët Regjionale me temën “Roli i Ombudsmenit në Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kushtetutën e Ardhshme të Malit të Zi”. Tryeza e Rrumbullakët ishte organizuar nga Ombudsmeni i

Malit të Zi dhe misionit të OSBE-së në Mal të Zi, dhe ishte mbajtur në Podgoricë, Mali i Zi.

Në **maj 2007**, zëvendës drejtorja e Departamentit të Hetimeve të Institucionit të Ombudspersonit ka marrë pjesë në një konferencë me temën “Pozita e grave në rajonin e Ballkanit perendimor” e cila është mbajtur në Beograd nga Qendra Rajonale për Minoritete. Zëvendës drejtorja ka bërë dy prezantime gjatë konferencës, njërën lidhur me të drejtën e grave në tregun e punësimit dhe tjetrën lidhur me dhunën në famije në Kosovë.

Më **8 dhe 9 qershor 2007**, Institucioni i Ombudspersonit ka qenë nikoqir i Konferencës së Ombudsmanëve të Rajonit me temën: “Përkrahja dhe pengesat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut”. Konferenca ka mbledhur përfaqësuesit e Institucioneve të Ombudsmanëve nga e tërë Evropa Jug-Lindore, poashtu edhe autoritetet lokale, grupet e shoqërisë civile dhe mediat. Kjo ngjarje është përshkruar më detajisht më poshtë, dhe rekomandimet e dala nga përfundimet e konferencës janë të bashkangjitura në aneksin 4 të këtij raporti vjetor.

Më **27 qershor 2007**, një delegacion nga QNTD-ja ka vizituar Institucionin për të mbajtur një grup punues me përfaqësuesit e Institucionit, organizatave ndërkombëtare, grupeve të shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara. Grupi punues është organizuar për të ndihmuar QNTD-në në formulimin e rekomandimeve për draft-ligjin e Kuvendit të Kosovës Ombudspersonin si dhe lidhur me të ardhmen e strukturës së Institucionit.

Ndërtimi i kapaciteteve: Vizitat studimore dhe trajnimet

Në **shtator 2006**, menagjeri i prokurimit në Institucionin e Ombudspersonit e filloi një trajnim në Prokurimin Publik në Universitetin për Biznes dhe Teknologji në Prishtinë. Ky program u financua nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe përfundon në nëntor të vitit 2007.

Më **12 shtator 2006**, personeli ligjor dhe administrativ i Institucionit të Ombudspersonit kanë marrë pjesë në një trajnim për procedurat adekuate të arkivimit. Trajnimi është mbajtur si pjesë e vazhdueshme e Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) për ndërtimin e kapacitetit dhe përkrahjes së Institucionit të Ombudspersonit, dhe është organizuar nga Këshilli i Evropës. Në përcjellje të këtij sesioni, një ekspert nga Arkivi i Kosovës ka mbajtur trajnim për trajnerë për të gjitha zyrat e Institucionit të Ombudspersonit në mbarë Kosovën në pjesën e dytë të shtatorit 2006.

Më **18-19 shtator 2006**, personeli i Institucionit të Ombudspersonit ka ndjekur një trajnim dy ditor me fokus në çështjet mjedisore. Trajnimi ishte sponzoruar nga Bugjeti i Konsoliduar i Kosovës dhe është udhëhequr nga Juristët e Lartë të Ombudsmanit grek në zyrën qendrore të Institucionit në Prishtinë.

Nga **tetori 2006**, personeli ligjor i Institucionit të Ombudspersonit ka filluar që të ndjekë ciklin e dytë të kursit për gjuhë angleze për terminologji ligjore që mbahet në Cambridge School në Prishtinë, kurse financohet nga SIDA. Një pjesë e kursit do të vazhdojë pjesërisht edhe në periudhën e ardhshme për të cilën do të raportohet.

Më **6-7 tetor 2006**, juristët e Institucionit të Ombudspersonit morën pjesë në një seminar që u mbajt në Prishtinë me temën "Sundimi i së Drejtës dhe Qështjet e Qeverisjes së mirë". Seminari i organizua nga Këshilli i Evropës dhe u financua nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA).

Më **16-20 tetor 2006**, dy juristë nga Institucioni i Ombudspersonit kanë vizituar zyrat e Ombudsmanit në Tuscany, Itali, si pjesë e programit shkëmbyes në mes të Institucionit dhe Asociacionit të Komunave të Valdnievolës (Tuscany). Vizita është sponsoruar nga një donacion i qeverisë amerikane për iniciativat e ndërtimit të kapacitetit të Institucionit.

Nga **tetori deri në dhjetor 2006**, personeli administrativ dhe përkthyesit e Institucionit të Ombudspersonit kanë ndjekur një kurs për gjuhën angleze të biznesit në New Age School në Prishtinë. Kostoja e kursit është mbuluar nga qeveria e SHBA-së.

Në **nëntor 2006**, personeli i Institucionit ka ndjekur kurset për aftësitë drejtshkrimore në gjuhën shqipe dhe serbe, të financuar nga SIDA në zyrën qendrore të Institucionit. Kurset janë mbajtur nga një trajner i Kuvendit të Kosovës dhe janë organizuar nga Këshilli i Evropës.

Më **14-17 nëntor 2006**, një psikolog nga zyra e Ombudspersonit grek ka mbajtur një trajnim për trajnerë për GDF-në, në zyrën qendrore të Institucionit të Ombudspersonit në Prishtinë, trajnimi është financuar nga qeveria norvegjeze. Trajnimi kishte për qëllim këshillimin e juristëve të GDF-së për trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve nga këndvështrimi i psikologut.

Më **1-2 dhjetor 2006**, një ekspert ndërkombëtar mbi të drejtat e fëmijëve dhe profesor në Qendrën për të drejtat e njeriut në Universitetin Ghent të Belgjikës, ka mbajtur një trajnim për juristët e personelit të Institucionit të Ombudspersonit në zyrën qendrore të Institucionit në Prishtinë. Trajnimi është financuar nga donacioni i qeverisë norvegjeze, kurse është fokusuar në dispozitat e ndryshme të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve.

Më **4-8 dhjetor 2006**, një delegacion nga Institucioni i Ombudspersonit ka vizituar zyrën e Ombudsmanit të Hungarisë në Budapest me qëllim të shkëmbimit të përvojave administrative dhe ligjore. Kjo vizitë studimore është financuar nga SIDA.

Më **27–29 mars 2007**, përkthyesit e Institucionit të Ombudspersonit kanë udhëtuar për në Tribunalin Ndërkombëtar për Krime Luftë në ish-Jugosllavi, në Hagë të Holandës. Kjo vizitë studimore e financuar nga SIDA iu ka mundësuar përkthyesve që të shohin për së

afermi përvojat dhe profesionalizmin e përkthyesve simultant të Gjykatës. Udhëtimi është organizuar nga Këshilli i Evropës.

Në **maj 2007**, përkthyesit e Institucionit të Ombudspersonit kanë ndjekur një kurs tre ditorë lidhur me përkthimin simultant të mbajtur nga një përkthyes i pavarur nga Bosnja dhe Hercegovina. Ky trajnim është financuar nga SIDA dhe është organizuar nga Këshilli i Evropës në zyrën qendrore të Institucionit në Prishtinë.

Më **2-30 maj 2007**, menaxhmenti dhe administrata e Institucionit të Ombudspersonit kanë ndjekur disa sesione të ndryshme trajnuese të financuara nga SIDA në lëmin e planifikimit dhe buxhetit, burimeve njerëzore dhe menaxhimit të zyrës të mbajtura në Prishtinë nga organizata “Management and Development Associates” (Shoqëritë për Zhvillim dhe Menaxhim). Trajnimi është organizuar nga Këshilli i Evropës.

Më **14-25 maj 2007**, një juriste e Institucionit të Ombudspersonit ka marrë pjesë në një trajnim të quajtur “Kur qytetarët ankohen: roli i Ombudsmanit në përmirësimin e shërbimeve publike” Kursi është mbajtur në Londër dhe është organizuar nga Public Administration International “Administrimi Publik Ndërkombëtar” një organizatë me bazën kryesore në Britani të Madhe që mban trajnime dhe përkrahje për institucionet e sektorëve publikë. Pjesëmarrja e juristes në trajnim është financuar nga SIDA.

Më **23-30 qershor 2007**, dy juristë dhe një përkthyes nga Institucioni i Ombudspersonit kanë marrë pjesë në Shkollën Verore Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në Varshavë të Polonisë. Sesionet janë fokusuar në paragrafët e ndryshëm të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Pjesëmarrja e anëtarëve të personelit është organizuar nga Fondacioni i Polonisë me bazë në Helsinki për të Drejtat e Njeriut dhe është financuar nga SIDA.

Konferenca e Ombudsmanëve të Rajonit

Gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportohet, Institucioni i Ombudspersonit ka qenë nikoqir i Konferencës së parë të Ombudsmanëve të Rajonit. Konferenca me temën “Përkrahja dhe Pengesat në Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut” është mbajtur në Prishtinë më 8-9 qershor 2007 me përkrahjen financiare të Zyrës Amerikane në Prishtinë dhe me asistencën organizative të misionit të OSBE-së në Kosovë. Konferenca është kryesuar nga shefi i ZKLDNJ në Prishtinë.

Konferenca ka mbledhur përfaqësuesit e Institucioneve të Ombudsmanëve nga Evropa jug-lindore si dhe të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, autoritetet lokale, grupe të shoqërisë civile dhe mediat. Fjalimet hyrëse janë mbajtur nga Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, si dhe nga shefi i misionit të OSBE-së në Kosovë, Presidenti i Kosovës dhe Ministri i Drejtësisë.

Një numër i Ombudsmanëve nga rajoni dhe përfaqësuesit e tyre kanë bërë prezantime lidhur me punën e zyrave të tyre dhe sfidat ditore me të cilat janë ballafaquar. Prezantime të tjera lidhur me natyrën dhe mandatin e institucioneve të ombudsmanëve dhe me

bashkëpunimin e tyre me media janë bërë nga këshilltari ligjor i Zyrës së Këshillit Evropian të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut dhe nga Kryesuesi i Rrjetit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (Rajoni Evropian). Presidenti i Fondacionit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Ombudspersoni i mëparshëm ndërkombëtar në Kosovë gjithashtu ka folur rreth themelimit të Institucionit të Ombudspersonit në Kosovë në vitin 2000. Në përgjithësi, diskutimet janë fokusuar në mandatet e ndryshme të Ombudsmanëve, bashkëpunimin e tyre me autoritetet publike dhe çështje të tjera me rëndësi për pjesëmarrësit. Ndonëse një numër i pjesëmarrësve përfaqësonin IPVQ-të, shoqërinë civile dhe mediat, kontributi i tyre në diskutime ka qenë i kufizuar.

Në përfundim të konferencës, pjesëmarrësit u pajtuan lidhur me publikimin e disa rekomandimeve dhe shpërndarjen e tyre të gjithë kuotë-mbajtësve gjatë periudhës së ardhshme. Ndhimesë në formulimin e rekomandimeve kanë dhënë edhe një përfaqësues pjesëmarrës nga zyra qendrore e ZKLDNJ në Gjenevë, si dhe shefi i ZKLDNJ-së në Prishtinë. Rekomandimet janë të përfshira në Aneksin 4 të këtij raporti vjetor.

Duke pas parasysh pajtimin e pjesëmarrësve se kjo ngjarje ishte një sukses i madh , pritet që kjo Konferencë e Ombudsmanëve të Rajonit t'i shtohet kalendarit vjetor të Institucioneve të Ombudsmanëve të rajonit, dhe po ashtu, që mediat, grupet e shoqërisë civile dhe autoritetet lokale të tregojnë interesim më të madh në konferencën e vitit të ardhshëm.

E ardhmja financiare e Institucionit të Ombudspersonit

Sikurse çdo institucion tjetër i pavarur, dhe *sui generis*, Institucioni i Ombudspersonit në Kosovë mund të kryej punën e vet siç duhet vetëm nëse është gjithashtu i pavarur nga autoritetet ekzekutive, gjyqësore dhe legjislativë në Kosovë. Një pavarësi e tillë nënkupton se Institucioni nuk është përgjegjës financiarisht para këtyre organeve të qeverisë që menaxhojnë Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës. Asnjë nga këto autoritete nuk duhet të jenë në gjendje të ndikojnë në punën aktuale të Institucionit, duke përfshirë edhe hetimet e saj. Në rastin e ekzekutivit, kjo gjithashtu nënkupton se ajo nuk mund të ndërhyj në procesin e buxhetit vjetor, meqë çdo ndërhyrje e tillë do të mund që në mënyrë indirekte të ndikoi në funksionimin e Institucionit dhe punën e tij. Kjo është përcaktuar në Nenin 17.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit. E njëjta dispozitë thotë se nëse Institucioni konsideron që propozimet buxhetore nga Qeveria mund të komprometojnë aftësinë e saj në zbatimin e funksioneve të tij plotësisht dhe pavarësisht, ajo mund të tërheq vëmendjen Kuvendit të Kosovës për këtë çështje.

Gjatë diskutimeve me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave lidhur me buxhetin e Institucionit për vitin 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit vazhdimisht ka theksuar rëndësinë e sigurimit të qëndrueshmërisë së Institucionit dhe punës së tij duke siguruar fonde të mjaftueshme për burimet njerëzore. Përkundër disa diskutimeve me Ministrinë si edhe me Komisionin Buxhetor të Kuvendit të Kosovës, ishte vetëm në saje

të përkrahjes së PSSP-së që kërkesa e buxhetit të Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit u plotësua pjesërisht në fund të vitit 2006.

Deri më sot, Institucioni i Ombudspersonit ia ka dalë të mbajë shumicën e personelit të tij në sajë të kontributeve të vazhdueshme të donatorëve ndërkombëtar. Megjithatë, duhet theksuar edhe një herë, se pagesa e pagave të këtij personeli dhe aktiviteteve tjera nga fondet donatore nuk është një zgjidhje e qëndrueshme, dhe nuk shfaqëson autoritetet publike në Kosovë nga përgjegjësia e tyre në sigurimin e Institucionit me financim adekuat. Përderisa institucioni i ka mirë të njohura kufizimet e buxhetit të Kosovës, ky fakt nuk duhet të pengojë juridiksionin dhe funksionet e asaj që mbetet mekanizmi i vetëm i pavarur i të drejtave të njeriut në Kosovë.

Në të ardhmen pritet që do të ketë një pjesëmarrje më aktive të IPVQ-ve në përkrahjen dhe garantimin e qëndrueshmërisë së ardhshme financiare të Institucionit, dhe që diskutimet e vazhdueshme dhe kontestuese lidhur me buxhetin e Institucionit së shpejti do të takojnë së kaluarës. Autoritetet kompetente duhet të pranojnë rëndësinë e mbajtjes së personelit aktual profesionist ligjor në Institucion. Në vitin 2003, PSSP në atë kohë u njoh me problemin dhe aprovoi skemën speciale të pagave për personelin profesionist ligjor të Institucionit. Institucioni i Ombudspersonit pret që një njohje e tillë do të pranohet nga zyrtarët kompetentë të IPVQ-ve, ashtu që punë e rëndësishme e Institucionit të mund të vazhdojë ashtu siç ka vazhduar gjatë gjashtë viteve të kaluara.

Përkrahja financiare dhe në të mira

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit përdori fonde nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, nga Korporata Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (KZZHN) dhe nga qeveritë e vendeve në vijim: Austria, Belgjika, Finlanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Lista e projekteve:

SIDA

Në shtator të vitit 2005, Institucioni i Ombudspersonit filloi realizimin e projektit trevjeçar të financuar nga SIDA me qëllim që punonjësve të Institucionit t'u ofrohet aftësim dhe trajnim në fushën e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit, administratës së përgjithshme dhe menaxhimit të zyrës, si dhe shkathtësi në përkthim. Partneri zbatues i projektit është Këshilli i Evropës.

Në këtë periudhë për të cilën po raportohet, SIDA financoi një seminar mbi sundimin e së drejtës dhe qeverisjes së mirë, kurset në gjuhën angleze në terminologjinë ligjore në zyret e Shkollës së Kembrixhit në Prishtinë, një vizitë studimore në Zyrën e Ombudsmanit Hungarez dhe pjesëmarrja e anëtarëve të personelit të Institucionit në një mori shkollash verore në sundimin e ligjit dhe çështjet e të drejtave të njeriut. Këto përfshijn një shkollë verore të të drejtave të njeriut organizuar nga Fondacioni i Helsinkit Polak për të drejtat e

njeriut, trajnimi u mbajt në Londër dhe u organizua nga organizata “Public Administration International” në atë se si munden ombuds-institucionet të përmirësojnë shërbimet e tyre ndaj publikut, si edhe trajnim në ndërtimin e paqes dhe transformimi i konfliktit organizuar në Cluj Napoca në Rumani nga Rrjeti kalues për transformimin e konfliktit me mjete paqësore. SIDA gjithashtu financoi pjesëmarrjen e menaxherit të prokurimit të Institucionit në një kurs nëntë mujor në prokurim në Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë. Qysh nga periudha e fundit raportuese, një ekspert i Këshillit të Evropës është duke përgatitur një sistem të të dhënave të bazës për menaxhimin e rastit, i cili u testua në prill të vitit 2007 dhe pritet të instalohet në korrik të vitit 2007.

Projekti i SIDA gjithashtu përfshiu trajnimin në përkthim simultan dhe një vizitë në Tribunalin Ndërkombëtar për Krime për Ish Jugosllavinë për përkthyesit e Institucionit të Ombudspersonit. Një trajnim tjetër i financuar nga SIDA dhe implementuar nga Këshilli Evropian në këtë periudhë për të cilën po raportohet përfshin kurse në shkrime akademike në gjuhën shqipe dhe serbe e zhvilluar nga një ekspert nga Kuvendi i Kosovës, si edhe sesione të ndryshme trajnimi për personelin administrativ për buxhetin, burimet njerëzore dhe menaxhimin e zyrës.

AUSTRIA

Në pajtim me një marrëveshje me Agjencinë Austriake për Zhvillim në Ministrinë e Jashtme të Austrisë, ky donacion i pranuar në dhjetor të vitit 2004 ka vazhduar të financoj zyrën në terren në Graçanicë të Institucionit të Ombudspersonit, gjatë periudhës për të cilën po raportohet.

BELGJIKA

Qeveria e Belgjikës ka vazhduar të siguroi donacione në periudhën për të cilën po raportohet. Në pajtim me marrëveshjen me donatorin, fondi i Belgjikës është përdorur për të paguar pagat për dy punonjës specialist dhe për ta publikuar Informatorin periodik në katër gjuhë. Ky projekt është ende në vazhdim.

FINLANDA

Si pjesë e një projekti të nxitur në fund të vitit 2004, Ministria e Punëve të Jashtme e Finlandës, vazhdoi për të paguar pagat për dy përkthyes të lartë me kualifikime të larta në Institucionin e Ombudspersonit.

LIHTENSHTAJNI

Deri në fund të vitit 2006, ky donacion u shfrytëzua për t'i mbuluar pagën e menaxherit të teknologjisë së informative në Institucion..

NORVEGJIA

Deri kah fundi i vitit 2006, donacioni norvegjez u shfrytëzua për të paguar tre juristë dhe për të mbuluar shpenzimet e një numri publikimesh të Institucionit, aktivitetet e grupit të të drejtave të fëmijëve dhe shërbimet e jashtme të përkthimit.

Në janar të vitit 2007, Institucioni i Ombudspersonit pranoi edhe një donacion nga Norvegjia për një projekt të ri. Ky donacion u shfrytëzua për të mbuluar shpenzimet e publikimeve dhe përkthimeve, projektet e veçanta të Grupit të të Drejtave të Fëmijëve (GDF) në Institucion dhe Njësisë për Barazi Gjinore (NjBGJ), dhe pagimin e personelit profesionist që punon në zyrën e Institucionit në teren në Graçanicë.

TURQIA

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, ky donacion u shfrytëzua për të mbuluar shpenzimet për publikimet e Institucionit të Ombudspersonit në gjuhën turke. Projekti ende është në vazhdim.

ShBA

Kontributi nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për Institucionin e Ombudspersonit, që nga viti 2001, ka përkrahur shpenzimet e përgjithshme dhe për ta paguar pagën e Ombudspersonit të mëparshëm ndërkombëtar. Në dhjetor të vitit 2005, sipas udhëzimeve të qeverisë së ShBA-ve, objektiva e fondit u ndryshua për të mbuluar iniciativën për ndërtimin e kapacitetit të Institucionit të Ombudspersonit. Partner zbatues i këtij fondi është Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ky fond është shfrytëzuar për të mbuluar shpenzimet e Kursit të biznesit në gjuhën angleze për personelin administrativ në Institucion dhe një vizitë nga dy juristë të zyrave të Ombudspersonit në Tuscany, Itali, si pjesë e një programi shkëmbyes në mes të Institucionit të Ombudspersonit dhe Ombudsmanit të komunave pjesëmarrëse të Valdinevole (Tuscany). Përveç kësaj, nga donacioni u mundësua blerja e një softueri të kontabilitetit dhe pajisjeve të zyrës, të cilat ishin shumë të nevojshme për zyrat kryesore në Prishtinë.

Një pjesë e madhe e këtij donacioni u shfrytëzua për të financuar Konferencën e parë Ombudsmanëve të rajonit.. Konferenca u mbajt më 8 dhe 9 qershor 2007 në Prishtinë dhe u titullua “Përkrahja dhe pengesat në mbrojtjen e të drejtave të djeriut”. Fondi përfundoi në fund të qershorit 2007.

Format tjera të përkrahjes:

Gjatë vitit 2006-2007, Misioni i OSBE-së në Kosovë vazhdoi të përkrah Institucionin në një numër fushash. Misioni siguroi dy këshilltarë të brendshëm të veçantë që mbulonin

çështjet në lidhje punët administrative, ligjore, politike dhe publike. Një këshilltar i tretë i OSBE-së ishte i vendosur pranë Institucionit deri në janar të vitit 2007. Përveç kësaj, OSBE-ja vazhdoi në ofrimin e përkrahjes së saj teknike duke e siguruar Institucionin me pajisjet e përkthimit për seminare dhe konferenca si edhe këshillë gjithëpërfshirëse në çështjet lidhur më TI.

Organizatat tjera që sponsorizuan aktivitetet apo që ofruan përkrahje për aktivitetet e Institucionit gjatë periudhës për të cilën po raportohet janë:

- EUNOMIA Programi i Ombudsmanit
- Iniciativa Rinore e Kosovës për të Drejtat e Njeriut
- UNICEF
- UNDP

PËRMBLEDHJA E RASTEVE DHE STATISTIKAVE

Përmbledhja e rasteve

Gjatë periudhës për të cilën raportohet, përafërsisht 4 612 persona kanë kontaktuar Institucionin e Ombudspersonit në zyrën kryesore në Prishtinë apo në zyrat rajonale për të bërë ankesa ose për të kërkuar këshilla dhe ndihmë. Gjatë 109 Ditëve të Hapura që janë mbajtur gjatë periudhës për të cilën raportohet, rreth 1 013 persona janë takuar personalisht me Ushtruesin e Detyrës të Ombudspersonit, zëvendësin e tij ose drejtorin e hetimeve. Statistikat e mëposhtme janë të ndara në tri kategori të rasteve: Rastet për reagim (CR), aplikacionet dhe ankesat, edhe pse statistikat përkatëse të tyre nuk janë gjithmonë drejtpërdrejtë të krahasueshme.

Para vitit 2006, rastet në pritje për t'u zgjidhur në Institucionin e Ombudspersonit janë ndarë në aplikacione dhe raste CR (këto raste nuk i janë nënshtruar procedurave formale për shkak të natyrës së urgjencës së tyre). Ky dallim është zhdukur në janar të vitit 2006 dhe të gjitha rastet u emëruan ankesa. Në periudhën aktuale për të cilën raportohet, Institucioni ka vazhduar që të hetojë dhe të mbyllë rastet CR dhe aplikacionet e hapura para vitit 2006.

Ashtu si edhe gjatë periudhave të mëparshme për të cilat është raportuar, një numër i rasteve që janë hetuar nga Institucioni i Ombudspersonit gjatë 12 muajve të kaluar kanë qenë të lidhura me çështje procedurale (siç janë zgjatja e procedurave pranë gjykatave civile si dhe DÇPB/AKP), mos reagimet e administratave, çështjet pronësore, pensionet dhe asistenca sociale, ankesat lidhur me keqpërdorimin e autoritetit, çështjet për gjykim të drejtë, ankesa të lidhura me punësim ose ankesat për mosndëshkim.

Masat e përkohshme dhe raportet

Atëherë kur Ombudspersoni konsideron se duhet të merren masa të menjëhershme nga autoritetet publike, ai mund të kërkojë formalisht që organi administrativ kompetent të ndërmarrë ose të suspendojë një veprim të veçantë si masë e përkohshme për të parandaluar dëmtimin e papërmirësueshëm të ankuesve apo pasurisë së tyre. Shiko Aneksin 2 për një përmbledhje të kërkesave për masa të përkohshme të lëshuara nga Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjatë kësaj periudhe për të cilën raportohet.

Atëherë kur letrat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë të suksesshme, Ombudspersoni mund të lëshojë një raport, duke siguruar analiza të thella dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut ose të ligjeve të aplikueshme, së bashku me rekomandime për institucionin publik përkatëse se si të evitohen shkeljet. Raportet janë metoda e fundit e Institucionit për avokim, kurse kopjet e raportit i dorëzohen autoritetit që e ka bërë shkeljen si dhe Kuvendit të Kosovës, nga i cili në disa raste kërkohet që të diskutojë rastet e veçanta të lidhura me shkeljet e të drejtave të

njeriut. Shiko Aneksin 1 për një përmbledhje të raporteve të lëshuara gjatë periudhës për të cilën raportohet dhe përgjigjet e autoriteteve publike ndaj këtyre raporteve.

Përmbledhja statistikore e rasteve¹

Rastet për reagim (rastet CR) :		
Rastet CR të mbyllura nga 1 korriku 2006 deri 30 qershor 2007		
	Të shpallura të papranueshme	26
	Të zgjidhura pozitivisht	33
	Arsye tjera	88
<i>Total</i>		147
Aplikacionet :		
Aplikacionet e mbyllura nga 1 korriku 2006 deri 30 qershor 2007		
	Të shpallura të papranueshme	18
	Arsye tjera	79
	Të zgjidhura pozitivisht	70
<i>Total</i>		164
Ankesat :		
Ankesat e regjistruara nga 1 korriku 2006 deri 30 qershor 2007		690
Përkatësia etnike e ankuesve		
	Shqiptarë:	515
	Serbë:	124
	Të tjerë :	51
Palët përgjegjëse		
	Gjykatat	190
	Komunat:	131
	Të tjera	68
	Ministritë qeveritare:	174
	DÇPB	74
	SHPK	51
	UNMIK	5

1

	KFOR	4
Ankesat e mbyllura nga 1 korriku 2006 deri 30 qershor 2007		
	Të shpallura të papranueshme	145
	Të zgjidhura pozitivisht	163
	Arsye tjera	94
<i>Total</i>		402
Lënda e ankesave		
	Heshtja administrative dhe çështje të ngjashme	181
	Çështje procedurale dhe të tjera të gjykimit të drejtë (procedura civile)	105
	Çështjet e lidhura me DÇPB-në	72
	Keqpërdorim i autoritetit	82
	Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore	81
	Çështje të lidhura me pronën (tjera nga ato të DÇPB-së)	68
	Çështje të lidhura me punësimin	56
	Qasja në Gjykatë (Procedurat civile)	32
	Çështjet për proces të rregullt dëgjimor (procedura kriminale):	25
	Dështime për të hetuar një vepër penale	26
	Shërbime të mira	18
	Të drejtat e tjera të mbrojtura nga KEDNJ	40
	Mosndëshkimi i autoriteteve	24
	E drejta për liri	5
Hetimet dhe raportet		
(1 korrik 2006 – 30 qershor 2007)		
	Raporte speciale	3
	Raporte Ex.Officio	2
	Raporte mbi rastet	10
	Hetime të hapura Ex-Officio	9
	Kërkesa për masa të përkohshme	1

SHTOJCA I: PËRMBLEDHJET E RAPORTEVE

Në pajtim me kompetencat e tija nga Neni 4 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/06 mbi Institucionin e Ombudspersonit dhe Rregullat e Procedurale të Institucionit, Institucioni i Ombudspersonit, gjatë periudhës raportuese, i drejtoi Kuvendit të Kosovës raportet si në vijim:

***Ex officio* Numri i regjistrimit 48/05**

Lidhur me çështjen e diskriminimit në bazë të gjinisë në shpalljen e konkursit për vendet e punës së arkivistit në sektorin publik

Më 5 tetor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka publikuar një raport lidhur me çështjen e lartpërmendur. Kjo ishte një rezultat i analizimit të rreth 1.000 shpalljeve të konkurseve për vende pune në sektorin publik në gazetën ditore “Koha Ditore”. Në bazë të hetimeve të tija, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka përfunduar se tek një numër i rasteve, mënyra e të shprehurit në konkurs që i referohet vetëm fjalës femër për vendet e caktuara të punës, ka përjashtuar kandidatët meshkuj nga aplikimi.

Në raport, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka përfunduar se nuk kishte justifikim të arsyeshëm për kufizime të tilla në baza gjinore. Këto kufizime kanë përbërë një formë direkte të diskriminimit duke shkelur të dy ligjet, atë vendor (kryesisht Ligjin për barazi gjinore), si dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare (kryesisht Pakti Ndërkombëtar në të Drejtat Civile dhe Politike, e cila i mbron individët nga të gjitha format e diskriminimit).

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Kuvendi i Kosovës të udhëheqë një debat në kuadër të Komitetit për çështje gjyqësore dhe legjislative dhe në kuadër të Kornizës kushtetuese për të gjetur mënyrat për të siguruar implementimin direkt të dispozitave relevante ligjore që ndalojnë diskriminimin e bazuar në gjini në aspekt të punësimit. Për më tepër, ai ka rekomanduar që Kuvendi të kërkojë rregullisht informata nga njësitet për të drejtat e njeriut në kuadër të ministrive të Kosovës dhe nga organe tjera relevante që të sigurojnë informata të rregullta mbi implementimin e Ligjit për barazi gjinore nga ana e ministrive, nga sipërmarrja “Termokos” dhe nga PTK. Gjithashtu, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka kërkuar nga Kuvendi që të garantojë se ky raport do t’u shpërndahet të gjitha institucioneve të Kosovës.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit nuk ka pranuar përgjigje lidhur me këtë raport dhe nuk është informuar lidhur me atë nëse Kuvendi i Kosovës ka diskutuar apo ka për qëllim të diskutojë për rekomandimet e tija.

***Ex officio* Numri i regjistrimit 1/06**
Lidhur me implementimin e neneve 7 dhe 9 të Rregullores së UNMIK-ut
Nr.2003/12 për mbrojtjen kundër dhunës në familje

Më 23 nëntor 2006, në një tryezë të rrumbullakët të organizuar nga Institucioni i Ombudspersonit dhe nga UNDP-ja mbi implementimin e Rregullores së lartpërmendur të UNMIK-ut, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka publikuar një raport lidhur me këtë çështje. Hetimet e Institucionit të Ombudspersonit janë përqendruar në çështjen nëse gjykatat komunale në Kosovë kanë vepruar në përputhje me afatet kohore për lëshimin e urdhër-mbrojtjeve në rastet e dhunës shtëpiake e rregulluar në nenet 7.1 dhe 9.1 të Rregullores së lartpërmendur. Këto nene kanë veçuar se gjykatave u është nevojitur të vendosin mbi kërkesat për urdhër-mbrojtje brenda 15 ditëve dhe për kërkesat për mbrojtje emergjente brenda 24 orëve.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka vërejtur se në të gjitha rastet që ishin nën hetime, gjykatat kanë tejkaluar afatet kohore të dhëna në Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2003/12 me javë bile edhe muaj. Zvarritjet e tilla janë në kundërshtim me nenet 7.1 dhe 9.1 të Rregullores. Për më tepër, një administrim i tillë ka treguar se gjykatat e caktuara nuk i kanë plotësuar obligimet e tyre për mbrojtjen e viktimave të dhunës shtëpiake në pajtim me ligjin e aplikueshëm, duke përbërë shkelje të të drejtave të këtyre viktimave që të jenë të lirë nga trajtimi jonjerëzorë dhe degradues siç është paraparë me nenin 3 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, gjithashtu, ka vërejtur se gjykatat nuk kanë vepruar në përputhje me obligimet e tyre për të siguruar që viktimat mund të ushtrojnë të drejtat e tyre për siguri, paqe dhe dinjitet brenda shtëpive të tyre. Kjo ishte në kundërshtim me nenin 8 të Konventës, i cili mbron të drejtën në jetën private dhe familje. Në fund, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjeti se mungesa e ndonjë mjeti juridik në rastet ku gjykatat kanë zvarritur procedurat, ka përbërë shkelje të nenit 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, që mbron të drejtën e çdo personi për një mjet efektiv juridik.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar se kryetarët e gjykatave komunale në Kosovë duhet të sigurojnë që rastet të cilat merren me urdhër-mbrojtje të viktimave të dhunës shtëpiake t'u jepet prioritet, kështu që këto urdhra të mund të lëshohen brenda afateve kohore të parapara me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2003/12. Ai gjithashtu ka kërkuar nga kryetarët e gjykatave komunale të sigurojnë që raporti t'u shpërndahet të gjithë gjykatësve nëpër gjykatat e tyre. Më në fund, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet të caktojë dhe trajtojë, në afat sa më të shkurtër, një numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve për t'u marrë me rastet e dhunës në familje. .

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit nuk ka marrë përgjigje lidhur me këtë raport dhe nuk është informuar se a janë zbatuar apo do të zbatohen rekomandimet e tija nga palët relevante.

Numri i regjistrimit 1362/04
lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Xhemajl Pllanës

Më 31 tetor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka publikuar një raport lidhur me rastin e lartpërmendur i cili ka të bëjë me një kontest prone dhe që është zvarritur në gjykatat lokale që nga viti 2001. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, në raport ka vërejtur se Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i është dashur të kalojnë dy vite për të thirrur panelin për ta shqyrtuar rastin. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit konsideron se kjo është në kundërshtim me të drejtën e ankuesit për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor nga neni 6 para. 1 i Konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Sipas Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit, numri i pamjaftueshëm i gjyqtarëve që punojnë në Gjykatën e Qarkut (fakt të cilin kryetari i Gjykatës së Qarkut e ka dhënë si arsyetim për vonesat) mund ta arsyetojë një vonesë të tillë vetëm nëse ajo ishte e përkohshme. Pasi që problemi i numrit të vogël i gjyqtarëve përpiqet të zgjidhë çështjen e rritjes së vazhdueshme të ngarkesës me raste ka ekzistuar për një kohë të gjatë, dhe pasi që nuk janë ndërmarrë plane afatgjate për zgjidhjen e rasteve të pakryera në Gjykatën e Qarkut, argumenti i lartpërmendur ishte një shkas i pamjaftueshëm për ta arsyetuar vonesën. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjithashtu ka vërejtur se mungesa e menaxhmentit adekuat të rasteve në gjykatë duket se i ka kontribuar zvarritjeve të procedurave. Për më tepër, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka gjetur se mungesa e një mjeti juridik për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm ka përbërë një shkelje të të drejtës për një mjet efektiv nën Nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Duke ditur që rasti kishte mbetur i zvarritur në Gjykatën Komunale në Prishtinë në kohën kur raporti ishte duke u publikuar, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Kryetari i Gjykatës Komunale të sigurojë që kjo gjykatë të lëshojë një vendim në rastin e ankuesit pa vonesa të mëtejme. Veç kësaj, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka apeluar tek Kryetari i Gjykatës së Qarkut që të sigurojë që menaxhimi dhe shpërndarja e rasteve brenda kësaj gjykate t'i nënshtrohet një vlerësimi të pavarur me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të gjykatës. Në fund, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Kuvendi i Kosovës të fillojë diskutimin me të gjitha organet dhe institucionet kompetente për hartimin e një instrumenti relevant ligjor që, në rastet ku janë të përfshira zvarritjet e procedurave në gjykatë, të formojë një mjet efektiv në kuadër të kuptimit të nenit 13 të Konventës.

Deri më sot, nuk ka pasur asnjë përgjigje në këtë raport, as Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit nuk është informuar nëse rekomandimet e tija janë zbatuar apo do të zbatohen.

Raport Special Nr.11
Lidhur me dështimin e kryetarit të Gjykatës Komunale në Ferizaj për të bashkëpunuar me Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë

Më 6 prill 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka publikuar një raport special lidhur me rastin e lartpërmendur. Në këtë raport, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka shqyrtuar nëse dështimi i kryetarit të Gjykatës Komunale në Ferizaj për t'iu përgjigjur korrespondencës së pranuar nga Institucioni i Ombudspersonit ishte në kundërshtim me obligimet e tija për të bashkëpunuar me Institucionin nën nenin 4.6 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë.

Në mes të nëntorit të vitit 2005 dhe shtatorit të vitit 2006, Ombudspersoni dhe Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kanë dërguar një mori të letrave kryetarit të Gjykatës Komunale, ku ka kërkuar informata lidhur me raste të ndryshme të paraqitura në Institucionin e Ombudspersonit dhe që kanë të bëjnë me vonesa të procedurave civile dhe penale në këtë gjykatë. Deri në datën kur është publikuar raporti special, Institucioni i Ombudspersonit nuk ka pranuar përgjigje në asnjërin nga këto letra. Në raportin special, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka arritur në përfundim se dështimi i kryetarit të Gjykatës Komunale për të bashkëpunuar ka shkelur dispozitat e lartpërmendura të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2006/06, e cila kërkon që të gjitha institucionet publike të asistojnë Institucionin e Ombudspersonit në punën e tij dhe t'i përgjigjen kërkesave të tija për informata dhe dokumente brenda një afati të arsyeshëm.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (si gjykatë e shkallës më e lartë përgjegjëse për mbikëqyrjen e Gjykatës Komunale në Ferizaj) të sigurojë që kryetari i Gjykatës Komunale të përgjigjet pa vonesë të mëtejme në kërkesat e kaluara dhe të ardhshme dhe në intervenimet e Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit. Ai gjithashtu i rekomandoi Këshillit Gjyqësor të Kosovës që ai t'i shpërndajë kopjet e këtij raporti nëpër të gjitha gjykatat e Kosovës.

Më 18 prill 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, në emër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me të cilën e ka informuar atë se Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka kërkuar nga kryetari i Gjykatës Komunale në Ferizaj të bashkëpunojë me Institucionin e Ombudspersonit.

Më 26 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga Kryesuesi i Nën-Komitetit për Barazi Gjinore, Peticione dhe Ankesa Publike dhe për Persona të Zhdukur në Kuvendin e Kosovës, ku është theksuar se Nën-Komiteti ka shqyrtuar raportin e lartpërmendur special dhe se do të kërkojë nga kryetari i Gjykatës Komunale në Ferizaj të rishikojë këtë raport. Kryesuesi i Nën-Komitetit shtoi se Nën-Komiteti do të kërkojë nga Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të rishikojë këtë raport.

Numri i regjistrimit 1736/2005

Sheribane Ademi kundër Gjykatës Komunale në Vushtrri, Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës

Më 10 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka publikuar një raport lidhur me rastin që përfshinte zvarritje të procedurës gjyqësore në një kontest prone; procedura kishte filluar në mes të majit 2001 dhe ende vazhdonte kur raporti ishte duke u publikuar.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kishte gjetur se dështimi i këtyre gjykatave për të zgjidhur rastin e ankuesit brenda një kohe adekuate ka bërë shkelje të nenit 6 para.1 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, i cili mbron të drejtën e çdo personi për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm. Duke mos e mohuar se rasti që përfshinte trashëgimi të pasurisë ka mundur të jetë rast i ndërlikuar, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka gjetur se kjo vetvetiu nuk mund ta arsyetojë mënyrën në të cilën është udhëhequr procedura. Shkelja nuk ka rrjedhur nga ndonjë mos aktivitet i gjykatës, për më tepër, vonesat që kanë qar në një zvarritje të paarsyeshme të procedurës ishin shkaktuar nga shqyrtime të përsëritura të rastit nëpër të dy shkallët. Kjo pasqyroi një pamjaftueshmëri serioze në sistemin gjyqësor, posaçërisht kur bëhet fjalë për aplikimin e duhur të ligjit dhe të funksionimit të strukturës hierarkike të këtij sistemi. Pastaj, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka vërejtur se mungesa e një mjeti juridik me të cilën do të kërkohej lehtësim nga procedurat e zgjatura gjyqësore, ka bërë shkelje të të drejtës së ankuesit për një mjet efektiv nën nenin 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Pasi që rasti përsëri qëndronte i pakryer në Gjykatën Komunale në Vushtrri në kohën kur raporti ishte publikuar, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që gjykata të vendosë mbi rastin e ankuesit jo më vonë se më 10 qershor 2007. Më tutje, ai rekomandoi që kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe kryetari i Gjykatës Komunale në Vushtrri të fillojnë së diskutuari, sa më shpejtë që është e mundur, se si të aplikohet më së miri e drejta materiale dhe procedurale dhe të parandalohen shqyrtimet e rasteve në mënyrë të përsëritur në të ardhmen. Në fund, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka rekomanduar Kuvendit të Kosovës të fillojë diskutimin me PSSP-në lidhur me nxjerrjen e një instrumenti ligjor që do të formonte një mjet efektiv në kuptim të nenin 13 të Konventës.

Më 21 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, ku ai u pajtua me konkluzionet e Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit. Sidoqoftë, kryetari i Gjykatës së Qarkut theksoi se raporti i Institucionit të Ombudspersonit të duhet të përfshijnë jo vetëm lëshimet e gjykatave, por edhe lëshimet e institucioneve tjera siç janë administrata e UNMIK-ut dhe organet tjera gjyqësore përgjegjëse për emërimin e gjykatësve dhe punëtorëve tjerë gjyqësor. Këta persona gjithashtu duhet të jenë të obliguar për të ndërmarrë masat e nevojshme për të parandaluar dhe për t'u marrë me situatën e tanishme në sistemin gjyqësor. Kjo gjendje vazhdon të ndikojë në të drejtën për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor siç është i garantuar me nenin 6

të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Veç kësaj, kryetari i Gjykatës së Qarkut vërejti se gjykatat rajonale dhe Gjykata Supreme ka bashkëpunuar. Në këtë bashkëpunim përfshihen diskutime mbi çështje të ndryshme ligjore, posaçërisht në lidhje me aplikimin e së drejtës materiale dhe procedurale si dhe pjesëmarrja e gjyqtarëve në trajnime të organizuara nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Në fund, kryetari i Gjykatës së Qarkut premtoi se do të jetë plotësisht i angazhuar për të siguruar që rasti i ankuesit të zgjidhet.

Deri më sot, Gjykata Komunale në Vushtri nuk marrë vendim të ri lidhur me rastin e ankuesit.

Numri i regjistrimit 1734/2007

Jeton Kurshumliu kundër Gjykatës Komunale në Mitrovicë, Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe Gjykatës Supreme të Kosovës

Më 10 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka publikuar një raport lidhur me një rast që ka të bëjë me zgjatje të procedurës gjyqësore në një kontest rreth një borxhi, të iniciuar në janar të vitit 2003.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjeti se dështimi i këtyre gjykatave në zgjidhjen e rastit të ankuesit brenda një periudhe kohore adekuate, ka shkelur nenin 6 para.1 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, i cili mbron të drejtën e çdo personi për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm. Edhe pse Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit vërejti se gjykatat e përfshira në këtë rast nuk kanë qëndruar joaktive, vonesat që kanë çuar në një zgjatje të paarsyeshme ishin shkaktuar nga shqyrtimi i përsëritur i rastit nëpër disa shkallë. Kjo ka pasqyruar një pamjaftueshmëri serioze në sistemin gjyqësor lokal, posaçërisht lidhur me aplikimin e duhur të së drejtës dhe funksionimin e strukturës hierarkike të këtij sistemi. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjithashtu vërejti se mungesa e një mjeti juridik me të cilën do të kërkohej lehtësim nga procedurat e zgjatura gjyqësore, ka bërë shkelje të të drejtës së ankuesit për një mjet efektiv sipas nenin 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar se pasi që rasti ende gjendet i pazgjidhur në Gjykatën Supreme, kryetari i kësaj gjykate duhet të ndërmerr hapa të shpejta për të marrë një vendim lidhur me rastin pa vonesa të mëtejme, duke pasur parasysh se çështja ka qëndruar pa u zgjidhur nëpër gjykata të ndryshme për më tepër se katër vite. Ai gjithashtu ka kërkuar që të informohet lidhur me çdo veprim të ndërmarrë si përgjigje në këtë raport.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, më tutje, ka rekomanduar që kryetari i Gjykatës Supreme, kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë dhe kryetari i Gjykatës Komunale në Mitrovicë të diskutojnë se si të aplikohet e drejta materiale dhe procedurale në të ardhmen me qëllim të parandalimit të shqyrtimeve të shpeshta të rasteve mbi tri shkallë. Në fund, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Kuvendi i Kosovës të fillojë diskutimin me të gjitha organet

relevante, duke përfshirë institucionet e Kosovës, për hartimin e një instrumenti ligjor që do të formonte një mjet efektiv në kuptim të nenit 13 të Konventës.

Më 21 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, ku ishte pajtuar me gjetjet e Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit nga raporti lidhur me rastin. Sidoqoftë, kryetari i Gjykatës së Qarkut ka theksuar se raporti i Institucionit të Ombudspersonit të duhet të përfshijnë jo vetëm lëshimet e gjykatave, por edhe lëshimet e institucioneve tjera siç janë administrata e UNMIK-ut dhe organet tjera gjyqësore përgjegjëse për emërimin e gjykatësve dhe punëtorëve tjerë gjyqësor. Këta persona gjithashtu duhet të jenë të obliguar për të ndërmarrë masat e nevojshme për të parandaluar dhe të merren me situatën e tanishme në gjyqësor. Kjo gjendje vazhdon të ndikojë në të drejtën për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm kohor siç është i garantuar me nenin 6 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut. Veç kësaj, kryetari i Gjykatës së Qarkut vërejtë se gjykatat rajonale dhe Gjykata Supreme ka bashkëpunuar. Në këtë bashkëpunim përfshihen diskutime mbi çështje të ndryshme ligjore, posaçërisht në lidhje me aplikimin e të drjetës materiale dhe procedurale si dhe pjesëmarrja e gjyqtarëve në trajnime të organizuara nga Instituti Gjyqësor i Kosovës. Në fund, kryetari i Gjykatës së Qarkut premtoi se do të jetë plotësisht i angazhuar për të siguruar që rasti i ankuesit zgjidhet.

Më 17 maj 2007, Gjykata Supreme e Kosovës, me trupin gjykues të të pesë gjyqtarëve, ka marrë vendim me të cilin ka refuzuar kërkesën e palës mbrojtëse për revizion të vendimit të Gjykatës së Qarkut. Pasi që Gjykata e Qarkut kishte vërtetuar aktgjykimin e Gjykatës Komonale me të cilin kishte vendosur në favor të ankuesit, tanimë nuk kishte pengesa për implementim të shpejtë dhe të duhur të këtij aktgjykimi.

Raport Special Nr. 13

Mbi dështimin e autoriteteve komunale në Skenderaj dhe Mitrovicë për të bashkëpunuar me Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë

Më 22 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka publikuar një raport special ku ai ka hetuar çështjen nëse dështimi i autoriteteve komunale në Skenderaj dhe Mitrovicë për t'iu përgjigjur korrespondencës së pranuar nga Institucioni i Ombudspersonit ishte në kundërshtim me obligimet e këtyre komunave për të bashkëpunuar me Institucionin e Ombudspersonit nën nenet 4.6 dhe 4.8 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë.

Në mes të shtatorit të vitit 2005 dhe marsit 2007, sikurse ish-Ombudspersoni, dhe më vonë edhe Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kanë dërguar një mori letrash lidhur me rastet e caktuara në Drejtorinë për Arsim në Komunën e Skenderajt, dhe më vonë te kryetari i Komunës. Asnjë përgjigje nuk është pranuar. Probleme të ngjashme janë hasur me letrat e dërguara lidhur me raste të tjera, drejtuar organeve të ndryshme në Komunën e Mitrovicës. Ministria e administrimit të pushtetit lokal dhe Ministria

për arsim, shkencë dhe teknologji ishin informuar lidhur me këtë mungesë të bashkëpunimit, por gjithashtu ka dështuar t'i përgjigjet çdo letre të dërguar nga Institucioni i Ombudspersonit.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka përfunduar se dështimi i autoriteteve komunale në Skenderaj dhe në Mitrovicë për më tepër se një vit e gjysmë për t'iu përgjigjur korrespondencës së dërguar nga Institucioni i Ombudspersonit ishte në kundërshtim me nenet 4.6 dhe 4.8 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/6, të cilat i obligojnë të gjitha institucionet publike në Kosovë për të asistuar Institucionin e Ombudspersonit në punën e tij dhe për t'iu përgjigjur kërkesave të tija për informata dhe dokumente brenda një afati të arsyeshëm. Ai gjithashtu gjeti se dështimi i Ministrisë për administrim të pushtetit lokal dhe Ministria për arsim, shkencë dhe teknologji për të siguruar që këto autoritete komunale t'i plotësojnë obligimet e tyre nga Rregullorja e UNMIK-ut Nr.200/06 ka përbërë shkelje të obligimeve të tyre në pavëmendje administrative mbi komunat dhe drejtoritë e tyre. Ky obligim është përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut Nr.2004/50 mbi ministrinë e reja dhe themelimin e posteve të zëvendës Ministrisë dhe zëvendës Ministrave në Degën e Ekzekutivit, si dhe nën Shtojcën IV të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të IPVQ-ve në Kosovë.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që ministri i Administrimit të pushtetit lokal dhe ministri i Arsimit, shkencës dhe teknologjisë të sigurojnë që kryetari i Komunës së Skenderajt dhe kryetari i Komunës së Mitrovicës si dhe të punësuarit e tyre të përgjigjen pa ndonjë vonesë të mëtejme në kërkesat e kaluara dhe të ardhme dhe në intervenimet e Institucionit të Ombudspersonit. Më tej, ai kërkoi nga ministrat e lartpërmendur të sigurojnë që kopjet e këtij raporti special të shpërndahen nëpër të gjitha drejtoritë e komunave në tërë Kosovën dhe që ministrinë ta informojnë Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit lidhur me çdo veprim të ndërmarrë si përgjigje në raportin e tij.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit nuk ka pranuar përgjigje në këtë raport, ndërsa rekomandimet e tija lidhur me bashkëpunimin në këto raste dhe në rastet në të ardhmen nuk janë zbatuar nga autoritetet komunale në Skenderaj dhe Mitrovicë.

Raport Special nr.12

Mbi dështimin e komunave të caktuara për të rindërtuar shtëpitë e shkatërruara në vitin 1999

Më 28 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka publikuar raportin special, ku ka hetuar nëse dështimi i komunave të caktuara për të përmbushur premtimet e tyre për rindërtimin e shtëpive të dëmtuara apo të shkatërruara gjatë luftimeve në vitet 1998-1999 ka përbërë shkelje të të drejtës së pronarëve të shtëpive që mbrohet me nenin 1 të Protokollit Nr.1 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Pasi që vëren se komunat e themeluara nga ana e UNMIK-ut nuk ishin përgjegjëse për dëmtimet e shkaktuara në këto shtëpi, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit konsideron se duke dhënë premtime për rindërtimin e shtëpive, komuna të caktuar kanë shkaktuar tek pronarët të caktuar të shtëpive pritshmëri legjitime se kjo do të ndodhte. Ndonëse vëren se komunat në Kosovë kanë buxhet të vogël, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit konsideroi se kjo nuk i çliron ata nga obligimet e tyre për të bashkëpunuar me pronarët e shtëpive me qëllim të gjetjes së zgjidhjes për këtë problem. Masat që kanë mundur të merren, përfshijnë ndarjen e një pjese të buxhetit komunal për rindërtimin e këtyre shtëpive (siç ishte rasti në Komunën e Prizrenit), duke përfshirë aktivisht autoritetet qendrore apo duke kërkuar fonde të donatorëve. Me mosndërmarrje të ndonjë veprimi për plotësimin e premtimeve të tyre për të rindërtuar shtëpitë e dëmtuara gjatë viteve 1998-1999, këto komuna kanë shkelur të drejtën e pronarëve të shtëpive në gëzim efektiv të pronave të tyre sipas nenit 1 të Protokollit Nr.1, i cili gjithashtu mbron pritshmërinë legjitime për ta fituar këtë të drejtë. Më tutje, fakti se Qeveria e Kosovës nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të mbështetur këto komuna për të përmbushur obligimet e tyre nga Konventa, ka përbërë një mungesë serioze të përgjegjësisë kur kemi parasysh shtrirjen e problemit. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjithashtu ka gjetur se ky mosveprim ka shkelur të drejtën e pronarëve të shtëpive në gëzimin e efektiv të pronave të tyre.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që komunat e caktuara dhe Qeveria e Kosovës duhet, pa vonesë të mëtejme, të përgatisin strategji lidhur me atë se si të sigurohen rindërtimet e shtëpive të mbetura, duke përfshirë edhe sigurimin e fondeve të donatorëve apo ndarjen e fondeve të posaçme nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit më tutje kërkoi që të informohet lidhur me çdo veprim të ndërmarrë si përgjigje në këtë raport special.

Më 16 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një përgjigje në raportin special nga kryetari i Komunës së Vushtrrisë, ku ai e ka përshëndetur zotimin e Institucionit të Ombudspersonit në ngritjen e çështjes së dështimit të komunave për të rindërtuar shtëpitë e shkatërruara gjatë vitit 1999. Kryetari i Komunës theksoi se komuna e tij, deri më tani, nuk ishte në pozitë për t'u marrë me çështjen në mënyrë të duhur për shkak të mungesës së burimeve financiare. Ai gjithashtu informoi Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit se komuna e Vushtrrisë kishte ndërtuar objekte për strehim kolektiv për 13 familje. Më tutje, komuna kishte premtuar se do të ndërtonte nja 20 shtëpi për të pastrehët gjatë vitit.

Numër i Regjistrimit 1669/05

Lidhur me zvarritjen e procedurës në rastin e Elmi Dragushës

Më 4 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka publikuar një raport lidhur me procedurat e zgjatura të ankimit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë në një kontest pune.

Duke pasur parasysh kujdesin që duhet të aplikohet në kontestet e punës, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka përfunduar se Gjykata e Qarkut ka shkelur obligimet e veta nga neni 6 i Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, që mbron të drejtën për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm. Duke pasur parasysh argumentet e kryetarit të Gjykatës së Qarkut, i cili ishte ankuar se zvarritjet e procedurës ishin shkaktuar për shkak të numrit të pamjaftueshëm të gjyqtarëve dhe numri i madh i rasteve, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit konsideroi se zvarritja gati dyvjeçare për të përfunduar se ankuesi nuk i kishte shfrytëzuar të gjitha mjetet vendore juridike, nuk është e mjaftueshme; një zvarritje e tillë, për më tepër, ka vërtetuar mungesën e menaxhimit efektiv me rastet. Ai gjithashtu vërejti se numri i madh i rasteve mund të arsyetojë vetëm zvarritjet e procedurave gjyqësore nëse ato ishin të përkohshme dhe të papritura. Ky nuk ishte një rast i tillë, pasi që Gjykata e Qarkut në Prishtinë ishte ballafaquar me një numër të rasteve në rritje gjatë shtatë viteve të fundit.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjithashtu ka gjetur se mungesa e një mjeti juridik me të cilin do të kërkohej lehtësim nga procedurat e zgjatura gjyqësore, ka bërë shkelje të të drejtës së ankuesit për një mjet efektiv nën nenin 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të ndërmerr hapa të shpejtë për të siguruar që Gjykata e Qarkut të vendosë lidhur me rastin e ankuesit pa vonesa të mëtejme, duke pasur parasysh se rasti i tij kishte mbetur i pazgjidhur për më tepër se pesë vite. Më tutje, ai rekomandoi që kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të sigurojë, në çdo mënyrë të mundshme, që menaxhmenti dhe shpërndarja e rasteve brenda kësaj gjykate t'i nënshtrohet një vlerësimi të pavarur në mënyrë që të përmirësohet menaxhimi i rasteve brenda gjykatës. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka kërkuar që të informohet lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra si përgjigje në rekomandimet e tija. Në fund, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Kuvendi i Kosovës të fillojë diskutimin me të gjitha organet dhe institucionet kompetente për hartimin e një instrumenti relevant ligjor që do të krijonte një mjet efektiv në pajtim me nenin 13 të Konventës.

Numri i regjistrimit 1704/2006 Idriz Morina kundër Ministrisë së Shëndetsisë

Me 21 qershor 2007, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka nxjerrë një raport në lidhje me ankësen e një individi lidhur me dështimin e Ministrisë së Shëndetësisë për implementimin e një vendimi që do t'i siguronte atij mjete financiare për trajtimin mjeksor të vajzës së tij jashtë Kosovës.

Në këtë raport, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka gjetur se, duke premtuar për mbulimin e shpenzimeve për trajtim mjeksor në Turqi dhe duke lëshuar vendim lidhur me këtë qëllim, Ministria e Shëndetësisë ka krijuar një besim legjitim për gëzimin efektiv të së drejtës në anën e ankuesit, i cili është i mbrojtur me Nenin 1 të

Protokollit Nr 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Fakti që vendimi i Ministrisë mund të mos ishte i vlefshëm (pasi që nuk ishte i nënshkruar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave) nuk ishte relevant në këtë rast, sepse nga ankuesi nuk mund të pritej që të bënte këtë ndryshim. Dështimi i Ministrisë së Shëndetësisë për të implementuar vendimin e saj në këtë mënyrë përbën shkelje të së drejtës së ankuesit për pasurinë e veçuar më lartë. Në këtë kontekst, mungesa e mjeteve financiare e dhënë si arsye nga Ministria e Shëndetësisë nuk ka mundur që të justifikojë dështimin e Ministrisë për të përmbushur premtimin e saj. Pasi që Ministria është dashur që të vlerësojë realizimin e një projekti të tillë, paraprakisht është dashur që ta informojë ankuesin për mungesën e mjeteve financiare për trajtim mjeksor që nga fillimi, në vend se kjo gjë të bëhet pas vendimit të marrë, për t'i siguruar një shumë të hollash. Në fund, ankuesi është detyruar që të huazojë mjetet e nevojshme financiare nga të afërmit dhe shokët. Për fat të keq, pavarësisht nga marrja e trajtimit mjeksor në Turqi, vajza e tij ka ndërruar jetë.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Ministria e Shëndetësisë së bashku me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave të sigurojnë që ankuesi të pranojë të hollat e caktuara fillimisht për të, si kompenzim për çfarëdo humbjeje apo dëmi të marrë si rrjedhojë e paaftësisë së Ministrisë për të zbatuar vendimin e marrë. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit, për më tepër, ka rekomanduar që Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave të koordinojnë aktivitetet e tyre në të ardhmën duke krijuar strategji të përbashkëta për implementimin e duhur të Programit për trajtim mjeksor jashtë vendit.

Me 2 korrik 2007, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër elektronike nga koordinatori i Njësisë për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave se në mungesë të mjeteve financiare, as Ministria e Shëndetësisë dhe as Ministria e Ekonomisë dhe Financave nuk e kanë nënshkruar dokumentin i cili e aprovon vendimin e bordit ekzekutiv të komisionit mjeksor në kuadër të Ministrisë përgjegjëse për programin e lartëshënuar. Për më shumë, ai ka deklaruar se vendimi tjetër që i siguronte të hollat ankuesit është nënshkruar vetëm nga Ministria e Shëndetësisë dhe jo edhe nga Ministria e Financave siq është kërkuar. Koordinator i Njësitit për të Drejtat e Njeriut ka shpjeguar se vendimi për ndarjen e një shume të tillë të të hollave, i lëshuar nga bordi ekzekutiv është dashur që të nënshkruhet nga të dy ministrinë.

Numri i regjistrimit 1806/2005

Ali Juniku kundër Gjykatës Komonale në Gjakovë

Më 28 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka publikuar një raport lidhur me procedurat e zgjatura gjyqësore lidhur me një kontest prone në Gjykatën Komonale në Gjakovë. Ankuesi nuk ishte i kënaqur me faktin se në bazë të një vendimi gjyqësor gojor, të dhënë nga Gjykata Komonale gjatë një seance të mbajtur

në shkurt të vitit 2005, kaluan shtatë muaj deri sa ai e pranoi aktgjykimin në formë të shkruar.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, në raport ka gjetur se për shkak të numrit vazhdimisht të madh të rasteve dhe mungesës së gjyqtarëve, vonesa e Gjykatës Komunale në dërgimin e aktgjykimit me shkrim palëve ishte në kundërshtim me nenin 337 të Kodit të aplikueshëm jugosllav të procedurës civile, i cili përcakton se një aktgjykim duhet të bëhet me shkrim brenda afatit tetë ditësh nga data kur është nxjerrur.

Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, më tej, ka vërejtur se Gjykatës së Qarkut në Pejë, në procedurën e saj ankimore, i është dashur përafërsisht 16 muaj që ta formojë panelin për ta diskutuar çështjen.

Duke pasur parasysh ankesat e kryetarëve të të dy gjykatave që vonesat në procedurat gjyqësore ishin për shkak të mungesës së numrit të mjaftueshëm të gjyqtarëve dhe numrit të madh të rasteve, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka arritur në përfundim se asnjëra nga vonesat nuk ka mundur të arsyetohet. Përgatitja e aktgjykimit me shkrim nga gjyqtari kompetent i Gjykatës Komunale nuk ka kërkuar ndonjë seancë shtesë apo ndonjë shqyrtim të thellë të rastit, dhe formimi i trupit gjykues për diskutimin e rastit nuk do të merrte një kohë prej 16 muajsh. Të dy rastet kanë paraqitur një mungesë të menaxhimit efektiv të rasteve. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjithashtu ka vërejtur se mungesa e gjyqtarëve dhe numri i madh i rasteve mund të arsyetojnë vetëm vonesat në procedurat gjyqësore nëse ato kanë qenë të përkohshme dhe të papritura, dhe megjithatë Gjykata Komunale dhe ajo e Qarkut janë ballafaquar me një numër në rritje e sipër të rasteve të shtatë viteve paraprake.

Në fund, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka vërejtur se mungesa e një mjeti efektiv për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm ka përbërë shkeljen e të drejtës për një mjet efektiv nga neni 13 i Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Pasi që rasti ende kishte mbetur pa u zgjidhur në Gjykatën Komunale në Gjakovë dhe duke pasur parasysh vonesën e mëparshme të procedurës, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Kryetari i kësaj gjykate të sigurojë që të merret një aktgjykim lidhur me rastin e ankuesit sa më shpejtë që është e mundur pas gjykimit. Më tutje, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Kryetari i Gjykatës së Qarkut në Pejë duhet të sigurojë që, me çdo mjet të mundshëm ligjor, menaxhimi dhe shpërndarja e rasteve brenda Gjykatës së Qarkut t'i nënshtrohet një vlerësimi të pavarur me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të gjykatës.

Në fund, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Kuvendi i Kosovës të fillojë diskutimin me të gjitha organet dhe institucionet kompetente në Kosovë për hartimin e një instrumenti ligjor që formon një mjet efektiv në kuadër të kuptimit të nenit 13 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut.

Numri i regjistrimit No. 1486/04
Në lidhje me zgjatjen e procedurës në rastin e Gani Bajramit

Me 29 qershor 2007, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka nxjerrë një raport lidhur me zgjatjen e procedurës sipas ankesës para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, lidhur me një kontest pune.

Në raport, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka vërejtur se Gjykatës së Qarkut në Prishtinë i janë dashur më shumë se tri vjet për të caktuar një panel për ndëgjimin e një rasti. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit këtë akt e konsideron të jetë në kundërshtim me të drejtën e ankuesit për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme sipas Nenit 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas ushtruesit të detyrës së Ombudspersonit, numri i pamjaftueshëm i gjykatësve që punojnë në Gjykatën e Qarkut (një fakt që kryetari i Gjykatës së Qarkut e përdor si justifikim për vonesë) do të mund të arsyetonte një shtyerje të tillë nëse do të ishte i përkohshëm. Pasi që problemi i numrit të vogël të gjykatësve që mundohen të zgjidhin një barrë të madhe të rasteve, e që është në rritje e sipër, ekziston për një kohë të gjatë, dhe pasi që nuk është bërë asnjë plan afatgjatë për të zgjidhur rastet e pakryera që presin para Gjykatës së Qarkut, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit e konsideron argumentin e dhënë si arsye të pamjaftueshme për të justifikuar shtyerjen. Duke pasë parasysh kujdesin dhe vëmendjen që nevojitet për kontestet e punes, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka vërejtur se një pjesë e madhe e shtyerjes duket se është shkaktuar nga menaxhimi i dobët i rasteve.

Për më shumë, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka gjetur se mungesa e trajtimit ligjor për shkeljen e së drejtës për një gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme, përbën shkelje të së drejtës për trajtim efektiv sipas Nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të sigurojë që, sipas të gjitha mënyrave, menaxhimi dhe distribuimi i rasteve brenda Gjykatës së Qarkut, të jenë objekt i një vlerësimi të pavarur me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të gjykatës. Ai poashtu ka kërkuar nga kryetari i Gjykatës së Qarkut që informojë për çdo veprim që ndërmerret si përgjigje ndaj raportit.

Për më shumë, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Kuvendi i Kosovës, pa ndonjë shtyerje shtesë, të iniciojë diskutime me të gjitha organet kompetente dhe institucionet e Kosovës për draftimin e një dokumenti ligjor që do të siguronte trajtim efektiv sipas Nenit 13 të konventës (i cili siguron ndihmë preventive dhe shpërblyese për ankuesit lidhur me procedura të stërzgjatura në gjykatat civile)

Numri i regjistrimit. 1276/2006

Lidhur me dështimin e Drejtoratit të Inspekcionit në Komunën e Suharekës për implementimin e marrveshjes me qëllim të gjetjes së një zgjidhjeje për problemin e ujrave të zeza në fshatin Leshan.

Me 29 qershor 2007, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka nxjerrë një raport lidhur me një ankesë të dorëzuar nga një përfaqësues i fshatit Leshan të Komunës së Suharekës. Rasti kishte të bënte me pakënaqësinë e banorëve të fshatit ndaj Drejtoratit Komunal të Inspekcionit, i cili ka dështuar që të implementojë marrveshjen e lidhur me fshatin Leshan dhe me fshatrat në rrethin e Shirokës. Marrveshja e lidhur ka paraparë një numër të masave për parandalimin e ndotjes së vazhdueshme të lumit në Leshan. Kjo ndotje është shkaktuar nga ujërat e zeza që kanë dalur nga sistemi i kanalizimit në Shirokë.

Ushtruesi i detyrës ka gjetur në raportin e tij se dështimi i Drejtoratit Komunal të Inspekcionit për të implementuar marrveshjen e lidhur është shkelje e obligimeve të tyre për të mbrojtur të drejtat e banorëve të Leshanit për të shijuar jetën e tyre (sipas Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut) e cila është ndikuar shumë nga pamundësia për të përdorur lumin e fshatit për ujë të pijshëm dhe ujtitje. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit poashtu ka vërejtur se nuk ka pasur hetime zyrtare lidhur me gjendjen e ndotur të lumit të fshatit dhe lidhur me ndikimin e tij, në banorët e fshatit Leshan. Si rrjedhojë, banorët e fshatit kanë jetuar në frikë duke u brengosur jo vetëm për ujin por edhe për shëndetin e tyre në përgjithësi.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Drejtorati i Inspekcionit Komunal duhet të sigurojë implementimin sa më të shpejtë që është e mundur të marrveshjes së arritur me banorët e këtyre fshatrave me të gjitha mjetet e nevojshme (duke e përfshirë edhe përvetësimin e financimit nga donatorët) Ai poashtu ka kërkuar që të informohet lidhur me çdo veprim që ndërmirret nga Drejtorati Komunal si përgjigje ndaj rekomandimeve të tij.

Numri i regjistrimit . 1643/05

Besim Jashari dhe të tjerët kundër Komunës së Vushtrrisë

Me 29 qershor 2007, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka nxjerrë një raport në lidhje me dështimin e implementimit të vendimit të gjykatës dhe një vendimi të lëshuar nga Bordi i Pavarur Mbikqyrës. Vendimi ka urdhëruar Komunën e Vushtrrisë për të lejuar shefin ekzekutiv dhe drejtorët e katër drejtorateve komunale të kthehen në vendet e tyre të punës. Kuvendi Komunal i kishte shkarkuar ankuesit për herë të parë në maj të vitit 2004. Kuvendi i kishte shkarkuar ata për herë të dytë në janar të vitit 2005, 2 javë pasi që gjykata i kishte rivendosur në pozitat e tyre.

Në lidhje me procedurat pasuese pas shkarkimit të parë, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka vërejtur se Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës i ka dhënë mandat Bordit të Pavarur Mbikqyrës që të merr vendim lidhur me

kontestet e punës në mes të shërbyesve civil dhe punëdhënësve të tyre. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit poashtu ka vërejtur se në kohën kur ankuesit kishin filluar procedurat kundër Komunës së Vushtrrisë, ky Bord nuk kishte qenë operativ.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka gjetur se ankesat e ankuesve për përjashtimin e tyre mund të përbëjnë një kërkesë të bazuar se të drejtat e tyre janë shkelur sipas Nenit 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas ligjit për raste të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ky nen poashtu garanton mbrojtje lidhur me profesionin e personave. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit për më tepër ka debatuar se në rast të mungesës së funksionimit të Bordit të Pavarur Mbikqyrës do të kishte zgjidhje alternative ligjore në dispozicion për ankuesit me të cilët ata do të mund t'i ngrisin këto ankesa të bazuar. Duke vërejtur se ka pasur huti të përgjithshme lidhur me çështjen e gjykatës përgjegjëse për të marrë vendime lidhur me çështjet e punësimit duke i përfshirë shërbyesit civil, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka gjetur se si Gjykata Komunale e Vushtrrisë kishte vendosur lidhur me ratsin dhe e kishte ekzekutuar vendimin dhe ankesit nuk i është hequr trajtimi ligjor efektiv në kuadër të nenit 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Lidhur me procedurat përcjellëse të shkarkimit të tyre të parë, nuk pa pasur shkelje të Nenit 13 në rastin konkret.

Në lidhje me procedurat përcjellëse të shkarkimit të dytë të ankuesit, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka vërejtur se, edhe pse Bordi i Pavarur për Mbikqyrës gjatë asaj kohe ishte operativ, Komuna kishte refuzuar për të implementuar vendimin e tij. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka gjetur se për arsye të mungesës së zbatimit të procedurave adekuate për rastet e tilla, Bordi i Pavarur Mbikqyrës nuk ka krijuar trajtim efektiv në kuadër të Nenit 13 të Konventës. Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit poashtu ka vënë re se nuk ka pasur procedura të qarta të ankesave. Rrjedhimisht, përmbledhja e mjeteve juridike ekzistuese nuk i plotësojnë kërkesat sipas nenit 13.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Bordi i Pavarur Mbikqyrës në bashkpunim me Kryeministrin dhe PSSP-në të sigurojnë që vendimet e Bordit lidhur me rastet e ankuesve të ekzekutohen dhe që komuna e Vushtrrisë të lejojë ankuesit të kthehen në vendet e tyre punës. Ai poashtu ka kërkuar nga Bordi që ta informojnë lidhur me ndonjë veprim të ndërmarrë në përgjigje të raportit.

Më tej, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që Kuvendi i Kosovës, pa ndonjë shtyerje, të inicojë diskutime me UNMIK-un dhe me organet tjera kompetente dhe Institucionet e Kosovës lidhur me domosdoshmerinë e draftimit e procedurave të duhura për zbatimin e vendimeve të Bordit të Pavarur Mbikqyrës dhe nga procedurat adekuate të ankesave kundër vendimeve të tilla.

Numri i regjistrimit. 537/02

M. M. kundër Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë dhe Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK)

Me 29 qershor 2007, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka nxjerrë një raport lidhur me supozimin për hetime të pamjaftueshme nga autoritetet kompetente lidhur me zhdukjen e burrit të M.M në korrik të vitit 1999, i cili nuk është gjetur që nga ajo kohë.

Edhe pse hetimet e Institucionit të Ombudspersonit fillimisht janë bërë ndaj policisë së UNMIK-ut, më vonë ato janë kufizuar tek autoritetet hetuese lokale, duke iu përmbajtur shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr 2006/6 e cila përjashtonte UNMIK-un nga mandati i Institucionit të Ombudspersonit.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit fillimisht ka vërejtur se neni 2 i Konventës Evropiane i cili mbron të drejtën për jetën e individëve është aplikuar në zhdukjen e personave në një kontekst kërcënues për jetë. Pasi që situata në Kosovë nuk ka qenë ende e stabilizuar pas intervenimit të NATO-s në pranverën e vitit 1999, mund të konsiderohej si kërcënuese për jetë. Në këtë mënyrë ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka marrë parasysh aplikimin e menjëhershëm të nenit 2 në rastin konkret.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka vërejtur se neni 2 i Konventës kërkon që hetimet duhet të qojnë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës për një veprim të tillë kriminal. Duke vënë re se Prokurori Publik i Qarkut nuk kishte qenë i informuar lidhur me këtë rast deri sa ishte informuar nga Ombudspersoni në tetor të vitit 2004, ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit megjithatë ka gjetur se Prokurori Publik i Qarkut, ndonëse ishte informuar lidhur me rastin, kishte dështuar për të zhvilluar hetime të mjaftueshme në kuadër të nenit 2 të Konventës, të parashikuar edhe në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës. Fakti që as Policia e UNMIK-ut dhe as SHPK-ja nuk i ishin përgjigjur kërkesave të pakta të bëra nga Prokurori Publik i Qarkut ka dëshmuar mungesën serioze të bashkpunimit në mes të policisë dhe prokurorisë.

Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar se Prokurori Publik i Qarkut duhet të bashkpujojë në mënyrë aktive me autoritetet kompetente të policisë në bazë të rregullt për të siguruar progres efikas në hetimet për rrethanat e zhdukjes së M .M, duke përfshirë marrjen në pyetje të të dyshuarve dhe dëshmitarëve (rasti ka qenë nën hetime për gati tetë vjet në kohën e publikimit të raportit). Ushtruesi i detyrës së Ombudspersonit poashtu ka kërkuar nga Prokurori Publik i Qarkut që të informohet për ndonjë veprim të ndërmarrur si përgjigje ndaj këtij rekomandimi.

SHTOJCA II: PËRMBLEDHJE TË MASAVE TË PËRKOHËSHME

Përpjekje për të ndaluar ritet fetare në Xhaminë e Madhe në Gjilan

Më 26 Tetor 2006, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një ankesë nga Komuniteti i Bashkësisë Islame i Kosovës (KBIK) në Gjilan lidhur me urdhëresën e lëshuar nga Kryeshefi Ekzekutiv në Komunën e Gjilanit, për të ndaluar ritet fetare në objektin e Xhamisë së Madhe në Gjilan. Në të njëjtën kohë, përfaqësuesit e KBIK ankoheshin se SHPK kishte ushtruar dhunë ndaj besimtarëve gjatë zbatimit të urdhëresës së lartpërmendur në këtë xhami.

Më 30 tetor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, duke vërejtur se urdhëresa e Komunës nuk ishte bazuar në ndonjë vendim gjyqësor ashtu siç kërkohet në bazë të ligjit, i dërgoi Kryetarit të Komunës së Gjilanit një kërkesë për masë të përkohshme. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kërkoi nga Kryetari i Komunës që të siguroi që zbatimi i urdhëresës së lartpërmendur të suspendohet derisa të ketë një vendim gjyqësor.

Më 2 nëntor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit pranoi një letër nga Kryetari i Komunës së Gjilanit, në të cilën ky i fundit theksoi që urdhëresa e Komunës nuk ishte në kundërshtim me ligjin në fuqi (Neni 8 i Ligjit mbi liritë fetare në Kosovë). Në të njëjtën letër, Kryetari i Komunës vërejtë se urdhëresa e lartpërmendur nuk ishte lëshuar për të ndërhyrë në ritet fetare në vendet e kultit, dhe që kjo përfshiu zbatimin e disa dispozitave të Ligjit Nr.2004/15 mbi ndërtimin dhe udhëzimin administrativ që kishte të bëjë me të (kërkesat e veçanta për siguri, qasja në zonat private dhe publike, dhe përfundimi i ndërtimit).

Më 14 nëntor 2006, Kryetari i KBIK në Gjilan i dërgoi një letër Institucionit të Ombudspersonit duke çmuar veprimet e institucionit dhe duke e falënderuar atë për ndërhyrjen e shpejtë dhe të duhur në këtë rast.

Më 25 nëntor 2006, një përfaqësues nga Institucioni i Ombudspersonit u takua me përfaqësues të KBIK për të marrë informatat më të reja lidhur me rastin. Përfaqësuesi i Ombudspersonit u informua se pas ndërhyrjes së Institucionit të Ombudspersonit, gjendja në përgjithësi tashmë ishte zgjidhur dhe nuk kishte arsye që Institucioni të vazhdonte me rastin.

SHTOJCA III: PËRMBLEDHJEVE TË LETRAVE TË PËRZGJEDHURA INTERVENUESE

Konfiskimi i automjeteve nga Shërbimi Policor i Kosovës

Më 5 maj 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër drejtorit të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut, lidhur me një ankesë për konfiskimin e një automjeti nga Shërbimi Policor i Kosovës. Sipas ankuesit, kjo ka ndodhur për shkak se është dyshuar se automjeti i tij është regjistruar në mënyrë ilegale. Sipas Shërbimit Doganor të UNMIK-ut, pasi që ankuesi nuk i kishte paguar të gjitha taksat para se të bënte regjistrimin e automjetit, ai nuk i ishte përmbajtur ligjit të aplikueshëm në Kosovë. Atij gjithashtu i është thënë se regjistrimi i tij i mëparshëm me targa të regjistruara të ish Jugosllavisë, i bërë në Serbi, konsiderohet ilegal; gjoja se është bërë nga institucionet paralele që funksionojnë në Kosovë, të cilat nuk njihen nga ligji i aplikueshëm në Kosovë.

Më 16 qershor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër përkujtuese drejtorit të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut duke e përsëritur kërkesën e tij për informata lidhur me këtë rast dhe rastet e tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me konfiskimin e veturave.

Më 26 qershor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një përgjigje nga drejtori i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut në të cilën thuhej se ai e kishte shqyrtuar rastin. Pasi që ankuesit përkatës ishin banorë të Kosovës, atyre nuk iu lejohej ngasja e automjeteve pa i paguar taksat relevante. Pasiqë automjetet e tyre ishin importuar fillimisht në Serbi dhe në Mal të Zi dhe pastaj në Kosovë, pronarët e tyre ishin të obliguar që të paguajnë vetëm taksën doganore dhe TVSH-në. Dështimi për të paguar këto taksa bënte që automjetet të bëheshin të konfiskueshme, ashtu që ato konfiskoheshin në përputhje me rrethanat e krijuara. Drejtori i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut poashtu ka potencuar se taksat në fjalë është dashur që të paguhen para regjistrimit të automjeteve në Kosovë. Pasiqë kjo gjë nuk ishte bërë, është konsideruar se automjetet janë regjistruar ilegalisht. Ai gjithashtu ka shtuar se, pagesa e taksave në Serbi dhe Mal të Zi nuk i ka liruar pronarët e tyre nga pagesa e taksave doganore dhe TVSH-ja në Kosovë, pasi që Kosova është territor i ndarë doganor.

Më 30 qershor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një tjetër letër drejtorit të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut duke iu referuar korrespondencës së tyre paraprake. Letra ka theksuar se Rregullorja e aplikueshme e UNMIK-ut nr. 32/2005 mbi kodin e akcizës në Kosovë nuk ka hyrë në fuqi deri më 1 korrik të vitit 2005, që është një vit pas regjistrimit të automjeteve të ankuesve. Nuk kishte ndonjë dispozitë në Rregulloren e lartpërmendur të UNMIK-ut që tregonte se kjo do të aplikohet në mënyrë retroaktive. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit poashtu ka kërkuar nga drejtori i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut që të ri-shqyrtojë aspektet ligjore të rasteve përkatëse dhe të përgjigjet në pyetjet e parashtruara në letër.

Më 4 korrik 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një përgjigje tjetër nga drejtori i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut në të cilën thuhej se kjo nuk është një çështje e aplikimit retroaktiv të mbledhjes së taksave të akcizës. Por, automjetet janë regjistruar ilegalisht në bazë të ligjit të aplikueshëm aktualisht; taksat e akcizës dhe TVSH-ja janë aplikuar për ato automjete para regjistrimit. Drejtori i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut ka theksuar se autoritetet kompetente të prokurorisë i kanë marra parasysh rastet e një numri të automjeteve që tanimë dyshohet se janë regjistruar ilegalisht. Ai ka shtuar se Shërbimi Doganor i UNMIK-ut ka qenë i përfshirë në këtë proces dhe është duke kërkuar mënyra për zgjidhjen e rasteve që kanë të bëjnë me çështjet lidhur me taksat.

Më 23 shkurt 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër asistentit të Zëvendës Komisionerit të Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) në lidhje me konfiskimin e automjetit të ankuesit, dhe dështimit të SHPK-së për të ekzekutuar vendimin e Prokurorit Publik Komunal në Mitrovicë për kthimin e automjetit të ankuesit.

Më 23 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar letër përkujtuese asistentit të Zëvendës Komisionerit të SHKP-së duke e përsëritur kërkesën për informata lidhur me këtë rast.

Më 29 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një përgjigje nga ndihmësi i Zëvendës Komisionerit të SHPK-së. Në letër ishte përfshirë edhe një kopje e bashkëngjitur e një memorandumit të brendshëm të pranuar nga Zyra Qendore e SHPK-së në të cilën thuhej se, në bazë të urdhërit të Prokurorit Publik Komunal të Mitrovicës, është lëshuar një vërtetim për lirimin e gjërave të konfiskuara pronarit të automjetit më 23 mars 2007. Kur ankuesi kishte kërkuar nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut kthimin e automjetit të tij, atij i ishte thënë se pa pagesën e taksave të domosdoshme kërkesa e tij do të refuzohej.

Më 28 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga zëvendës drejtori i Departamentit kundër-kontrabandë në Shërbimin Doganor të Kosovës në të cilën thuhej se drejtori i përgjithshëm i Shërbimit Doganor të UNMIK-ut ka kërkuar që Departamenti i tij të kërkojë nga ankuesi për të paraqitur një vërtetim që do të dëshmonte pagesën e tatimit në Serbi. Pasi që ankuesi do të paguante taksën e akcizës dhe TVSH-në, automjeti do t'i lirohej. Zëvendës drejtori i departamentit poashtu ka shpjeguar se ankuesi i kishte informuar ata se ishte përpjekur për të marrë një kopje të dokumentit në Serbi disa herë, por nuk kishte pasur sukses. Ankuesi siq dukej nuk dëshironte të vazhdonte me këto përpjekje dhe të paguante taksat për automjetin e tij. Zëvendës drejtori gjithashtu ka potencuar se departamenti i tij kishte kërkuar nga autoritetet përgjegjëse në Serbi për sigurimin e dokumentacionit që do ta vërtetonte pagesën e taksave në Serbi nga ankuesi.

Mungesa e paisjeve funksionale në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë

Më 24 gusht 2005, gazeta ditore e Kosovës “Lajm” publikoi një raport lidhur me mosfunksionimin e një aparati koronaro grafik në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë para dy vjetësh.

Më 8 qershor 2006, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit u takua me përfaqësuesit e Departamentit të Mjeksisë Interne në kuadër të Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë. Gjatë këtij takimi përfaqësuesi i Institucionit të Ombudspersonit është informuar se pas inaugurimit solemn të aparatit koronaro grafik, aparati kurrë nuk është futur në funksion. Arsyeja kryesore për këtë ishte mungesa e paisjeve shtesë dhe se aparati ishte vendosur në një dhomë në të cilën vazhdonin riparimet. Gjatë takimit përfaqësuesi i Institucionit të Ombudspersonit poashtu u informua se pesëmbëdhjetë mjekë ishin trajnuar në IRJ të Maqedonisë, Angli dhe Turqi për përdorimin e aparatit dhe ishin të gatshëm për të filluar punën.

Më 16 qershor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër ministrit të Shëndetësisë dhe ka kërkuar informata për planifikimin apo ndërmarrjen e hapave nga ana e Ministrisë me qëllim të futjes në funksion të aparatit koronaro grafik sa më shpejtë që është e mundur.

Më 13 korrik 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga Ministri i Shëndetësisë në të cilën thuhej se ai është kyçur në këtë çështje së fundmi, dhe që së shpejti do të hapte një tender për blerjen e një monitori hemodinamik dhe mjeteve programuese për të siguruar funksionimin e aparatit.

Më 23 shkurt 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër Kryeministrit të Kosovës duke shfaqur brengën për mos funksionizimin e aparatit koronaro grafik, edhe pse Qendra Klinike Universitare ishte paisur me të para dy vjetësh. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka kërkuar nga Kryeministri që të shfrytëzojë autoritetin që e posedon për të ndërmarrë të gjitha masat për të siguruar futjen në funksion të aparatit.

Më 20 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi letër përsëri Kryeministrit të Kosovës në të cilën e përsëriti kërkesën e tij paraprake.

Keq trajtimi i aktivistëve të “Vetëvendosjes” nga pjesëtarët e SHPK-së

Më 25 gusht 2006, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një ankesë nga aktivistët e lëvizjes “Vetëvendosje” duke pohuar se ata ishin keqtrajtuar nga anëtarët e SHPK-së më 23 gusht 2006 gjatë një proteste kur ata po protestonin para Kuvendit të Kosovës dhe selisë qendrore të UNMIK-ut në Prishtinë. Aktivistët pohuan që ata ishin arrestuar gjatë protestës dhe që policët e SHPK-së i kishin rrahur ata pasi që i kishin sjell në stacionin e policisë në Prishtinë.

Më 25 gusht 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryeprokurorit të Kosovës në lidhje me çështjen e keqtrajtimit të aktivistëve “Vetëvendosje” në objektet e stacionit policor të SHPK-së. Ushtruesi i Detyrës së

Ombudspersonit kërkoi nga Kryeprokurori që urgjentisht të hap hetimet në lidhje me këtë incident dhe të informoi atë për rezultatet.

Më 11 dhjetor 2006, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër përkujtuuese Kryeprokurorit të Kosovës duke përsëritur kërkesën për informata në letrën e tij të 25 gushtit 2006.

Më 19 dhjetor 2006, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit pranoi një letër nga Kryeprokurori i Kosovës duke pohuar se ai i kishte dorëzuar kërkesën e Ushtuesit të Detyrës së Ombudspersonit dhe tërë dokumentacionin përcjellës prokurorisë publike komunale në Prishtinë më 31 gusht 2006. Në të njëjtën datë, Kryeprokurori i Kosovës kishte kërkuar nga zyra e lartpërmendur që të ndërmer të gjitha veprimet e duhura në përputhje me ligjin në fuqi.

Më 16 janar 2007, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryeprokurorit të prokurorisë publike komunale në Prishtinë duke kërkuar informata mbi hetimet në incidentet e pohuara të 23 gushtit 2006.

Më 19 janar 2007, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga prokurori i Prokurorisë publike komunale. Letra njoftonte se me të marr letër këmbimin nga Prokuroria publike në Kosovë, prokurori kishte filluar hetimet në këtë rast. Në bashkëpunim me Shtabin e përgjithshëm të Komandës rajonale në Prishtinë, Prokurori kompetent publik komunal kishte arritur të identifikonte emrat policëve të pretenduar si të përgjegjshëm për keqtrajtimin e aktivistëve si pasojë e numrave të tyre identifikues që ishin përmendur në letrën e Ushtuesit të Detyrës së Ombudspersonit. Në fund, prokurori tha që rasti ishte ende nën hetime, dhe pas hetimeve të plota Institucioni i Ombudspersonit do të njoftohet për rezultatet.

Më 18 prill 2007, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryeprokurorit të Prokurorisë publike komunale në Prishtinë duke kërkuar informata në lidhje me fazën e procedurave dhe ndonjë veprimi që janë ndërmarr nga zyra e tij në ndërkohë në lidhje me rastin.

Deri kah fundi i periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit nuk kishte pranuar përgjigje në letrën me datë 18 prill 2007.

Mungesa e oksigjenit në repartin e Neonatologjisë në klinikën gjinekologjike në Prishtinë

Një artikull gazete i publikuar në gazetën ditore të Kosovës "Lajm Ekslusive" më 1 shtator 2006, raportoi që gjatë natës së 31 gushtit 2006 kishte mungesë oksigjeni në repartin e Neonatologjisë në Klinikën Gjinekologjike në Prishtinë, e cila është pjesë e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Si rrjedhojë, artikulli pohoi se jeta e një foshnjeje ishte në rrezik.

Më 4 shtator 2006, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit kontaktoi me Drejtorin e klinikës gjinekologjike, i cili e informoi atë se shtypja e oksigjenit kishte rënë edhe dy herë gjatë natës së 31 gushtit 2006. Drejtori i Klinikës po ashtu vërejtë që departamenti i Neonatologjisë ishte ballafaquar me të njëjtin problem dy muaj më herët, dhe ishte formuar një komision për të hetuar shkaqet e rënies së shtypjes së oksigjenit gjatë natës se 31 gushtit 2006.

Më 7 shtator 2006, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi letër Drejtorit Ekzekutiv të QKUK-së, me anë të së cilës ai e ngriti çështjen e mungesës së oksigjenit në klinikën gjinekologjike. Ai kërkoi nga drejtori Ekzekutiv t'i merr të gjitha masat e duhura që të siguroi që kjo situatë të mos përsëritet në të ardhmen, duke pasur parasysh natyrën serioze të problemit dhe efektin e tij në shëndetin e foshnjave që trajtohen në QKUK. Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit më tej kërkoi nga drejtori Ekzekutiv që të themeloi një komision për të hetuar shkakun e rënies së oksigjenit dhe të dorëzoj raport mbi rezultatet e hetimeve.

Më 22 shtator 2006, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga drejtori Ekzekutiv i QKUK-së në të cilën u pohua se komisioni i kishte përfunduar hetimet dhe kishte përgatit raport mbi të gjeturat e tyre. Në raport, komisioni kishte përfunduar se mungesa e oksigjenit në repartin e Neonatologjisë ishte shkaktuar në fakt nga moskryerja e detyrave të veta siç duhet nga punonjësi përgjegjës.

Më 23 janar 2007, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit i drejtoi letër drejtorit Ekzekutiv të QKUK-së duke kërkuar informata mbi ndonjë masë të ndërmarr gjer më tani për të siguruar që në të ardhmen, mbikëqyrja profesionale në QKUK-së do të parandalonte situatat që mund të vënë jetën e pacientëve në rrezik.

Më 23 janar 2007, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit po ashtu i dërgoi letër Krye Inspektorit në Inspektoratin e Shëndetësisë të Kosovës duke kërkuar informata për ndonjë veprim që Inspektorati i Shëndetësisë, i cili ka mandatin për të ushtruar mbikëqyrje profesionale të jashtme mbi institucionet e shëndetësisë, ka ndërmarr në lidhje me rastin e lartpërmendur. Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit po ashtu kërkoi një kopje të ndonjë raporti të përgatitur në lidhje me këtë çështje.

Më 31 janar 2007, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit pranoi letër nga kryetari i Bordit të Përkohshëm Ekzekutiv të QKUK-së i cili e informoi atë që atëherë kur të identifikohet shkaku i mungesës së oksigjenit, do të merret veprim disiplinor kundër punonjësit përgjegjës; i njëjti punonjës po ashtu ka marrë vërejtje me shkrim për dështimin në kryerjen e detyrave të veta.

Më 19 mars 2007, Ushtuesi i Detyrës së Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Krye inspektori i shëndetësisë duke e njoftuar atë se i tërë dokumentacioni relevant ishte ekzaminuar dhe ishin kontaktuar udhëheqësi i shërbimeve teknike në QKUK dhe drejtori i resurseve humane i QKUK-së. Në bazë të kësaj, menaxhmenti i QKUK-së formoi një komision për të hetuar çështjen. Në përfundim të këtyre hetimeve, komisioni disiplinor kishte vendosur të suspendonte punonjësin përgjegjës nga puna me pagesë dhe t'i

lëshohej një vërejtje me shkrim. Kryeinspektori i shëndetësisë po ashtu vërejtë që Inspektorati i shëndetësisë ishte përfshirë vetëm me vonesë në ngjarjet që kishin ndodhur me 31 gusht. Nuk ishte hera e parë që një problem i tillë ishte shfaqur, dhe drejtori i resurseve humane në QKUK kishte urdhëruar suspendimin një mujor me pagesë nga puna e punonjësit përgjegjës në secilin rast—më 8 mars 2006 dhe 28 shtator 2006. Për më tepër, Kryeinspektori njoftoi Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit që ai i kishte rekomanduar Bordit të Përkohshëm Ekzekutiv që menaxhmenti të ndërmerre masa që të siguronte që rastet e tilla të mos përsëriten në të ardhmen. Inspektorati i Shëndetësisë gjithashtu përkrahi rekomandimet e komisionit disiplinor që numri i punonjësve në këtë shërbim duhet të rritet.

Mungesa e fondeve për personel në qendrën e shëndetit në Fushë Kosovë

Më 14 janar 2006, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një ankesë nga punonjësit e Qendrës kryesore të shëndetit familjar “Dr. Fatmir Krasniqi” në Fushë Kosovë në lidhje me dështimin e Qendrës për të vazhduar kontratat e punës të disa punonjësve, si edhe fakti që të tjerët nuk kishin marrë të gjitha pagesat e tyre si pasojë e mungesës së mjeteve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës i vitit 2006.

Në mes të janarit dhe majit 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi disa letra ministrit të Shëndetësisë, kryetarit të Komunës së Fushë Kosovës dhe Kryeministrit, duke kërkuar nga ata që të zgjidhin këtë çështje. Letrat po ashtu i rikujtuan ata që kjo qendër shëndeti ishte institucioni i vetëm shumë-etnik në komunën e Fushë Kosovës, që kishte të punësuar anëtarë nga të dy komunitetet nga ai shqiptar dhe serb. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit konsideroi që dështimi për të mirëmbajtur këtë qendër shëndeti do të vinte në dyshim përpjekjet e komunës në krijimin e një shoqërie funksionale dhe shumë-etnike.

Më 6 shtator 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit prapë i dërgoi letër Kryeministrit të Kosovës duke e informuar atë për një takim që ai kishte pasur me kryetarin e Komunës së Fushë Kosovës. Ky i fundit e kishte informuar atë se punonjësit e qendrës së shëndetit ishin në gjendje të vështirë financiare dhe po i drejtoheshin atij në baza ditore për të kërkuar asistencë. Sipas kryetarit të Komunës problemet financiare më të cilat ballafaqohej qendra e shëndetit kishin ekzistuar që një kohë dhe ka qenë dashur të zgjidhen para disa kohësh.

Më 16 janar 2007, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit u takua me një përfaqësues nga komuna e Fushë Kosovës. Ai gjatë takimit u informua se problemet me të cilat ballafaqohej qendra e shëndetit janë zgjidhur në mënyrë të pjesshme, mjetet financiare për pagesat e pagave të papaguara ishin aprovuar për 13 punonjës të komunitetit minoritar, e kontrata e punës së të cilëve ishte zgjatur për vitin 2007. Megjithatë, problemet me të cilat ballafaqoheshin punonjësit e përkatësisë shqiptare vazhduan, përkundër faktit se disa nga ata i kishin më shumë se 25 vjet përvojë pune.

Më 2 shkurt 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi edhe një letër Kryeministrit duke e informuar atë për takimin e 16 janarit në mes të përfaqësuesve të

Institucionit të Ombudspersonit dhe Komunës së Fushë Kosovës. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit në letër vërejtë se, duke marrë parasysh karakterin unik, shumë-etnik të qendrës së shëndetit, autoritetet kompetente publike duhet të angazhohen më shumë në sigurimin e qëndrueshmërisë dhe trajtimin e barabartë të punonjësve të vet.

Kah fundi i periudhës për të cilën raportohet, Institucioni i Ombudspersonit nuk pranoi asnjë përgjigje ndaj letrave të dërguara për rastin e lartpërmendur.

Dështimi për të implementuar nenin 13 të Ligjit mbi pensionet e personave me aftësi të kufizuara

Më 13 mars 2006, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një ankesë nga një person me aftësi të kufizuara i cili ankohej se Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) refuzoi të përjashtoi atë dhe personat tjerë më aftësi të kufizuara nga pagesa e plotë e detyrimit për harxhimin e energjisë përkundër nenit 13 të Ligjit mbi pensionet për personat me aftësi të kufizuara që parashihte se, ndër benificionet tjera, detyrimet e lartpërmendura duhet të zvogëlohen për persona me aftësi të kufizuara.

Pas një numri të letrave që ju dërguan autoriteteve menaxhuese të KEK-ut dhe të dërguar si kopje Ministrisë së Energjisë dhe Minierave dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit mori informata nga zëvendës Drejtori i KEK-ut më 4 maj 2006, që ministritë kompetente ente nuk kanë lëshuar aktet e nevojshme nën ligjore për implementimin e duhur të nenit 13 të ligjit të lartpërmendur, dhe atëherë kur të ketë ndodhur kjo, KEK-u do të angazhohet në ekzekutimin e këtyre akteve. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit po ashtu morri një letër nga Drejtori i Departamentit të Kosovës për Administrimin e pensioneve pranë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale më 19 maj 2006, duke informuar atë se Ministria e Energjisë dhe Minierave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave ishin njoftuar në kohën e duhur rreth obligimit të tyre për të lëshuar udhëzimet e nevojshme administrative për të implementuar Ligjin mbi Paaftësitë. Drejtori i departamentit shtoi se ai nuk kishte qenë informuar për atë se nëse këto udhëzime administrative ishin lëshuar.

Më 15 shtator 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Krye ministrit të Kosovës duke i shprehur brengat e tij se udhëzimet e nevojshme administrative për implementimin e Ligjit mbi Pensionet e Personave me Aftësi të kufizuara nuk është lëshuar ende. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit konsideroi që dështimi në lëshimin e udhëzimeve të tilla administrative përbënte neglizhencë nga ana e autoriteteve kompetente. Neglizhenca e tillë është në kundërshtim me nevojën për qeverisje të mirë dhe respektim të të drejtave të njeriut, e që duhet të jetë qëllim i çdo qeverie. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ishte edhe më i brengosur nga ideja që autoritetet qendrore vetë mund të kenë qenë fajtorë për një neglizhencë të tillë dhe me këtë i mohonin të drejtat e personave të mbrojtur me këtë ligj. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit vuri në pah që sa më shpejtë të lëshohen udhëzimet administrative për të implementuar ligjin e lartpërmendur, zbatueshmëria e tyre retroaktive do të arsyetonte lëshimin aktual dhe do të kontribuonte vlerave demokratike dhe funksionimit të duhur të

sundimit të ligjit. Për më tepër, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kërkoi nga Kryeministri që të shfrytëzoi autoritetin e tij për të siguruar që ministritë relevante të aprovojnë aktet nën ligjore sa më shpejtë të jetë e mundur, dhe me këtë të sigurojnë implementimin e ligjit të lartpërmendur.

14. Shqetësimet lidhur me ndotjen e lumit Llap që shkaktohet nga mbeturinat industriale të kompanisë “Pajtimi”

Në fillim të majit 2006, mediat kosovare kanë publikuar informata lidhur me ndotjen e lumit Llap e cila shkaktohet nga mbeturinat industriale të fabrikës së ushqimit “Pajtimi Company” e cila gjendet në fshatin Llugë në Komunën e Podujevës.

Më 15 maj 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër kryetarit të Komunës së Podujevës në të cilën i ka paraqitur shqetësimet e tij për mirëqenien e banorëve të fshatrave që gjenden në breg të lumit Llap. Këta njerëz janë ballafaqur me probleme serioze, duke e përfshirë rrezikun për shëndetin e fëmijëve të tyre dhe pamundësinë për të përdorur ujin e lumit për ujitje. Ky problem kishte ekzistuar që nga fillimi i punës së fabrikës, sistemi i ujrave të zeza të së cilës kishte filluar që ta ndotte lumin. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit, në letrën e tij ka kërkuar nga kryetari i Komunës që të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për hetim dhe ta informojë Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit për çdo veprim të ndërmarrur.

Më 5 tetor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër përkujtuese kryetarit të Komunës së Podujevës, në të cilën ka kërkuar përgjigje për letrën paraprake.

Më 19 tetor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Podujevës në të cilën thuhej se me të marrë ankesën e parë në prill të vitit 2004 lidhur me ndotjen e lumit, ai kishte bërë inspektim në vendin e ngjarjes së bashku me inspektorin përgjegjës komunal dhe me koordinatorin komunal për çështje mjedisore. Gjatë atij inspektimi, është gjetur se kompania “Pajtimi” nuk posedonte gropë për ujrave të zeza ose sistem për sigurimin e duhur të rrjedhës së ujrave të zeza. Kryeshefi ekzekutiv ka potencuar se është njoftuar Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor dhe ishte kërkuar nga ta për të bërë një vlerësim të kësaj në ambientin rrethues. Ai poashtu ka përmendur se në gusht të vitit 2005, një ekip i përbashkët me përfaqësuesit e ministrisë, kryetari i komunës dhe kryeshefi ekzekutiv, drejtori për urbanizëm dhe një inspektor sanitar kanë bërë një inspektim tjetër në vendngjarje. Me këtë rast, ata kanë ekzaminuar për së afërmi procesin e futjes së filterëve për trajtimin e mbeturinave industriale që buronin nga fabrika. Sipas kryeshefit ekzekutiv, projekti ka përfunduar, dhe për një kohë të caktuar nuk ka pasur ankesa. Me 23 maj 2006, komuna ka pranuar një ankesë tjetër nga banorët e fshatrave përreth lumit nëpërmes SHPK-së të cilët e kishin vizituar vendin dhe kanë vënë re se ishte përsëri i ndotur dhe si rrjedhojë shumë peshq kishin ngordhur. Kryeshefi ekzekutiv ka potencuar se komuna e tij kishte kontaktuar Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me këtë çështje dhe zhvillimet e fundit.

Më 20 tetor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor. Në letrën e sekretarit të përhershëm thuhet se pasiqë fabrika e kishte ndryshuar procesin teknologjik të saj, është urdhëruar që të sigurojë një raport të ri për vlerësimin e ndikimit të ujrave të zeza që dalin nga fabrika në mjedis, dhe që kompania ka aplikuar për Lejen Ujore në Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Më 28 shkurt 2007, Ushtruesi Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar letër Sekretarit të Përhershëm të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duke kërkuar informata lidhur me zhvillimet e fundit mbi rastin. Në veçanti, Ushtruesi i Detyrës ishte i interesuar që të dinte rreth plotësimit ose jo të kriterëve nga ana e kompanisë për marrjen e Pëlqimit Mjedisor dhe Lejen Ujore, nëse janë lëshuar lejet e tilla, dhe nëse jo, nëse kompania kishte vazhduar që të funksiononte pa to.

Më 10 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër përkujtuese sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor duke kërkuar përgjigje për letrën e dërguar më 28 shkurt 2007.

Më 21 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga Sekretari i Përhershëm në Ministrinë e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor në të cilën thuhet se Inspektorati i Ministrisë kishte inspektuar kompaninë e lartpërmendur pesë here, dhe kishte ardhur në përfundim se rrjedhja e mbeturinave industriale nuk po trajtohej siq duhet. Rrjedhimisht, inspektorati kishte urdhëruar kompaninë për t'i trajtuar mbeturinat industriale në bazë të normave dhe standardeve ligjore dhe për funksionalizimin e sistemit efektiv për filtrim. Sekretari i Përhershëm poashtu ka potencuar se kompania ka aplikuar për marrjen Pëlqimit Mjedisor, mirëpo është refuzuar për arsye se masat e ofruara nga kompania nuk mund të garantonin zvogëlimin e ndotjes potenciale në përputhje me legjislacionin përkatës për ambientin. Për shkak të ndryshimeve në procesin teknologjik të saj, nga kompania është kërkuar që të paraqesë një raport të ri me vlerësimin e ndikimit të mbeturinave industriale të saj në mjedisin rrethues.

Në fund, Sekretari i Përhershëm ka potencuar se asnjë masë ndëshkuese ligjore nuk është ndërmarrë pasiqë mostrat e marra nga lumi dhe ujrati e zeza të kompanisë nuk kanë treguar se ndotja ka shkaktuar gjendje alarmante (ndoshta për arsye se rrjedhja e lumit e ka shpërlarë ujin e ndotur). Inspektorët janë urdhëruar që të bëjnë kontrollime të rregullta deri në vlerësimin e tërësishëm të sipërfaqës së ujit të ndotur nga mbeturinat industriale të kompanisë.

Në kohën e publikimit të raportit vjetor, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit kanë caktuar takime të tjera me përfaqësuesit e fshatrave për të vlerësuar përmirësimin e situatës.

Zgjatja e procedurave për një kontest pronësor kundër AKM-së

Më 18 tetor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër kryetarit të Gjykatës Komunale të Istogut në lidhje me zgjatjen e supozuar të procedurës në një kontest pronësor. Procedura ishte inicuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështje që kishin të bënin me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit, të cilën Dhoma e Posaçme më pas kishte vendosur për ta transferuar në Gjykatën Komunale të Istogut. Në këtë letër, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka kërkuar nga kryetari i gjykatës për t'u informuar lidhur me ndonjë veprim që është ndërmarrë nga gjykata për zgjidhjen e rastit të ankuesit.

Më 17 nëntor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër drejtorit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) lidhur me vendimin e AKM-së për privatizimin e pronës kontestuese. Ai e ka informuar drejtorin e AKM-së lidhur me vendimin e Dhomës së Posaçme për transferimin e rastit tek Gjykata Komunale në Istog. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka kërkuar nga drejtori i AKM-së që ta informojë rreth procesit të privatizimit të pronës kontestuese, dhe rreth vazhdimit ose jo të procedurës përderisa çështja ishte në pritje pranë Gjykatës Komunale të Istogut.

Më 25 janar 2007, Institucioni i Ombudspersonit ka marrë një letër nga drejtori i AKM-së në të cilën thuhej se Gjykata Komunale e Istogut kishte lëshuar aktgjykimin në këtë çështje me datën 6 nëntor 2006. AKM-ja ka parashtruar ankesë ndaj këtij aktgjykimi tek Dhoma e Posaçme dhe çështja ishte ende në pritje.

Në kohën e publikimit të këtij raporti vjetor, procedura gjyqësore rreth këtij rasti janë në vazhdim e sipër.

Një kërkesë për transferimin e një të burgosuri nga IRJ e Maqedonisë në Kosovë

Më 20 tetor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar letër drejtorit të Departamentit të Drejtësisë në kuadër të UNMIK-ut duke kërkuar informata lidhur me një rast ku një i burgosur i cili mbahet në Institutin Korrektues "Idrizovë" në Shkup, IRJ e Maqedonisë, ka kërkuar të transferohet në një burg të Kosovës. Kopjet e kësaj letreje i ishin dërguar ministrit të Drejtësisë, kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan dhe kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prizren.

Më 19 janar 2007, ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër të dytë drejtorit të Departamentit të Drejtësisë në kuadër të UNMIK-ut, duke kërkuar përgjigje ndaj letrës së dërguar me 20 tetor 2006 dhe informata rreth rastit përkatës.

Më 13 mars 2007, pas kontaktimit të Ombudsmanit të IRJ të Maqedonisë lidhur me këtë rast, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga Ombudsmani i IRJ të Maqedonisë. Në bazë të letrës, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit është informuar se personi i mbajtur në Shkup është dënuar me 3 vjet heqje lirie, dhe është mbajtur në këtë objekt që nga gushti i vitit 2005. I burgosuri kishte bërë kërkesë tek Ministria e

Drejtësisë së IRJ të Maqedonisë duke kërkuar transferim në një burg të Kosovës, në përputhje me një protokoll të përkohshëm për transferimin e të burgosurve të ënuar, i nënshkruar nga IRJ e Maqedonisë dhe UNMIK-u në mars të vitit 2006. Ombudsmani i IRJ të Maqedonisë e ka informuar ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit se procedurat për transferimin e këtij të burgosuri janë nën kompetencat e autoriteteve kosovare.

Më 30 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar letër kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke kërkuar informata lidhur me fazën aktuale të procedurave lidhur me transferin e të burgosurit.

Më 25 Maj 2007, Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar një letër nga kryetari i Gjykatës së Qarkut në Prizren në të cilën thuhej se gjykata nuk ishte kompetente për të marrë vendime për çështje të tilla, në letër poashtu thuhej se lidhur me kërkesën e Departamentit të Drejtësisë duhet të mirret vendim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Më 15 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër përkujtuese kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë duke i përsëritur kërkesën për informata të përfshirë në letrën e dërguar më 30 mars 2007. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka vënë re se, sipas kryetarit të Gjykatës së Qarkut në Prizren, rasti në fjalë i ishte dërguar Gjykatës së Qarkut në Prishtinë për procedura të mëtutjeshme.

Deri në datën e publikimit të këtij raporti vjetor, Institucioni i Ombudspersonit nuk ka pranuar ndonjë përgjigje ndaj letrës së dërguar Departamentit të Drejtësisë së UNMIK—ut dhe Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

Mos respektimi i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/14 mbi taksën rrugore të automjeteve

Më 11 dhjetor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër ministrit të Punëve të Brendshme duke cekur që Departamenti i regjistrimit të automjeteve i ka detyruar personat që të paguajnë taksën rrugore të automjeteve mbi automjetet e importuara posa pronarët e automjeteve tentuan të regjistrojnë automjetet; kjo përkundër faktit që Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/14 mbi taksën rrugore të automjeteve vendos që njerëzit që importojnë automjete në Kosovë i kanë tridhjetë ditë kohë brenda së cilës paguhet taksa rrugore për automjetin sipas datës me të cilën ata kanë paguar të gjitha taksat e importit. Madje edhe në rastet kur kjo periudhë kohore nuk ka kaluar, njerëzit që bëjnë pjesë në kategori të cilët janë zënë duke vozitur automjetet e tyre e që nuk kanë paguar taksën rrugore për automjetin janë kërcënuar me gjoba. Duke marrë parasysh seriozitetin e çështjes, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kërkoi nga ministri që të ndërhyjë në interes të mbrojtjes së të drejtave të njerëzve në përputhje me të drejtën e e zbatueshme në Kosovë dhe me sundimin e ligjit në përgjithësi.

Më 10 prill 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi edhe një letër ministrit të Punëve të Brendshme në të cilën ai përsëriti brengat e tij dhe kërkoi që ministri të përgjigjet në letrën e tij me datë 11 dhjetor 2006.

Më 24 prill 2007, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga udhëheqësi i departamentit të regjistrimit të automjeteve, i cili e informoi për interpretimin ligjor të Shtojcës A pika 10 e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2005/14. Sipas ministrit, kjo dispozitë u aplikua tek personat të cilët kishin importuar automjete dhe që i kishin paguar taksat e importit. Kjo parashikonte që në rastet e tilla, pronarët e automjeteve kishin të drejtën për të paguar taksën rrugore të automjeteve brenda një afati kohor prej 30 ditësh. Gjatë kësaj periudhe 30 ditësh, gjobat administrative bazuar në nenet 4.3 dhe 4.4 të Rregullores së lartpërmendur nuk do të aplikohen.

Pamundësia për marrjen e dokumentacionit civil në Komunën e Pejës

Më 15 dhjetor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër Ministrisë së Shërbimeve Publike për të kërkuar informata lidhur me një ankesë të pranuar nga shefi i Shërbimit të Gjendjes Civile në Pejë. Ankuesi i referohej çështjes së problemeve me të cilat janë ballafaquar disa njerëz në komunën e tij për nxjerrjen e dokumenteve, veçanërisht dokumenteve të lëshuara nga viti 1990 deri 1999. Shefi i Shërbimit të Gjendjes Civile kishte bërë disa ankesa ndaj institucioneve të ndryshme duke kërkuar ndihmë në zgjidhjen e këtij problemi.

Më 16 shkurt 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër përkujtuese Ministrisë së Shërbimeve Publike duke kërkuar përgjigje për letrën e datës 15 dhjetor 2006.

Më 29 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka marrë një përgjigje nga zyrtari ligjor në Ministrinë e Shërbimeve Publike në të cilën thuhej se zyra e lartpërmendur në bashkëpunim me Departamentin e Gjendjes Civile të Ministrisë së Shërbimeve Publike kanë lëshuar udhëzimin administrativ nr. MPS 2006/07 për përgatitjen e regjistrimit për gjendje civile. Sipas zyrtarit ligjor, ky udhëzim i përcakton rregullat dhe procedurat për ripërtëritjen e regjistrave të gjendjes civile që janë humbur, prishur apo dëmtuar. Ai poashtu ka potencuar se Ministria e Shërbimeve Publike është duke e finalizuar draft Ligjin për gjendjen civile, dhe se ripërtëritja e regjistrave civilë është përcaktuar në nenin 21 të draft Ligjit.

Dështimi për të kompensuar pronarët e pronave të shpronësuara për ndërtimin e rrugës

Që nga mesi i vitit 2005, Ombudspersoni dhe më vonë Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ishin në kontakt me ministrinë kompetente në lidhje me ankesat e pranuar nga Institucioni duke përfshirë shpronësimin de facto të një numri të njerëzve që jetojnë në komunën e Lipjanit. Shpronësimet ishin rezultat i ndërtimit të rrugës që shpinte nga Komorani Komuna e Glllogocit përmes Komunës së Lipjanit në Caralevë Komuna e Shtimes. Informata e fundit e pranuar nga Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit në periudhën raportuese të mëhershme ishte nga ministri i Transportit dhe Post-telekomunikacionit i cili në letrën e dërguar në mars 2006, ceku se ministria e tij kishte të nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me të tri komunat që ishin të përfshira në ndërtimin e rrugës. Në këtë memorandum, komunat e lartpërmendura morën

përsipër që të zgjidhin të gjitha kontestet e pronës në lidhje me rrugën Komoran – Caralevë e cila kalonte përmes territorit të tyre. Ministri ceku se ai kishte kërkuar nga komunat që të zgjidhin të gjitha rastet në lidhje me shpronësimin e pronave ashtu siq kërkohej nga marrëveshja e lartpërmendur.

Më 22 dhjetor 2006, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër ministrit të Transportit dhe Post-Telekomunikacionit duke informuar atë se sipas ankuesve, implementimi i projektit rrugor që prekte pronat e tyre ishte në vazhdim, por që komunat kompetente ende nuk kishin filluar procedurat e shpronësimit në lidhje me pronën e tyre. Sipas informatave të pranura nga komunat përkatëse, komunat tashmë kishin filluar të zhvillonin vlerësimin teknik të pronave që do të shpronësoheshin, pa përcjell procedurat e rregullta të shpronësimit, e që nuk ishte përfunduar ende. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit po ashtu kërkoi informata se sa kishte përparuar implementimi i projektit rrugor dhe procedurat e kompensimit të personave të shpronësuar.

Më 13 prill 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër të dytë ministrit të Transportit dhe Post-Telekomunikacionit në të cilën ai përsëriti brengat e ngritura në letrën e tij me datë 22 dhjetor 2006.

Më 27 prill 2007, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga ministri i Transportit dhe Post-Telekomunikacionit në të cilën ai dha një shpjegim të hollësishëm për rëndësinë e projektit rrugor për banorët e komunave të prekura. Përkundër vështirësive të caktuara që ishin shfaqur gjatë implementimit të projektit, Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit ishte angazhuar për të ekzekutuar projektin që përfshinte ndërtimin e rrugës Komoran – Caralevë.

Vështirësitë në marrjen e dokumentacionit mbi pronën nga koha jugosllave

Më 22 janar 2007, *Institucioni i Ombudspersonit pranoi një ankesë në lidhje me pamundësinë e një personi për të dëshmuar pronësinë mbi pronën si pasojë e humbjes së dokumentacionit. Sipas ankesës, tapia e humbur ishte në emër të gjyshit të tij të ndjerë dhe dëshmonte pronësinë mbi 16 hektarë tokë në komunën e Pejës. Sipas ankuesit, dokumentet e nevojshme janë arkivuar në atë që më parë quhej arkivi federal në Shkup, Maqedoni.*

Më 29 janar 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë duke kërkuar informata në lidhje me pretendimet e ankuesit që dokumentet e tij mbi pronësinë janë ruajtur në Arkivin shtetëror të Shkupit.

Më 22 shkurt 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit pranoi një letër nga Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë, më të cilën u informua se Arkivi shtetëror i Republikës së Maqedonisë nuk përmbante ndonjë dokument në lidhje me pronën e zotëruar në ish-Jugosllavi apo tapi sa i përket pronës së paluajtshme. Për më tepër, Arkivi nuk përmbante asnjë dokument në emrin e gjyshit të ankuesit.

Mos zbatimi i vendimit të gjykatës në Glogoc

Më 26 janar 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi letër ministrit së Drejtësisë duke shpjeguar se sipas procedurave gjyqësore në Gjykatën Komunale në Gllogoc, as Gjykata Komunale e as Kuvendi Komunal në Gllogoc si i paditur i çështjes, nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim për të zbatuar këtë aktgjykim të gjykatës që ka të bëjë me një kontest borxhi. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit vuri në pah se dështimi në zbatimin e vendimeve të plotfuqishme të gjykatës ishte në kundërshtim me administrimin e duhur të drejtësisë, qeverisjen e mirë dhe respektimin e sundimit të ligjit. Ai theksoi se çështja ishte edhe më brengosëse nëse autoritetet lokale refuzonin të zbatonin parimet e lartpërmendura. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kërkoi nga ministri i Drejtësisë që të përdorë kompetencat e tij, në bashkëpunim me ministrinë tjera me ndikim dhe në veçanti me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, për t'i kushtuar vëmendjen e duhur atyre rasteve dhe duke ndihmuar për të siguruar që vendimet e plotfuqishme të gjykatës të implementohen siç duhet. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit më tej kërkoi nga ministri i Drejtësisë që të lëshoi një udhëzim administrativ apo qarkore me të cilën autoritetet komunale do të udhëzoheshin mbi zbatimin e vendimeve të plotfuqishme të gjykatës. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit konsideroi që kjo do të ketë ndikim në përmirësimin e sundimit të ligjit, e cila ishte një parakusht i rëndësishëm për funksionimin e një sistemi ligjor dhe demokratik.

Më 4 qershor 2007, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën ky i fundit vuri në pah se si autoritet ekzekutues, Ministria e Drejtësisë nuk ishte kompetente për të ndërhyrë në vendimet e gjykatës apo procedurat gjyqësore. Megjithatë, Sekretari i Përhershëm premtoi se kjo Ministri e tij do të bëjë çmos në sqarimin dhe lehtësimin e procedurave mbi zbatimin e vendimeve të gjykatës në bashkëpunim me autoritetet relevante.

2) Implementimi i Ligjit mbi Procedurën Administrative

Më 29 janar 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Kryeministrit të Kosovës në lidhje me mungesën e implementimit të duhur të Ligjit mbi Procedurë Administrative të Kuvendit të Kosovës nga ana e administratës publike. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit në letrën e tij ceku se një numër i ankesave lidhur me çështje të ndryshme i kishin tërhequr atij vëmendjen për këtë problem. Ai specifikoi se si pasojë e mungesës së implementimit të duhur të ligjit, individët shpeshherë u deshën të prisnin me muaj të tërë që disa procedura të caktuara administrative të përfundojnë. Po ashtu njerëzit u privuan nga e drejta e tyre për t'u ankuar pasi që shumë akte administrative nuk përmbanin informacione mbi të drejtën e ankesës. Aktet tjera administrative nuk përfshinin arsyet apo shpjegimet për disa vendime administrative, dhe kur individët e dëmtuar kërkuan arsyet, shpeshherë dështuan në marrjen e përgjigjes nga zyrat administrative. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kërkoi nga Kryeministri që t'i këshilloi të gjitha organet kompetente administrative që të angazhohen më shumë në implementimin e Ligjit mbi Procedurën Administrative, duke cituar disa nga ato si shembuj të keqpërdorimit.

Më 20 shkurt 2007, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga drejtori i Zyrës së Shërbimeve Ligjore në Zyrën e Kryeministrit në Kosovë. Me anë të kësaj letre Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit informohej se Qeveria e Kosovës është angazhuar për të siguruar se dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Administrative dhe të gjitha ligjet dhe aktet tjera të implementohen plotësisht nga personat përgjegjës në organet dhe institucionet administrative. Për më tepër, zyra e informoi Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit që rastet të cilat janë referuar në letrën e tij i janë përcjellë autoriteteve kompetente dhe se nga udhëheqësit e këtyre autoriteteve është kërkuar që të sigurojnë që pasojat e shkaktuara nga sjellja e mëhershme e personelit të tyre të eliminohen sa më shpejtë të jetë e mundur. Zyra shtoi se në të ardhmen ata duhet të përpiqen që t'u shmangen lëshimeve të tilla.

Më 19 prill 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit pranoi një letër nga Sekretari i Përhershëm i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që e informonte atë që është lëshuar një vendim për themelimin e një grupi punues prej pesë vetash pranë Ministrisë, për hartimin e formave të duhura për të gjitha vendimet, në përputhje me Ligjin mbi Procedurën Administrative me qëllim të shmangies së akteve të mundshme të gabueshme administrative.

Plehrat industriale dhe gazrat e rrezikshme të liruara nga shkriticorja e metaleve

Më 6 shkurt 2007, Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar një ankesë nga një banor i fshatit Keçekollë, komuna e Prishtinës. Banori supozonte se mbeturinat dhe gazrat industriale të liruara nga shkriticorja "Galena" ishin kërcënim serioz për shëndetin e familjes së tij dhe për banorët e tjerë të asaj rrethine.

Më 6 shkurt 2007, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit vizitoi fshatin Keçekollë dhe konfirmoi përshkrimin e ankuesit rreth gjendjes së mbeturinave industriale që nga shkriticorja rrjedhin në lumin e afërt, i cili rrjedh në liqenin e Batllavës. Rrjedhimisht, mbeturinat mund të kontaminojnë ujin e pijshëm për komunën e Prishtinës, e cila furnizohet nga ky liqen.

Më 8 shkurt 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar letër drejtorit të Institutit Kombëtar për Shëndet Publik duke kërkuar veprim urgjent për parandalimin e pasojave të dëmshme për shëndetin e njeriut që po shkaktoheshin nga ndotja; në bazë të letrës poashtu është kërkuar informimi i Institucionit të Ombudspersonit për çdo veprim që do të ndërmerrej lidhur me këtë çështje. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një kopje të letrës edhe ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe kryetarit të Komunës së Prishtinës.

Më 16 shkurt 2007, Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar një letër nga drejtori i Institutit Kombëtar për Shëndet Publik në Kosovë në të cilën thuhej se, pas pranimit të letrës nga ana e Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit, Instituti ka dërguar një specialist për ekologji njerëzore dhe një teknik të lartë sanitar për të inspektuar shkriticoren "Galena" në fshatin Keçekollë. Ekipi inspektues ka ardhur në përfundim se objekti i

shkrites nuk paraqet rrezik vetëm për ambientin por edhe për banorët e fshatit Keçekollë dhe të gjithë njerëzit në Prishtinë që konsumojnë ujin nga liqeni i Batllavës.

Instituti Kombëtar për Shëndet Publik ka rekomanduar që, si pasojë e këtij kërcënimi, Ministria e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Departamenti për Mbrojtjen e Ambientit dhe Departamenti i Ujrave duhet të përgatisin një raport ekspertësh lidhur me këtë çështje duke u bazuar në Ligjin për Ujë të Kosovës 2004/24.

Në kohën e publikimit të këtij raporti, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit kanë caktuar takime të tjera me Komunën e Prishtinës dhe me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të vëzhguar përmirësimin e situatës.

Ankesat në lidhje me pagimin e dyfishtë të taksave të RTK

Më 20 prill 2006, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një ankesë nga një person i cili ishte obliguar të paguante taksën e Radio Televizionit të Kosovës (RTK) dy here për shkak se ai kishte dy njehsor elektrik në pronën e tij, dhe pavarësisht nga fakti se ai kishte vetëm një televizor.

Kur përfaqësuesi i Institucionit të Ombudspersonit u takua me Menaxherin e Konsumatorëve në KEK një muaj më vonë, ai u informua se KEK-u i kishte dërguar një letër PSSP-së duke kërkuar ndryshimin apo shfuqizimin e udhëzimit kompetent administrative përmes së cilës taksat e RTK-së inkasoheshin sipas njehsorit elektrik dhe jo sipas ekonomisë shtëpiake.

Më 6 shkurt 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër menaxherit për konsumatorë në KEK në të cilën ai u referua në takimin e fundit të mbajtur në lidhje me këtë çështje në maj të vitit 2006. Meqë, në ndërkohë, ai nuk kishte pranuar ndonjë përditësim nga KEK-u, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit pyeti Menaxherin për Konsumator se cilat veprime janë ndërmarr apo do të ndërmerreshin për të zgjidhur këtë problem.

Më 21 shkurt 2007, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një letër nga Udhëheqësi i sektorit për kujdes ndaj konsumatorëve në KEK që përmendte se sipas Ligjit mbi Radio dhe Televizionin e Kosovës, të gjitha subjektet fizike dhe juridike të vendosur në territorin e Kosovës ishin të obliguar për të paguar parapagimin për transmetuesin publik. Subjekti i tillë konsideroj si njësi të cilat kanë një faturë për rrymë apo ndonjë faturë tjetër publike. Udhëheqësi i këtij sektori shtoi se Departamenti për konsumator e kishte ngritur çështjen e parapagimit për transmetuesin publik disa herë nëpër takime që kishte pasur ky departament, mirëpo asnjëherë nuk ka adresuar ndonjë kërkesë me shkrim organeve drejtuese të KEK-ut lidhur me parapagimin e RTK-së.

Pohimet për zvarritje të hetimeve të SHPK-së në rastin e një personi të zhdukur

Më 8 shkurt 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër Zyrtarit Ndërlidhës të SHPK-së për institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me një rast në të cilin babai-biri i të cilit ishte zhdukur-ishte ankuar që hetimet e zhvilluara nga

SHPK-ja për këtë rast ishin vonuar. Sipas ankuesit biri i tij ishte zhdukur më 21 shkurt 2004 në lagjen “Taslixhe” në Prishtinë, dhe ai kur nuk kishte marr ndonjë informatë nga SHPK-ja mbi statusin e procedurave të hetimeve pas zhdukjes së të birit të tij. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit kërkoi që SHPK-ja të informoi atë për ndonjë veprim të ndërmarrë sa i përket këtij rasti në ndërkohë.

Më 5 prill 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit pranoi një letër nga zëvendës Komisar i SHPK-së që e informonte atë që pasi ankuesi e njoftoi SHPK-në për zhdukjen e birit të tij më 16 mars 2004, u caktuan dy policë për të hetuar rastin. Policët kishin intervistuar persona të ndryshëm të cilët i kishte njohur viktimë, por pa ndonjë rezultat. Ai më tutje theksoi që, gjatë tërë hetimeve, hetuesit kompetent të policisë e informonin të ankuarin në lidhje me gjendjen e procedurave. Zëvendës Komisar theksoi që rasti tani është duke u hetuar nga Njësia Rajonale e Hetimeve e SHPK-së në Prishtinë. Njësia përcillte linja të ndryshme të hetimit dhe do të informonte Institucionin e Ombudspersonit mbi rezultatet në kohën e duhur.

Mungesa e transparencës dhe e hetimeve të pavarura lidhur me rrethanat e vdekjes së dy kosovarëve gjatë protestave të 10 shkurtit 2007

Më 13 shkurt 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar letër Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) dhe Kryeministrit të Kosovës duke paraqitur shqetësimet e tij lidhur me rrethanat e vdekjes së dy kosovarëve gjatë protestës së 10 shkurtit 2007. Protestat ishin organizuar nga lëvizja “Vetëvendosje”. Sipas raporteve të mediave, Komisioneri i Policisë kishte premtuar se do të inicohe hetime të brendshme lidhur me sjelljen e poplucisë gjatë protestës. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka theksuar se është shumë e rëndësishme që të inicohen hetime të pavarura rreth ngjarjes së 10 shkurtit 2007 sa më shpejtë që të jetë e mundur, në mënyrë të pavarur nga hetimet e brendshme. Hetimet e tilla mund të bëhen ose nga trupa kompetentë të prokurorisë ose nga një komision i pavarur i formuar veçanërisht për këtë qëllim. Ushtruesi i Detyrës ka theksuar se hetimet e brendshme të zhvilluara nga policia nuk do t'i plotësonin në mënyrë të kënaqshme kërkesat për përgjegjësinë publike ose për pavarësi dhe transparencë siq kërkohet nga standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka nxitur PSSP-në dhe Kryeministrin për të siguruar zhvillimin e hetimeve të pavarura lidhur me sjelljen e policisë së UNMIK-ut dhe Shërbimit Policor të Kosovës gjatë 10 shkurtit 2007.

Më 5 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një përgjigje nga PSSP-ja në të cilën thuhej se ai pajtohet plotësisht se hetimet duhet të jenë të plota, të pavarura dhe transparente. Prandaj, PSSP-ja i kishte marrë kompetencat Policisë së UNMIK-ut për hetimet e ngjarjeve të 10 shkurtit 2007 dhe i kishte vënë ato nën udhëheqjen e një prokurori ndërkombëtar. PSSP-ja ka thënë se hetimet do të fokusohen kryesisht në mundësinë e veprimeve kriminale nga ana e policisë më 10 shkurt 2007, ai poashtu ka shtuar se hetimet do të duhej gjithashtu të kërkojnë gjetjen e përfundimeve lidhur me organizimet operationale për policinë, duke përfshirë sistemin komandues dhe kontrollin. PSSP-ja gjithashtu ka potencuar se për të garantuar transparencë, Inspektorati i Policisë së Kosovës është ftuar që t'i mbikëqyrë dhe monitorojë hetimet. Veç kësaj,

Inspektorati i Policisë së Kosovës i ka inicuar inspektimet e udhëhequra nga vet lidhur me sjelljet e SHPK-së gjatë 10 shkurtit 2007, dhe një prokuror vendor nga Zyra e Posaçme e Prokurorëve të Kosovës është duke bashkëpunuar për së afërmi me një prokuror ndërkombëtar lidhur me hetimet.

Gjatë marsit dhe prillit, Inspektorati i Policisë së Kosovës dhe Prokurori ndërkombëtar publik lëshuan një raport për sjelljen e policëve gjatë protestave të lartpërmendura. Inspektorati i Policisë së Kosovës kishte ardhur në përfundim se komunikimi i zyrtarëve të SHPK-së në terren me ata në zyrat kryesore kishte qenë problematik, dhe disa policë ishin ankuar se nuk ishin pajisur siq duhet për protestën. Prokurori publik ndërkombëtar kishte gjetur se vdekja e dy protestuesve nuk kishte qenë e domosdoshme dhe kishte mundur të evitohet. Dukej se që të dy protestuesit ishin vrarë nga plumbat e gomës të shtënë nga një apo më shumë zyrtarë të policisë së UNMIK-ut të cilët ishin me kombësi Rumune. Sidoqoftë, ai kishte konkluduar se dëshmitë e mbledhura nuk i përmbushin kërkesat për dyshim të arsyeshëm të një akti kriminal.

Shkelje e supozuar e të drejtave pronësore

Në rastin në fjalë, ankuesja ka pranuar një vendim nga Komisioni i Ankesave në kuadër të DÇPB-së i cili e rikonfirmonte të drejtën e saj për riposëdim të apartamentit të saj në Prishtinë, më 7 korrik të vitit 2003. Edhe pse DÇPB-ja kishte dëbuar uzurpuesin ilegal nga apartamenti në korrik të vitit 2006, Gjykata Komunale në Prishtinë, në bazë të procedurave të inicuar nga uzurpuesi ilegal, ka lëshuar aktgjykim duke e urdhëruar ankuesin për ta liruar pronën duke e lënë atë në dispozicion të palës tjetër. Në vendimin e saj, Gjykata Komunale nuk e kishte përmendur vendimin paraprak të lëshuar nga DÇPB-ja në favour të ankueses. Ankuesja ka bërë ankesë kundër këtij vendimi ndaj Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

Më 2 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar letër drejtorit ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Pronës (agjencia trashëgimtare e DÇPB-së) duke e informuar atë se vendimi i marrur nga DÇPB lidhur me këtë rast nuk është respektuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit poashtu ka kërkuar për qartësimin se sa ka ndikim një vendim i gjykatës në vlefshmërisë e vendimit të DÇPB-së dhe nëse ky i fundit është ende në fuqi.

Më 16 prill 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga drejtori ekzekutiv i Agjencisë Kosovare të Pronës në të cilën thuhej se, sipas paragrafit 2.7 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23, vendimet e marra nga Komisioni për Ankesa i DÇPB-së janë detyruese, përfundimtare dhe nuk mund të jenë objekt shqyrtimi nga ndonjë autoritet tjetër ligjor apo administrativ në Kosovë. Për më shumë ai ka shtuar se vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë i datës 10 nëntor 2006 është marrë pa autorizim ligjor dhe në kundërshtim me juridiksionin ekskluziv të Komisionit të Ankesave për zgjidhjen e kontesteve të tilla pronësore. Prandaj, urdhri i Gjykatës në bazë të të cilit ankuesja ishte obliguar për ta liruar apartamentin e saj ishte i pavlefshëm. Drejtori ekzekutiv i AKP-së në vazhdim kishte shtuar se, pasiqë DÇPB më 26 korrik 2006 kishte zbatuar vendimin e Komisionit të Ankesave dhe i kishte dorëzuar çelësat e

apartamentit ankueses, nuk mund të kishte juridiksion të mëtutjeshëm mbi atë patundshmëri e cila i ishte kthyer autoriteteve vendore. Drejtori ekzekutiv i AKP-së ka theksuar se tani e tutje zbatimi i vendimeve të Komisionit të Ankesave do të duhej të bëhej nga Shërbimi Policor i Kosovës.

Pamundësia për tu ankuar kundër vendimeve të plotfuqishme të Komisionit të Ankesave të DÇPB

Më 2 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër drejtorit ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) lidhur me pakënaqësinë e një ankuesi ndaj vendimit të plotfuqishëm të marrë nga Komisioni i Ankesave i Agjencisë Kosovare të Pronës, e cila e kishte refuzuar kërkesën e tij për rishqyrtim të vendimit të mëparshëm. Ankuesi poashtu kishte pas vërejtje ndaj faktit se ai nuk kishte mundur që të ankohej ndaj këtij vendimi të plotfuqishëm tek asnjë organ tjetër ligjor apo administrativ në Kosovë. Sipas ankuesit, ai i kishte dorëzuar pranë DÇPB-së në Mitrovicë të gjithë dokumentacionin lidhur me çështjen, duke i përfshirë dokumentet që e vërtetonin pronësinë e tij mbi patundshmërinë kontestuese. Sidoqoftë, sipas Komisionit të Ankesave të DÇPB-së, ai e kishte shitur apartamentin. Ankuesi kishte kërkuar që këto supozime të hetohen, dhe të mirret parasysh kërkesa e tij për adresim të kësaj çështjeje tek një Gjykatë kompetente në Kosovë. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka kërkuar nga drejtori ekzekutiv i AKP-së për ta informuar lidhur me ndonjë veprim të ndërmarrë rreth kësaj çështjeje.

Më 30 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër përkujtuese drejtorit ekzekutiv të AKP-së në të cilën e ka përsëritur kërkesën e pëparshme për informacione.

Më 18 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar edhe një kërkesë për informata drejtorit ekzekutiv të AKP-së duke kërkuar përgjigje për dy letrat e më parshme të 2 dhe 30 marsit 2007.

Më 21 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka marrë një përgjigje nga drejtori ekzekutiv i AKP-së në të cilën thuhej se në procedurën e shkallës së parë, Komisioni i Ankesave i DÇPB-së kishte marrë vendim për të hedhur poshtë ankesën e ankuesit, dhe më vonë e kishte refuzuar kërkesën e tij për rishqyrtim. Drejtori ekzekutiv i AKP-së ka theksuar se, duke u bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/23, Komisioni i Ankesave i DÇPB-së është themeluar si organ i pavarur me juridiksion ekskluziv për të zgjidhur ankesat e kategorive sipas nenit 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/23.

Zgjatja e procedurës lidhur me një kërkesë për kompenzim e dëmit për një arrestim të pajustificuar

Më 9 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër drejtorit të Departamentit të Drejtësisë së UNMIK-ut për ta informuar lidhur me një rast në të cilin një individ është mbajtur në arrest për një muaj, në qendrën për paraburgim në Mitrovicë,

para se të lirohet si rrjedhojë e mungesës së provave. Ky ish i burgosur është ankuar se Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut nuk i ka paguar ende kompensimin e dëmit të shkaktuar gjatë asaj kohe.

Më 18 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër përkujtuese Ushtruesit të Detyrës së drejtorit të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut duke e përsëritur kërkesën për informata lidhur me këtë rast.

Më 1 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga Ushtruesi i Detyrës së drejtorit të Departamentit të Drejtësisë të UNMIK-ut në të cilën thuhej se Departamenti i Drejtësisë nuk kishte asnjë kërkesë të regjistruar nga ankuesi. Në letër thuhej se Departamenti i Komisionit të Administratës Juridike për kompensimin e personave të akuzuar, të dënuar ose të burgosur gabimisht, është organi adekuat për trajtimin e kërkesave për kompenzim, më tej premtonte se kjo çështje do të merrej parasysht.

Më 29 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar letër Komisionit për kompensimin e personave të akuzuar, të dënuar ose të burgosur gabimisht, duke kërkuar informata lidhur me rastin e ankuesit.

Vonesat për lëshimin e autopsisë mjeksore

Më 26 janar 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka hapur një hetim ex officio lidhur me vetëvrasjen e supozuar të një burgosuri në stacionin e policisë në Mitrovicën Veriore më 25 janar 2007. Sipas informatave të mbledhura nga zyrtarët e policisë të cilët ishin duke e hetuar rastin, trupi ishte dërguar në Zyrën ligjore të UNMIK-ut për personat e pagjetur menjëherë pas konfirmimit të vdekjes së tij më 25 janar 2007, për t'u përcaktuar shkaktari i saktë i vdekjes së tij. Gjatë këtyre hetimeve, Ushtruesi i Detyrës është informuar se edhe pas gati dy muajve që trupi i pajetë ishte dërguar në Zyrën ligjore të UNMIK-ut për personat e pagjetur, autopsia mjeksore nuk kishte përfunduar ende.

Më 16 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër shefit të Zyrës ligjore të UNMIK-ut për personat e pagjetur, duke kërkuar përgatitjen e një raporti mbi autopsinë sa më shpejtë që të ishte e mundur në mënyrë që të vazhdonin hetimet e policisë dhe të zgjidhej rasti. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit poashtu ka kërkuar nga shefi i zyrës për t'ia siguruar ndonjë kopje të raportit të autopsisë sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Më 27 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga shefi i Zyrës ligjore të UNMIK-ut për personat e pagjetur në të cilën thuhej se autopsia në atë person ishte bërë në datën 15 janar 2007, kurse raporti përkatës i autopsisë ishte përfunduar brenda një muaji (muajit shkurt). Ajo më tej shtoi se, edhe pse policia që po i bënte hetimet kishte pasur njohuri për raportin, ata nuk e kishin përmbledhur raportin deri më 19 mars 2007.

Duke iu përgjigjur kërkesës së Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit për një kopje të raportit të autopsisë, shefi i zyrës në fjalë ka thënë se autopsia është bërë në bazë të urdhërit të gjykatësit dhe raporti i autopsisë i është dorëzuar vetëm gjykatësit, prokurorit kompetent dhe policisë hetuese. Ajo e ka këshilluar Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit për ta kërkuar një kopje të raportit të autopsisë drejtpërdrejtë nga gjykatësi.

Vonesë e pagesës së rrogës për një mësues të shkollës fillore në Obiliq

Më 26 mars 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Obiliqit, duke e adresuar faktin që një mësues në shkollën fillore “Pandeli Sotiri” në Obiliq, nuk kishte marrë rrogë për pesë muaj gjatë vitit 2005. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka kërkuar nga kryeshefi ekzekutiv për ta informuar lidhur me ndonjë veprim që është ndërmarrë apo që planifikohej të ndërmerret me qëllim të zgjidhjes së problemit të ankuesit.

Më 18 prill 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga kryeshefi ekzekutiv i Komunës së Obiliqit në të cilën thuhej se nuk duhet të fajësohej Drejtoria Komunale për Arsim për dështimin e dhënies së rrogave, pasi që administrata komunale së bashku me Drejtorinë për Arsim dhe Shëndet ishin të financuara nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Sipas kryeshefit ekzekutiv, Komuna nuk është e lejuar që të përfshijë punëtorët që marrin rroga nga ky buxhet në listën e rrogave pa miratimin e Ministrisë.

Më 27 prill 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar letër ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për ta informuar lidhur me rastin e ankuesit duke kërkuar nga ai, si autoriteti më i lartë në fushën e arsimit në Kosovë, për të intervenuar lidhur me këtë çështje në mënyrë që ankuesi të mund të gëzonte të drejtën e tij ligjore për të marrë rrogën sipas kontratës të punësimit për shërbyesit civil.

Më 15 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër nga inspektori kryesor i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në të cilën thuhej se çështja e sistematizimit të rrogave ka rënë nën përgjegjësitë e Ministrisë së Shërbimeve Publike dhe Kuvendit Komunal. Inspektori kryesor kishte shtuar se Drejtoria e Arsimit në Komunën e Obiliqit e ka procesuar letrën për kërkimin e pagesës së rrogës së ankuesit, dhe ka shpjeguar se shtyerja e rrogës mund të kishte ndodhur për shkak të problemeve teknike ose neglizhencës nga ana e shërbimit përkatës.

Pak kohë para përfundimit të periudhës për të cilën raportohet, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit është informuar nga ankuesi se ai ende nuk i kishte marrë rrogat e vonuara.

Lirimi nga pagimi i taksave për patundshmëri për shtëpitë e dëmtuara gjatë tërmetit në Gjilan

Më 4 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar letër ushtruesit të detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Gjilanit duke e informuar se një numër i njerëzve nga fshati Uglarë janë ankuar se janë diskriminuar nga autoritetet komunale të cilët iu kishin imponuar taksa për shtëpitë e dëmtuara rëndë gjatë tërmetit të vitit 2002. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka theksuar se përderisa disa nga pronarët e shtëpive të dëmtuara ishin urdhëruar për të paguar taksat, të tjerët janë liruar nga ky obligim. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka rekomanduar që autoritetet komunale duhet të anulojnë vendimin e tyre që t'i ngarkojnë me taksa pronarët e shtëpive të dëmtuara.

Më 23 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka marrë një përgjigje nga udhëheqësi i sektorit të taksave të patundshmërisë në Komunën e Gjilanit. Në letër thuhej se të gjithë pronarët e shtëpive që i takonin kategorisë së shtëpive të dëmtuara rëndë janë liruar nga pagesa e taksave për vitin 2003. Ai kishte shtuar se sipas ligjit të aplikueshëm, një lirim nga obligimi për të paguar taksat ka qenë i pamundur pa vlerësimin e pasurive të dëmtuara. Për më shumë në letër thuhej se kryeshefi ekzekutiv komunal kishte themeluar një komision për të vlerësuar këtë çështje, kurse procedurat ankimore ishin ende në zhvillim e sipër.

Më 2 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një letër elektronike nga ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Gjilanit në të cilën thuhej se ai e kishte shqyrtuar çështjen. Ai e ka informuar Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit se pronarët e një kategorie të caktuar të shtëpive të dëmtuara të cilët ishin ankuar kundër vendimit për detyrim të pagesës së taksave janë liruar nga pagesa e taksave për vitin 2003. Ai ka përsëritur se ligji i aplikueshëm nuk parasheh lirim nga taksat dhe se ishte formuar një komision në kuadër të Komunës për vlerësimin e shumës së taksës e cila duhet të paguhet për pasuritë e dëmtuara. Në fund të letrës së tij, ushtruesi i detyrës së kryeshefit ekzekutiv të Komunës së Gjilanit e ka falënderuar Ushtruesin e Detyrës së Ombudspersonit për bashkëpunim.

Zgjatja e procedurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit

Më 7 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në lidhje me një ankesë, për zgjatjen e procedurës në një rast ndaj ish-ndërmarrjes shoqërore "Ibër Lepenci" lidhur me procesin e zgjedhjes për pozitën e drejtorit menaxhues të ndërmarrjes.

Më 15 maj 2007, Institucioni i Ombudspersonit ka pranuar një përgjigje nga nëpunësi ndërkombëtar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet lidhur me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit në të cilën thuhej se, sipas paragrafit 14.2 të

Udhëzimit administrativ të UNMIK-ut nr. 2006/17 (UA) kryetari i trupit gjykues ia ka caktuar secilën ankesë të parashtruar Dhomës Posaçme një gjyqtari raportues. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ishte informuar se ankesa e ankuesit është shqyrtuar nga një gjyqtar raportues dhe se, duke e pasë parasysh numrin e madh të punëve të këtij gjykatësi, nuk kishte ndonjë vonesë në procesimin e ankesës së ankuesit.

Ky rast ishte ende në pritje në kohën e publikimit të këtij raporti.

Shpërndarja e revistës për fëmijë “Zog Mëngjesi” në Republikën e Maqedonisë

Më 14 maj 2007, drejtori i Hetimeve në Institucionin e Ombudspersonit i dërgoi një letër Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë në lidhje me një ankesë nga një kompani botuese kosovare që dëshironte të shpërndante revistën për fëmijë “Zog Mëngjesi” në Republikën e Maqedonisë. Nga se thuhet, kërkesa që i është dorëzuar Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës në Maqedoni ishte në pritje qysh prej 9 dhjetorit 2004, dhe ndonëse ankuesi e kishte ri-dërguar këtë kërkesë më 11 shtator 2006, Ministria kompetente në Republikën e Maqedonisë ende nuk ishte përgjigjur. Drejtori i Hetimeve kërkoi nga Ombudsmeni i Maqedonisë që të hetoj këtë çështje dhe të informoi Institucionin e Ombudspersonit për fazën në të cilën procedurat ndodhen pas kërkesës së ankuesit para Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës.

Më 24 maj 2007, Institucioni i Ombudspersonit pranoi një përgjigje nga Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë, i cili tha se ai kishte kërkuar nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës që të rishikoj rastin dhe të informoi atë për arsyet se përse nuk është përgjigjur ndaj kërkesës së ankuesit. Avokati i Popullit të Republikës së Maqedonisë po ashtu kishte kërkuar nga Ministria që të marrë parasysh këtë kërkesë dhe premtoi se do të informoi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë për hapat e tij të mëtejshëm.

Një konfiskim tjetër i automjetit nga SHPK

Më 21 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut lidhur me konfiskimin e një automjeti nga SHPK-ja në Prishtinë. Policia e kishte informuar ankuesin se automjeti i tij supozohej se ishte i regjistruar ilegalisht, kurse ky rast i është dorëzuar Shërbimit Doganor të UNMIK-ut dhe zyrës së Prokurorisë Publike në Mitrovicë për procesim të mëtejshëm. Zyrtarët e SHPK-së, gjithashtu e kishin akuzuar ankuesin për mospërputhshmëri me ligjet e aplikueshme në Kosovë duke mos i paguar taksat doganore para regjistrimit të automjetit të tij me targa të regjistrimit të Kosovës (Targa KS).

Më 7 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një përgjigje nga drejtori i Departamentit Kundër-Kontrabandë në kuadër të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut në të cilën thuhej se departamenti i tij e kishte shqyrtuar çështjen e ankuesit. Ai kishte potencuar se Departamenti Kundër-Kontrabandë ishte takuar me ankuesin në disa raste për t’i shqyrtuar mundësitë ligjore për kthimin e automjetit të ankuesit pasi që ai t’i kishte paguar taksat e importit. Drejtori i Departamentit për më shumë kishte potencuar se ankuesi i kishte dorëzuar një kërkesë zyrtare zyrës administrative të

Shërbimit Doganor të UNMIK-ut për të kërkuar që t'i kthehet automjeti pasi që ai do t'i paguante taksat. Ai poashtu kishte shtuar, se ankuesi pasi që e kishte parë automjetin e tij në objektet e Shërbimit Doganor të UNMIK-ut, gojarisht e kishte shprehur vullnetin e tij për të ndërprerë procedurat dhe e kishte falënderuar Shërbimin Doganor të UNMIK-ut për ndihmën në gjetjen e mënyrës për zgjidhjen e problemit të tij.

Më 11 qershor 2007, një përfaqësues i Institucionit të Ombudspersonit e ka informuar ankuesin lidhur me përgjigjen e pranuar nga Shërbimi Doganor i UNMIK-ut. Ankuesi mohoi kërkesën për ndërprerjen e procedurave dhe e paraqiti një kopje të kërkesës origjinale, që ia kishte dorëzuar drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Doganor të UNMIK-ut, në të cilën kërkohej kthimi i automjetit të tij pas pagesës së taksës së importit.

Më 26 qershor 2007, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit janë takuar me ankuesin dhe kanë premtuar se do të takohen edhe me përfaqësuesit e Shërbimit Doganor të UNMIK-ut me qëllim të zgjidhjes së kësaj çështjeje.

E drejta e banorëve të lagjes Mëhalla e Romëve në Mitrovicë për t'i shitur shtëpitë e tyre

Lagja Mëhalla e Romëve në pjesën jugore të Mitrovicës ishte shkatërruar në korrik të vitit 1999 gjatë intervenimit të NATO-s në Kosovë. Rindërtimi i kësaj mëhalle nuk filloi deri gjashtë vite më vonë. Deri në maj 2007, një numër i ish-banorëve u vendosën në shtëpitë dhe apartamentet e sapondërtuara sipas marrëveshjes trepalëshe nënshkruar nga secili banor, donatori dhe komuna e Mitrovicës. Këto marrëveshje trepalëshe nuk kanë përfshirë asnjë klauzolë që kufizon shitblerjen e shtëpive të rindërtuara.

Në maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit u informua që në përpjekje të një përfituesi për të shitur shtëpinë e sapo rindërtuar, përfaqësuesit e UNMIK-ut në Mitrovicë u takuan me Kryetarin e Gjykatës së Qarkut dhe me kryetarin e Gjykatës komunale në Mitrovicë për të diskutuar situatën ligjore. Duket se gjatë këtij takimi, përfaqësuesit e UNMIK-ut kërkuan këshillë ligjore se si të parandalojnë shitblerjen e shtëpive në të ardhmen në Mëhallën e Romëve. Kryetari i Gjykatës së Qarkut i kishte informuar ata se shitjet e tilla nuk mund të parandalohen sipas dispozitave ligjore ekzistuese. UNMIK-u mund të parandalojë shitjen e këtyre shtëpive duke ia bashkëngjitur një shtojcë marrëveshjes trepalëshe që do të parashihte që përfituesi i marrëveshjes nuk do të jetë në gjendje të shes shtëpinë e tij/saj përderisa nuk pajtohen edhe dy nënshkruesit tjerë për këtë. Atëherë kur kjo të ndodh, donatori dhe Komuna mund t'i adresojnë një letër gjykatave kompetente komunale duke kërkuar nga ata që ti regjistrojnë kontratat mbi shitblerjet duke përfshirë edhe shtëpitë në Mëhallën e Romëve vetëm nëse ka dëshmi që të gjitha palët nënshkruese të marrëveshjes trepalëshe janë pajtuar për këtë. Kryetari i Gjykatës së Qarkut pohoi se përderisa kjo të të hyjë në fuqi, gjykatat mund të pezullojnë regjistrimin e të gjitha kontratave mbi shitblerjet që bëjnë pjesë në këtë kategori të rasteve.

Më 22 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një letër PSSP-së duke i adresuar këto çështje. Ndërsa vërejtje se ai i kuptoi plotësisht brengat legjitime të komunitetit ndërkombëtar në lidhje me shitblerjen e shtëpive në Mëhallën e Romëve (duke pas parasysh përpjekjet dhe mjetet që janë vendos në projektin për rindërtimin e kësaj lagjeje), Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit shtoi se strategjitë e diskutuara nga UNMIK-u dhe gjykatat në Mitrovicë kishin ngritur brenga serioze. Përveç faktit që ato veprime mund të komprometojnë pavarësinë e gjykatave, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit theksoi që e drejta në pronë mund të kufizohet vetëm në disa rrethana specifike. Ai dyshoi nëse kishte ndonjë bazë ligjore për të kërkuar miratimin e palëve të treta para se të shiste një pjesë e pronës së dikujt përveç nëse një kërkesë e tillë ishte përfshirë tashmë në kontratat origjinale mbi shitblerjen. Meqë kjo nuk ishte ky rast këtu, dukej se nuk kishte arsyetim ligjor për të kufizuar të drejtën e të kthyerve për të shitur shtëpitë e tyre. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit gjithashtu gjeti se shtojca që i bashkëngjitet një kontrate tashmë të nënshkruar nuk mund të jetë pjesë e vlefshme e asaj kontrate përveç nëse vetë shtojca është nënshkruar nga të gjitha palët nënshkruese. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit sugjeroi që hartimi i shtojcave të tilla si kontrata të reja mund të jenë një mënyrë pak më e përshtatshme në parandalimin e shitjes së menjëhershme të shtëpive në Mëhallën e Romëve, dhe do të ishte më shumë duke ju përmbajtur ligjit në fuqi dhe standardeve të përgjithshme të sundimit të ligjit. Për më tepër, të kthyerit mund të binden të mos shesin shtëpitë e tyre dhe të mbesin në Kosovë sikur jetesa e tyre të jetë më e qëndrueshme. Përpjekjet dhe projektet e bashkërenduara do të siguronin një përmirësim të standardit të jetesës në Mëhallën e Romëve. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i dërgoi një kopje të letrës institucioneve tjera në Kosovë, përfshirë këtu edhe kryetarin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë.

Më 28 maj 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit pranoi një letër nga kryetari i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, në të cilën ai shpjegoi se kontaktet e lartë përmendura në mes të përfaqësuesve të komunitetit ndërkombëtar dhe gjykatave në Mitrovicë ishin pjesë e bashkëpunimit të tyre të përgjithshëm. Për më tepër, kryetari i Gjykatës së Qarkut saktësoi se marrëveshjet trepalëshe ishin mjaft të prera. Nuk kishte bazë ligjore që i lejonte gjykatat të pengonin transaksionet ligjore në lidhje me shtëpitë në Mëhallën e Romëve, dhe banorët e kësaj lagjeje kishin të drejtën të ushtronin kontroll të plotë mbi pronat e tyre ashtu siç do ta shihnin ato të përshtatshme.

Më 19 qershor 2007, përfaqësuesit e Institucionit të Ombudspersonit u takuan me përfaqësuesit komunal të UNMIK-ut në Mitrovicë, të cilët theksuan se takimet që ata i kishin me kryetarin e Gjykatës së Qarkut dhe me kryetarin e Gjykatës Komunale në Mitrovicë ishin mjaft miqësore, dhe ata thjesht i kishin pyetur gjykatësit përkatës se nëse kishte baza ligjore që mund të parandalonte shitblerjen e shtëpive në Mëhallën e Romëve. Përfaqësuesit e UNMIK-ut theksuan që ata respektonin punën dhe pavarësinë e gjykatave dhe i kishin marrë parasysh brengat e Ushtruesit të Detyrës së Ombudspersonit. Megjithatë, ata ishin të brengosur se tendenca për të shitur shtëpitë e rindërtuara në Mëhallë mund të ndikonte në ish banorët tjerë të kësaj lagjeje të cilët synonin të ktheheshin por të cilën ende nuk e kishin bërë këtë.

Dështimi për ekzekutimin e aktgjykimit të gjykatës lidhur me mos pagesën e pagës

Më 11 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit i ka dërguar një letër kryetarit të Gjykatës Komunale në Vushtrri lidhur me dështimin e zbatimit të aktgjykimit me të cilin urdhërohej Drejtoria për Arsim në Komunën e Vushtrrisë për të paguar pagën e pa-paguar të ankuesit. Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit poashtu ka kërkuar nga kryetari i Gjykatës Komunale të Vushtrrisë që ta informojë për çdo veprim që do të ndërmerret për të siguruar ekzekutimin e aktgjykimit të gjykatës.

Më 18 qershor 2007, Ushtruesi i Detyrës së Ombudspersonit ka pranuar një përgjigje nga kryetari i Gjykatës Komunale në Vushtrri në të cilën thuhej se Drejtoria Komunale për Arsim kishte kundërshtuar fillimin e procedurës së ekzekutimit si rrjedhojë e gjendjes së vështirë financiare të Drejtorisë. Sipas kryetarit të Gjykatës Komunale, gjykata ka refuzuar propozimin e Drejtorisë së Arsimit për të suspenduar procedurën e ekzekutimit, kundër së cilës Drejtoria Komunale mund t'i paraqiste ankesë Gjykatës së Qarkut brenda tetë ditësh. Nëse nuk parashtrrohet ankesë brenda kësaj periudhe, Gjykata Komunale do të lëshonte vendim për ekzekutim, duke e bllokuar xhironlogarinë bankare të Drejtorisë deri në implementimin e aktgjykimit të Gjykatës Komunale nga ana e Drejtorisë.

SHTOJCA IV: REKOMADIMET E PËRBASHKËTA NGA PJESËMARRËSIT E KONFERENCËS SË OMBUDSMANËVE TË RAJONIT (8-9 QERSHOR 2007)

- Përfaqësuesit e institucioneve të ombudsmanëve dhe të organizatave ndërkombëtare në takimin e tyre në Prishtinë diskutuan për mënyrat me të cilat institucionet e ombudsmanëve mund të bashkëpunojnë me administratën publike, mediat dhe shoqërinë civile, për realizimin e të drejtave të njeriut.
- Institucionet e ombudsmanëve do të jenë më efektive në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut nëse, në minimum, ato janë në pajtim të plotë me Parimet e Parisit.
- Pjesëmarrësit vlerësuan se keqadministrimi dhe kualiteti i dobët i personelit të administratës publike–përfshirë mungesën e trajnimit mbi të drejtat e njeriut-ka një efekt të pafavorshëm në përcjelljen e rekomandimeve të bëra nga Institucioni i Ombudsmait.
- Pjesëmarrësit gjithashtu vlerësuan se institucionet e Ombudsmanëve duhet të veprojnë të pavarura nga Parlamenti dhe të kenë marrëdhënie reciproke të fuqizimit të dyanshëm.
- Është vlerësuar se institucionet e ombudsmanëve që veprojnë në situatat e tranzicionit apo në situata pas-konfliktit, ballafaqohen me sfida unike, siç janë ngritja e vetëdijes, hetimi, këshillëdhëniet, dhe pajtimi. Ata luajnë një rol thelbësor në vendosjen e sundimit të së drejtës dhe janë në pozitë të përsosur për t'i adresuar shqetësimet për të drejtat e njeriut që kanë të bëjnë me minoritetet dhe grupet e tjera të cenueshme.
- Pjesëmarrësit vlerësuan se ka argumente për dhe kundër për të pasur një institucion të specializuar të ombudsmanit me mandat që të shqyrtoj çështjet e të drejtave të njeriut siç janë të drejtat e pakicave. Në njërin anë kjo mund të paraqesë huti në publik, kontradiktë dhe shumëfishimin të mandateve, apo mund të rezultojë me dobësimin e institucionit vendor të ombudsmanit. Në anën tjetër një institucioni të specializuar do të i mundësoheshin ekspertiza të veçanta dhe autoritet për të ngritur çështje të caktuara për të drejtat e njeriut. Në secilin rast, çdonjëri variant paraqet një mekanizëm themelor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
- Është vlerësuar se institucionet e ombudsmanëve përbëjnë një pjesë thelbësore të sistemit kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut; i cili po ashtu përfshinë një gjyqësor të pavarur, një administrim të duhur të drejtësisë, një kuvend me përfaqësues kombëtar dhe një shoqëri civile të fortë dhe dinamike. Bashkëpunimi efektiv në mes të këtyre faktorëve është i domosdoshëm në vendosjen dhe forcimin e sundimit të ligjit, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe luftimin e korrupsionit dhe mosndëshkueshmërisë.

- Institucionet e ombudsmanëve duhet të angazhohen për të shkëmbyer informata në lidhje me qasjen, përvojat dhe praktikat më të mira ndërmjet veti dhe me rrjetet ndërkombëtare dhe rajonale si dhe me partnerët ndërkombëtarë që kanë mandat të tillë.
- Është vlerësuar se institucionet e ombudmanëve në rajon funksionojnë brenda mandateve të shumëllojshme dhe burimeve të kufizuara. Rekomandimet në vijim kanë për qëllim të paraqesin aspiratat për punën e këtyre institucioneve.

A. Bashkëpunimi në mes institucioneve të ombudsmanëve dhe administratës publike

1. Me qëllim që të sigurojë funksionim të duhur të shoqërisë demokratike, administrata publike duhet të ketë marrëdhënie efikase të punës me institucionet e ombudspersonit dhe të funksionoj në shërbim të qytetarëve të vet. Administratës po ashtu duhet t'i jepet hapësirë e mjaftueshme të sqarojë situatën për të cilën i drejtohet vëmendja nga ana e institucionit të ombudspersonit.
2. Institucionet e ombudsmanëve duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në adresimin e keqadministrimit, i cili shpesh ndodhë për shkak të zbrazëtirave legjislative.
3. Institucionet e ombudsmanëve duhet t'i adresojnë keqadministrimet me anë të propozimeve për plotësime legjislative, apo përmes iniciativave për ngritjen e kapaciteteve për përmirësimin e kualitetit të punës të personelit të administratës publike.
4. Institucionet e ombudsmanëve duhet të luajnë një rol në ngritjen e kualitetit të administratës publike nëpërmes zgjidhjes individuale të ankesave, me anë të publikimit të raporteve speciale, trajnimit të administratorëve dhe me anë të kontakteve personale me administratorët.
5. Administrata publike duhet të krijoj një nivel bashkëpunimi me institucionin e ombudsmanit që në mënyrë adekuate dhe me kohë të përgjigjet ndaj rekomandimeve të bëra nga institucioni i ombudsmanit. Po ashtu, administrata publike është e obliguar që të bashkëpunojë me institucionet e ombudsmanit në sigurimin e informatave dhe lehtësimin e hetimeve.
6. Institucionet e ombudsmanëve duhet të sigurojnë angazhimin me persona, të drejtat e të cilëve janë shkelur, me anë të mbështetjes së vazhdueshme dhe aktiviteteve të ngritjes së vetëdijes.
7. Në rast se administrata publike nuk pajtohet me rekomandimet e institucionit të ombudspersonit, ky i fundit, në mënyrë të duhur dhe pas një vlerësimi të kujdesshëm, duhet të hulumtojë mënyra tjera shtesë, përfshirë mediat për të siguruar pajtueshmërinë.

B. Roli i kuvendit–partner i institucionit të Ombudsmanit?

8. Kuvendet duhet të themelojnë një kornizë të duhur legjislative për themelimin e një institucioni të ombudsmanit, në pajtim me Parimet e Parisit.
9. Kuvendet duhet të sigurojnë standardet më të larta lidhur me procesin e zgjedhjes dhe emërimit të ombudsmanit
10. Institucionet e ombudsmanit duhet të angazhohen në aktivitet e ngritjes së vetëdijes për parlamentarët mbi të drejtat ndërkombëtare të njeriut si dhe për mandatin dhe punën e institucionit të ombudsmanit.
11. Kuvendet dhe institucionet e ombudsmanit duhet të zhvillojnë marrëdhënie efektive pune me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.
12. Kuvendet duhet të sigurojnë që burimet dhe lehtësirat e duhura t'i sigurohen institucionit të ombudsmanit, që t'ia mundësojnë atij kryerjen e funksioneve në mënyrë efikase.
13. Institucioni i ombudsmanit duhet të ketë obligim statutor që t'i paraqesë kuvendit raportet vjetore si dhe raportet e posaçme në rast të ndonjë çështjeje urgjente të të drejtave të njeriut, e cila kërkon vëmendje urgjente.
14. Raportet vjetore dhe të posaçme të një institucioni të ombudsmanit duhet t'i dërgohen kuvendit, si dhe organeve të tjera shtetërore në kohë të duhur, me qëllim të ngritjes së transparencës dhe vetëdijes.
15. Raportet vjetore dhe të posaçme duhet të debatohen menjëherë në kuvend dhe përgjigja e qeverisë ndaj raporteve duhet të raportohet menjëherë në kuvend.
16. Deputetët e kuvendit duhet të ftojnë ombudsmanin të takohet me ta rregullisht për të diskutuar çështje që janë shqetësuese dhe në interes.
17. Deputetët e kuvendit duhet të sigurojnë që zgjedhësit e tyre, apo publiku i gjërë, të jenë të vetëdijshëm për punën e institucionit të ombudsmanit.
18. Deputetët e kuvendit duhet të sigurojnë që një pjesë e mandatit të institucionit të ombudsmanit është të këshillojë kuvendin në pajtueshmëri ose lidhur me cilindo legjislacion që mund të ndikojë në gëzimin e të drejtave të njeriut dhe të adresojnë rastet e keqadministrimit.
19. Institucioni i ombudsmanit, kur i lejohet me mandat, duhet ta këshillojë kuvendin mbi implikimet e të drejtave të njeriut në legjislacionit e propozuar dhe ndryshimet kushtetuese, si dhe ligjet ekzistuese dhe të rekomandojë ndonjë ndryshim të nevojshëm legjislativ.

20. Deputetët e kuvendit duhet të sigurojnë që t'u përmbahen rekomandimeve të institucionit të ombudsmanit.

C. Roli i institucionit të Ombudsmanit në situatat e pas konfliktit apo tranzicionit

21. Institucionet e ombudsmanit duhet të kenë autoritet të mjaftueshëm që të luajnë rol të rëndësishëm në reformimin dhe forcimin e institucioneve për zbatimin e ligjit përfshirë policinë dhe administratën e burgjeve dhe monitorimin dhe zbatimin e standardeve të qeverisjes së mirë.

22. Institucionet e ombudsmanit duhet të sigurojnë që administrata e drejtësisë të jetë në përputhshmëri me standardet e të drejtave të njeriut dhe të sigurojë mjete efektive, posaçërisht për pakicat dhe grupet më të cenueshme në shoqëri.

23. Institucionet e ombudsmanit janë faktor kyç në zhvillimin e strategjive të drejtësisë tranzitore e cila mund të sigurojë përgjegjësi për krimet e të kaluarës, si dhe të lehtësojë krijimin e mekanizmave efektivë të pajtimit kombëtar.

24. Institucionet e ombudsmanit luajnë rol kyç në luftimin e mosndëshkueshmërisë, adresimin e çështjeve kritike të të drejtave të njeriut, siç është tortura dhe paraburgimi arbitrar.

25. Institucionet e ombudsmanëve duhet të luajnë rol edukativ në trajnimin dhe ngritjen e vetëdijes së publikut për çështjet e të drejtave të njeriut, në mënyrë që të ngritet një kulturë e të kuptuarit të të drejtave të njeriut.

26. Institucionet e ombudsmanëve duhet të marrin parasysh hetimet e çështjeve që janë të ndërlidhura me shkaqet kryesore të konfliktetve të kaluara dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut si çështje me prioritet.

27. Institucionet e ombudsmanëve duhet të nxjerrin rekomandime për qeverinë se si të trajtohen çështjet e të drejtave të njeriut që kanë qenë shkas i konflikteve në të kaluarën.

28. Institucionet e ombudsmanit duhet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë rasteve që kanë të bëjnë me personat në institucionet psikiatrike, posaçërisht në një ambient të pas luftës.

29. Institucionet e ombudsmanit, posaçërisht ato në pajtim me Parimet e Parisit, duhet t'ua rikujtojnë qeverive të tyre pozitën e tyre unike për përmbushjen e rolit të mekanizmit parandalues, siç është paraparë në Protokolin shtesë të Konventës kundër torturës.


D. Roli i Ombudsmanit në mbrojtjen e të drejtave të pakicave dhe grupeve të tjera të cënueshme

30. Institucionet e ombudsmanit duhet të luajnë një rol të rëndësishëm në synimet e ndërmjetësimit ndërmjet të gjitha palëve në fjalë dhe në promovimin e debateve publike.
31. Institucionet e ombudsmanit kanë një rol hetues dhe përforcues përmes shqyrtimit të ankesave(përfshirë edhe ndërmjet palëve private) hetimet ex officio, dispozitave të ndihmës ligjore dhe mendimeve të ekspertëve.
32. Institucionet e ombudsmanit kanë një rol politik dhe legjislativ përmes dispozitave të komenteve dhe plotësimeve të propozuara në (draft) legjislacion, si dhe në promovimin e ratifikimit dhe zbatimit të standardeve të të drejtave të njeriut .
33. Institucionet e ombudsmanit kanë një rol arsimor dhe informues nëpërmjet fushatave për ngritjen e vetëdijes, promovimit të debatit publik, përhapjes së standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe dispozitave të trajnimeve për zyrtarët publikë.
34. Institucionet e ombudsmanit duhet gjithashtu të konsiderojnë ngritjen e vetëdijes së publikut dhe promovimin e dialogut shoqëror përmes shfrytëzimit të mediave.
35. Institucioni i ombudsmanit duhet të bashkëpunojë, aty ku është e mundur, me shoqërinë civile në aktivitete arsimore dhe të ngritjes së vetëdijësimit në organizimin e seminareve/tryezave të rrumbullakëta në çështjet e të drejtave të pakicave, dhe në pranimin e ankesave përmes OJQ-ve.

E Bashkëpunimi i mediave me ombudsmanin në luftimin e nepotizmit dhe korrupsionit

36. Institucionet e ombudsmanit duhet t'i luftojnë rastet e nepotizmit dhe korrupsionit në autoritetet publike duke u bazuar në informatat e besueshme dhe, aty ku është e duhur, të krijojnë një situatë që të drejtojnë vëmendjen e publikut të gjerë.
37. Institucionet e ombudsmanit duhet t'i kenë para sysh synimet specifike të mediave, në veçanti nevojën për të apeluar tek publiku sa më i gjërë, kur mbështeten në të si një burim i informacionit.
38. Institucionet e ombudsmanit duhet të shfrytëzojnë në mënyrë të duhur mediat për t'i dhënë më tepër peshë argumenteve të tyre kur i adresohen autoriteteve publike, ndërsa në të njëjtën kohë të sigurojnë ruajtjen e pavarësisë së tyre.

39. Institucionet e Ombudsmanit dhe mediat janë partnerë të natyrshëm që duhet ta plotësojnë njëri tjetrin dhe duhet të jenë të informuar mirë për punën e njëri tjetrit. Institucioni i ombudsmanit duhet gjithashtu të shfrytëzojë mediat në mënyrë optimale për të ngritur vetëdijen tek publiku i përgjithshëm për mandatin e tij dhe punën e tij të përditshme.




Këshilltare e Posaçme e OSBE-së për Ombudspersonin (Të drejtat e njeriut dhe çështje ligjore)

Këshilltar i Posaçëm i OSBE-së për Ombudspersonin (Çështje me publikun)

Institucioni i Ombudspersonit
Skema organizative

shtojca V: skemat Organizative e Institucionit të Ombudspersonit

Institucioni i Ombudspersonit
Nën-skema për Zyret në teren



SHTOJCA VI: LISTA E PUNONJËSVE

Punonjësit e Institucionit (më 30 qershor 2007)

Zëvendës i Ombudspersonit/ Ushtrues i Detyrës së Ombudspersonit	Hilmi Jashari
Zëvendës i Ombudspersonit	Ljubinko Todorović
Drejtor Ekzekutiv	Hanife Statovci
Drejtor i Departamentit të Hetimeve	Veton Vula
Zëvendëse e Drejtorit të Departamentit të Hetimeve për Projekte Speciale	Violeta Krasniqi-Rexha
Jurist i Lartë, Prishtinë	Avni Hasani
Juriste e Lartë, Prishtinë	Gjylbehare Murati
Juriste e Lartë, Prishtinë	Ilijana Çollaku
Kryesues i Zyrës Rajonale në Gjilan	Goroljub Pavić
Kryesuese e nën-zyrës Rajonale	Aleksandra Dimitrijević
Kryesues i Zyrës Rajonale në Mitrovicë	Naim Krasniqi
Kryesuese e Zyrës Rajonale në Pejë	Hasie Islami
Kryesues i Zyrës Rajonale në Prizren	Murlan Prizreni
Jurist, Prishtinë	Agron Kelmendi
Jurist, Prishtinë	Faton Morina
Juriste për GDF	Igballe Rrahmani
Juriste për NjBGj	Luljeta Domaniku
Juriste e Lartë për GMD	Dragana Rodić
Juriste e Lartë për GMD	Merita Syla
Jurist i Lartë, Gjilan	Isuf Sadiku
Juriste, Mitrovicë Veriore	Miljana Scekić
Juriste, Pejë	Shqipe Ibraj-Mala
Juriste, Prizren	Hunaida Pasuli
Jurist, Vidanje	Vlado Prođović
Drejtor i Administratës	Përparim Vula
Zyrtar për Informim dhe Media	Ibrahim Arslan
Përkthyes i Lartë/Zyrtar për Media	Jetmir Sefa
Zyrtare për TI dhe Prezantim në Internet	Leonora Ibraj
Zyrtar për Prokurim	Gëzim Latifi
Zyrtar i Financave	Beqir Musliu
Udhëheqës i Përkthyesve	Isak Skenderi
Përkthyes i Lartë	Rrahim Sylejmani
Përkthyes	Safete Sadrija
Përkthyes/Asistente Ligjore, Gjilan	Meliha Brestovci
Asistent Ligjor, Graçanicë	Dušan Dimitrijević
Përkthyes/Asistente Ligjore, Mitrovicë	Merita Gara
Përkthyes/Asistente Ligjore, Pejë	Aida Nela
Përkthyes/Asistent Ligjor, Prizren	Abdullah Kryeziu

Asistente Ekzekutive	Shqipe Paçarada
Asistente Ekzekutive	Arta Ibrahim
Asistent Ligjor	Labinot Sheremeti
Udhëheqës i Vozitësve	Shpëtim Reçica
Vozitës	Sami Kuqi
Vozitës	Goran Stević
Rojtar	Hakif Imeri
Rojtar	Mentor Myftari
Pastruese	Gëzime Lepaja
Pastruese, Graçanicë	Vesna Cvejić

Personat që u larguan nga Institucioni i Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet

Juriste për GDF	Thellenza Arifi
Përgjegjës për TI	Flamur Gogolli
Përkthyes i Lartë	Lirak Hamiti
Përkthyes i Lartë	Alban Stafai
Përkthyes	Marko Djekic
Asistente Ligjore	Venera Rizvanolli
Vozitës	Tamer Gas
Udhëheqës i Rojtarëve	Bekim Bunjaku
Rojtar	Muhamet Jahiri
Rojtar	Avni Osmani
Rojtar	Besim Osmani
Pastruese	Nekibe Hoxha

Këshilltarët ndërkombëtarë (më 30 qershor 2007)

Këshilltar i Posaçëm i OSBE-së për Ombudspersonin (Të Drejtat e Njeriut/Legjislacion)	Alice Thomas
Këshilltar i Posaçëm i OSBE-së për Ombudspersonin (Politikat dhe Çështjet me Publikun)	Richard Medic

Këshilltarët ndërkombëtarë që u larguan nga Institucioni i Ombudspersonit gjatë periudhës për të cilën raportohet

Këshilltare e Posaçme e OSBE-së për Ombudspersonin (Të Drejtat e Njeriut)	Antonella Ingravallo
---	----------------------

SHTOJCA VII: LISTA E SHKURTESAVE

AKP	Agjensioni Kosovar i Pronave
DÇPB	Drejtoria e KB-ve për Çështje Pronësore dhe Banesore
GDF	Grupi për të Drejtat e Fëmijëve në Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë
GMD	Grupi i Mos-diskriminimit në Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë
FKBZHG	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin e Grave
FKBF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
IRJM	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë
IPVQ	Institucionet e Përkohshme për Vetëqeverisjes
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
KFOR	Forcat e NATO-së në Kosovë
KLKBR	Komisari i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
KSZHN	Korporata Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
MKBK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
NATO	Organizata e Paktit Veri Atlantike
NJBGJ	Njësia për Barazi Gjinore në Institucionin e Ombudspersonit
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJQ	Organizata joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
PZHBV	Personat e zhvendosur brenda vendit
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
ZPSSP	Zëvendës i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm